



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR “PËR AUDITIMIN E ZBATIMIT TË
REKOMANDIMEVE, TË VITIT 2023”

RAPORT I KONSOLIDUAR I AUDITIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
TË LËNA NË AUDITIMET E VITIT 2023

Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore

Tiranë, 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqja
1	Përmbledhje ekzekutive	3
1.1	Hyrje	4-5
1.2	Objektivat	5
1.3	Qëllimi	5
1.4	Metodologjia	5
1.5	Konkluzione	5
2	Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve	5
3	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara për periudhën 2023	5 -197
3.1	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	6 – 40
3.2	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	40 – 71
3.3	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale	71 – 94
3.4	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	94 – 113
3.5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	113 – 129
3.6	Ministria e Drejtësisë	129– 141
3.7	Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”	141– 182
3.8	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror	182 - 197
3.9	Shtëpia e të moshuarve (Shkodër)	
3.10	Shtëpia e të moshuarve (Tiranë)	
4	Anekse	198-201
4.1	Rekomandimet për përmirësime/ndryshime legjislativ / Masa organizative	198
4.2	Masa shpërblim dëmi	198
4.3	Masa për eliminimin e efekteve negative (3E)	199
4.4	Shkalla e pranueshmërisë dhe zbatimit të rekomandimeve sipas llojit të masës për secilin subjekt të audituar	199-201
4.5	Masa disiplinore / Masa administrative	201

1. Përmbledhje ekzekutive

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, të evaduara gjatë vitit 2023, në zbatim të Programit të Auditimit me Nr. 880/1 Prot., datë 02.07.2024 në institucionet:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Drejtësisë
- Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror
- Shtëpia e të moshuarve (Shkodër)
- Shtëpia e të moshuarve (Tiranë)

ka rezultuar si në vijim:

Sa i përket zbatimit të afateve për kthim përgjigje pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit konstatohet se,

Mbi respektimin e afateve të raportimit:

- 6 subjekte e kanë respektuar afatin prej 20 ditë: MEPJ, MSHMS, MTM, MBZHR, MD, QSUNT për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”,
- 2 subjekte: MEPJ, DPSHSSH nuk kanë respektuar afatin 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve dhe nuk kanë hartuar programin (Plan veprimi), veprime të cilat janë në kundërshtim me nenin 15 shkronja (j) të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”;
- Shtëpia e të Moshuarve, Tirane, Shtëpia e të Moshuarve Shkodër janë të përfshira tek materiali i DPSHSSH

b. Lidhur me detyrimin e institucioneve për të raportuar në KLSH mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor konstatohet se:

- 4 subjekte (Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”), kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor në zbatim të Ligjit Nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” të nenit 30, pika 2;
- 4 subjekte (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror / Shtëpia e të Moshuarve Shkodër / Shtëpia e të Moshuarve Tiranë) nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor në kundërshtim të Ligjit Nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” të nenit 30, pika 2.

Niveli i realizimit të masave sipas llojit të tyre, paraqitet si më poshtë:

Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi: Janë lënë 9 masa të cilat janë pranuar nga subjektet respektive MIE, MEPJ, QSUNT, DPSSH, nga të cilat: 2- zbatuar ose 15.4/%, 4- proces zbatimi, 3-pa zbatuar.

Masa organizative: Nga 323 masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht 320 rekomandime ose 99 % dhe 3 rekomandime nuk janë pranuar ose 1 %.

-Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 84 rekomandime; janë zbatuar pjesërisht 29 rekomandime, janë në proces zbatimi 102 rekomandime , si dhe 105 rekomandime rezultojnë të pa zbatuara.

Masa shpërblim dëmi: Nga 19 masa të rekomanduara në vlerën 278,475 mijë lekë, janë pranuar plotësisht 19 rekomandime ose 100 % e tyre.

-Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 4 rekomandime me vlerën 162,594 mijë lekë; të zbatuara pjesërisht janë 5 rekomandime me vlerën 66,648 mijë lekë; në proces zbatimi 5 rekomandime, me vlerën 24,722 mijë lekë si dhe 5 rekomandime rezultojnë të pa zbatuara me vlerën 24,511 mijë lekë.

Masa me efekt negativ financiar (3E) “Të ardhura të munguara”: Nga 24 masa të rekomanduara në vlerën 369,497 mijë lekë, janë pranuar plotësisht 24 rekomandime ose 100 % e tyre.

-Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 2 rekomandime në vlerën 72,419 mijë lekë, janë në proces zbatimi 14 rekomandime në vlerën 104,082 mijë lekë dhe rezultojnë pa zbatuar 8 rekomandime në vlerën 192,986 mijë lekë.

Të ardhura të munguara: Nga 2 masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht 2 rekomandime ose 100 %.

- Nga masat e pranuar 2 rekomandime ose 100 % e tyre janë zbatuar pjesërisht.

Masa administrative/ Nga 2 masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht 2 rekomandime ose 100 %.

- Nga masat e pranuar 2 rekomandime në vlerën 1,032,139 lekë rezultojnë të zbatuara plotësisht.

Njoftim APP: Nga 3 masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht 3 rekomandime ose 100 %. - Nga masat e pranuar 3 rekomandime e tyre janë zbatuar plotësisht.

Masa disiplinore: Nga 111 masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht 111 rekomandime ose 100 %.

-Nga masat e pranuar 69 rekomandime ose 62 % e tyre janë zbatuar plotësisht, 1 rekomandim është pjesërisht i zbatuar, 29 rekomandime janë në proces zbatimi dhe 12 rekomandime, janë pazbatuar.

Njoftim DAP /Njoftim KMSHC: Nga 4 masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht 4 rekomandime ose 100 %.

- Nga masat e pranuar 4 rekomandime ose 100 % e tyre janë zbatuar plotësisht.

1.1 Hyrje

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditori Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme në subjektet e lartpërmendur mbështetur në programet respektive të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me objekt: *“Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e gjashtë mujorit të dytë të vitit 2023”*, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”* dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrit elektronik institucional.

Auditimi u krye nga:

1. M.N, (përgjegjës grupi),
2. E.K, anëtarë
3. L.L, anëtarë
4. S.Z, anëtarë
5. N.M, anëtarë

Auditimi ka filluar më, 03.07.2024.

Auditimi ka përfunduar më, 18.07.2024.

1.2 Objektivat

1. Hartimi i programit (Planit të veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ.
4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik.
5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe economicitet.
6. Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative.
7. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

1.3 Qëllimi

Vlerësimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna, nga auditimet e mëparshme, koherencës së tyre dhe përgjegjshmërisë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

1.4 Metodologjia

Duke pasur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit dhe dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, u auditua niveli i zbatimit të secilit rekomandim në subjektet e përzgjedhura, vlerësuar sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë fazës së kryerjes së auditimit në terren.

1.5 Konkluzione

Për çështjet e shqyrtuara janë zhvilluar ballafaqime gjatë fazës së auditimit në terren dhe në përfundim të tij janë mbajtur akt verifikime për çdo subjekt të audituar, mbi rezultat e të cilit është përgatitur ky Raport Auditimi.

2. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve u konstatua se, shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezulton në nivel të konsiderueshëm, konkretisht nga 497 masa të rekomanduara gjithsej, janë pranuar 494 masa ose 99%, si dhe nuk janë pranuar 3 masa ose 1%.

-Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezulton:

Zbatuar plotësisht 170 rekomandime ose 34 %, zbatuar pjesërisht 37 rekomandime ose 7%, në proces zbatimi 158 rekomandime ose 32 %, si dhe rezultojnë 129 rekomandime të pa zbatuara ose 27 %.

3. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara gjatë vitit 2023.

Të analizuara dhe të detajuara sipas çdo subjekti dhe sipas llojit të masave të rekomanduara, niveli i zbatimit të tyre paraqitet si vijon:

3.1 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3.3.1 PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim tematik në **Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë** “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023”, për periudhën objekt auditimi 01.08.2018 deri në 31.12.2021, përcjellë me shkresën Nr.808/62 Prot. datë 19.09.2022, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2022, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve;

ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit nr. 880/1, datë 02.07.2024 me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në vitin 2023”, si dhe referuar ndarjes së detyrave (Dokumentit 5) me përbërje të grupit si vijon:

1. L.L përgjegjëse grupi
2. N.M anëtar

Auditimi ka filluar më 03.07.2024

Auditimi ka përfunduar më 18.07.2024

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën Nr. 808/62 Prot. datë 19.09.2022, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLuzioni:

Nga verifikimi i dokumentacionit kryer prej grupit të auditimit të KLSH-së rezulton se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **1** Masë për përmirësim legjislativ dhe **1** rekomandim të pranuar plotësisht, të cilat kanë statusin e ecursë së zbatimit si vijon, **1** Zbatuar.

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **31** Masa organizative nga ku **34** rekomandime, **34** të pranuar plotësisht, të cilat kanë statusin e ecursë së zbatimit si vijon, **20** zbatuar, **3** në proces, **5** pjesërisht të zbatuara dhe **6** pa zbatuar.

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **2** Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe në menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike nga ku **2** rekomandime janë pranuar 2 e cilat kanë statusin e ecursë së zbatimit si vijon, **1** Zbatuar, **1** i pazbatuar.

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **1** Masë për shpërblyerje të demit në shumën 155,695,418 lekë, **1** rekomandim, i pranuar plotësisht dhe i zbatuar.

-Për përmirësimin e gjendjes është lënë **1** Masë disiplinore, nga ku **1** rekomandim i përgjithshëm për të gjitha masat disiplinore, e cila rezulton e pranuar në dokumentin e planit të masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga Titullari Urdhrit Nr.200 datë 14.10.2022 me Nr.286/71 Prot datë 14.10.2022 dhe në proces.

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE:

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezulton në nivel 100%, konkretisht nga **39** rekomandime gjithsej, janë pranuar **39** rekomandime.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht rezultoi në masën **~59%**, niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara pjesërisht në masën **~13 %** dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara në proces zbatimi rezultoi **~10 %**, niveli i rekomandimeve pa zbatuara rezultoi **18 %**, nivele këto të cilat tregojnë vlerësimin e këtij procesi në lidhje me ndjekjen e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM:

Nga auditimi i ushtruar në **Ministrinë e Infstrukturës dhe Energjisë** për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për periudhën nga data 01.01.2020 deri në 31.12.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me Vendimin e Kryetarit të KLSH Nr.152, datë 08.09.2023, përcjellë. me shkresën Nr.249/14 Prot., datë 11.09.2023, rezultoi si më poshtë vijon:

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**, ka kthyer përgjigje në KLSH, Urdhrit Nr.200 datë 14.10.2022 me Nr.286/71 Prot datë 14.10.2022, brenda afatit ligjor.

Sa më sipër rezulton, se është zbatuar afati **20 ditor** për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga ana e subjektit të audituar lidhur me raportimin mbi zbatimin të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara sipas strukturave përgjegjëse, subjekti nuk ka raportuar në KLSH brenda afatit **6 muajsh** të raportimit, ***në mospërputhje me*** Ligjin Nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30 pika 2 e tij.

Sa më sipër rezulton, se nuk është zbatuar afati **6 muajsh** për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III/3. Realizimi i rekomandimeve të lëna, si pas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, rezulton si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:

1.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me ASHSH duhet të ngrënë një grup pune për hartimin dhe propozimin e ndryshimeve dhe përditësimeve të nevojshme të akteve nënligjore me qëllim optimizimin e mënyrës së përcaktimit të masës së vlerësimit të shpronësimit dhe rregullimin e problematikave të konstatuara në procesin e shpronësimit.

Brenda vitit 2022

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar Urdhrit Nr.227, datë 7.6.2021, Shkresës përcjellëse datë 14.04.2023 për incimin e projektvendimit “Për disa ndryshime në Vendimin 138 datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, si dhe mendimet e ministrave të linjës. si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

B. MASA ORGANIZATIVE:

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MIE, çdo raportim periodik të realizimit të buxhetit duhet ta shoqërojë me shpjegimet përkatëse, lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, si dhe të relatohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin.

Në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se: Referuar Raporteve 4 mujore të monitorimit të buxhetit për vitin 2022 dhe vitin 2023, Raportit vjetor i monitorimit të buxhetit për vitin 2022 dhe 2023 dhe Shkësës Nr.2411 datë 29.02.2024 të vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

1.2 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MIE, gjatë hartimit të raporteve të monitorimit dhe raportimit periodik të detyrimeve të prapambetura të institucionit, të argumentohet se si ato janë krijuar si dhe masat që parashikohet të merren për likuidimin e tyre.

Në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se: Subjekti ka vendosur në dispozicion dokumentacionin si më poshtë:

Shkresë Nr.4748 Prot. Datë 31.05.2023 Dërgohet PBA Faza Strategjike

Shkresë Nr.6202/2 Prot. Datë 22.09.2023 Dërgohet PBA Faza Teknike

Raportet 4 mujore të monitorimit të buxhetit për vitin 2022 dhe vitin 2023

Raporti vjetor i monitorimit të buxhetit për vitin 2022 dhe 2023

Shkresë Nr.7567 Prot. Datë 26.09.2023 Kërkesë për fonde buxhetore shtesë

Raportimet periodike të monitorimit të detyrimeve

Shkresa Nr.2709 datë 10.03.2023

Shkresa Nr.7008/10 datë 03.10.2023

Shkresa Nr.4820 datë 01.06.2023

Akti Normativ nr. 3.datë 12.03.2022

1.Ministria e Financave me shkresën nr.4934/3 datë 17.03.2022 ka përcjellë Detajimin e ndryshimeve sipas Aktit Normativ Nr. 3 datë 12.03.2022.

- MIE me shkresën nr.2495/1 date 18.03.2022 ka dërguar në MFE pakësimin e fondeve në investime për programin buxhetor Transporti Rrugor.

- MIE me shkresën nr.2495/2 datë 18.03.2022 ka dërguar në MFE detajimin e ndryshimeve sipas Aktit Normativ nr.3 date 12.03.2022 për shpenzimet korrente.

-MFE me shkresën nr.4934/51 datë 29.03.2022 ka dërguar në MIE shkresën mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.3 date 12.03.22 për shpenzimet korrente.

-MFE me shkresën nr.4934/118 datë 05.04.2022 ka dërguar në MIE shkresën mbi zbatimin e Aktit Normativ Nr.3 datë 12.03.22 për investimet.

Akti Normativ Nr. 12 datë 29.07.2022

2.Ministria e Financave me shkresën nr.14405/5 datë 03.08.2022 ka përcjellë Detajimin e ndryshimeve sipas Aktit Normativ Nr. 12 datë 29.07.2022.

-MIE me shkresën nr.5967/2 datë 23.08.2022 ka dërguar në MFE detajimin pjesor të ndryshimeve buxhetore për shpenzimet korrente në zbatim të Aktit Normativ nr.12 datë 29.07.2022 për shpenzimet korrente.

-MFE me shkresën nr.14405/109 datë 29.08.2022 ka dërguar shkresën në MIE mbi zbatimin e pjesshëm të Aktit Normativ nr.12 datë 29.08.2022 për shpenzimet korrente.

Akti Normativ Nr. 17 datë 01.12.2022

3. Ministria e Financave me shkresën Nr.22351 datë 05.12.2022 ka sjell Detajimin e ndryshimeve sipas Aktit Normativ nr. 17.datë 01.12.2022 për shpenzimet korrente dhe kapitale.

-MIE me shkresën nr.9345/1 datë 13.12.2022 ka dërguar në MFE detajimin pjesor të ndryshimeve buxhetore për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe me financim të huaj në zbatim të Aktit Normativ nr.17 datë 01.12.2022.

-MIE me shkresën nr.9345 datë 07.12.2022 ka dërguar në MFE detajimin pjesor për shpenzimet korrente në Burimet Natyrore dhe Transporti Ajror.

-MFE me shkresën nr.22351/111 datë 21.12.2022 ka dërguar shkresën në MIE mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.17 datë 01.12.2022 detajim pjesor.

-MFE me shkresën nr.22351/53 datë 14.12.2022 ka dërguar shkresën në MIE mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.17 datë 01.12.2022 detajim pjesor të shpenzimeve korrente.

Akti Normativ Nr. 19 datë 29.12.2022

4.Ministria e Financave me shkresën nr.24043/4 datë 30.12.2022 ka përcjellë Detajimin e ndryshimeve sipas Aktit Normativ nr. 19.datë 29.12.2022 për shpenzimet korrente dhe kapitale.

-MFE me shkresën nr.24043/16 datë 30.12.2022 ka dërguar shkresën në MIE mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.19 datë 29.12.2022 për miratimin e detajimit pjesor në programin Transporti Rrugor.

Akti Normativ Nr. 5 datë 18.10.2023

5.Ministria e Financave me shkresën nr.19139/2 datë 24.10.2023 ka përcjellë Detajimin e ndryshimeve sipas Aktit Normativ nr. 5 datë 18.10.2023.

-MIE me shkresën nr.8402/7 datë 30.10.2023 ka dërguar në MFE detajimin e ndryshimeve buxhetore për shpenzimet korrente në zbatim të Aktit Normativ nr.5 datë 18.10.2023.

-MIE me shkresën nr.8402/8 datë 30.10.2023 ka dërguar në MFE detajimin e ndryshimeve buxhetore për shpenzimet kapitale në zbatim të Aktit Normativ nr.5 datë 18.10.2023.

-MFE me shkresën nr.19139/78 datë 09.11.2023 ka dërguar shkresën në MIE mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.5 datë 18.10.2023 për shpenzime korrente.

-MFE me shkresën nr.19136/46 datë 02.11.2023 ka dërguar shkresën në MIE mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.5 datë 18.10.2023 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj.

Akti Normativ Nr. 6 datë 14.12.2023

6.Ministria e Financave me shkresën nr.22656/4 datë 18.12.2022 ka përcjellë Detajimin e ndryshimeve sipas Aktit Normativ nr. 6 datë 14.12.2023

-MIE me shkresën nr.9854/17 datë 26.12.2023 ka dërguar në MFE detajimin ndryshimeve buxhetore për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj në zbatim të Aktit Normativ nr.6 datë 14.12.2023

-MFE me shkresën nr.22656/75 datë 28.12.2023 ka dërguar shkresën në MIE mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.6 date 14.12.2023.

Bazuar në dokumentacionin e mësipërm si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masa për zbatimin e rekomandimi por masat nuk janë të plota për cdo njësi të cilës i adresohen. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

2.1 Rekomandim: Nga ana e Sektorit të Prokurimeve, Komisioni i Blerjeve të Vogla, të marrë masat në vijimësi, që në çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël, të realizojë inventarizimin e dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, duke bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik fitues, sipas kriterëve të përcaktuara në ftesën për ofertë, me qëllim krijimin e gjurmës së auditimit si dhe shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentacionit.

Në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se: Referuar fletëve të inventarit të vendosura në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e subjektit mbi optimizimin e procedurës, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

3.1 Rekomandim: Të merren masa nga titullari i institucionit, që menjëherë pas dërgimit të ftesës për pjesëmarrje në takime/evente jashtë vendit, të përgatitet dokumentacioni ligjor në kohë optimale duke respektuar afatet për qarkullimin e shkresave administrative, në mënyrë që blerja e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me sistem dinamik blerje të kryhet jo në datë të përafërt (apo brenda ditës) me datën e nisjes.

Në vijimësi

Institucioni ka observuar duke sjellë dokumentacion mbështetës:

Dokumentacioni mbështetës

Kopje të autorizimeve dhe të urdhrave të prokurimit si dhe ftesat e organizatorëve (bashkëlidhur).

Urdhër prokurimi nr.4, datë 24.01.2023, si dhe dokumentacioni bashkëlidhur

Urdhër prokurimi nr. 5, datë 26.01.2023, si dhe dokumentacioni bashkëlidhur

Urdhër prokurimi nr. 6, datë 27.01.2023, si dhe dokumentacioni bashkëlidhur

Urdhër prokurimi nr.13, datë 10.03.2023, si dhe dokumentacioni bashkëlidhur

Urdhër prokurimi nr.27, datë 05.07.2023, si dhe dokumentacioni bashkëlidhur

Nga verifikimi u kostatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

4.1 Rekomandim: MIE të marrë masat e një planifikimi/programimi sa më real dhe kredibël të buxhetit, me qëllim shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se: Subjekti vendosi në dispozicion dokumentacionin e mëposhtëm:

Raportet 4 mujore të monitorimit të buxhetit për vitin 2022 dhe vitin 2023

Raporti vjetor i monitorimit të buxhetit për vitin 2022 dhe 2023

Raportimet periodike të monitorimit të detyrimeve

Shkresë Nr.7567 Prot. Datë 26.09.2023 Kërkesë për fonde buxhetore shtesë

Shkresë Nr.4748 Prot. Datë 31.05.2023 Dërgohet PBA Faza Strategjike

Shkresë Nr.6202/2 Prot. Datë 22.09.2023 Dërgohet PBA Faza Teknike

rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

5.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa në vijimësi, që për detyrimet e krijuara të bëjë veprimin kontabël në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, me qëllim paraqitjen e drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të institucionit.

Në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se: Referuar pasqyrave financiare të viteve ushtrimore 2021,2022,2023 të vendosura në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e subjektit për rregullimin e pasqyrimit të zërave në pasqyrat financiare, rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

6.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të marri masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve.

- Sektori i Financës të marri masa për kreditimin e llogarisë 214 ‘*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*’ dhe llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” në vlerën e konstatuar për jashtë përdorimi dhe debitimin përkatësisht të llogarisë 219 “*Amortizimi i akumuluar i aktiveve afatgjata*” dhe të llogarisë 24 “*Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara*”.

Menjëherë

Nga verifikimi u kostatua se: Referuar pasqyrës financiare të vitit 2021 të vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e subjektit për rregullimin e pasqyrimit të zërave në pasqyrat financiare rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. -Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

7.1 Rekomandimi: Sektori i financës të marri masat, që përpara se të bëjë reflektimin e pakësimit ose të shtesës së aktiveve në kontabilitet nga lëvizjet kapitale pa pagesë brenda apo jashtë sistemit, të disponojë të gjithë dokumentacionin përkatës të kalimit kapital të aktiveve hyrëse ose dalëse, me qëllim mbylljen e ciklit të transferimit si dhe verifikimin e reflektimit në kontabilitet të tyre.

- Sektori i financës të marrë masa të menjëhershme për regjistrimin e automjetit me targën AA.E të dhuruar nga “*Zyra Gjermane për Bashkëpunimin Ndërkombëtar “GTZ”*”, në vlerën prej 3,189,063.46 lekë duke debituar llogarinë 215 “*Mjete transporti*”.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se: Referuar pasqyrës financiare të vitit 2021 të vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e subjektit për rregullimin e pasqyrimit të zërit në pasqyrën financiare të vitit 2021 rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

8.1 Rekomandimi: Sektori i financës të marrë masa të menjëhershme për sistemimin e vlerave të investimeve të cilat kanë përfunduar, duke bërë veprimin kontabël, kreditimin e Llogaris 230 “Për Aktive Afatgjata jo materiale” dhe 231 “Për Aktive Afatgjata materiale” në debi të llogarive 21 “Aktivet Afatgjata”, nëse këto aktive janë në pronësi të MIE-apo kalimin kapital të këtyre vlerave në pronësi të institucioneve, për llogari të të cilave janë realizuar këto investime.

Menjëherë

Nga verifikimi u kostatua se: Referuar pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2021 të vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

9.1 Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues i MIE-së duhet të ngrejë një komision me ekspertë të fushave, për artikujt, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të këtyre aktiveve, ku pas këtij shqyrtimi të bëhet rivlerësimi i vlerës së tyre. Mbi bazën e aktit të rivlerësimit, institucioni të realizojë regjistrimet e vlerës së tyre në kontabilitet.

Menjëherë

Institucioni ka observuar me të njëjtin koment si në akt verifikim, observacioni nuk pranohet duke qënë se në moszbatim të rekomandimit nuk është ngritur komisioni i ekspertëve të fushës.

Nga verifikimi u kostatua se: Referuar pasqyrave financiare të viteve ushtrimor 2022 dhe 2023 vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë nuk marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

10.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë të fondit neto, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Menjëherë

Nga verifikimi u kostatua se: Referuar pasqyrave financiare të viteve ushtrimore 2021 dhe 2022 të vendosura në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

11.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë i argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Subjekti ka vendosur në dispozicion dokumentacionin e mëposhtëm:

-Procesverbal datë 29.08.2023 për procedurën “Shërbim Konsulence për Shërbime inxhinierike të pavarura për zbatimin e kontratës koncesionare për aksin Thumanë Kashar”

Procesverbal datë 30.09.2022 “për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën blerje pajisje zyre”.

Procesverbal datë 11.04.2024 “për miratimin e dokumentave të tenderit me objekt “Shërbime inxhinierike të pavarura për zbatimin e kontratës koncesionare të Portit të Integruar në Triport

Vlorë Procesverbal datë 15.09.2022 Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike për procedurën instalim i qarkullimit të ajrit në magazinën e godinësRegjistër i parashikimit të prokurimeve publike viti 2024Regjistër i parashikimit të prokurimeve publike viti 2024 i

ndryshuar.Regjistër i parashikimit të prokurimeve publike viti 2023Regjistër i parashikimit të prokurimeve publike viti 2023 i ndryshuar Regjistër i parashikimit të prokurimeve publike viti 2023Regjistër i parashikimit të prokurimeve publike viti 2023 i ndryshuar

rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit.Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

12.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësim të marrin masa për plotësimin me dokumentacionin e nevojshëm të praktikave të shpronësimit, ndjekjen dhe zbatimin e procedurave që rregullojnë procesin e shpronësimit.

Në vijimësi

Institucioni ka observuar si më poshtë, duke sjellë dokumentacionin mbështetës:

Ky rekomandim është zbatuar në vijimësi nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin.

Gjithashtu, përsa i përket protokollimit të procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, do të merren masat e nevojshme për zbatimin me përpikmëri të rekomandimit të lënë nga KLSH.

Dokumentacioni mbështetës

Memo nr.789,prot., datë 02.10.2023 dorëzimi i dosjes së inventarizuar për procedurën e shpronësimit për projektin “Zgjerimi i varrezave publike Elbasan” .

Urdhri nr.148, datë 16.07.2024 “Për protokollimin e proces verbaleve të pambajtura nga komisioni i posaçëm për shpronësimin”.

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

12.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësim të marrin masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim inventarizimin dhe

arkivimin e të gjitha dosjeve të procedurave të shpronësimit, në zbatim të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë

Institucioni ka observuar si më poshtë, duke sjellë dokumentacionin mbështetës:

Lidhur me komentin tuaj se, ky rekomandim konsiderohet i papranuar, në fakt ky rekomandim është i pranuar nga MIE, referojuni pikës 2.14 të urdhrit nr.200, datë 14.10.2022 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit për Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”,

Lidhur me këtë rekomandim, MIE dhe ASHSH kanë marrë masa për plotësimin dhe inventarizimin e dokumentacionit të praktikave të shpronësimit dhe ky proces kryhet në vijimësi.

Pas depozitimit të kërkesës për shpronësim nga ana e subjektit kërkues ndiqen hapat e protokollimit të dokumentacionit në librin e protokollit, ngritja e Komisionit të Posacëm të Shpronësimit deri në finalizimin e procesit duke u protokolluar çdo korrespondencë e mbajtur institucionalisht, në përputhje me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë. Pas finalizimit të VKM-së përkatëse, nëpërmjet memo-s informuese sekretaria teknike, depoziton dosjen e projekteve të shpronësimit për interes publik në arkivin e ASHSH-së.

Për sa më sipër Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (në vijim DPA), pas asistencës metodologjike në sekretari – arkivin e ASHSH-së, me shkresën nr.6831/1 prot., datë 07.07.2022 sugjeroi ndjekjen dhe zbatimin e masave:

-Të krijohen kushtet teknike dhe teknologjike të ruajtjes dhe sigurisë fizike të dokumentave, ambjenti i arkivit të jetë me rafte metalike, dyert dhe dritaret të jenë të siguruara. Të krijohet mundësia për të pasur një ambjent vetëm për arkiv, jo bashkë me zyrën e proktokollit.

Në vijim të këtij sugjerimi ASHSH me anë të të shkresës nr.570/2 prot., datë 18.07.2022, i është drejtuar institucionit qendror, MIE për vendosjen në dispozicion të ambjenteve të përshtatshme për arkivim. Pas komunikimit shkresor MIE sqaron se e ka të pamundur vendosjen në dispozicion të hapësirave të tjera shtesë dhe se mbetet detyrë e përgjegjësi e ASHSH të riorganizojë hapësirën aktuale të vënë në dispozicion. Ndodhur në këto kushte, ASHSH realizoi procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje mobiljesh për zyra” dhe në ambjentin e arkivit u vendosën rafte metalike konform legjislacionit në fuqi. Po ashtu, u ble një sasi e konsiderueshme e dosjeve për ruajtjen e dokumentacionit, i cili u vendos në raftet metalike, në të cilën dokumentacioni është i ndarë sipas viteve 2021-2024, sipas strukturës administrative të institucionit. Dyert dhe dritaret janë të sigurta, dritaret janë të pajisura më qepena dhe punonjësi i arkivit tregon kujdes të veçantë për çdo hyrje – dalje në zyrë. Pranë ASHSH-së është depozituar shkresa nga DPA me nr.119/2 prot., datë 30.01.2023 me lëndë “Kërkesë për informacion”, me anë të së cilës ASHSH dërgoi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave specifikimet teknike, kërkesat sasiore dhe fondin limit për kutitë për ruajtjen e përhershme. ASHSH është në pritje të realizimit të procedurës së prokurimit nga ana e DPA, për marrjen në dorëzim të dosjeve. Në këtë moment i gjithë dokumentacioni RHK do të depozitohet në kutitë për ruajtjen e përhershme sipas formatit të përcaktuar nga

DPA. Në përputhje me ligjin nr.9154/2003 “Për arkivat” si dhe “Normës Teknike Profesionale dhe Metodologjike të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, Drejtoria e Financës dhe Burimeve Mbështetëse ka realizuar çdo vit, nga 2021, që shënon krijimin e institucionit deri në 2024 detyrat e parashikuara në ligjin e sipërcituar: pasqyrat emërtuese të çeljes së dosjeve, urdhri për ngritjen e komisionit të ekspertizës, lista konkrete me afatet e ruajtjes, urdhri për njëhësimin e dokumentit administrativ, certifikimi i regjistrave të protokollit janë përpiluar nga themelimi i institucionit në vitin 2021 deri në vitin 2024.

Procesi i arkivimit realizohet në zbatim të legjislacionit në fuqi, pavarësisht pamundësisë fizike të hapësirave në institucion dhe faktit që arkivi është bashkë me zyrën e protokollit.

Dokumentacioni mbështetës

-Urdhri nr.200, datë 14.10.2022 i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit për Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”,

-Procesverbal projekti “Disa shtesa dhe ndryshime ne VKM nr. 326, datë 30.03.2016 “Për shpronësimin për interes publik të pronatëve të pasurive, pronë private që preken nga zbatimi i projektit “Ndertim, Rikonstruksion dhe Rinovim i Unazes se Vogël “, datë 17.11.2022;

-Inventar për dosjen e shpronësimit për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i Qendres se Qytetit Koplik”, date 27.05.2021;

-Flete inventari i dosjes kerkesa per shpronesim për pasuritë e paluajtshme, pronë private që preken nga projekti “Për një ndryshim ne vendimin nr. 378, datë 26.04.2017 të Këshillit të

-Ministrave për shpronësim për interes publik, te pronareve te pasurive te paluajtshme që preken nga projekti i rikualifikimit urban i bllokut te kufizuar nga rruga Sulejman Delvina...”, datë 15.09.2023;

-Inventar për dosjen e shpronësimit: Rikonstruksion dhe zgjerim i rrugës “Muzak Topia”- Segmenti nga rrethrotullimi te ish-rezervat e shtetit deri te kisha e “Shën Ilias”, Berat, viti 2019.

-Shkresa nr.6831/1 prot., datë 07.07.2022 nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

-Shkresa nr. 570/2 prot., datë 18.07.2022 e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

-Shkresa nga DPA me nr.119/2 prot., datë 30.01.2023 me lëndë “Kërkesë për informacion.

Nga verifikimi u kostatua se: Në listën e dokumentacionit mbështetës mungon ”Procesverbali i projektit “Disa shtesa dhe ndryshime ne VKM nr. 326, datë 30.03.2016 “Për shpronësimin për interes publik të pronatëve të pasurive, pronë private që preken nga zbatimi i projektit “Ndertim, Rikonstruksion dhe Rinovim i Unazes se Vogël “, datë 17.11.2022” Për sa më sipër trajtuar dhe për mosngritjen e grupit të punës, ky rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

13.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësim të marrin masa që në Akt-Marrëveshjet e lidhura midis ASHSH dhe subjektit kërkues të shpronësimit, të vendoset një pikë e veçantë të “*Detyrimet e subjektit kërkues*” që e detyron subjektin kërkues të dërgojë informacion periodik pranë ASHSH mbi situacionin e likuidimeve dhe, në rast të mos likuidimit, të specifikohet shkaku që e ka sjellë rast pas rasti,

me qëllim që të bëhet e mundur ndjekja e këtij procesi nga ana e ASHSH nga fillimi e deri në fund, në realizim edhe të qëllimit fillestar të krijimit të kësaj agjencie.

Menjëherë dhe në vijimësi

Institucioni ka observuar si më poshtë, duke sjellë dokumentacionin mbështetës:

Ky rekomandim është zbatuar në vijimësi nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin.

Dokumentacioni mbështetës

Modele të marrëveshjeve të lidhura midis ASHSH dhe subjektit kërkues të shpronësimit si vijon:

-Aktmarrëveshje e datës 06.02.2023 me nr.protokolli në ASHSH 2024/2, dhe nr.protokolli në Bashkinë Elbasan nr.1383

-Aktmarrëveshje e datës 05.06.2024 me nr.protokolli në ASHSH 730/4, dhe nr.protokolli në Bashkinë Përmet nr.1129/1, datë 10.06.2024

Nga verifikimi u kostatua se: Për sa më sipër trajtuar, ky rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

14.1 Rekomandimi: Komisionet e Vlerësimit të Aplikimeve të marrin masa mbi vlerësimin e drejtë të aftësive teknike, financiare dhe ekonomike, të stafit të aftë dhe kompetent, me qëllim garantimin e vijimit të procedurave për subjekte që japin garanci, referuar kërkesave ligjore, se mund të kryejnë me sukses operimin në tregun e ndërtimit të impianteve të prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, si dhe të kryejnë aktivitetin e tyre brenda afateve të parashikuara, me qëllim evitimin e tejzgjatjes së procedurave.

Në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion: Praktika shkresore Nr.6849/1 Prot., datë 05.10.2024 Praktika shkresore Nr.9067/1 Prot.datë 07.12.2024, Praktika shkresore Nr.7911/3 Prot. datë 23.11.2024 , si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë pjesërisht masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

15.1 Rekomandimi: Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficencën e Energjisë të marrë masa për kryerjen brenda afateve dhe dokumentimin e vlerësimit të plotësisë apo mangësive të aplikimeve.

Në vijimësi

Institucioni ka observuar si më poshtë, duke sjellë dokumentacionin mbështetës:

Në vijim të rekomandimit, Sektori i Programeve të Zhvillimit për Burimet e Rinovueshme dhe Eficencën Energjetike, ka marrë masa për zbatimin me korrektësi të afateve të përcaktuar në VKM 822/2015. Lidhur me dokumentimin e procesit, çdo praktike shoqërohet me memo në rastin e një vlerësimi pozitiv nga Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve si dhe me memo në rast të refuzimit të kërkesës, ku eprori i ngarkuar me detyrë, informohet mbi procedurën. Në vijim të rekomandimit Nr. 15.1, ju vëmë në dijeni se, Sektori i Programeve të Zhvillimit për Burimet e Rinovueshme dhe Eficencën Energjetike, pjesë e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficencën e Energjisë, në Drejtorinë e Përgjithshme e

Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, në strukturën organizative është i përberë nga një përgjegjës sektori dhe 4 specialist. Ky sektor të punësuar ka 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialist. Pranë departamentit të administratës publike janë shpallur 2 vendet vakante, dhe pritet të përfundojnë procedurat administrative. Mungesa e stafit ka shkaktuar vonesa në trajtimin e kërkesave duke tejkaluar afatet.

Dokumentacioni mbështetës

-Praktikat e plota sipas procedurave administrative të përcaktuara në VKM Nr. 822, datë 7.10.2015 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni*”, e ndryshuar:

-Shkresa Nr. 6849/1 Prot., date 05.10.2022, lënda: “Njoftim”, nga Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficencën e Energjisë drejtuar Bashkimit të

Përkohshëm të Shoqërive “H, E” sh.p.k., “I.” sh.p.k. dhe “L. D. S” sh.p.k.

-Raport Vlerësimi Nr. 6849/2 Prot., date 02.11.2022 i Komisionit të Vlerësimit të aplikimit për pajisje me miratim paraprak “*Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 25 Më, dhe veprave ndihmese, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 1991, Fshati Jagodinë, Njësia Administrative Shirgjan, Bashkia Elbasan, Qarku Elbasan*” nga Bashkimi i Përkohshëm të Shoqërive “H.E” sh.p.k., “I.” sh.p.k. dhe “L.D.S” sh.p.k.

-Miratim Paraprak për vazhdimin e procedurave Nr. 6849/3 Prot., datë 02.11.2022 “*Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 25 Më, dhe veprave ndihmese, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 1991, Fshati Jagodinë, Njësia Administrative Shirgjan, Bashkia Elbasan, Qarku Elbasan*”.

-Shkresa Nr. 6849/4 Prot., date 02/11/2022, lënda: “Njoftim”, nga Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficencën e Energjisë drejtuar Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive “H. E” sh.p.k., “I” sh.p.k. dhe “L.D.S” sh.p.k.

-Shkresa Nr. 9067/1 Prot., datë 07.12.2022, lënda: “Njoftim”, nga Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficencën e Energjisë drejtuar Shoqërisë “5.” sh.p.k.

-Raport Vlerësimi Nr. 657 Prot., datë 18.01.2023 i Komisionit të Vlerësimit të aplikimit për pajisje me miratim paraprak “*Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 10 Më, dhe veprave ndihmese, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 1020, Fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnje, Qarku Fier*” nga Shoqëria “5” sh.p.k.

-Miratim Paraprak për vazhdimin e procedurave Nr. 657/1 Prot., date 18.01.2023 “*Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 10 Më, dhe veprave ndihmese, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 1020, Fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnje, Qarku Fier*”.

-Shkresa Nr. 657/2 Prot., date 18.01.2023, lënda: “Njoftim”, nga Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficencën e Energjisë drejtuar Shoqërisë “5” sh.p.k.

-Shkresa Nr. 1736/1 Prot., date 07.03.2022, lënda: “Kthim përgjigje”, nga Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficencën e Energjisë drejtuar Shoqërisë “G.S .B” sh.p.k.

-Raport Vlerësimi Nr. 1736/2 Prot., date 08.04.2022 i Komisionit të Vlerësimit të aplikimit për pajisje me miratim paraprak *“Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 100 MË, dhe veprave ndihmese, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 1090, Njesia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakaster, Qarku Fier”* nga Shoqëria “G.S. P.B” sh.p.k.

-Miratim Paraprak për vazhdimin e procedurave Nr. 1736/3 Prot., date 08.04.2022 *“Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 100 MË, dhe veprave ndihmese, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 1090, Njesia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakaster, Qarku Fier.*

-Shkresa Nr. 1736/4 Prot., date 08.04.2022, lënda: *“Njoftim”*, nga Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficencën e Energjisë drejtuar Shoqërisë “G. S.P. B” sh.p.k.

-Shkresa Nr. 2201/1 Prot., date 04.04.2024, lënda: *“Kërkesë për plotësim dokumentacioni”*, nga Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficencën e Energjisë drejtuar Shoqërisë “G.A” sh.p.k.

-Shkresa Nr. 2201/3 Prot., date 25.04.2024, lënda: *“Njoftim”*, nga Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficencën e Energjisë drejtuar Shoqërisë “G. A” sh.p.k.

-Raport Vlerësimi Nr. 2201/4 Prot., date 14.06.2024 i Komisionit të Vlerësimit të aplikimit për pajisje me miratim paraprak *“Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 10 MW, dhe veprave ndihmese, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Zonën Sheq Marinas, Njesia Administrative Topoje, Bashkia Fier, Qarku Fier”* nga Shoqëria “G. A sh.p.k.

-Miratim Paraprak për vazhdimin e procedurave Nr. 2201/5 Prot., date 14.06.2024 *“Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 10 MË, dhe veprave ndihmese, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Zonën Sheq Marinas, Njesia Administrative Topoje, Bashkia Fier, Qarku Fier”.*

-Shkresa Nr. 2201/6 Prot., date 14.06.2024, lënda: *“Njoftim”*, nga Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficencën e Energjisë drejtuar Shoqërisë “G. A” sh.p.k.

-Shkresa Nr. 7911/1 Prot., date 10.11.2022, lënda: *“Kërkesë për plotësim dokumentacioni”*, nga Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficencën e Energjisë drejtuar Shoqërisë “F.” sh.p.k.

-Shkresa Nr. 7911/3 Prot., date 23.11.2022, lënda: *“Njoftim”*, nga Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficencën e Energjisë drejtuar Shoqërisë “F.” sh.p.k.

-Raport Vlerësimi Nr. 56 Prot., date 04.01.2023 i Komisionit të Vlerësimit të aplikimit për pajisje me miratim paraprak *“Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 93 MW, dhe veprave ndihmese, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr..., Bashkia Libohove, Qarku Gjirokastër”* nga Shoqëria “F.” sh.p.k.

-Miratim Paraprak për vazhdimin e procedurave Nr. 56/1 Prot., date 08.03.2023 *“Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 93 MW, dhe veprave ndihmese, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. . Bashkia Libohove, Qarku Gjirokastër.*

Nga verifikimi u kostatua se: -Për sa më sipër trajtuar, ky rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe i zbatuar plotësisht.

16.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrë masa mbi dhënien e miratimeve për ndërtim vetëm pas vlerësimit të Komisioneve të Vlerësimit të Aplikimit.

Në vijimësi

Institucioni ka observuar si më poshtë, duke sjellë dokumentacionin mbështetës:

-Praktikat e plota sipas procedurave administrative të përcaktuara në VKM Nr. 822, datë 7.10.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, e ndryshuar:

-Raport Vlerësimi Nr. 6849/2 Prot., date 02.11.2022 i Komisionit të Vlerësimit të aplikimit për pajisje me miratim paraprak “Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 25 MË, dhe veprave ndihmese, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 1991, Fshati Jagodinë, Njësia Administrative Shirqjan, Bashkia Elbasan, Qarku Elbasan” nga Bashkimi i Përkohshëm të Shoqërive “H. E.” sh.p.k., “I.” sh.p.k. dhe “L. D. S” sh.p.k.

-Raport Vlerësimi Nr. 657 Prot., datë 18.01.2023 i Komisionit të Vlerësimit të aplikimit për pajisje me miratim paraprak “Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 10 MW, dhe veprave ndihmese, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 1020, Fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnje, Qarku Fier” nga Shoqëria “S” sh.p.k.

-Raport Vlerësimi Nr. 1736/2 Prot., date 08.04.2022 i Komisionit të Vlerësimit të aplikimit për pajisje me miratim paraprak “Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 100 MË, dhe veprave ndihmese, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 1090, Njesia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakaster, Qarku Fier” nga Shoqëria “G. S. P.B” sh.p.k.

-Raport Vlerësimi Nr. 2201/4 Prot., date 14.06.2024 i Komisionit të Vlerësimit të aplikimit për pajisje me miratim paraprak “Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 10 MË, dhe veprave ndihmese, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Zonën Sheq Marinas, Njesia Administrative Topoje, Bashkia Fier, Qarku Fier” nga Shoqëria “G. A” sh.p.k.

-Raport Vlerësimi Nr. 56 Prot., date 04.01.2023 i Komisionit të Vlerësimit të aplikimit për pajisje me miratim paraprak “Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 93 MW, dhe veprave ndihmese, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 2444, Bashkia Libohove, Qarku Gjirokastër” nga Shoqëria “F.” sh.p.k

Nga verifikimi u kostatua se: Për sa më sipër trajtuar, ky rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe i zbatuar plotësisht.

17.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrë masa mbi ndjekjen e rasteve të transferimit të së drejtës për ndërtim, me qëllim minimizimin e riskut të mospërfundimit të punimeve nga ana e mbajtësit të së drejtës për ndërtim.

Në vijimësi

Institucioni ka observuar si më poshtë:

Në vijim të rekomandimit Nr. 17.1 ju vëmë në dijeni se, nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, nga periudha e auditimit deri më sot nuk është bërë asnjë transferim i miratimit për ndërtimin e impianteve fotovoltaike/eolike.

Në rast se do të paraqitet një kërkesë e tillë pranë institucionit, ne do të zbatojmë rekomandimin e lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe do të zbatohet legjislacioni i sektorit në fuqi i cili përcakton se çdo kërkesë për transferim të së drejtës për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni bëhet në përputhje me përcaktimet ligjore të V.K.M. Nr. 822 datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, e ndryshuar.

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

18.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrë masa mbi ngritjen e një grupi pune për inventarizimin dhe arkivimin e të gjithë procedurave të dhënies së miratimit paraprak e përfundimtar për ndërtimin e impianteve të prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, duke dokumentuar të gjithë procesin në rend kronologjik, sikurse kërkohet nga normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në RSH.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Subjekti ka vendosur në dispozicion dokumentacionin si më poshtë: -Shkresa Nr. 02/05 Prot., datë 02.05.2024 “” -Shkresa Nr. 29/8 Prot., datë 29.08.2023 “ Shkresa Nr. 17/1 Prot., datë 17.01.2023 “ -Shkresa Nr. 16/9 Prot., datë 16.09.2022 “ -Shkresa Nr. 25/11 Prot., datë 25.11.2022 “ -Shkresa Nr. 10/11 Prot., datë 10.11.2022 “

Nga ntë cilat rezulton se janë marrë pjesërisht masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

18.2 Rekomandimi: Titullari i MIE të marrë masa mbi krijimin e procedurës së dokumentimit, arkivimit dhe ruajtjes së informacionit, duke bërë pjesë të detyrave funksionale të njësisë përgjegjëse, jo vetëm ndjekjen nga fillimi deri në fund të procesit të dhënies së miratimit paraprak e përfundimtar, por edhe arkivimin e dosjeve me qëllim ruajtjen e informacionit.

Brenda vitit 2022

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar Urdhrin nr. 571, datë 11.07.2018 “Për disa rregulla të përgjithshme për disiplinimin e trajtimit të korespondencës shkresore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë” rezulton se janë marrë masa e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

19.1 Rekomandimi: Grupet e punës për identifikimin e zonave të marrin masa në vijimësi për vlerësimin e të gjitha risqeve të ndërtimit të projekteve. Me qëllim që të evitohen konfliktet e mundshme, si dhe të garantohet përfundimi me sukses i projekteve.

Në vijimësi

Institucioni ka observuar si më poshtë:

Në zbatim të urdhrin nr. 200, datë 14.10.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nga viti 2022 deri më sot, nuk ka kryer asnjë procedurë tjetër për zhvillimin e projekteve fotovoltaike me vendndodhje të përcaktuar.

Në vijimësi, në rast zhvillimi të këtyre procedurave nga Grupet e punës do të merren të gjitha masat për vlerësimin e të gjitha risqeve të ndërtimit të projekteve, dhe do të zbatohen rekomandimet e dhëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Nga verifikimi u konstatua se: Observacioni **nuk pranohet** duke qënë se nuk ka sjellë asnjë fakt apo dokumentacion mbështetës. Rekomandimi është për fazën e identifikimit të zonave për projekte të mundshme, jo domosdoshmërisht për zhvillimin e projekteve. Për sa më sipër në mungesë të dokumentacionit mbështetës, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

20.1. Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, para çdo kontrate që do të lidhë me shoqëritë koncesionare gjatë realizimit të procedurave konkurruese për dhënien me koncesion për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike hidrike, duhet të bëjë identifikimin e koncesionit të mundshëm të projektit të koncesionit, shoqëruar me analizën e rentabilitetit dhe përshtatshmërisë financiare.

Në vijimësi

Institucioni ka observuar si më poshtë, duke sjellë dhe dokumentacion mbështetës:

Ky rekomandim është zbatuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise e cila ndër të tjera për identifikimin e koncesionit të mundshëm të projektit të koncesionit përfshirë analizën e rentabilitetit dhe përshtatshmërisë financiare të tij, ka propozuar ndryshimin e Ligjit nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar. Nëpërmjet këtij propozimi janë kërkuar ndryshimet si vijon:

-Në nenin nenit 17, shkronja “d” ndryshohet si më poshtë vijon:

“d) operatorët ekonomikë nëpërmjet propozimeve të pakërkuara vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve në: porte, aeroporte, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, me përjashtim të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nga burimet hidrike;”

Në nenin 25, pika “1” ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Autoriteti kontraktues autorizohet të shqyrtojë dhe të pranojë propozimet e pakërkuara vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve në: porte, aeroporte, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike me përjashtim të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nga burimet

hidrike, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë nen, me kusht që këto propozime të mos kenë të bëjnë me një projekt, për të cilin procedurat e përzgjedhjes kanë nisur apo janë shpallur.”

Propozimi jone u perfshi ne ligjin 28/2024 per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar.

Dokumentacioni mbështetës

-Shkresa nr. 1083/1 prot. date 28.2.2024 kthim pergjigje shkresës Kryeministritë nr.552/1Prot., datë 29.01.2024 mbi dhënien e mendimit për projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar
-Ligji nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” i ndryshuar.

Nga verifikimi u konstatua se -Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

21.1. Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Njësia e Prokurimit në procedurat e koncesioneve PPP që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter kualifikues të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, në mënyrë që të stimulohet konkurrenca.

Në vijimësi

Insitucioni ka observuar si më poshtë:

Ky rekomandim është zbatuar në vijimësi për procedurat koncesionare të zhvilluara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi dhe më konkretisht, për procedurat për segmentet rrugore Milot – Thumanë, Kashar – Pezë – Lekaj dhe Lekaj – Konjat – Fier, pjesë e Korridorit Blu, njoftimet e Dokumentave të Procedurës Konkurruese për të cilat janë publikuar në muajin gusht 2022, ndërkohë që raporti përfundimtar i auditimit të përputhshmërisë është i muajit shtator 2022. Prej muajit shtator 2022 e në vijim, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka shpallur asnjë procedurë tjetër të koncesioneve PPP.

Dokumentacioni mbështetës

-Dokumentat e Procedurës Konkurruese për dhënien me koncesion/PPP për projektimin, financimin, operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe transferimin e segmentit rrugor Milot – Thumanë;

-Dokumentat e Procedurës Konkurruese për dhënien me koncesion/PPP për projektimin, financimin, operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe transferimin e segmentit rrugor Kashar – Pezë – Lekaj;

-Dokumentat e Procedurës Konkurruese për dhënien me koncesion/PPP për projektimin, financimin, operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe transferimin e segmentit rrugor Lekaj – Konjat – Fier.

Sqarojmë se Dokumentat e Procedurës Konkurruese publikohen pranë sistemit elektronik të APP në formën dhe përmbajtjen të cilat i janë vënë në dispozicion grupit të audituesve. Më poshtë po paraqesim linkun e njoftimit të kontratës së shpallur <https://www.app.gov.al/njoftimi-i-kontrat%C3%ABs-s%C3%AB-shpallur/> si dhe screenshot

përkatës:

The screenshot shows the official website of the Agency for Public Procurement (AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK). The page is titled 'Njoftimi i kontratës së shpallur' (Notice of the awarded contract). It features a search bar at the top right and navigation tabs on the left. The main content area displays a list of tender announcements. Each announcement includes the object of the tender, the contracting authority, the date of publication, the date of the award, the reference number, the fund limit, and the status of the tender. The announcements are listed in a table format with columns for each of these details.

Nga verifikimi u kostatua se Për sa trajtuar më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

22.1. Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të marrë masat e nevojshme për të siguruar monitorimin në vijimësi nga NJZP, si dhe të bashkëpunojë me koncesionarin për përsheptimin e përfundimit të punimeve rehabilituese, me qëllimin realizimin në kohë sa më të afërt të treguesve të performancës dhe vënien në eficiencë të plotë të pasurisë publike të dhënë me koncesion.

Menjëherë dhe në vijimësi

Institucioni ka observuar si më poshtë duke sjellë dhe dokumentacion mbështetës:

NjZP ka siguruar monitorimin në vijimësi për kontratën në fjalë si dhe Autoriteti Kontraktor gjatë gjithë kësaj kohe, ka bashkëpunuar me institucione të tjera shtetërore dhe jo vetëm, në kuadër të masave për zgjidhjen e problematikave të ndryshme të hasura gjatë veprimtarisë së koncesionarit me qëllim vijimin normalisht të veprimtarisë së tij. Gjithashtu është vijuar me përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të lidhura me pagesën e tarifës koncesionare.

Dokumentacioni mbështetës

Për sa më sipër, po rendisim një sërë shkresash që tregojnë këto veprime të AK.

- Shkresa nr. 6823/1 prot. datë 14.11.2022 drejtuar shoqërisë koncesionare mbi lëshimin e faturës për arkëtim referuar tarifës koncesionare për vitin 2021;
- Shkresa nr. 1565/1 prot. datë 06.03.2023 drejtuar shoqërisë koncesionare mbi lëshimin e faturës për arkëtim referuar tarifës koncesionare për vitin 2022;
- Shkresa nr. 2124/1 prot. datë 23.04.2024 drejtuar shoqërisë koncesionare mbi lëshimin e faturës për arkëtim referuar tarifës koncesionare për vitin 2023;
- Shkresa nr. 6551/2 prot. datë 25.10.2023 drejtuar Bashkisë Vlorë “Kërkesë për ndërhyrje”;
- Shkresa nr. 3831/1 prot. datë 25.10.2023 drejtuar Bashkisë Vlorë “Kërkesë e përsëritur për vlerësimin e situatës së sinjalistikës rrugore të kalimeve në nivel të administruara nga Bashkia Vlorë;

-Shkresa nr. 4447/1 prot. datë 29.05.2024 drejtuar Bashkisë Vlorë “Kërkesë e përsëritur për ndërhyrje”;

-Shkresa nr. 6019/1 prot. datë 01.12.2022 drejtuar një sërë institucioneve si “Kërkesë e përsëritur për mbylljen e intersektimeve rrugore të paligjshme në linjën hekurrudhore Fier-Vlorë.

-Shkresa nr. 1564/1 prot. datë 17.03.2023 drejtuar një sërë institucioneve si Kërkesë e përsëritur për mbylljen e intersektimeve rrugore te paligjshme ne linjën hekurrudhore Fier – Vlorë.

-Shkresa nr. 1338/1 prot. date 19.05.2024 drejtuar një sërë institucioneve si Kërkesë e përsëritur për mbylljen e intersektimeve rrugore te paligjshme ne linjën hekurrudhore Fier – Vlorë

-Shkresa nr. 1208 prot. datë 5.02.2024 drejtuar Shoqërisë Koncesionare per marrjen ne konsideratë të sugjerimeve të përcjella nga Hekurrudha sh.a. dhe Inxhinieri i Pavarur.

-Shkresa nr. 2726/1 prot. date 30.10.2023 drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë “Kërkesë”.

Nga verifikimi u konstatua se Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

23.1. Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të shqyrtojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar nga mungesa e monitorimit në vijimësi nga NJZP, si dhe të marrë masat për ndërprerjen e kontratës koncesionare për mosplotësimin e detyrimeve të përcaktuara në kontratën koncesionare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Institucioni ka observuar si më poshtë duke sjellë dhe dokumenatcionin mbështetës:

NJZP e ngritur në datën 21.09.2016 me urdhrin nr.4836, ka pushuar së ekzistuari një vit më vonë për shkak të largimit të shumicës së anëtarëve të saj si e keni vënë dhe ju në dukje duke cituar datat e largimit të tyre ne *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 89-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*. Kjo NJZP është shpërbërë de facto dhe de juro që në vitin 2017 pasi ka humbur 5 nga shtatë anëtarët e saj.

Me urdhrin nr.451, datë 15.12.2021 të Ministrit të MIE u ngrit grupi i punës “Për verifikimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktore të Kontratës së Koncesionit me Nr. 2184/7, datë 10.06.2016 Për dhënien me koncesion të formës BOT (Ndërtim, shfrytëzim dhe transferim në pronësi të shtetit) të Portit të Jahteve Shëngjin.

Nga grupi i punës u konstatua se në terren deri në datën 12.01.2022 nuk është bërë asnjë veprim për ndërtimin e objektit të këtij koncesioni.

Duke qenë se edhe pas 6 vitesh nga lidhja e këtij koncesioni nuk ishin përmbushur detyrimet kontraktuale për ndërtimin e objektit, Grupi rekomandoi:

-Fillimin e hapave procedurale për mospërmbushje të detyrimeve kontraktore të parashikuara në dispozitat e kontratës.

-Në rast të dështimit të palës në mospërmbushje për të ndrequr situatën brenda afateve të përcaktuara në kontratë, atëherë AK ka të drejtën e fillimit të procedurave për zgjidhjen e kontratës sipas parashikimeve të nenit 21 “Zgjidhja e kontratës”.

Dokumentacioni mbështetës

- Urdhri nr.451, datë 15.12.2021 “Për verifikimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktore të Kontratës së Koncesionit me Nr.2184/7, datë 10.06.2016 Për dhënien me koncesion të formës BOT (Ndërtim, shfrytëzim dhe transferim në pronësi të shtetit) të Portit të Jahteve Shëngjin;
- Raport i grupit të punës, datë 14.01.2022;
- Urdhri nr.110, datë 02.06.2022 “Për një ndryshim në urdhrin nr.4536, datë 21.09.2016”;
- Shkresa nr.5376, datë 08.07.2022 e MIE;
- Shkresa nr.5376/1, datë 15.09.2022 e MIE;
- Relacion i NJZP ngritur me urdhrin nr.110, datë 02.06.2022;
- Shkresa nr.3093/1, datë 16.04.2024 e Ministrisë së Financave.

Nga verifikimi u konstatua se Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

24.1. Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të shqyrtojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar nga mos marrja e masave për rregullimin e konstatimeve nga monitorimi i zbatimit të kontratave koncesionare dhe mos vendosjen e sanksioneve sipas detyrimeve të parashikuara në kontratat përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Subjekti ka vendosur në dispozicion dokumentacionin e mëposhtëm:

Referuar Raportit të tremujorit të I-të dhe të II-të të vitit 2020, dërguar në MIE me shkresën Nr. 3243/1 Prot., datë 20.09.2021 “Dorëzim i Raporteve të Monitorimit të tremujorit të parë dhe të dytë të vitit 2020 në vijim të shkresës tuaj Nr. 6488 Prot datë 02.09.2021”, protokolluar në MIE me Nr. 6488/1 Prot., datë 20.09.2021, dhe raportit të III-të dhe të IV-rt të vitit 2020 të AKBN-së dërguar në MIE me shkresën Nr. 4641/1 Prot., datë 30.12.2021 “Dorëzim i Raporteve të Monitorimit të tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit 2020”, protokolluar në MIE me Nr. 9438 Prot., datë 30.12.2021, Autoriteti Kontraktues njoftuar shoqëritë koncesionare për mospërmbushje detyrimesh dhe aplikim penalitetit si më poshtë:

- Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 6488/2 Prot., datë 10.12.2021 “Mbi përmbushjen e detyrimeve kontraktuale”.
- Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 1088 Prot., datë 02.02.2022 “Njoftim për plotësim detyrimi kontraktual”.
- Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 1091 Prot., datë 02.02.2022 “Njoftim për plotësim detyrimi kontraktual”.
- Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 1090 Prot., datë 02.02.2022 “Njoftim për plotësim detyrimi kontraktual”.
- Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 1092 Prot., datë 02.02.2022 “Njoftim për plotësim detyrimi kontraktual”.
- Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 1082 Prot., datë 02.02.2022 “Njoftim për plotësim detyrimi kontraktual”.
- Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 1089 Prot., datë 02.02.2022 “Njoftim për plotësim detyrimi kontraktual”.
- Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 1086 Prot., datë 02.02.2022 “Njoftim për plotësim detyrimi kontraktual”.

- [illegible]

- Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 1418 Prot., datë 10.02.2022 “Njoftim për plotësim detyrimi kontraktual”.
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 2581 Prot., datë 23.03.2022 “Njoftim për plotësim detyrimi kontraktual”.
 - Aplikim penaliteti për shkelje të afatit të ndërtimit të HEC Arsti me Nr. 806/2 Prot., datë 23.08.2023.
 - Aplikim penaliteti për vonesa në fillimin e punimeve të ndërtimit të HEC Radovë me Nr. 4539 Prot., datë 24.05.2023.
 - Aplikim penaliteti për vonesa në fillimin e punimeve të ndërtimit të HEC “Backa Staravecka” me Nr. 808 Prot., datë 20.01.2023.
 - Aplikim penaliteti për shkelje të afatit të ndërtimit të HEC Picar 1 me Nr. 804 Prot., datë 20.01.2023.
 - Aplikim penaliteti për shkelje të afatit të ndërtimit të HEC-eve Gurshpat 1 dhe Gur Shpat 2 me Nr. 826/1 Prot., datë 23.02.2023.
 - Aplikim penaliteti për vonesa në fillimin e punimeve të ndërtimit të HEC “Zerec 1, 2” me Nr. 794 Prot., datë 20.01.2023.
 - Aplikim penaliteti për mosparaqitje në kohë të projektit të zbatimit të HEC-eve të “Lusës” me Nr. 1398 Prot., datë 10.02.2022.
- Gjithashtu, në vijim të shkresës së AKBN me Nr. 4612/1 Prot., datë 04.11.2022 “Dorëzim i raporteve të monitorimit të tremujorit të parë dhe të dytë të vitit 2022”, protokolluar në MIE me Nr. 8500 Prot., datë 07.11.2022, Autoritet Kontraktues i është drejtuar shoqërive koncesionare, lidhur me marrjen e masave për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale dhe plotësimin e dokumentacionit të munguar, dhe për dijeni AKBN-së i më poshtë:
- Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5593 Prot., datë 03.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5595 Prot., datë 03.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5596 Prot., datë 03.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5600 Prot., datë 03.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5597 Prot., datë 03.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5594 Prot., datë 03.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5603 Prot., datë 03.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5590 Prot., datë 03.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5592 Prot., datë 03.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5589 Prot., datë 03.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5588 Prot., datë 03.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5587 Prot., datë 03.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5602 Prot., datë 03.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5591 Prot., datë 03.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5601 Prot., datë 03.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5751 Prot., datë 06.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5757 Prot., datë 06.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5758 Prot., datë 06.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5756 Prot., datë 06.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5753 Prot., datë 06.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5754 Prot., datë 06.07.2023
 - Shkresë e Autoritetit Kontraktues Nr. 5752 Prot., datë 06.07.2023

Rezulton se nga subjekti janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

25.1. Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të shqyrtojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar nga mos marrja e masave për rregullimin e konstatimeve nga monitorimi i zbatimit të kontratave koncesionare dhe mos vendosjen e sanksioneve sipas detyrimeve të parashikuara në kontratat përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

26.1. Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria përkatëse, të shqyrtojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar nga mangësitë e dokumentacionit në dosjet e operatorëve ekonomikë aplikues për ndërtimin e burimeve të reja të energjisë elektrike, HEC-ve, si dhe të respektojë afatet dhe të vlerësojë me përpikmëri aplikimet e subjekteve

Menjëherë dhe në vijimësi

Institucioni ka observuar si më poshtë duke sjellë dhe dokumentacionin mbështetës:

Dokumentacioni mbështetës

Janë inventarizuar dhe janë dorëzuar pranë sektorit të Arkiv – Protokollit dosjet për dhënien e miratimit për ndërtimin e hidrocentraleve:

Arcova; Blineta; Bukaniku; Dohoshisht dhe Dohoshisht 1, 2, 3; Gastra; Gomsiqe dhe Gomsiqe e Epërme; Bjeshkës; Hekal; Kamican Kothpula; Kotorri; Kulota; Mazreka; Nica; Olben; Qam; Rrukaj; Zgallo 1,2.

Nga verifikimi u kostatua se Në observacionet e ardhura nuk është dokumentacioni i plotë i cituar si më sipër. Observimi që ka bërë institucioni nuk qëndron brenda kuadrit të rekomandimit të KLSH, si i tillë nuk pranohet dhe për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

27.1. Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria përkatëse të shqyrtojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar nga mos marrja e masave për rregullimin e konstatimeve nga monitorimi i zbatimit të kontratave dhe mos vendosjen e sanksioneve sipas detyrimeve të parashikuara në kontratat përkatëse me operatorët ekonomikë përfitues të miratimit përfundimtar për ndërtimin e burimeve të reja të energjisë elektrike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se : Subjekti ka vendsorur në dispozicion dokumentacionin si më poshtë:

Shkresa nr. 4359/4 date 14.11.2022 Shkresa nr. 4344/5 date 18.11.2022 Shkresa nr. 145 date 11.01.2023 Shkresa nr. 4347/4 date 25.10.2022, Shkresa nr. 4345/4 date 25.10.2022, Shkresa nr. 4349/5 date 18.11.2022, Shkresa nr. 4352/4 date 25.10.2022, Shkresa nr. 4361/4 date 25.10.2022 Shkresa nr. 4362/1 date 05.10.2022 Shkresa nr. 4357/1 date 05.10.2022 Shkresa nr. 5195/1 date 06.10.2022 Shkresa nr. 4344/4 date 14.11.2022 Shkresa nr. 4356/1 date 06.10.2022 Shkresa nr. 4355/6 date 30.12.2022 Shkresa nr. 250 date 11.01.2023 Shkresa nr.

4360/4 date 27.12.2022 Shkresa nr. 4348/1 date 18.11.2022, Shkresa nr. 4354/3 date 06.10.2022, nga të cilat rezulton se nga subjekti janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces**.

28.1. Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria përkatëse të shqyrtojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar nga mos marrja e masave për rregullimin e konstatimeve nga monitorimi i zbatimit të kontratave të HEC-ve dhe mos vendosjen e sanksioneve sipas detyrimeve të parashikuara në kontratat përkatëse me operatorët ekonomikë përfitues të miratimit përfundimtar për ndërtimin e burimeve të reja të energjisë elektrike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces**.

29.1.Rekomandimi: MIE, Komisioni i Vlerësimit të Aplikimit në zbatim të VKM nr. 822, datë 07.10.2015 të shqyrtojë plotësinë dhe saktësinë e të gjitha dokumenteve të paraqitura nga aplikuesi dhe ti paraqesë raportin ministrit, i cili nëse arrin në përfundimin se të gjitha dokumentet e paraqitura nga aplikuesi, sipas këtyre rregullave, janë të plota e të sakta, të miratojë ndërtimin e hidrocentralit sipas kërkesave të nenit 22.

Menjëherë

Institucioni ka observuar duke sjellë dokumentacionin mbështetës

Fletëthirrja nr.6485 Akti nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, protokolluar në MIE me nr.1786/1, datë 08.07.2024.

Nga verifikimi u kostatua se Në observacionet e ardhura nuk është dokumentacioni i plotë, i cituar si më sipër. Në kushtet kur palët për adresimin e situatës janë në proces gjyqësor, pritet zgjidhja që do japi gjykata dhe në këtë rast rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces**.

30.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e institucionit mëmë të Agjencisë Shtetërore për Shpronësim, të nisë një korrespondencë me Ministrinë e Drejtësisë, në cilësinë e institucionit mëmë të Agjencisë së Trajtimit të Pronave, për të përcaktuar se subjekt i cilit prej trajtimeve është rasti në fjalë, me qëllim evitimin e proceseve të mundshme gjyqësore që mund të iniciohen.

Brenda vitit 2022

Institucioni ka observuar më të njëjtën përgjigje si citohet në Akt –Verifikim për subjektin MIE .

Nga verifikimi u kostatua se Në mungesë të fakteve të reja dhe dokumentacionit mbështetës, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

31.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me AKBN, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin në terren të veprimtarisë së subjektit, sa i përket pjesëve të ankesës që i referohen MIE-s dhe institucioneve të varësisë së saj, si dhe të bëjë me dije ankuesin mbi rezultatet e verifikimit.

Brenda vitit 2022

Nga verifikimi u kostatua se Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masa për zbatimin e rekomandimi por masat nuk janë të plota për cdo njësi të cilës i adresohen. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e rritjes së shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën **155,695,418** lekë me TVSH dhe të ndiqen të gjitha procedurat administrative, me qëllim mos likuidimin e diferencës së shpenzimeve të rimbursueshme ndaj sipërmarrësi, për shkak të keq llogaritjeve të vlerës së shërbimit të mbikëqyrjes, nga grupi i hartimit të fondit limit.

Menjëherë

Nga verifikimi u kostatua se Subjekti ka vendosur në dispozicion dokumentacionin e mëposhtëm:

Shkresa Nr.286/72 datë 24.10.2022 Dërgohet Urdhri për zbatim të rekomandimeve të KLSH, Urdhër Nr.200 datë 14.10.2022, Shkresë Nr.8537 datë 08.11.2022 Kërkokesë për rakordimin e vlerës së kontratës sipas rekomandimeve të KLSH, Shkresë Nr.377 datë 11.11.2022 Kërkesë nga BOE Gj. shpk dhe G. shpk, Shkresë Nr.24/11 datë 21.11.2022 Vendosje dokumenti në dispozicion për BOE, Shkresë 13/12 13.12.2022 Kthim Përgjigje, Shkresë 8537 28.12.2022 Kthim Përgjigje, Urdhër Shpenzimi Nr.195 datë 15.05.2024, Akt Konstatimi Nr.1285/6 datë 10.05.2021 për njohjen e detyrimit ndaj BOE Gj. shpk dhe G. shpk Nga i cili rezulton se nga subjekti janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Subjekti ka kryer korrektimin e shumës së rimbursueshme ndaj sipërmarrësit, duke zbritur vlerën e evidentuar në rekomandim dhe duke bërë rillogaritje të kësteve sipas vlerës së mbetur nga momenti i lënies së rekomandimit me diferencën e evidentuar në rekomandim. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

D. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1 Rekomandimi: Titullari i MIE të shqyrtojë vlerën 44,498 mijë lekë, të cilat janë shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar padrejtësisht nga puna dhe kanë fituar shpërblim page deri në rikthim në punë të punonjësve ose dëmshpërblim page. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, pasi kjo vlerë shpenzimesh dhe përbën efekt financiar negativ për Buxhetin e Shtetit.

Në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

2.1 Rekomandimi: Nga Strukturat përgjegjëse të MIE, të merren masa në bashkëpunim me DAP, për rikthimin e menjëhershëm në punë të të gjithë punonjësve që kanë fituar këtë të drejtë si dhe të ndërpritet procesi i largimeve nga puna në mënyrë të padrejtë dhe të njëanshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Institucioni ka observuar si më poshtë:

Për sa është kontstatuar nga ju se, rekomandimi është i papranuar, gjithsesi sqarojmë se për periudhën objekt auditimi dhe në vijim, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka kryer asnjë proces të largimit nga puna në mënyrë të padrejtë dhe të njëanshme, dhe nuk ka asnjë proces gjyqësor për këtë qëllim. Të gjitha proceset gjyqësore që ju keni audituar i përkasin periudhave të mëparshme (përpara vitit 2018) të cilat janë ekzekutuar sikurse pranuar nga ju në pikën për zbatimin e rekomandimit 1.1 të këtij kreu “*masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike*”

Nga verifikimi u kostatua se Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

E. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, germet (b, c, ç) e nenin 58 “*Llojet e masave disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*” **i rekomandohet Titullarit të institucionit, që nëpërmjet një grupi pune, të bëjë vlerësimin dhe shqyrtimin e shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të cituara më poshtë, sipas përgjegjësisë individuale të nisë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse:**

1. Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues që kërkohet për miratimin e impianteve fotovoltaike/eolike referuar nenit 18 të VKM nr. 822, datë 07.10.2015 “*Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni*”, mbi të cilat Komisioni i Vlerësimit të Aplikimit gjykon për aftësitë teknike, ekonomike dhe financiare, të subjekteve aplikues, është konstatuar, se Komisionet e Vlerësimit të Aplikimit, rast pas rasti në material kanë dhënë vlerësimin për vijimin e procedurave, se subjektet aplikues zotërojnë aftësi teknike, ekonomike, financiare, si dhe staf të aftë dhe kompetent, kur dokumentacioni i sjellë nga subjektet aplikues nuk justifikonte me dokumentacion vërtetues që aplikuesi ka realizuar me sukses kontrata të ngjashme në fushën e energjisë (kërkesë kjo e fundit e cila u shfuqizua me ndryshimet ligjore të vitit 2021) apo pasqyrat financiare të audituara nga auditues të

licencuar në tre vitet e fundit, si kërkesa të nenit 7 “*Dokumentacioni shoqërues që kërkohet për një miratim*” të VKM nr. 822, datë 07.10.2015 “*Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni*”, i ndryshuar.

- Referuar nenit 19 të VKM nr. 822, datë 07.10.2015, i ndryshuar: “Komisioni i vlerësimit të aplikimit i paraqet ministrit, **brenda 45 ditëve** nga marrja e aplikimit, sipas pikës 1, të nenit 17, të këtyre rregullave, një raport lidhur me miratimin ose refuzimin e aplikimit”.

- Referuar nenit 21 të VKM nr. 822, datë 07.10.2015, i ndryshuar: “Komisioni shqyrton, **brenda 20 ditëve kalendarike**, nga dita e paraqitjes, plotësinë dhe saktësinë e të gjitha dokumenteve të paraqitura nga aplikuesi, sipas nenit 20, të këtyre rregullave” rezulton se, trajtuar rast pas rasti në material, Komisionet e Vlerësimit të Aplikimeve i kanë tejkaluar këto afate. (Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 162-242 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2. Nga auditimi i dokumentacionit të dhënies së miratimit për ndërtimin e impianteve fotovoltaike/eolike u konstatua se:

a. Ministria ka tejkaluar afatin e përcaktuar në nenin 12 VKM nr. 822, datë 07.10.2015, i ndryshuar, përcakton se: “1. Ministria shqyrton nëse dokumentet e depozituara nga aplikuesi janë në përputhje me kërkesat e këtyre rregullave. 2. Ministria mund të verifikojë besueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave të dokumenteve. 3. Nëse dokumentet dhe informacioni i paraqitur nga aplikuesi janë të plota dhe në përputhje me kërkesat e neneve 7, 8, 9 e 10, të këtyre rregullave, ministria i komunikon aplikuesit ose të deleguarit përgjegjës të tij pranimin e aplikimit, **brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së aplikimit...**” dhe në disa raste ka patur plotësim dokumentacioni nga ana e subjekteve, pa qenë e dokumentuar kërkesa e Ministrisë për paraqitjen e dokumentacionit të munguar, referuar nenit 13, ku përcakton se: Në rastet kur në aplikim mungon ndonjë nga dokumentet ose informacionet e parashikuara në nenet 7, 8, 9 e 10, të këtyre rregullave, Ministria i kërkon aplikuesit të paraqesë dokumentacionin e munguar, **brenda 10 ditëve kalendarike nga dita e njoftimit për plotësimin e tij**”. Në asnjë rast nuk ka dokumentacion vërtetues nga ana e **Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficiencën e Energjisë**, si njësia përgjegjëse për trajtimin e këtij dokumentacioni dhe gjykimin mbi plotësinë apo mangësitë e tij, ku të dërgojë një memo informuese drejtuar titullarit të institucionit, që paraprin Njoftimin për pranimin e aplikimit apo kërkesën për plotësim të dokumentacionit drejtuar subjektit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 162-242 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

b. Dosjet e administruara për licencimet e dhëna nga ana e MIE konsiderohen si “dosjet e subjekteve”, pra në ato dosje administrohet i gjithë dokumentacioni i sjellë nga subjektet dhe jo të gjithë korrespondencën e mbajtur edhe nga MIE ose hallka të tjera të procesit, sikundër konsiderohet dërgimi i njoftimit për pranimin e aplikimit, raportet e KVA, dhënia e miratimeve paraprake e përfundimtare, të cilat nuk ishin pjesë e dosjeve, por administroheshin nga Drejtoria përgjegjëse. Referuar nenit 21 të “Normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

-Gjithashtu, dosjet ishin të pa inventarizuara dhe pa numër progresiv faqesh, çka është pranuar edhe nga MIE, me arsyetimin se Drejtoria ka patur mungesa në staf për kryerjen e këtij procesi.

Referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Veprimtaria e Kontrollit, si një prej pesë komponentëve të MFK, përmban detyrimin e hartimit të procedurave për dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit, të cilat duhet të vendosen për të mbështetur kryerjen e operacioneve dhe kontrollimin e proceseve në njësinë publike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 162-242 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3. Nga auditimi i dokumentacionit të dhënies së miratimit për ndërtimin e impianteve fotovoltaike/eolike për aplikuesin “E, Xh” person fizik, u konstatua se:

a. Me shkresën nr. 9310/1 prot., datë 17.12.2018, drejtuar Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, mbi dhënien e miratimit përfundimtar për ndërtimin e objektit, nënshkruar nga zj. E. K z. A. B, zj. A. K, z. G. H, z. E. Dj, z. A. F, pa nënshkrimin e Sekretarit të Përgjithshëm, në cilësinë e “miratuesit”, kërkohet dhënia e miratimit përfundimtar për ndërtim për subjektin kërkues. Në shkresë, hartuesit referohen si “Komisioni”, por nuk citohet një Urdhër Ministri që ka ngritur këtë Komision. Ky Urdhër nuk është vënë në dispozicion të grupit të auditimit. Përbërja e këtij grupi është e ndryshme nga Komisioni i Vlerësimit të Aplikimit, i ngritur me anë të Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 390, datë 23.04.2018, i cili ka shqyrtuar dokumentacionin dhe ka hartuar raportin për dhënien e miratimit paraprak, bazuar në Urdhrin e sipërcituar. Aplikuesit “E.Xh” i është akorduar miratimi përfundimtar nr. 9310/2, datë 19.12.2018, i cili i është dërguar subjektit me anë të shkresës nr. 9310/3 prot., datë 19.12.2018. Sa më sipër MIE ka vepruar në kundërshtim me nenin 21 të VKM nr. 822, datë 07.10.2015, i ndryshuar, “Komisioni shqyrton, brenda 20 ditëve kalendarike, nga dita e paraqitjes, plotësinë dhe saktësinë e të gjitha dokumenteve të paraqitura nga aplikuesi...”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 162-242 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

b. Midis MIE dhe subjektit “E.Xh.” është lidhur kontrata nr. 6583 rep., nr. 2075 kol., datë 29.12.2018. Në raportimin periodik, administruar në MIE me nr. 10916 prot., datë 27.12.2019, administratori i shoqërisë “E.” ShPK bën me dije se në datën 18.12.2019, me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë “E.Xh.” ShPK, është miratuar ndryshimi i emrit të shoqërisë me N në “E.” ShPK. Sipas ekstraktit të N-it, shoqëria “E.” ShPK është themeluar në 27.03.2019 dhe është regjistruar në 01.04.2019. Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion që nga pala kontraktore “E.Xh.” person fizik me N të jetë bërë kalimi te një palë e tretë “E.Xh.” (e më pas E.) ShPK, duke kërkuar marrjen e miratimit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, që do ta bënte të vlefshëm këtë transferim. Sa më sipër MIE ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 822, datë 07.10.2015, e ndryshuar, nenin 28. Referuar Raportit Vjetor të ERE për vitin 2021, subjekti “E.” ka përfunduar ndërtimin dhe ka patur aktivitet në prodhimin e energjisë përgjatë vitit 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 162-242 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4. Në raportin e hartuar nga grupi i punës për identifikimin e zonës ku do të zhvillohej projekti fotovoltaike nuk është shprehur qartësisht se zona e Akërnisë është zonë e mbrojtur si park natyror kombëtar apo jo, pra nëse lejohet të ndërtohet në këtë zonë. Mos marrja parasysh e këtij informacioni nga ana e grupit të punës, për zonën ku do të zhvillohej ky projekt, ka krijuar problematika, të cilat, referuar korrespondencave të mëtejshme, mund të shkojnë deri në arbitrazh ndërkombëtar, që do të bënte që ky projekt jo vetëm të mos zhvillohej, por të reflektonte edhe me humbje të konsiderueshme të fondeve buxhetore në disfavor të shtetit, në

rast të fitimit të arbitrazhit nga subjekti privat. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shprehet se nuk ka informacion mbi ecurinë e procesit, nëse çështja ka vajtur në arbitrazh apo jo. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 162-242 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5. Nga auditimi i dosjes mbi monitorimin e kontratës koncesionare nr. 2184/7, datë 10.06.2016 “Për dhënien me koncesion të formës BOT (Ndërtim, shfrytëzim dhe transferim në pronësi të shtetit) të ndërtimit dhe shfrytëzimit të Portit të Jahteve Shëngjin” bazuar edhe në Raportet e Njësisë së Zbatimit të Projektit Koncesionar u konstatua se mungon kontrata e lidhur me shoqërinë koncesionare “A.” ShPK. krijuar nga bashkimi i operatorëve fitues.

Nga NjZP e ngritur me Urdhrin nr. 4836, datë 21.09.2016 nuk janë hartuar raporte tre mujore periodike të përgatitur për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës koncesionare; nuk ka hartuar një raport për mbikëqyrjen e vazhdueshme për zbatimin e kontratës për detyrimet e koncesionarit për fazën para ndërtimore, mbledhjen, përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e raportit paraprak brenda 60 ditëve nga përfundimi afatit paraardhës, hartimi i raportit të ndikimit në mjedis, etj, sipas përcaktimeve në nenet 14. Gjithashtu NjZP nuk ka hartuar një raport për mbikëqyrjen e vazhdueshme për zbatimin e kontratës për detyrimet e koncesionarit për fazën ndërtimore ku koncesionari brenda 90 ditëve nga pajisja me lejet, autorizimet, licencat përkatëse duhet të fillojë dhe të kryejë punimet e ndërtimit siç përcaktohen në aneksin V, dhe për çdo ditë vonesë koncesionari duhej të paguante penaltete ditore sipas përcaktimeve në nenet 15.

- NjZP nuk ka raportuar për rastet e mos përmbushjes nga koncesioni për rastet e përcaktuara në nenin 20 të kontratës dhe si pasojë nuk është plotësuar detyrimi i Autoritetit Kontraktues për pasojat e mos përmbushjes të njoftojë koncesionarin për zgjidhjen e kontratës me anë të një njoftimi me të drejtën e palës tjetër ti drejtohet gjykatës.

- Nga auditimi i dosjes së zbatimit të kontratës së koncesionit rezulton se nuk ka një dokument që vërteton ecurinë e procedurave për marrjen parasysh ose jo të rekomandimeve nga MIE ose shkresa të tjera për vazhdimësinë ose jo të kësaj kontrate koncesionare. Sa më lart është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” i ndryshuar, neni 10, pika 3; Kontratën koncesionare nr. 2184/7, datë 10.06.2016, Urdhrin e Ministrit nr. 4836, datë 21.09.2016. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 89-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

6. Nga auditimi dhe informacionet e MIE rezulton se deri 31.12.2021 nuk kanë hyrë në prodhim 64 kontrata të lidhura me prodhim vjetor energjie 3,759,366,951 Kw/h ose 50% e totalit, një pjesë e HEC-eve kanë hyrë në prodhim shumë më vonë se parashikimi në kontratë kjo e pasqyruar vetëm për tre vitet e fundit 2019, 2020, 2021 si më poshtë:

- Në vitin 2019 kanë hyrë në prodhim 12 HEC-et me një total të prodhimit të energjisë vjetore prej 219,565,780 Kw/h me vonesë me një kohë mbi 5 vjet nga hyrja në fuqi e kontratës.

- Në vitin 2020 kanë hyrë në prodhim 5 HEC-et me një total të prodhimit të energjisë vjetore prej 143,335,871 Kw/h me vonesë me një kohë mbi 7 vjet nga hyrja në fuqi e kontratës.

- Në vitin 2021 kanë hyrë në prodhim 8 HEC-et me një total të prodhimit të energjisë vjetore prej 251,057,070 Kw/h ku 6 prej tyre me prodhim të energjisë vjetore prej 191,354,391 Kw/h me vonesë me një kohë mbi 5 vjet nga hyrja në fuqi e kontratës.

Nga MIE nuk janë marrë masat për rregullimin e konstatimeve nga monitorimi i zbatimit të kontratave duke zgjidhur kontratat ose vendosjen e sanksione sipas detyrimeve të

parashikuara në kontratat përkatëse. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 89-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7. Nga auditimi i monitorimit të kontratës koncesionare BOT datë 06.09.2013 “Për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e Hidrocentralit “Dobrenjë Tomorricë”, në Përroin e Hijes Skrapar, objekt koncesioni” bazuar edhe në Raportet e AKBN-së të monitorimit të tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit 2020 u konstatua:

- Në raportin e monitorimit referuar analizës ligjore faktike është konstatuar se kontrata koncesionare është regjistruar nga shoqëri koncesionare në datën 06.05.2016 (gati 5 muaj me vonesë) duke mos respektuar afatin e 30 ditëve nga miratimi i projekt zbatimit sipas kërkesave të nenit 30 të kontratës koncesionare.

- Koncesionari ka kryer punime pa disponuar Lejen e Ndërtimit kur miratimi i projektit të zbatimit për HEC Dobrinjë-Tomorricë, mban datën 17.11.2015, Leja e ndërtimit nr. 59/1, datë 10.01.2019 dhe Shoqëria koncesionare ka detyrimin e dorëzimit pranë AK të procesverbalit të fillimit të punimeve. Në bazë nenit 10 pika 2 Koncesionari duhet ta vinte në punë hidrocentralin brenda 12 muajve nga data e marrjes së lejes së ndërtimit. (Sipas kontratës shtesë datë 22.11.2018). Afati i fundit për vënien në punë të HEC-it ishte data 10.01.2020, por HEC-i rezulton të jetë në prodhim që nga muaji dhjetor 2018.

- Bazuar në raportin teknik të monitorimit rezulton se në dosjen teknike mungon dokumentacioni teknik (ndërtimor) ndër të tjera si: Licenca profesionale, projekti i zbatimit të objektit; preventivi i projekt zbatimit; grafiku i punimeve; akti i piketimit me koordinatat dhe kuotat; akti i marrjes në dorëzim të punimeve; librezat e masave; raporti përfundimtar i mbikëqyrësit të punimeve; Akti i kolaudit; etj.

- Sa është konstatuar nga monitorimi i zbatimit të kontratës rezulton se nga MIE nuk janë përlllogaritur penalitetet për vonesat në fillimin e punimeve sa parashikohet në neni 23.1/iii të kontratës “Për çdo ditë vonesë për fillimin e punimeve penalizohet me 10,000 lekë”.

Gjithashtu MIE nuk ka hartuar, paraqitur ndonjë shkresë drejtuar koncesionarit për njohjen me shkeljet dhe rregullimin e tyre duke pritur për një periudhë 40 ditore përgjigjen e tij, me argumentet përkatëse në zbatim të nenit 24.1 të kontratës.

Nga **MIE** nuk janë marrë masat për rregullimin e konstatimeve nga monitorimi i zbatimit të kontratave duke zgjidhur kontratat ose vendosjen e sanksione sipas detyrimeve të parashikuara në kontratat përkatëse. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 89-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8. Nga auditimi i dosjeve të procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e Hidrocentraleve nën 2 Mw që nuk janë objekt koncesioni sipas VKM nr. 822, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni” dhe shqyrtimit të dokumentacionit në dosjet për procedurën e aplikimit dhe miratimi të lejes për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e Hidrocentraleve u konstatua se:

- Dosjet kanë mangësi të theksuara në dokumentacion në të gjithë fazën e aplikimit, mungesë shqyrtimi të thelluar në lidhje me autorësinë e përgatitjes së dokumentacionit nga specialistë të fushës të licencuar, në disa me mos plotësim të kriterëve nga ana e subjekteve aplikuese, mangësi të veprimtarisë së dokumentuar të komisionit të shqyrtimit të aplikimit, humbje e

afateve të vlefshmërisë së lejeve dhe licencave për mungese përgjigjeje në kohë të institucioneve shtetërore etj.;

- Dosjet e aplikuesve janë të pa sistemuara, pa protokolluara dhe të pa arkivuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, duke e vështirësuar çështjen e shqyrtimit si nga ana e audituesve të jashtëm ashtu dhe për vetë **punonjësit e sektorit përkatës të MIE:**... (Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqe 162-242 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9. Mbështetur në neni 9, të VKM Nr. 504, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushave të përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, në strukturën e kësaj ministrie është ngritur **Sektori i Partneritetit Publik Privat në Fushën e Energjisë**, i cili funksionon brenda Drejtorisë së Partneritetit Publik Privat në Fushën e Infrastrukturës dhe Energjisë. Në zbatim të VKM Nr. 822, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni” janë lidhur 87 kontrata jo koncesionare për HEC nën dy Mw me prodhim vjetor energji 453,248,902 Kw/h, nga të cilat 57 kontrata të lidhura me prodhim vjetor energji 317,350,850 Kw/h ose 70% nuk kanë hyrë në prodhim. Gjithashtu konstatohet se një pjesë e HEC-eve kanë hyrë në prodhim shumë më vonë se parashikimi në kontratë, në total 30 HEC-e me prodhim energjie vjetore 135,898,052 Kw/h. Nga MIE nuk janë marrë masat për rregullimin e konstatimeve nga monitorimi i zbatimit të kontratave duke zgjidhur kontratat ose vendosjen e sanksione sipas parashikimeve në kontratat përkatëse. (Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 162-242 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në dosjet e monitorimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni sipas VKM nr.822, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni” janë konstatuar mangësi.

- Në dosjet e monitorimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni konstatohen mangësi si vonesa në komunikimin e MIE me të autorizuarin e tij AKBN (pavarësisht se nuk cilësohet në asnjë rast ky institucion në kontratat për ndërtimin e burimeve të reja energjetike);

- Monitorimi kryhet vetëm nga AKBN, megjithëse mbajtësi i miratimit për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit e ka detyrim për të dorëzuar në MIE çdo 3 muaj një raport mbi veprimtarinë e tij, detyrim i cili përgjithësisht nuk është zbatuar, dhe kontraktuesi duhej të penalizohej me zgjidhjen e kontratës;

- Për dosjet e monitorimit të HEC-eve të përzgjedhura për auditim, nga ana e AKBN janë konstatuar penalitete të llogaritura dhe të pa mbajtura nga MIE në vlerën 3,525,000 lekë;

- Nga **MIE** nuk u paraqitur informacion lidhur me veprimet e saj në drejtim të zbatimit të penaliteteve dhe zgjidhjes së problematikave të evidentuara sipas kontratave përkatëse nga procesi i monitorimit të kryer nga AKBN. (Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 162-242 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Institucioni ka observuar si më poshtë vijon më dokumentacionin mbështetës:

Lidhur me këtë rekomandim sqarojmë se, nëpunësit zj. E. K, z. A. B, zj. A. K, z. G. H, z. A. F, kanë shkëputur marrëdhëniet juridike dhe financiare me institucionin përkatësisht.

Nëpunësi Akti Data

E. 1536/3 prot. 04.02.2019

A.B 6662 prot. 15.07.2018

A.K 1228/2 prot. 28.01.2021

G.H 4020/3 prot. 01.06.2021

A.F 2183/1prot. 10.03.2022

Gjithashtu, sqarojmë se, Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë me Urdhrin nr. 124, datë 10.06.2024 “Për ngarkimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë me nxjerrjen e urdhrave për ngritjen e komisioneve disiplinore dhe komisioneve të posaçme të nëpunësve civilë” ka deleguar kompetencën për ngritjen e komisioneve disiplinore në ngarkim të nëpunësve civilë të institucionit, në përputhje me nenin 59, pika 8 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, i cili parashikon se “Procedimi disiplinor fillon pa vonesë, me marrjen dijeni për një shkelje disiplinore, por jo më vonë se brenda një afati 2-vjeçar nga data e kryerjes së shkeljes. Në rastin e shkeljeve të rënda, që mund të rezultojnë në marrjen e masës disiplinore të largimit nga shërbimi civil, afati është 8 vjet”.

Dokumentacioni mbështetës

Urdhri i Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr.124, datë 10.06.2024 “Për ngarkimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë me nxjerrjen e urdhrave për ngritjen e komisioneve disiplinore dhe komisioneve të posaçme të nëpunësve civilë”.

Nga verifikimi u kostatua se: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces**.

Konkluzioni i Auditimit

Në përfundim të procesit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, rezulton se nga **39** rekomandime të lëna, nga Subjekti **MIE** janë pranuar të 39 rekomandime, nga të cilat: janë zbatuar **23** masa ose **59% e tyre**; 6 masa janë zbatuar pjesërisht; 4-masa janë në proces zbatimi si dhe 6 masa janë pa zbatuar, pra 12 masa mbeten për tu zbatuar nga subjekti MIE, për periudhën në vijim. Grupi i auditimit duke analizuar Rekomandimet e pranura dhe të zbatuara nga MIE (njësitë përgjegjëse të saj) apo dhe ato në proces zbatimi, arriti në konkluzionin që: - Për kategorinë “Për përmirësim legjislacioni” R 1.1; Për kategorinë "Masa Organizative"- Rekomandimet R 1.1; R 1.2; R 2.1; R 4.1; R 5.1; R 6.1; R 7.1; R 8.1; R 10.1; R 11.1; R 12.1; R 15.1; R 16.1; R 17.1; R 18.1; R 21.1; R 22.1; R 23.1; R 24.1; R 25.1; R 27.1; R 28.1; - Kategorinë "Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave"- R 1.1; Kategorinë "Masa shpërblim dëmi të konstatuara në përdorimin e fondeve publike për investimet e kryera - Rekomandim R 1.1; në vlerën **155,695,418** lekë; - Kategorinë "Masa Disiplonore" janë pranuar dhe zbatuar apo në proces zbatimi nga MIE, prandaj nuk mund të qëndrojnë për periudhën në vijim.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmisimin e gjëndjes *Rikërkojmë që*, MIE të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuar si dhe pjesërisht të zbatuara brenda 3-mujorit të parë të vitit 2025.

Si dhe marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

A. MASA ORGANIZATIVE:

53.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i institucionit, që menjëherë pas dërgimit të ftesës për pjesëmarrje në takime/evente jashtë vendit, të përgatitet dokumentacioni ligjor në kohë optimale duke respektuar afatet për qarkullimin e shkresave administrative, në mënyrë që blerja e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me sistem dinamik blerje të kryhet jo në datë të përafërt (apo brenda ditës) me datën e nisjes.

9.1 Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues i MIE-së duhet të ngrejë një komision me ekspertë të fushave, për artikujt, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të këtyre aktiveve, ku pas këtij shqyrtimi të bëhet rivlerësimi i vlerës së tyre. Mbi bazën e aktit të rivlerësimit, institucioni të realizojë regjistrimet e vlerës së tyre në kontabilitet.

13.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësim të marrin masa që në Akt-Marrëveshjet e lidhura midis ASHSH dhe subjektit kërkues të shpronësimit, të vendoset një pikë e veçantë të “*Detyrimet e subjektit kërkues*” që e detyron subjektin kërkues të dërgojë informacion periodik pranë ASHSH mbi situacionin e likuidimeve dhe, në rast të mos likuidimit, të specifikohet shkaku që e ka sjellë rast pas rasti, me qëllim që të bëhet e mundur ndjekja e këtij procesi nga ana e ASHSH nga fillimi e deri në fund, në realizim edhe të qëllimit fillestar të krijimit të kësaj agjencie.

14.1 Rekomandimi: Komisionet e Vlerësimit të Aplikimeve të marrin masa mbi vlerësimin e drejtë të aftësive teknike, financiare dhe ekonomike, të stafit të aftë dhe kompetent, me qëllim garantimin e vijimit të procedurave për subjekte që japin garanci, referuar kërkesave ligjore, se mund të kryejnë me sukses operimin në tregun e ndërtimit të impianteve të prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, si dhe të kryejnë aktivitetin e tyre brenda afateve të parashikuara, me qëllim evitimin e tejzgjatjes së procedurave.

18.2 Rekomandimi: Titullari i MIE të marrë masa mbi krijimin e procedurës së dokumentimit, arkivimit dhe ruajtjes së informacionit, duke bërë pjesë të detyrave funksionale të njësisë përgjegjëse, jo vetëm ndjekjen nga fillimi deri në fund të procesit të dhënies së miratimit paraprak e përfundimtar, por edhe arkivimin e dosjeve me qëllim ruajtjen e informacionit.

19.1 Rekomandimi: Grupet e punës për identifikimin e zonave të marrin masa në vijimësi për vlerësimin e të gjitha risqeve të ndërtimit të projekteve. Me qëllim që të evitohen konfliktet e mundshme, si dhe të garantohet përfundimi me sukses i projekteve.

20.1. Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, para çdo kontrate që do të lidhë me shoqëritë koncesionare gjatë realizimit të procedurave konkurruese për dhënien me koncesion për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike hidrike, duhet të bëjë identifikimin e koncesionit të mundshëm të projektit të koncesionit, shoqëruar me analizën e rentabilitetit dhe përshtatshmërisë financiare.

26.1. Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria përkatëse, të shqyrtojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar nga mangësitë e dokumentacionit në dosjet e operatorëve ekonomikë aplikues për ndërtimin e burimeve të reja të energjisë elektrike, HEC-ve, si dhe të respektojë afatet dhe të vlerësojë me përpikmëri aplikimet e subjekteve

29.1.Rekomandimi: MIE, Komisioni i Vlerësimit të Aplikimit në zbatim të VKM nr. 822, datë 07.10.2015 të shqyrtojë plotësinë dhe saktësinë e të gjitha dokumenteve të paraqitura nga aplikuesi dhe ti paraqesë raportin ministrit, i cili nëse arrin në përfundimin se të gjitha dokumentet e paraqitura nga aplikuesi, sipas këtyre rregullave, janë të plota e të sakta, të miratojë ndërtimin e hidrocentralit sipas kërkesave të nenit 22.

30.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e institucionit mëmë të Agjencisë Shtetërore për Shpronësim, të nisë një korrespondencë me Ministrinë e Drejtësisë, në cilësinë e institucionit mëmë të Agjencisë së Trajtimit të Pronave, për të përcaktuar se subjekti i cilit prej trajtimeve është rasti në fjalë, me qëllim evitimin e proceseve të mundshme gjyqësore që mund të iniciohen.

31.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me AKBN, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin në terren të veprimtarisë së subjektit, sa i përket pjesëve të ankesës që i referohen MIE-s dhe institucioneve të varësisë së saj, si dhe të bëjë me dije ankuesin mbi rezultatet e verifikimit.

D. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

2.1 Rekomandimi: Nga Strukturat përgjegjëse të MIE, të merren masa në bashkëpunim me DAP, për rikthimin e menjëhershëm në punë të të gjithë punonjësve që kanë fituar këtë të drejtë si dhe të ndërpritet procesi i largimeve nga puna në mënyrë të padrejtë dhe të njëanshme.

3.2 Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

3.2.1 PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditimin në **Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme** mbi “*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023*” për auditimin e kryer në vitin 2023, për periudhën objekt auditimi 01.01.2020 deri në datën 30.09.2022, përcjellë me shkresën Nr.894/9 Prot. datë 15.11.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve;

ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, si dhe manualit *“Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”*.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 880/1 Prot., datë 02.07.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. L. L, (Përgjegjës grupi)

2. N. M anëtar

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën Nr. 894/9 Prot. datë 15.11.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLZIONI:

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se janë lënë në total 78 rekomandime , të cilat janë pranuar plotësisht nga subjekti dhe se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **4 Masa për përmirësim legjislativ** dhe **4** rekomandime të pranuar plotësisht, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, **1** zbatuar plotësisht, **1** në proces, **2** pazbatuar.

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **47 Masa organizative**, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, **9** zbatuar plotësisht, **11** në proces, **6** pjesërisht të zbatuara dhe **21** pa zbatuar.

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 3 *Masa për shpërbllim dëmi* në shumën 756,000 lekë, nga ku 3 rekomandime, janë pranuar plotësisht 3 të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 pjesërisht e zbatuar dhe 2 të pazbatuara.

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 12 *Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe në menaxhimin me ekonomicitet, efizienz dhe efektivitet të fondeve publike* nga ku 12 rekomandime të pranuar plotësisht, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 10 në proces zbatimin dhe 2 të pazbatuara.

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 12 *Masa disiplinore*, nga ku 12 rekomandime për 12 punonjës, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 12 rekomandime të pazbatuara.

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën ~13 % , niveli i zbatimit të rekomandimeve në proces është 28%, të zbatuara pjesërisht është ~9 % dhe të pazbatuara 50% nivele këto të cilat tregojnë se subjekti i adutuar duhet të rrisi masën e vlerësimit të këtij procesi në lidhje me ndjekjen e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimi) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka miratuar planin e veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, por e ka dërguar në KLSH me shkresën Nr.4911 Prot, datë 29.03.2024 jashtë afatit, në mospërputhje me Ligjin Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, shkronja j.

-Sa më sipër rezulton, se nuk është zbatuar afati **20 ditë** për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga ana e subjektit të audituar lidhur me raportimin mbi zbatimin të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara sipas strukturave përgjegjëse, subjekti ka raportuar në KLSH me shkresën Nr. 4911/1 Prot., datë 20.05.2024 brenda afatit **6 muaj** të raportimit, **në përputhje me** Ligjin Nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30 pika 2 e tij.

-Sa më sipër rezulton, se është zbatuar afati **6 muaj** për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

A. Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi:

1.1.Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ të merren masat për harmonizimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor mbi shërbimin e jashtëm, duke marrë masat për një zbatimin të plotë dhe efektiv të

parimit të ekskluzivitetit, dhe të ndërmerren masat e nevojshme për të iniciuar amendime në Ligjin nr.23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë” dhe aktet e dala në zbatim të tij, me synim qartësimin dhe sanksionimin e "pagesës së sigurimit të shëndetit", në funksion të përdorimit me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve të buxhetit të shtetit.

Menjëherë

Nga verifikimi u kostatua se: Referuar dokumentacionit Urdhri Nr. 48, datë 31.01.2024, vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për plotësimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor mbi shërbimin e jashtëm, pasi është hartuar projekt ligji “ Për shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë” Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

2.1. Rekomandimi:

Të merren masat nga ana e institucionit, për hartimin dhe miratimin nga ana e Ministrisë të Urdhërësive dhe Metodologjive të Brendshme që përcaktojnë rregullat dhe normojnë kriteret e limitet, gjurmët e auditimit, aprovimet dhe procedurën që duhet zbatuar në lidhje me marrjen me qira të godinave të ambasadave dhe selive diplomatike apo apartamenteve në përdorim të diplomatëve gjatë ushtrimit të funksionit zyrtar prej tyre si dhe mënyrës së zbatimit të gjurmës dhe procedurave të detyrueshme për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimeve.

Në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar. Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

3.1. Rekomandimi:

Të merren masa të menjëhershme për nxjerrjen e udhëzimeve, që do të vijnë në ndihmë për zbatimin me korrektësi të dispozitave të ligjit të posaçëm, lidhur me procedurat e rekrutimit të ekspertëve të jashtëm, përcaktimin e afatit maksimal të qëndrimit në pozicionin e kreut të misionit diplomatik në situata të përkohshme, rotacionet e emërimeve në përfaqësi, si dhe çdo aspekt tjetër të konstatuar në veprimtarinë praktike, për të cilën kuadri ligjor aktual nuk është shprehur, apo lë vend për interpretim, duke shmangur në këtë mënyrë mungesën e theksuar të transparencës dhe vendimmarrjen subjektive.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

4.1. Rekomandimi:

Titullari i institucionit të marrë masat dhe të ngrejë një grup pune për hartimin e rregulloreve në harmoni me legjislacionin e azhornuar, me qëllim saktësimin e detyrave dhe përgjegjësi të çdo punonjësi, referuar pozicioneve të strukturës së miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe në **proces zbatimi**.

B. MASA ORGANIZATIVE:

1.1. Rekomandimi:

Të merren masat për plotësimin e zbatimit të gjurmës së auditimit dhe zbatimin me korrektesë të procedurave të detyrueshme për kryerjen e shërbimeve dhe disiplinimin e lëvizjes së automjeteve, referuar përcaktimeve të Urdhrit nr.507, datë 15.10.2012 të Ministrit.

Në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe në **proces zbatimi**.

2.1.Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të hartuar dhe paraqitur pasqyrat financiare në përputhje me Udhëzimet dhe formatet zyrtare aktuale të miratuara nga MEF.

Në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar. Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe në **proces zbatimi**.

3.1.Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ-së, të merren masat për administrimin e dokumentacionit të nevojshëm nga NJQQ mbi kalimin e përgjegjësisë së operimit/menaxhimit të këtyre aktiveve tek kjo Ministri. Nga ana e MEPJ-së të merren masat për të hartuar dhe paraqitur në mënyrë të drejtë, zërat e bilancit (në pasqyrat financiare), në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Gjithashtu t'i kushtohet rëndësi e veçantë klasifikimit në mënyrë të drejtë të posteve të bilancit. Aktivitet afatgjatë në përdorim të njësive të kontabilizohen në përputhje me procedurat e përgatitjes, paraqitjes, dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar. Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe në **proces zbatimi**.

4.1.Rekomandimi:

Të merren masat nga MEPJ të rishikohet formati i akt-rakordimit të të ardhurave me thesarin, me qëllimin e shmangies së keq-klasifikimit të të ardhurave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

5.1.Rekomandimi: Nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të kërkohet dhe të ndiqet në vijimësi arkëtimi i të drejtave të arkëtueshme (debitorët), duke zbatuar të gjitha

procedurat e nevojshme në rrugë administrative e ligjore, deri në finalizimin e arkëtimit të këtyre vlerave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar. Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

6.1. Rekomandimi:

Të hartohen analizat e llogarisë inventariale 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” duke identifikuar dhe peshën specifike të çdo artikulli në bilancin kontabël (në shënimet shpjeguese), si dhe të ndërmerren veprimet e nevojshme të verifikimit të ekzistencës së tyre nëpërmjet kryerjes së inventarizimit periodik fizik të kësaj pasurie.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **ne proces zbatimi**.

7.1 Rekomandimi:

Të merren masat nga ana e MEPJ, me qëllim finalizimin e procedurës për nxjerrjen jashtë përdorimit të automjeteve, pas kryerjes së një analize të plotë kosto përfitim mbi këto automjete si dhe mbështetur në vlerësimet dhe relacionet argumentues për çdo automjet nga ana e inxhinierit vlerësues dhe nga të gjithë anëtarët e komisionit., për nxjerrjen nga përdorimi, ku të përshkruhet procedura e ndjekur sipas rastit për çdo aktiv lidhur me dhënien në përdorim ose tjetërsimin e tyre, ose nxjerrjen jashtë përdorimit dhe destinacionin përfundimtar të këtyre aktiveve, dhe nënshkruhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se: . Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

8.1 Rekomandimi:

Të merren masat nga ana e Nëpunësit Zbatues dhe Sektorit Financiar të këtij institucioni, për aplikimin me korrektesë të normave të amortizimit vjetor të aktiveve afatgjata materiale e jo materiale dhe llogaritjen e drejtë të amortizimit të aktiveve, sipas përcaktimeve në UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u kostatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

9.1 Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ-së të merren masa konkrete për të arkëtuar vlerat e munguara dhe sistemuar diferencat reale të të ardhurave të munguara.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

10.1 Rekomandimi:

Të merren masa konkrete për kryerjen e veprimtarisë operative në përputhje dhe në zbatim me bazën ligjore rregullatore si dhe të zbatohen detyrimet e kontratës mes palëve “Posta Shqiptare” sh.a dhe MEPJ-së, sikundër edhe parashikohet në nenin 2 “Të drejtat dhe detyrimet e palëve”, pika 2.3 dhe 2.4 e saj.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se nuk janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

11.1 Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ-së të merren masat për të kryer rakordimin dhe unifikim të vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare, me vlerat e paraqitura në aktet e rakordimit të kundërfirmuara me degën e thesarit, si dhe për rastet e mospërputhjeve të bëhen shpjegimet e nevojshme në relacionet që shoqërojnë pasqyrat financiare vjetore. Të hartohet dhe nënshkruhen rregullisht situacionet mujore, periodike dhe vjetore për shpenzimet e ushtrimit nga veprimtaria e MEPJ dhe për çdo mospërputhje të të dhënave të pasqyrave financiare që shoqërojnë bilancin kontabël, të jepen shpjegimet sqaruese për çdo rast.

Periodikisht dhe çdo muaj

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar. Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

12.1 Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të ndërtuar dhe përditësuar regjistrin e aktiveve në përputhje me detyrimet e normuara në Udhëzimin e MFE nr.30 datë. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik”, i ndryshuar.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se nuk janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

13.1 Rekomandimi:

Të merren masa të menjëhershme për të iniciuar procedurat e inventarizimit të aseteve të njësisë dhe çdo aktiv tjetër që ky Institucion disponon për të verifikuar e rakorduar gjendjen fizike të tyre me të dhënat e librave të llogarisë.

Të kryhet rakordimi i gjendjes fizike me gjendjen kontabël në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së aktiveve të njësisë.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konkludohet se rekomandimi është zbatuar pjesërisht. Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

14.1 Rekomandimi:

Të merren masa të menjëhershme për të iniciuar procedurat e regjistrimit të pronësisë dhe përcaktuar kufijtë e pasurive të paluajtshme që janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë apo posedimit për çdo rast dhe kryerja e rivlerësimit të tyre në mënyrë që të pasqyrojnë drejt dhe saktë vlerat në pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

15.1 Rekomandimi:

Të merren masa nga ana e zyrtarëve përgjegjës për :përcaktimin e normave të harxhimit konsumit për secilin automjet në përdorim në përputhje me bazën ligjore përkatëse. hartimin në mënyrë periodike procesverbaleve për matjen e harxhimit të karburantit për automjetet e institucionit, si dhe të raporteve mbi monitorimin dhe informimin e rezultateve, në kuadër të një sistemi kontrolli dhe monitorimi proaktiv; hartimin dhe miratimin e një plani mujor sipas tipit të makinave dhe ngarkesës së punëve, për lëvizjeve të personave që i përdorin automjetet për nevoja të punës, si dhe në mënyrë të vazhdueshme të kryhen verifikime për kilometrat e përshkruara nga makinat e Ministrisë, plotësimin me dokumentacionin e domosdoshëm justifikues të këtyre praktikave administrative.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit por një pjesë e procedurave janë në vijim. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces**.

16.1 Rekomandim:

Të merren masa të dokumentohen dhe monitorohen me korrektesë lëvizjet e automjeteve me qëllim që të shmangur veprimet që sjellin keqadministrim financiar të fondeve publike.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar. Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

17.1. Rekomandimi:

Njësitë e Prokurimit në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të marrin masa për hartimin e kriterëve të kualifikimit në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

17.2. Rekomandimi: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të marrin masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për punë publike, mallra, shërbime me shkelje ligjore, dhe të shpallura fitues në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara në DST, me qëllim garantimin e përdorimit me eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

17.3. Rekomandimi:

Me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumenteve zyrtare të procedurave të prokurimit, nga ana e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

18.1.Rekomandimi:

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të marrë masat e menjëhershme për pajisjen me certifikatë dhe regjistrimin e ashensorit pranë strukturave të posaçme si Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, në funksion të sigurimit të jetës të përdoruesve të tij.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit.Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

19.1. Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ-së në çdo rast të analizohen me saktësi elementet e buxhetit për çdo zë të tij duke argumentuar shtesat dhe pakësimet, me qëllim rritjen e efektshmërisë së planifikimit dhe realizimit, dhe miradministrimin e buxhetit të akorduar.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

20.1. Rekomandimi:

-Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm për MEPJ sipas formës së kërkuar nga ligji, pasi ai ka rolin e një autoriteti që monitoron sistemin e kontrollit të brendshëm financiar publik për institucionin dhe që ofron këshilla për Ministrin brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të kësaj ministrie. KAB të zhvillojë veprimtarinë e tij sipas një kalendari të miratuar, të zhvillojë takimet/mbledhjet jo më pak se 4 (katër) herë në vit bazuar në kompetencat e raportimit, si dhe të zbatojë parashikimet e legjislacionit për organizimin dhe funksionim e organeve kolegjiale.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

21.1. Rekomandimi:

-Njësia e Auditimit të Brendshëm të marrë masa për përfshirjen në planet vjetore dhe strategjike të auditimit, të angazhimeve të auditimeve financiare dhe atyre të kombinuara, në auditimet e misioneve diplomatike dhe përfaqësive jashtë vendit.

-Njësia e Auditimit të Brendshëm në hartimin e planeve të subjekteve për tu audituar të mbajë parasysh frekuencën e kryerjes së këtyre angazhimeve audituese, duke mos lënë asnjë subjekt pa u audituar për më shumë se 5 vjet, me qëllim kryerjen në kohë të misionit të auditimit, duke i shërbyer përmirësimit të vazhdueshëm të veprimtarisë së institucionit dhe parandalimit të parregullsive dhe shkeljeve të ligjshmërisë.

- NJAB të angazhohet për të evidentuar në çdo rast parregullsitë dhe shkeljet e disiplinës financiare në shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë, duke siguruar në këtë mënyrë një mekanizëm efikas për përmirësimin e vazhdueshëm të punës në Institucion.

-NJAB të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e rekomandimeve të lëna, duke siguruar dhënien e mbështetjes së titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

22.1. Rekomandimi:

Titullari i institucionit të ngrejë një grup pune, i cili të analizojë në mënyrë të plotë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për dobësitë dhe moszbatimin e harmonizuar të komponentëve të Menaxhimit të Financave Publike dhe Kontrollit të Brendshëm dhe mbi këtë bazë të hartojë një plan pune të detajuar për përmirësimin e gjendjes dhe për zbatimin e menjëhershëm të këtyre detyrimeve. Njësia e Auditimit të Brendshëm e MEPJ të monitorojë në vijimësi zbatimin e këtij plani dhe të cilësisë së MFK për institucionin..

Titullari i institucionit të ndjekë zbatimin dhe monitorimin e të gjithë komponentëve dhe çështjeve të Menaxhimit të Financave Publike dhe Kontrollit të Brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit dhe po vijohet për të zbatuar plotësisht rekomandimin e KLSH. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces**.

23.1. Rekomandimi:

Drejtoria e Shërbimeve dhe e Prokurimeve pranë MEPJ të kryej një parashikim më të saktë në regjistrat e parashikimit, sidomos për procedura të përsëritura, për të cilat strukturat e MEPJ kanë informacionin e plotë, me qëllim parashikimin sa më korrekt të këtyre procedurave dhe eventeve, me qëllim shmangien e procedurave emergjente kur kjo është e pajustificuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

24.1. Rekomandimi:

Drejtoria e Shërbimeve dhe Prokurimeve pranë MEPJ në asnjë rast mos të anashkalojë procedurat elektronike online duke përzgjedhur procedurën emergjente, me qëllim nxitjen e konkurrencës midis operatoreve ekonomikë dhe garantimin e përdorimit me kursim, dobi dhe frytshmëri të fondeve buxhetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se nuk marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

25.1 Rekomandimi:

Strukturat përgjegjëse të MEPJ-së, në të gjitha rastet të tregohen sa më korrekte në likuidimin e faturave të pranuar sipas kushteve të përcaktuara për pagesë, me qëllim shmangien e kostove të tjera shtesë për buxhetin e saj si dhe të nxirren përgjegjësitë për çdo rast penaliteti të ardhur si pasojë e neglizhencës së zyrtarëve të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

26.1. Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të hartuar dhe paraqitur pasqyrat financiare individuale nga këto njësi shpenzuese në përputhje me Udhëzimet dhe formatatet zyrtare të miratuara nga Ministria përgjegjëse për financat.

Nga ana e MEPJ-së të përditësohet, standardizohet dhe zyrtarizohet evidenca, e cila do të përdoret për raportimin e shpenzimeve nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore në MEPJ.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se nuk janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

27.1 Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ të merren masat për evidentimin, regjistrimin dhe pasqyrimin në kontabilitet të elementeve analitike inventarialë që bëjnë pjesë në llogaritë e aktiveve afatgjata dhe aktiveve qarkulluese duke garantuar elementet e kontrollit të përvitshëm të ekzistencës së aktiveve nëpërmjet inventarizimit vjetor e periodik, për të evituar riskun e humbjes dhe keqadministrimit të aktiveve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit por masat nuk janë të plota për cdo njësi të cilës i adresohen. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

28.1. Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ në bashkëpunim me përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të RSH jashtë vendit, të merren masa të:

Kryhen përmirësimet ligjore e nënligjore të nevojshme, duke plotësuar bazën rregullatore me të gjithë elementët që parashikon kuadri ligjor për fushën e përgjegjësisë së MEPJ;

Studiohet tregu i pasurive të paluajtshme në vendin pritës dhe operohet sipas formave që parashikon ligji për vijueshmërinë;

Përcaktohen periodikisht kushtet kryesore të qiramarrjes, listës së orendive të nevojshme për ambientet e banimit;

Nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip (si varianti origjinal), për rastet e hartimit të këtyre dokumenteve në gjuhë të huaj fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit por procesi vijon për të plotësuar të gjitha rekomandimet e lena nga KLSH. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces**.

29.1. Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ në bashkëpunim me përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të RSH jashtë vendit, të merren masa:

Për të plotësuar praktikatat dokumentare me të gjithë dokumentacionin justifikues të nevojshëm;

Të kryhet analiza e tregut në vazhdimësi, nëse ka ndryshim në termat e kontratave apo do të lidhen kontrata të reja, shoqëruar me argumentimin shterues për rastet kur pranohet rinovim me rritje rente/norme qiraje mujore/vjetore.

Në të gjitha rastet të hartohet kopje e dokumentacionit /dublikatë në gjuhën amtare për kontratat e lidhura.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit por procesi vijon për të plotësuar të gjitha rekomandimet e lena nga KLSH. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces**.

30. Rekomandimi:

Nga ana e përfaqësive të merren masa për të punuar, zbatuar dhe mbikëqyrur me korrektesë Urdhrin nr. 507, datë 15.10.2012 të Ministrit të Punëve të Jashtme, duke mbajtur në konsideratë plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm autorizues dhe justifikues sipas parashikimeve në bazën ligjore dhe aktet e tjera rregulluese.

Nga ana e përfaqësive të merren masa që i gjithë dokumentacioni të mbahet në mënyrë kronologjike dhe të plotë me qëllim kjo, verifikimin e përdorimit të sasisë së karburantit të furnizuar në përputhje me kriteret e miradministrimit material, si dhe kryqëzimin e të dhënave midis lëvizjeve të shoferëve dhe fletë udhëtimeve të plotësuar për lëvizjet e brendshme/ jashtme, duke rakorduar me kilometrat e përshkruara.

Nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore të merren masa për të kryer procesin e inventarizimit të aseteve që administrohen, me qëllim që në përfundim të procesit, të ngarkohen me procesverbal të rregullt tek personat përgjegjës që i kanë në ngarkim.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se nuk janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

31.1. Rekomandimi:

Nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore të merren masa për të plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm justifikues praktikën e bartjes së sendeve personale të përfaqësuesve dhe familjarëve të tyre (“cargo”).

Të vlerësohet rast pas rasti praktika e cargo-ve nëpërmjet bashkëpunimit dhe bashkëveprimit mes përfaqësisë dhe Drejtorisë së Financës së MEPJ-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar Urdhri nr. 48, datë 31.1.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projekt-akteve mbi rregullimin e veprimtarisë së shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

32.1. Rekomandimi:

Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave. Ky dokumentacion duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin nr.26, neni 4, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Per MFK”, i

ndryshuar i cili specifikon se “Dokument financiar” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.”, si dhe kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 30, datë, 27.12.2011 i ndryshuar, paragrafi 34-36 dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar, kreu II, paragrafi 2.2. MEPJ të marrë masa për të kryer analizimin e faturave dhe pagesave të kryera në vlerën prej 4,285.25 Euro, argumentimin e nevojave dhe nxjerrjen e përgjegjësiive konkrete.

32.2. Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ-së në bashkëpunim me përfaqësinë Pragë të merren masa për të kryer verifikimin e vlerës totale prej 4,958.89 Euro (detajuar si në gjetje);

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar shkresës 6350 datë 25.04.2024. dhe reagimit të Ambasadës Pragë me anë të shkresës nr. 183 datë 30.04.2024 rezulton se janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit, por procesi i zbatimit nuk është i plotë. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

32.3. Rekomandimi:

Nga ana e përfaqësisë Romë të merren masa për të kryer verifikimin e vlerës prej 2,380 Euro;

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit, por procesi i zbatimit nuk është i plotë. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

Menjëherë dhe në vijimësi

32.4. Rekomandimi:

Nga ana e përfaqësisë Madrid të merren masa për të verifikuar vlerën totale prej 2,481.86 Euro;

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

33.1 Rekomandimi:

Nisur nga risku i lartë që mbart mbajtja e 4 llogarive të ndryshme bankare, (në 2 monedha të ndryshme), e kjo sjell impakt të konsiderueshëm nga kursi i këmbimit në konvertim, mundësi të larta për humbje nga kursi këmbimit, të merren masat për të rishikuar mbajtjen e vetëm 2 llogarive bankare sipas monedhave respektive.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit, por procesi i zbatimit nuk është i plotë.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti **dhe i zbatuar pjesërisht**.

34.1 Rekomandimi:

Nga ana e secilës përfaqësi të merren masa për zbatimin e kuadrit të normave mbi mirëmenaxhimin material të magazinës, kryerjes së inventarizimit të saj periodik si dhe hartimin e kartelave personale të punonjësve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se nuk janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

35.1. Rekomandimi:

Për shkak të ndjeshmërisë së lartë të vlerave të aktiveve qarkulluese, nga ana e secilës përfaqësie diplomatike dhe konsullore të merren masa për mirë menaxhimin e këtyre zërave të pronës shtetërore dhe kryerjen e procesit të rregullt të inventarizimit të tyre.

Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues i MEPJ-së në bashkëpunim me titullarët e përfaqësive të marrin masa të kryejnë procesin e inventarizimit të aktiveve dhe të procedojnë në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Të merren masa për të kryer evidentim të plotë të situatës së inventarizimit për çdo llogari, arsyetimi i shkaqeve mbi inventarin jashtë funksionit, qëndrimi i titullarit / disponimi mbi mënyrën se si do të procedohet në vijim, etj.

Të merren masa për aktivet që janë për dalje jashtë përdorimit të procedojnë në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011, duke iniciuar procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi; listën e aktiveve të identifikuar dhe kriteret për vlerësim, procesverbalin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve në referencë UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Të merren masa për të shmangur kryerjen e shpenzimeve personale me paratë publike dhe përfshirjen e tyre në inventarët e njësisë;

Në rastin e përfaqësisë Izrael, të merren masa për sistemim të diferencave dhe nxirret përgjegjësia për to sikundër trajtuar në material.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se nuk janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

36.1. Rekomandimi:

Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e vakancave të krijuara në stafin e institucionit dhe shërbimin e jashtëm.

Për të gjitha lëvizjet e reja nga pozicione në strukturën e MEPJ drejt misioneve diplomatike apo posteve konsullore të ndiqet me korrektesë procedura e parashikuar sipas kuadrit ligjor në fuqi. Strukturat përkatëse në MEPJ të organizohen dhe koordinohen në mënyrë që në vijim vendimet e KKD, të eprorit direkt dhe të strukturës trajnuese, për përfitimin e gradës “Atashe” të përcillen pranë Ministres jo më vonë se një muaj përpara përfundimit të periudhës së provës.

Të merren masa për zëvendësimin e punonjësve në tre pozicionet në të cilat janë emëruar punonjës ku grada diplomatike personale nuk ju përputhet me gradën diplomatike sipas hierarkisë së gradave.

Menjëherë dhe vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se marra nga subjekti nuk janë të plota . Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

37.1. Rekomandimi:

Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme për miratimin e strukturave të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore, si dhe për çdo rast për përcaktimin e numrit të personelit në këto struktura të lidhë marrëveshjet me shtetet pritëse.

Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme, që për çdo vit të miratojë plane vjetore të emërimeve/mbarimit të detyrës në misionet diplomatike dhe postet konsullore.

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në process zbatimi**.

37.2. Rekomandimi:

Të merren masa për largimin nga pozicionet e emërimit dhe heqjen e statusit të diplomatit të personelit të misioneve diplomatike, të cilët vijnë të kryejnë funksione diplomatike edhe pse kanë mbushur moshën e pensionit. Të merren masa për largimin nga pozicioni i emërimit për punonjësit që kanë mbushur moshën e pensionit në MEPJ.

Të merren masa për zëvendësimin nga postet pranë misioneve diplomatike dhe posteve konsullore, për 64 (gjashtëdhjetë e katër) anëtarët e personelit të misioneve diplomatike apo poste konsullore të cilët vijnë të mbajnë këto poste edhe pasi ka përfunduar afati 3 vjeçar.

Të merren masa për zëvendësimin nga detyra si Kreu i Misionit Diplomatik, të diplomatit me gradë personale “Sekretar i Tretë”, i emëruar në pozicionin i ngarkuar me punë a.i, i cili vijon ta ushtroj këtë detyrë vijon për një periudhë mbi 2 vjet.

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar shkresës nr. 15297/1, date 5.12.2023 raportuar në DAP dhe KMSHC) rezulton se janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit, por procesi i zbatimit nuk është i plotë. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

37.3. Rekomandimi:

Të ngrihet grup pune me qëllim verifikimin nëse 28 (njëzetë e tetë) punonjësit e emëruar si raste të veçanta, ekspertë jashtë Shërbimit të Jashtëm, zotërojnë njohuri dhe ekspertizë, sipas specifikave të pozicionit të emërimit. Në varësi të përfundimit të arritur prej grupit të merren masa për qëndrimin e mëtejshëm të tyre në atë pozicion apo largimin e tyre.

Të merren masa për largimin nga pozicionet e punës së 64 (gjashtëdhjetë e katër) diplomatë të cilët punojnë pranë misioneve diplomatike dhe nuk ju përputhet grada emërore me gradën personale dhe vendosjen në pozicione të tjera pune në të cilat ju përputhet grada emërore me gradën personale.

Menjëherë dhe vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

38.1 Rekomandimi:

Komisionit të Karrierës Diplomatike, të marrë masa për të zhvilluar mbledhjet brenda afateve ligjore dhe pa vonesa, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për shërbimin e jashtëm.

Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme për vendimmarrje dhe përcjelljen pranë Presidentit të Republikës, me qëllim dhënien e gradës “Ambasador” për 4 (katër) diplomatët e karrierës për të cilët është shprehur Komisioni i Karrierës Diplomatike (KKD).

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

39.1. Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ-së të merren masa për planifikim dhe shpërndarjen e fondeve buxhetor në kohën e duhur dhe sipas prioriteteve të projekteve në kuadër të mbështetjes për Shqipërinë dhe forcimin e rolit të saj në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian si dhe shmangien e vonesave në implementimin e projekteve.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

40.1. Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ-së të merren masa që në çdo rast, përpara inicimit të një procesi zgjerimi apo shtimi në poste konsullore apo të stafit në postet ekzistuese duke miratuar dhe fondet përkatëse, të merren masat për koordinimin e politikës së jashtme të ndërmarr nga MEPJ dhe Qeveria Shqiptare me qëllim mbarëvajtjen e saj.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

1.1 Rekomandimi:

MEPJ të marrë të gjitha masat për arkëtimin e vlerës prej 345,600 lekë si penalitet i pa mbajtur ndaj kontraktorit “I” SHPK për kryerje punimesh me 100 ditë vonesë, në kundërshtim me parashikimet e dokumenteve të tenderit.

Deri më 31.12.2023

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar shkresës nr.4071 prot., datë 18.03.2024 rezulton se janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit me vonesë në raport me afatin e zbatimit të rekomandimit, por procedurat për zbatimin e plotë janë në vijim. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

2.1 Rekomandimi:

MEPJ të marrë të gjitha masat për arkëtimin e vlerës prej 292,800 lekë për penalitet të pa mbajtur kontraktorit “I” SHPK për kryerje punimesh me 100 ditë vonesë.

Deri më 31.12.2023.

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar. Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

3.1 Rekomandimi:

MEPJ të marrë masa që t'i kërkojë kontraktorit “C.”, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e shumës 117,600 lekë.

Deri më 31.12.2023.

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

D. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1 Rekomandim:

Nga ana e DAB të MEPJ-së të merren masa për të risjellë në vëmendje të titullarit të institucionit, nevojën për të ndërmarrë nismën për ekzekutimin e masave të lëna nga ana e grupit të auditit të brendshëm lidhur me raportin e lënë në përfaqësinë e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Spanjës, ku impakti financiar në dëm të buxhetit të përfaqësisë Madrid është në vlerën 5,784.42 Euro.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

2. 1 Rekomandimi:

Nga Drejtoria Juridike dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të MEPJ të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

3.1 Rekomandimi:

Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të verifikuar vlerën prej 10,147.2 Euro dhe të operohet duke mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin nr.26, neni 4, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 30, datë, 27.12.2011 i ndryshuar, paragrafi 34-36, si dhe të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar, kreu II, paragrafi 2.2.

Nga ana e MEPJ të ngrihet një grup pune me specialistë të fushës për të saktësuar vlerën e mësipërme si dhe për të identifikuar destinacionin e shpenzimeve të kryera nga kjo përfaqësi.

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar shkresave nr. 6327, dhe nr. 6350 datë 25.04.2024, përfaqësitë diplomatike janë në proces verifikimi sipas rekomandimeve të KLSH. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

4. 1 Rekomandimi:

Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të verifikuar vlerën totale prej 2,065.57 Euro dhe të operohet duke mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin nr.26, neni 4, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 30, datë, 27.12.2011 i ndryshuar, paragrafi 34-36, si dhe të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar, kreu II, paragrafi 2.2.

Nga ana e MEPJ të ngrihet një grup pune me specialistë të fushës për të saktësuar vlerën e mësipërme si dhe për të identifikuar destinacionin e shpenzimeve të kryera nga kjo përfaqësi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar shkresave nr. 6327, dhe nr. 6350 datë 25.04.2024, përfaqësitë diplomatike janë në proces verifikimi sipas rekomandimeve të KLSH. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

5.1 Rekomandimi:

Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të verifikuar vlerën totale prej 931.72 Euro si dhe të operohet duke mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin nr.26, neni 4, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 30, datë, 27.12.2011 i ndryshuar, paragrafi 34-36, si dhe të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar, kreu II, paragrafi 2.2.

Nga ana e MEPJ të ngrihet një grup pune me specialistë të fushës për të saktësuar vlerën e mësipërme si dhe për të identifikuar destinacionin e shpenzimeve të kryera nga kjo përfaqësi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar shkresave të MEPJ nr. 6327, dhe nr. 6350 datë 25.04.2024, përfaqësitë diplomatike janë në proces verifikimi sipas rekomandimeve të KLSH

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

6. 1 Rekomandimi:

Të merren masa për hartimin e gjurmës rregullatore lidhur me shpenzimet e transportit publik si dhe përdorimit të taksive, nga ana e stafit të misionëve diplomatik dhe konsullorë;

Të merren masa për hartimin e gjurmës së plotë të argumentimit dhe miratimit lidhur me nevojën për kryerje të udhëtimeve;

Përfaqësia Mynih, të marr masa për plotësim të praktikës dokumentare për të gjitha rastet e lëvizjeve;

Përfaqësinë Athinë, të marr masa për verifikim të vlerës prej 2,509.08 Euro dhe 285.82 Euro për shpenzime udhëtimi e cila rezulton e pambuluar me dokumentacion justifikues, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues.

Përfaqësia BE - Bruksel, të marr masa për plotësim të praktikës dokumentare për të gjitha rastet e lëvizjeve si dhe verifikim të vlerës prej 600.91 Euro, e cila rezulton e pambuluar me dokumentacion justifikues;

Përfaqësia Berlin, të marr masa për plotësim të praktikave dokumentare;

Përfaqësia Londër, të marr masa për verifikim të vlerës totale prej 1,331.25 Paund Britanik e pambështetur në dokumentacion justifikues, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues.

Përfaqësia Madrid, të marr masa për verifikim të vlerës prej 710.5 Euro si dhe plotësim të praktikës dokumentare për të gjitha rastet e lëvizjeve plotësim të praktikës dokumentare për të gjitha rastet e lëvizjeve

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar shkresave të MEPJ nr. 6327, dhe nr. 6350 datë 25.04.2024, përfaqësitë diplomatike janë në proces verifikimi sipas rekomandimeve të KLSH Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

7.1. Rekomandimi:

Përfaqësia Paris të marrë masa për verifikim të vlerës prej 144.84 Euro, e pa mbështetur në dokumentacionin mbështetës, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues.

Përfaqësia Berlin të marrë masa për mbajtje të dokumentacionit në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin nr.26, neni 4, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për MFK”, i ndryshuar, si dhe kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 30, datë, 27.12.2011 i ndryshuar, paragrafi 34-36 dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar, kreu II, paragrafi 2.2

Përfaqësia Romë të marrë masa për verifikim të vlerës prej 461.32 Euro, e pa mbështetur në dokumentacionin mbështetës, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;

Përfaqësia Londër të marrë masa për plotësim të praktikave dokumentare me të gjithë dokumentacionin justifikues të nevojshëm;

Përfaqësia Vjenë të marrë masa për plotësim të praktikave dokumentare me të gjithë dokumentacionin justifikues të nevojshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar shkresavete MEPJ nr. 6327, dhe nr. 6350 datë 25.04.2024, përfaqësitë diplomatike janë në proces verifikimi sipas rekomandimeve të KLSH

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

8.1 Rekomandimi:

Nga ana e përfaqësive tona në Milano, në Paris, në Mynih, në Berlin; si dhe nga përfaqësia BE në Bruksel:

të merren masa për të mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin nr.26, neni 4, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 30, datë, 27.12.2011 i ndryshuar, paragrafi 34-36, përcaktimet e Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar, kreu II, paragrafi 2.2, i ndryshuar si dhe akteve udhëzuese të nxjerra nga ana e MEPJ.

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar shkresavete MEPJ nr. 6327, dhe nr. 6350 datë 25.04.2024, përfaqësitë diplomatike janë në proces verifikimi sipas rekomandimeve të KLSH
Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

8.2. Rekomandimi:

Nga ana e përfaqësive tona në Madrid, Uashington, Romë:

Nga ana e përfaqësive respektive, të merren masa për të mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin nr.26, neni 4, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 30, datë, 27.12.2011 i ndryshuar, paragrafi 34-36, përcaktimet e Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar, kreu II, paragrafi 2.2, i ndryshuar si dhe akteve udhëzuese të nxjerra nga ana e MEPJ, si dhe të plotësojnë praktikat dokumentare me të gjithë elementët përkatës, në përputhje me kërkesat e miradministrimit financiar.

MEPJ në bashkëpunim me përfaqësinë Madrid, të marrë masa për verifikim të vlerës prej 903.34 Euro dhe 36.03 Euro mbartur prej 2020 pa dokumentacion justifikues, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;

MEPJ në bashkëpunim me përfaqësinë Uashington, të marrë masa për të verifikuar vlerën totale prej 1,565.67 Dollar;

MEPJ në bashkëpunim me përfaqësinë Romë, të marrë masa për verifikimin e vlerës prej 2,614.65 Euro.

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar shkresave të MEPJ nr. 6327, dhe nr. 6350 datë 25.04.2024, përfaqësitë diplomatike janë në proces verifikimi sipas rekomandimeve të KLSH
Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

8.3. Rekomandimi:

Nga ana e përfaqësisë sonë në Londër:

Të merren masa që në të gjitha rastet e trajtimit të një blerje si emergjente, autoriteti të vërtetojë, argumentojë dhe dokumentojë se nevoja ekstreme apo situata emergjente nuk janë shkaktuar nga veprimi a mosveprimi i tij;

Të merren masa për të verifikuar vlerën prej 1,370 £, e rezultuar si diferencë mes vlerës së faturave të dhe evidencës përmbledhëse, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues në përputhje me kërkesat e miradministrimit financiar.

Të merren masa për të unifikuar formatet dhe konsoliduar veprimtarinë e përfaqësisë në të njëjtën evidencë përmbledhëse dhe në kuadër të sistemit të raportimit financiar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar shkresave të MEPJ nr. 6327, dhe nr. 6350 datë 25.04.2024, përfaqësitë diplomatike janë në proces verifikimi sipas rekomandimeve të KLSH.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

9.1 Rekomandimi:

Në lidhje me Përfaqësinë New york, të marrë këto masa:

- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 29,041.35 USD për broker fees, paguar në kundërshtim me VKM nr.20, datë 18.01.2017, pika 10, germa ç, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;
- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar dhe konfirmuar vlerën prej 2,952 USD, paguar për qëndrimin në Hotel Kimberly të grupit të auditit të MEPJ-së, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;
- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 2,104.55 Dollar, biletë avioni dhe shtesë në të, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;

Përfaqësia BE-Bruksel, të marr masa:

- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 395.48 Euro pagesa për hotel, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;
- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 81.88 Euro pagesa për hotel kryer, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;
- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 271.96 Euro, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;

Në lidhje me Përfaqësinë Milano, të marrë këto masa:

- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 99.98 Euro prerë për itinerarin “Budapest – Milano”, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;
- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 134 Euro për të cilën nuk arrin të identifikohet produkti apo shërbimi i marr, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;
- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 947.63 Euro nuk arrin të identifikohet se për cilin është paguar, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;
- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 28.846 all për itinerarin Tiranë Bergamo, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;
- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 192.8 Euro total, për itinerarin Milano-Santiago-Milano, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;

Në lidhje me Përfaqësinë Athinë, të marr këto masa:

- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 1,488 Euro pagesë e kryer për agjenci imobiliare, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Lartë të Arkivave, nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, pika 9, neni 4.

Në lidhje me Përfaqësinë Romë, të marrë këto masa:

- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën totale prej 3,470.1 Euro si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;

Në lidhje me Përfaqësinë Londër të marrë këto masa:

- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën totale prej 910 GBP si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;

Në lidhje me Përfaqësinë Përfaqësia Uashington të marrë këto masa:

- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën totale prej 669.13 USD si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;

Në lidhje me Përfaqësinë Podgoricë të marrë këto masa:

- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar dokumentacionin justifikues për ra trajtohet në raportin përfundimtar të auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar shkresave të MEPJ nr. 6327, dhe nr. 6350 datë 25.04.2024, përfaqësitë diplomatike janë në proces verifikimi sipas rekomandimeve të KLSH Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

10. 1 Rekomandimi:

Nga ana e përfaqësisë të kryhet analiza kosto përfitim dhe të gjykohet për vijueshmërinë duke patur në konsideratë menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike. Të kryhet analizimi i këtyre situacioneve/ faturave dhe pagesave të bëra në vlerën prej **4,385.87 Euro**, duke kërkuar argumentimin e nevojave dhe nxjerrjen e përgjegjësi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar shkresave të MEPJ nr. 6327, dhe nr. 6350 datë 25.04.2024, përfaqësitë diplomatike janë në proces verifikimi sipas rekomandimeve të KLSH. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**

E.MASA DISIPLINORE

Për punonjësit në marrëdhënie pune

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germet (b, c, ç) e nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, sipas përgjegjësisë individuale të nis procedurat për dhënien e masave disiplinore sipas shkallës nga “Vërejtje”, “Pezullim nga drejta e ngritjes në detyrë” deri në “Largim”, për punonjësit si më poshtë:

“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë për një periudhë deri në 1 vit”

Z. P. K, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara për hartimin e pasqyrave financiare të Aparatit dhe të Konsoliduara, viti 2021-2022; për mangësitë/parregullsitë e konstatuara lidhur me mos marrjen e masave për arkëtimin e debitorëve dhe të drejtave të munguara, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara në lidhje me regjistrin e aktiveve, sa më sipër në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Financës;

Z. S.G, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara në administrimin e shpenzimeve të karburanteve, mos hartimin e normativave të harxhimit/konsumit të karburantit; mos verifikimin e kilometrave të kryera nga makinat e Ministrisë; mos dokumentimin e plotë dhe të saktë të lëvizjeve sa më sipër në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve dhe Prokurimeve, si dhe

- për mosrealizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të personelit dhe në ambientet e përbashkëta të MEPJ, në cilësinë e kryetarit të komisionit të inventarizimit,

- për mangësitë/parregullsitë e konstatuara në hartimin e dokumenteve të tenderit, për procedurat si më poshtë: blerje dhe vendosje ashensor godine, viti 2021, blerje dhe vendosje gjenerator godine, viti 2022, blerje sigurim shëndeti, shëndeti në udhëtim dhe jete, viti 2022, në cilësinë e kryetarit të njësisë së prokurimit,

- për mos inventarizimin e dosjeve të prokurimit ku ka qenë pjesëmarrës, në cilësinë e anëtarit të komisioneve në procedurat e prokurimit publik,

- për problematikat e konstatuara në procedurat e blerjeve me vlerë të vogël dhe ato emergjente, në cilësinë e Kryetarit të komisionit për blerjet e vogla;

Znj. O.C, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara për mos rakordimin e të ardhurave konsullore, duke operuar në kundërshtim me bazën ligjore, konkretisht Udhëzimin nr.37, datë 31/12/2014 pika 5 e tij, në cilësinë e Drejtorit të Çështjeve Konsullore, Për të ardhurat e mbledhura nga agjentët e mbledhjes së tarifave (Posta Shqiptare, TNT, Albania Courier dhe Albania Delivery Express) nga ana e MEPJ-së nuk mbahej asnjë aktrakordimi me degën e thesarit, në kundërshtim me Udhëzimin nr.37, datë 31.12.2014

“Largim nga shërbimi civil”

Znj. I.D, për parregullsi të theksuara në fushën e organizimit, funksionimit dhe menaxhimit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar, mos hartim të strategjisë së riskut, mos hartim të regjistrit të riskut, mos evidentim i asnjë raporti monitorimi të fushave me risk, për mos hartimin dhe mos miratimin e gjurmës së auditimit, për mos hartim të pyetësorit të vetëvlerësimit, mos hartim dhe mos dërgim në MFE i Raportit të monitorimit të Kontrollit të Brendshëm, sa më sipër në cilësinë e Nëpunësit Zbatues;

- për mangësitë/parregullsitë e konstatuara për mos kryerjen e procesit të inventarizimit të pasurisë publike, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara lidhur me përfaqësitë diplomatike, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm.

“Vërejtje”

Z. E.H, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara për procedurat si më poshtë: Përkthim i legjisllacionit të Bashkimit Evropian”, viti 2021, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,

- për problematikat e konstatuara në procedurat e blerjeve me vlerë të vogël dhe ato emergjente, në cilësinë e anëtarit të komisionit për blerjet e vogla,

- për mos inventarizimin e dosjeve të prokurimit ku ka qenë pjesëmarrës, në cilësinë e anëtarit të komisioneve në procedurat e prokurimit publik,

- për mos kryerjen e inventarizimit ku ka qenë pjesëmarrës, në cilësinë e anëtarit të komisionit të inventarizimit të aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të personelit dhe në ambientet e përbashkëta të MEPJ;

Z. E.Z për mos kryerjen e inventarizimit ku ka qenë pjesëmarrës në cilësinë e anëtarit të komisionit të inventarizimit të aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të personelit dhe në ambientet e përbashkëta të MEPJ.

Znj. N.K për mos kryerjen e inventarizimit ku ka qenë pjesëmarrës në cilësinë e anëtarit të komisionit të inventarizimit të aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të personelit dhe në ambientet e përbashkëta të MEPJ.

Z. G.H, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara në hartimin e dokumenteve të tenderit, për procedurat si më poshtë: blerje dhe vendosje ashensor godine, viti 2021, Blerje dhe vendosje gjenerator godine, viti 2022, blerje sigurim shëndeti, shëndeti në udhëtim dhe jete, viti 2022, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit,

- për mos inventarizimin e dosjeve të prokurimit ku ka qenë pjesëmarrës, në cilësinë e anëtarit të komisioneve në procedurat e prokurimit publik.

- për problematikat e konstatuara në procedurat e blerjeve me vlerë të vogël dhe ato emergjente, në cilësinë e anëtarit të komisionit për blerjet e vogla,

- për mos kryerjen e inventarizimit ku ka qenë pjesëmarrës, në cilësinë e anëtarit të komisionit të inventarizimit të aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të personelit dhe në ambientet e përbashkëta të MEPJ;

Znj. E.Sh, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara për procedurat si më poshtë: Përkthim i legjislacionit të Bashkimit Evropian”, viti 2021, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

- për mos inventarizimin e dosjeve të prokurimit ku ka qenë pjesëmarrës, në cilësinë e anëtarit të komisioneve në procedurat e prokurimit publik;

Z. A.H, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara për procedurat si më poshtë: Blerje dhe vendosje ashensor godine, viti 2021, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,

- për mos inventarizimin e dosjeve të prokurimit ku ka qenë pjesëmarrës, në cilësinë e anëtarit të komisioneve në procedurat e prokurimit publik;

Znj. E.Dh, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara në hartimin e dokumenteve të tenderit, për procedurat si më poshtë: Blerje dhe vendosje ashensor godine, viti 2021, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit;

Znj. E.I për mangësitë/parregullsitë e konstatuara për procedurat si më poshtë: Blerje dhe vendosje ashensor godine, viti 2021 në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

Nga verifikimi u konstatua se: Rekomandimet e lëna për tre lloje masash disiplinore për punonjësit e MEPJ konsiderohen të pranura nga grupi i auditimit, pasi institucioni nuk është shprehur për mospranimin e tyre, referuar kërkesave e përcaktimeve të ligjit organik për KLSH dhe Vendimit të Kryetarit të KLSH-së Nr.67, datë 23.06.2020 “Për Miratimin e Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve si dhe të regjistrimit institucional të zbatimit të rekomandimeve” faqe 14 pasi Institucioni nuk është shprehur në plan veprimin 6-mujor përcjellë në KLSH me shkresën Nr. 4911/1 Prot, datë 20.05.2024.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimet konsiderohen të pranura nga subjekti dhe të **pazbatuara**.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Në përfundim të procesit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, rezulton se nga **78** rekomandime të lëna, nga Subjekti **MEPJ** janë pranuar të **78** rekomandimeve, nga të cilat: janë zbatuar **10** masa ose **12.8% e tyre**; 7-masa janë zbatuar pjesërisht; **22**-masa janë në proces zbatimi si dhe **39** masa janë pa zbatuar, pra **43**- masa mbeten për tu zbatuar nga subjekti **MEPJ**, për periudhën në vijim. Grupi i auditimit duke analizuar Rekomandimet e pranura dhe të zbatuara nga **MEPJ** (njësitë përgjegjëse të saj) apo dhe ato në proces zbatimi, arriti në konkluzionin që: - Për kategorinë "Për përmirësim legjislacioni" R 1.1; R4.1; Për kategorinë "Masa Organizative"- Rekomandimet R 1.1; R 2.1; R 3.1; R 4.1; R 6.1; R 7.1; R 8.1; R 14.1; R 15.1; R 18.1; R 19.1; R 20.1; R 21.1; R 22.1; R 23.1; R 24.1; R 28.1; R 29.1; R 37.1; R 38.1; R 39.1; R 40.1; - Kategorinë "Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave"- R 2.1; R 3.1; R 4.1; R 5.1; R 6.1; R 7.1; R 8.1; R 8.2; R 8.3; R 9.1; R 10.1; janë pranuar dhe zbatuar apo në proces zbatimi nga **MEPJ**, prandaj nuk mund të qëndrojnë për periudhën në vijim.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmisimin e gjëndjes *Rikërkojmë që*, **MEPJ** të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara si dhe pjesërisht zbatuar brenda 3-mujorit të parë të vitit 2025.

Si dhe marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH-së të pranura prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:

2.1. Rekomandimi: Të merren masat nga ana e institucionit, për hartimin dhe miratimin nga ana e Ministrit të urdhëresave dhe metodologjive të brendshme që përcaktojnë rregullat dhe normojnë kriteret e limitet, gjurmët e auditimit, aprovimet dhe procedurën që duhet zbatuar në lidhje me marrjen me qira të godinave të ambasadave dhe selive diplomatike apo apartamenteve në përdorim të diplomatëve gjatë ushtrimit të funksionit zyrtar prej tyre si dhe mënyrës së zbatimit të gjurmës dhe procedurave të detyrueshme për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimeve.

3.1. Rekomandimi: Të merren masa të menjëhershme për nxjerrjen e udhëzimeve, që do të vijnë në ndihmë për zbatimin me korrektësi të dispozitave të ligjit të posaçëm, lidhur me procedurat e rekrutimit të ekspertëve të jashtëm, përcaktimin e afatit maksimal të qëndrimit në pozicionin e kreut të misionit diplomatik në situata të përkohshme, rotacionet e emërimeve në përfaqësi, si dhe çdo aspekt tjetër të konstatuar në veprimtarinë praktike, për të cilën kuadri ligjor aktual nuk është shprehur, apo lë vend për interpretim, duke shmangur në këtë mënyrë mungesën e theksuar të transparencës dhe vendimmarrjen subjektive.

B.MASA ORGANIZATIVE:

5.1.Rekomandimi: Nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të kërkohet dhe të ndiqet në vijimësi arkëtimi i të drejtave të arkëtueshme (debitorët), duke zbatuar të gjitha procedurat e nevojshme në rrugë administrative e ligjore, deri në finalizimin e arkëtimit të këtyre vlerave.

9.1 Rekomandimi: Nga ana e **MEPJ**-së të merren masa konkrete për të arkëtuar vlerat e munguara dhe sistemuar diferencat reale të të ardhurave të munguara.

10.1 Rekomandimi: Të merren masa konkrete për kryerjen e veprimtarisë operative në përputhje dhe në zbatim me bazën ligjore rregullatore si dhe të zbatohen detyrimet e kontratës mes palëve “Posta Shqiptare” sh.a dhe MEPJ-së, sikundër edhe parashikohet në nenin 2 “Të drejtat dhe detyrimet e palëve”, pika 2.3 dhe 2.4 e saj.

11.1 Rekomandimi: Nga ana e MEPJ-së të merren masat për të kryer rakordimin dhe unifikim të vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare, me vlerat e paraqitura në aktet e rakordimit të kundërfirmuara me degën e thesarit, si dhe për rastet e mospërputhjeve të bëhen shpjegimet e nevojshme në relacionet që shoqërojnë pasqyrat financiare vjetore.

Të hartohet dhe nënshkruhen rregullisht situacionet mujore, periodike dhe vjetore për shpenzimet e ushtrimit nga veprimtaria e MEPJ dhe për çdo mospërputhje të të dhënave të pasqyrave financiare që shoqërojnë bilancin kontabël, të jepen shpjegimet sqaruese për çdo rast.

12.1 Rekomandimi: Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të ndërtuar dhe përditësuar regjistrin e aktiveve në përputhje me detyrimet e normuara në Udhëzimin e MFE nr.30 datë. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik”, i ndryshuar.

13.1 Rekomandimi: Të merren masa të menjëhershme për të iniciuar procedurat e inventarizimit të aseteve të njësisë dhe çdo aktiv tjetër që ky Institucion disponon për të verifikuar e rakorduar gjendjen fizike të tyre me të dhënat e librave të llogarisë.

Të kryhet rakordimi i gjendjes fizike me gjendjen kontabël në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së aktiveve të njësisë.

16.1 Rekomandim: Të merren masa të dokumentohen dhe monitorohen me korrektesë lëvizjet e automjeteve me qëllim që të shmangur veprimet që sjellin keqadministrim financiar të fondeve publike.

17.1. Rekomandimi: Njësitë e Prokurimit në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të marrin masa për hartimin e kriterëve të kualifikimit në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

17.2. Rekomandimi: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të marrin masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për punë publike, mallra, shërbime me shkelje ligjore, dhe të shpallura fitues në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara në DST, me qëllim garantimin e përdorimit me eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

17.3. Rekomandimi: Me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumenteve zyrtare të procedurave të prokurimit, nga ana e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

25.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse të MEPJ-së, në të gjitha rastet të tregohen sa më korrekte në likuidimin e faturave të pranuar sipas kushteve të përcaktuara për pagesë, me qëllim shmangien e kostove të tjera shtesë për buxhetin e saj si dhe të nxirren përgjegjësitë për çdo rast penaliteti të ardhur si pasojë e neglizhencës së zyrtarëve të institucionit.

26.1. Rekomandimi: Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të hartuar dhe paraqitur pasqyrat financiare individuale nga këto njësi shpenzuese në përputhje me Udhëzimet dhe formatatet zyrtare të miratuara nga Ministria përgjegjëse për financat.

Nga ana e MEPJ-së të përditësohet, standardizohet dhe zyrtarizohet evidenca, e cila do të përdoret për raportimin e shpenzimeve nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore në MEPJ.

27.1 Rekomandimi: Nga ana e MEPJ të merren masat për evidentimin, regjistrimin dhe pasqyrimin në kontabilitet të elementeve analitike inventarialë që bëjnë pjesë në llogaritë e aktiveve afatgjata dhe aktiveve qarkulluese duke garantuar elementet e kontrollit të përvitshëm të ekzistencës së aktiveve nëpërmjet inventarizimit vjetor e periodik, për të evituar riskun e humbjes dhe keqadministrimit të aktiveve.

30.1 Rekomandimi: Nga ana e përfaqësive të merren masa për të punuar, zbatuar dhe mbikëqyrur me korrektesë Urdhrin nr. 507, datë 15.10.2012 të Ministrit të Punëve të Jashtme, duke mbajtur në konsideratë plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm autorizues dhe justifikues sipas parashikimeve në bazën ligjore dhe aktet e tjera rregulluese.

Nga ana e përfaqësive të merren masa që i gjithë dokumentacioni të mbahet në mënyrë kronologjike dhe të plotë me qëllim kjo, verifikimin e përdorimit të sasisë së karburantit të furnizuar në përputhje me kriteret e miradministrimit material, si dhe kryqëzimin e të dhënave midis lëvizjeve të shoferëve dhe fletë udhëtimeve të plotësuara për lëvizjet e brendshme/ jashtme, duke rakorduar me kilometrat e përshkruara.

Nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore të merren masa për të kryer procesin e inventarizimit të aseteve që administrohen, me qëllim që në përfundim të procesit, të ngarkohen me procesverbal të rregullt tek personat përgjegjës që i kanë në ngarkim.

31.1. Rekomandimi: Nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore të merren masa për të plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm justifikues praktikën e bartjes së sendeve personale të përfaqësuesve dhe familjarëve të tyre ("cargo").

Të vlerësohet rast pas rasti praktika e cargo-ve nëpërmjet bashkëpunimit dhe bashkëveprimit mes përfaqësive dhe Drejtorisë së Financës së MEPJ-së.

32.2. Rekomandimi: Nga ana e MEPJ-së në bashkëpunim me përfaqësinë Pragë të merren masa për të kryer verifikimin e vlerës totale prej 4,958.89 Euro (detajuar si në gjetje);

32.3. Rekomandimi: Nga ana e përfaqësive Romë të merren masa për të kryer verifikimin e vlerës prej 2,380 Euro;

32.4. Rekomandimi: Nga ana e përfaqësive Madrid të merren masa për të verifikuar vlerën totale prej 2,481.86 Euro;

33.1 Rekomandimi: Nisur nga risku i lartë që mbart mbajtja e 4 llogarive të ndryshme bankare, (në 2 monedha të ndryshme), e kjo sjell impakt të konsiderueshëm nga kursi i këmbimit në konvertim, mundësi të larta për humbje nga kursi këmbimit, të merren masat për të rishikuar mbajtjen e vetëm 2 llogarive bankare sipas monedhave respektive.

34.1 Rekomandimi: Nga ana e secilës përfaqësi të merren masa për zbatimin e kuadrit të normave mbi mirëmenaxhimin material të magazinës, kryerjes së inventarizimit të saj periodik si dhe hartimin e kartelave personale të punonjësve.

35.1. Rekomandimi: Për shkak të ndjeshmërisë së lartë të vlerave të aktiveve qarkulluese, nga ana e secilës përfaqësie diplomatike dhe konsullore të merren masa për mirë menaxhimin e këtyre zërave të pronës shtetërore dhe kryerjen e procesit të rregullt të inventarizimit të tyre. Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues i MEPJ-së në bashkëpunim me titullarët e përfaqësive të marrin masa të kryejnë procesin e inventarizimit të aktiveve dhe të procedojnë në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Të merren masa për të kryer evidentim të plotë të situatës së inventarizimit për çdo llogari, arsyetimi i shkaqeve mbi inventarin jashtë funksionit, qëndrimi i titullarit / disponimi mbi mënyrën se si do të procedohet në vijim, etj.

Të merren masa për aktivet që janë për dalje jashtë përdorimit të procedojnë në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011, duke iniciuar procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi; listën e aktiveve të identifikuara dhe kriteret për vlerësim, procesverbalin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve në referencë UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Të merren masa për të shmangur kryerjen e shpenzimeve personale me paratë publike dhe përfshirjen e tyre në inventarët e njësisë;

Në rastin e përfaqësisë Izrael, të merren masa për sistemim të diferencave dhe nxirret përgjegjësia për to sikundër trajtuar në material.

36.1. Rekomandimi: Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e vakancave të krijuara në stafin e institucionit dhe shërbimin e jashtëm.

Për të gjitha lëvizjet e reja nga pozicione në strukturën e MEPJ drejt misioneve diplomatike apo posteve konsullore të ndiqet me korrektesë procedura e parashikuar sipas kuadrit ligjor në fuqi. Strukturat përkatëse në MEPJ të organizohen dhe koordinohen në mënyrë që në vijim vendimet e KKD, të eprorit direkt dhe të strukturës trajnuese, për përfitimin e gradës “Atashe” të përcillen pranë Ministres jo më vonë se një muaj përpara përfundimit të periudhës së provës.

Të merren masa për zëvendësimin e punonjësve në tre pozicionet në të cilat janë emëruar punonjës ku grada diplomatike personale nuk ju përputhet me gradën diplomatike sipas hierarkisë së gradave.

37.2. Rekomandimi: Të merren masa për largimin nga pozicionet e emërimit dhe heqjen e statusit të diplomatit të personelit të misioneve diplomatike, të cilët vijnë të kryejnë funksione diplomatike edhe pse kanë mbushur moshën e pensionit. Të merren masa për largimin nga pozicioni i emërimit për punonjësit që kanë mbushur moshën e pensionit në MEPJ.

Të merren masa për zëvendësimin nga postet pranë misioneve diplomatike dhe posteve konsullore, për 64 (gjashtëdhjetë e katër) anëtarët e personelit të misioneve diplomatike apo poste konsullore të cilët vijnë të mbajnë këto poste edhe pasi ka përfunduar afati 3 vjeçar.

Të merren masa për zëvendësimin nga detyra si Kreu i Misionit Diplomatik, të diplomatit me gradë personale “Sekretar i Tretë”, i emëruar në pozicionin i ngarkuar me punë a.i, i cili vijon ta ushtroj këtë detyrë vijon për një periudhë mbi 2 vjet.

37.3. Rekomandimi: Të ngrihet grup pune me qëllim verifikimin nëse 28 (njëzetë e tetë) punonjësit e emëruar si raste të veçanta, ekspertë jashtë Shërbimit të Jashtëm, zotërojnë njohuri dhe ekspertizë, sipas specifikave të pozicionit të emërimit. Në varësi të përfundimit të arritur prej grupit të merren masa për qëndrimin e mëtejshëm të tyre në atë pozicion apo

largimin e tyre.

Të merren masa për largimin nga pozicionet e punës së 64 (gjashtëdhjetë e katër) diplomatë të cilët punojnë pranë misioneve diplomatike dhe nuk ju përputhet grada emërore me gradën personale dhe vendosjen në pozicione të tjera pune në të cilat ju përputhet grada emërore me gradën personale.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

1.1 Rekomandimi: MEPJ të marrë të gjitha masat për arkëtimin e vlerës prej 345,600 lekë si penalitet i pa mbajtur ndaj kontraktorit “I.” SHPK për kryerje punimesh me 100 ditë vonesë, në kundërshtim me parashikimet e dokumenteve të tenderit.

2.1 Rekomandimi: MEPJ të marrë të gjitha masat për arkëtimin e vlerës prej 292,800 lekë për penalitet të pa mbajtur kontraktorit “I.” SHPK për kryerje punimesh me 100 ditë vonesë.

3.1 Rekomandimi: MEPJ të marrë masa që t’i kërkojë kontraktorit “C.”, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e shumës 117,600 lekë.

D.MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:

1.1 Rekomandim: Nga ana e DAB të MEPJ-së të merren masa për të risjellë në vëmendje të titullarit të institucionit, nevojën për të ndërmarrë nismën për ekzekutimin e masave të lëna nga ana e grupit të auditit të brendshëm lidhur me raportin e lënë në përfaqësinë e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Spanjës, ku impakti financiar në dëm të buxhetit të përfaqësisë Madrid është në vlerën 5,784.42 Euro.

E. MASA DISIPLINORE:

“Për punonjësit në marrëdhënie pune”

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germat (b, c, ç) e nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, sipas përgjegjësisë individuale të nis procedurat për dhënien e masave disiplinore sipas shkallës nga “Vërejtje”, “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë” deri në “Largim”, për punonjësit si më poshtë:

“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë për një periudhë deri në 1 vit”

Z. P.K, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara për hartimin e pasqyrave financiare të Aparatit dhe të Konsoliduara, viti 2021-2022; për mangësitë/parregullsitë e konstatuara lidhur me mos marrjen e masave për arkëtimin e debitorëve dhe të drejtave të munguara, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara në lidhje me regjistrin e aktiveve, sa më sipër në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Financës;

Z. S.G, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara në administrimin e shpenzimeve të karburanteve, mos hartimin e normativave të harxhimit/konsumit të karburantit; mos verifikimin e kilometrave të kryera nga makinat e Ministrisë; mos dokumentimin e plotë dhe të saktë të lëvizjeve sa më sipër në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve dhe Prokurimeve, si dhe

- për mosrealizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të personelit dhe në ambientet e përbashkëta të MEPJ, në cilësinë e kryetarit të komisionit të

inventarizimit,

- për mangësitë/parregullsitë e konstatuara në hartimin e dokumenteve të tenderit, për procedurat si më poshtë: blerje dhe vendosje ashensor godine, viti 2021, blerje dhe vendosje gjenerator godine, viti 2022, blerje sigurim shëndeti, shëndeti në udhëtim dhe jete, viti 2022, në cilësinë e kryetarit të njësisë së prokurimit,

- për mos inventarizimin e dosjeve të prokurimit ku ka qenë pjesëmarrës, në cilësinë e anëtarit të komisioneve në procedurat e prokurimit publik,

- për problematikat e konstatuara në procedurat e blerjeve me vlerë të vogël dhe ato emergjente, në cilësinë e Kryetarit të komisionit për blerjet e vogla;

Znj. O.C, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara për mos rakordimin e të ardhurave konsullore, duke operuar në kundërshtim me bazën ligjore, konkretisht Udhëzimin nr.37, datë 31/12/2014 pika 5 e tij, në cilësinë e Drejtorit të Çështjeve Konsullore, Për të ardhurat e mbledhura nga agjentët e mbledhjes së tarifave (Posta Shqiptare, TNT, Albania Courier dhe Albania Delivery Express) nga ana e MEPJ-së nuk mbahej asnjë aktrakordimi me degën e thesarit, në kundërshtim me Udhëzimin nr.37, datë 31.12.2014

“Largim nga shërbimi civil”

Znj.I.D, për parregullsi të theksuara në fushën e organizimit, funksionimit dhe menaxhimit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar, mos hartim të strategjisë së riskut, mos hartim të regjistrimit të riskut, mos evidentim i asnjë raporti monitorimi të fushave me risk, për mos hartimin dhe mos miratimin e gjurmës së auditimit, për mos hartim të pyetësorit të vetëvlerësimit, mos hartim dhe mos dërgim në MFE i Raportit të monitorimit të Kontrollit të Brendshëm, sa më sipër në cilësinë e Nëpunësit Zbatues;

- për mangësitë/parregullsitë e konstatuara për mos kryerjen e procesit të inventarizimit të pasurisë publike, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara lidhur me përfaqësitë diplomatike, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm.

“Vërejtje”

Z. E.H, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara për procedurat si më poshtë: Përkthim i legjislacionit të Bashkimit Evropian”, viti 2021, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,

- për problematikat e konstatuara në procedurat e blerjeve me vlerë të vogël dhe ato emergjente, në cilësinë e anëtarit të komisionit për blerjet e vogla,

- për mos inventarizimin e dosjeve të prokurimit ku ka qenë pjesëmarrës, në cilësinë e anëtarit të komisioneve në procedurat e prokurimit publik,

- për mos kryerjen e inventarizimit ku ka qenë pjesëmarrës, në cilësinë e anëtarit të komisionit të inventarizimit të aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të personelit dhe në ambientet e përbashkëta të MEPJ;

Z. E.Z, për mos kryerjen e inventarizimit ku ka qenë pjesëmarrës në cilësinë e anëtarit të komisionit të inventarizimit të aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të personelit dhe në ambientet e përbashkëta të MEPJ.

Znj. N. K, për mos kryerjen e inventarizimit ku ka qenë pjesëmarrës në cilësinë e anëtarit të komisionit të inventarizimit të aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të personelit dhe në ambientet e përbashkëta të MEPJ.

Z. G. H, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara në hartimin e dokumenteve të tenderit, për procedurat si më poshtë: blerje dhe vendosje ashensor godine, viti 2021, Blerje dhe vendosje gjenerator godine, viti 2022, blerje sigurim shëndeti, shëndeti në udhëtim dhe jete, viti 2022, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit,

- për mos inventarizimin e dosjeve të prokurimit ku ka qenë pjesëmarrës, në cilësinë e anëtarit të komisioneve në procedurat e prokurimit publik.

- për problematikat e konstatuara në procedurat e blerjeve me vlerë të vogël dhe ato emergjente, në cilësinë e anëtarit të komisionit për blerjet e vogla,

- për mos kryerjen e inventarizimit ku ka qenë pjesëmarrës, në cilësinë e anëtarit të komisionit të inventarizimit të aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të personelit dhe në ambientet e përbashkëta të MEPJ.

Znj. E.Sh, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara për procedurat si më poshtë: Përkthim i legjislacionit të Bashkimit Evropian”, viti 2021, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

- për mos inventarizimin e dosjeve të prokurimit ku ka qenë pjesëmarrës, në cilësinë e anëtarit të komisioneve në procedurat e prokurimit publik;

Z. A.H, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara për procedurat si më poshtë:

Blerje dhe vendosje ashensor godine, viti 2021, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,

- për mos inventarizimin e dosjeve të prokurimit ku ka qenë pjesëmarrës, në cilësinë e anëtarit të komisioneve në procedurat e prokurimit publik;

Znj. E. Dh, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara në hartimin e dokumenteve të tenderit, për procedurat si më poshtë: Blerje dhe vendosje ashensor godine, viti 2021, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit;

Znj. E.I, për mangësitë/parregullsitë e konstatuara për procedurat si më poshtë:

Blerje dhe vendosje ashensor godine, viti 2021 në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

.....

3.3 MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQËNIES SOCIALE

3.3.1 PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditimin tematik në **Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** (*këtu e në vazhdim MSHMS*), me objekt “*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në vitin 2023*”, për periudhën objekt auditimi 01.04.2021 deri më datën 31.12.2022, përcjellë me shkresën Nr.1178/11 Prot, datë 31.07.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

Vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

Vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

Vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve;

Vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, si dhe Manualit “*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë dhe regjistrit elektronik institucional*”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 880/1 Prot, datë 02.07.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Auditimi u krye nga:

1. N.M, përgjegjës grupi
2. S.Z, anëtar

Auditimi filloi më datë 03.07.2024.

Auditimi përfundoi më datë 18.07.2024.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën Nr. 1178/11 Prot, datë 31.07.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetëror të KLSH-së.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLZIONI:

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **36** rekomandime si masa organizative, nga ku janë pranuar plotësisht **35** të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, **1** zbatuar plotësisht, **22** në proces zbatimi, **11** pa zbatuar, **1** zbatuar pjesërisht.

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **2** rekomandime për shpërblim dëmi në shumën **1,032.2 mijë lekë** nga ku **2** rekomandime të pranuar plotësisht, dhe **2** kanë statusin e ecurisë **në proces zbatimi**.

-Për marrjen e masave për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike është lënë **1 rekomandim**, i pranuar plotësisht në shumën totale **38,935 mijë lekë** dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit **zbatuar pjesërisht**.

-Për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, janë lënë **14 rekomandime** të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit **zbatuar plotësisht**.

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **2** rekomandime si masë administrative për **2** subjekte, të pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit, **zbatuar plotësisht**.

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **2** rekomandime për Njoftimin e Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, të pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit, **zbatuar plotësisht**.

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezulton në nivel **98.2 %**, konkretisht nga **57** rekomandime gjithsej, janë pranuar **56** rekomandime.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht rezultoi në masën **34%**, niveli i zbatimit të rekomandimeve në proces zbatimi rezultoi **43%**, niveli i rekomandimeve pa zbatuara rezultoi **21%**, niveli i rekomandimeve zbatuara pjesërisht rezultoi **2%** nivele këto të cilat tregojnë vlerësimin e ulët të këtij procesi në lidhje me ndjekjen e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

Nga auditimi i ushtruar në **MSHMS** për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, “*Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë*” për periudhën nga data 01.04.2021 deri më

31.12.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së me Nr.130, datë 26.07.2023, përcjellë me shkresën Nr.1178/11 Prot, datë 31.07.2023, rezultoi si më poshtë vijon:

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) të nenit 15, në Ligjin Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH me shkresën Nr.225/56 Prot, datë 21.08.2023, në përputhje me Ligjin Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, shkronja j.

-Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga ana e subjektit të audituar në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, MSHMS, ka raportuar në KLSH me shkresën Nr. 2969/2 Prot, datë 08.07.2024, jashtë afatit 6 mujor të raportimit në kundërshtim me Ligjin Nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 30, pika 2 e tij.

-Sa më sipër rezulton se nuk ka zbatuar afatin 6 mujor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III/3. Realizimi i rekomandimeve, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, rezulton si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik, të marrin masat e nevojshme në mënyrë që në periudhat në vijim të eliminohen praktikatat e çeljes së projekteve të reja pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore, si dhe të respektohen projektet e investimeve të parashikuara në PBA.

Në vijimësi

Observacion i ardhur nga MSHMS me shkresën Nr. 2969/9 Prot, datë 28.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr. 880/27 Prot, datë 30.10.2024.

Pretendimi i subjektit:

Dokumentacioni mbështetës (miratimi i transferimit për shpenzimet kapitale nga MF me nr. 1165/2, datë 11.03.2024, me nr. 655/29, datë 08.07.2024, Mli i SP së Ministrisë së Financave datë 26.04.2024)

-Justifikimi për rekomandimin 1.1 është i njëjtë me rekomandimin 2.1, rekomandim i cili, nga ana e grupit auditues të KLSH është konsideruar i pranuar nga subjekti dhe i zbatuar.

-Nisur nga sa më sipër Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kërkon që ky rekomandim të kalojë nga “në proces” në “i zbatuar”.

Referuar observacionit të ardhur pas periudhës së auditimit në terren, grupi i auditimit pasi shqyrtoi me vëmendje pretendimin e subjektit vendosi të mos e marrë në konsideratë pasi dokumentacioni i paraqitur në këtë fazë nuk paraqet fakt të ri.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi nuk paraqet *fakt të ri dhe nuk do të pranohet*. Sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm nuk pranohet.

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin mbështetës vendosur në dispozicion dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi është në proces zbatimi. Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me njësitë shpenzuese në varësi të saj dhe ekipet e ngritura për menaxhimin e programeve buxhetore të MSHMS, të marrin masatë nevojshme për rritjen e bashkëpunimit me tyre dhe kryerjen e një planifikimi sa më efektiv të fondeve në përputhje me objektivat institucionale, me qëllim shmangien e ndryshimeve të shpeshta në buxhet të fondeve, situatë kjo me impakt negativ në treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin mbështetës vendosur në dispozicion dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi është në proces zbatimi. Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

3.1 Rekomandimi: NA dhe NZ të marrin masat për monitorimin e zbatimit të Buxhetit të Shtetit duke hartuar raportet të monitorimit të buxhetit çdo katër muaj për aparatin e MSHMS si njësi shpenzuese për produktet e buxhetit të administruara nga ana e saj, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit.

Në vijimësi

Observacion i ardhur nga MSHMS me shkresën Nr. 2969/9 Prot, datë 28.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr. 880/27 Prot, datë 30.10.2024.

Pretendimi i subjektit:

Referuar sa më sipër kur insitucioni që nxjerr aktet ligjore dhe nënligjore “Për procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore” referon se Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si njësi shpenzuese dhe jo program buxhetor nuk mund të hartojë Raporti i Monitorimit për 4-8-12 mujorin, pasi nuk ka as akses në modulën e BPPM në sistemin AFMIS, kërkojmë që ky rekomandim të kalojë nga “në proces” në “i pazbatueshëm”

Referuar observacionit të ardhur pas periudhës së auditimit në terren, grupi i auditimit pasi shqyrtoi me vëmendje pretendimin e subjektit vendosi ta marrë në konsideratë pasi dokumentacioni i paraqitur në këtë fazë paraqet fakt të ri.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi paraqet *fakt të ri dhe do të pranohet*. Sa më sipër, observacioni merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm pranohet .

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi është i pa zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**

4.1 Rekomandimi: MSHMS të marrë masat për një planifikim/programim sa më real dhe të besueshëm të buxhetit, duke u mbështetur në analizën e të dhënave që raportohet nga Sektori i Financës, si dhe të dhënave që gjenerohen nga sistemi SIFQ, me qëllim shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

5.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS-së të merren masa në vijimësi për dokumentimin e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, si dhe realizimin e inventarizimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, me qëllim krijimin dhe ndjekjen e gjurmës së auditimit si dhe shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentacionit.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

5.2 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masa për vënien në punë të sistemit financiar “Financa 5”, me qëllim evidentimin në kohë dhe me besueshmëri të të dhënave të kontabilitetit, magazinës dhe inventarit.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është zbatuar**.

6.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të marrë masa që menjëherë pas dërgimit të ftesës për pjesëmarrje në takime/evente jashtë vendit, të përgatitet dokumentacioni ligjor në kohë optimale duke respektuar afatet për qarkullimin e shkresave administrative, në mënyrë që blerja e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me sistem dinamik blerje të kryhet në përputhje me shpenzimet me efektivitet të fondeve buxhetore.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të

ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

6.2 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa që në të gjitha praktikat për udhëtime dieta për jashtë shtetit, dokumentit të pagesave t'i bashkëngjitet ftesa e vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve/takimeve etj.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Bazuar në mungesën e dokumentacionit justifikues dhe argumentimit të Institutcionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar .Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

7.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që menjëherë pas marrjes së faturave për blerje mallra/shërbime/punë të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionit justifikues dhe argumentimit të Institutcionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

7.2 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që menjëherë pas marrjes së vendimit gjyqësorë të formës së prerë të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit të plotë të titullit ekzekutiv, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionit justifikues dhe argumentimit të Institutcionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

8.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të analizojë mosveprimet dhe të marrë masat për sistemimin e këtyre vlerave, të cilat janë të parashkruara dhe të paarkëtueshme, me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të Institutcionit.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionit justifikues dhe argumentimit të Institutcionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

9.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa që për diferencat e konstatuara dhe të paargumentuar të bëjë sistemimet kontabël, me qëllim paraqitjen e drejtë të gjendjes së llogarive vjetore të institucionit.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionit justifikues dhe argumentimit të Institutcionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MSHMS të marrë masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve, duke debituar llogarinë 2140160 “Instalimi i sistemit te kompjuterëve” për shumën 71,400,000 lekë dhe kredituar Llogarinë 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore” për të njëjtën vlerë.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme, për P.F të vitit 2023.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MSHMS të marrë masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve, duke debituar llogarinë 212 “Ndërtime e Konstruksione” në shumën prej 22,337,073 lekë dhe llogarinë 2140160 “Instalimi i sistemit te kompjuterëve” për shumën 277,912,554 lekë për regjistrin PAK dhe “Sistemi i Shërbimit Social” dhe duke kredituar llogarinë 28 “Caktim”, për shumat respektive.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme, për P.F të vitit 2023.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MSHMS të marrë masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionit justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe **i pa zbatuar**

12.2 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MSHMS të marrë masa për sistemimin e llogarisë 24 “Aktive te Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara”, duke mbajtur në këtë llogari në vlerën neto, ato aktive të cilat janë vlerësuar për jashtë përdorimi deri në momentin e asgjësimit apo te tjetërsimit të tyre.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme, për P.F të vitit 2023.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MSHMS të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të manualit

të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë të fondit neto, me qëllim që të parandalohen gabimet materiale dhe parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme, për P.F të vitit 2023.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

14.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat, që përpara se të bëjë reflektimin e pakësimit ose të shtesës së aktive në kontabilitet nga lëvizjet kapitale pa pagesë brenda apo jashtë sistemit, të administrojë të gjithë dokumentacionin përkatës të kalimit kapital të aktiveve hyrëse ose dalëse, me qëllim mbylljen e ciklit të transferimit si dhe verifikimin e regjistrimit në kontabilitet të tyre.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion, regjistri i aktiveve dhe pasqyrat 7/a, 7/b, si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim është në process zbatimi.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

15.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit në cilësinë e NA të marrë masa në vijimësi për shmangien e përfshirjes së punonjësve në proceset e punës, të cilat e vendosin atë në konflikt interesi, me qëllim funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm sa më të qëndrueshëm dhe më efektiv.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar argumentimeve të dhëna nga ana e Institucionit, konkludohet se rekomandimi është në process zbatimi. -Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

16.1 Rekomandimi: Nga personat përgjegjës për prokurimet në MSHMS të merren masat e arkivimit të procedurave të prokurimit në SPE, si dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit sipas afateve ligjore në fuqi dhe përditësimin e regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit me të gjithë elementet e parashikuar.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion, regjistri i parashikimit i miratuar, si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

17.1 Rekomandimi: Njësia e Prokurimit pranë MSHMS të marrë masa në vazhdimësi për planifikimin e shërbimit të përkthimit në regjistrin e procedurave të prokurimit, duke realizuar sipas parashikimit marrëveshjen përkatëse kuadër, për procedura të cilat janë mbi kufirin e lartë monetar dhe që kërkohet hartimi i dokumenteve të tenderit në anglisht.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion, regjistri i parashikimit dhe realizimit, si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

18.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve/punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo proces pune të jetë i argumentuar dhe i dokumentuar me dokumentacionin përkatës, si dhe Njësia e Prokurimit të ketë në përbërje të saj numër anëtarësh tekë, sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion, regjistri elektronik në sistemin SPE, ngritjen e komisionit të njësive, prokurimeve me numër tek antarësh etj, si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

19.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioni i vlerësimit të ofertave në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo proces pune të jetë i argumentuar dhe i dokumentuar me dokumentacionin përkatës.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

20.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Njësia Përgjegjëse për Prokurimet të marrë masë në vijimësi që përpara realizimit të çdo procedure prokurimi, të regjistrojnë ne sistem SIFQ çdo vlerë prokurimi të përcaktuar në planin e miratuar të prokurimeve të institucionit dhe pasi marrin numrin unik të regjistrimit ne SIFQ, të fillojë me procesin e prokurimit.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

20.2 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masat në vijimësi që destinacioni final i mallrave/shërbimeve dhe punëve që prokurohen të jetë në përputhje me DT dhe me kërkesat të cilat janë planifikuar që në PBA dhe në planin vjetor nga njësitë.

Nëse për kërkesa emergjente kërkohet ndryshimi i destinacionit, të merren masa për argumentimin me dokumentacione bashkëngjitur, si dhe miratimi i ndryshimit të bëhet nga NA i Institucionit dhe jo nga persona që s'kanë "asnjë kompetence drejtuese ose administrative mbi stafin ministror".

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion rregjistri i realizimit si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim mbetet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

21.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, gjatë vlerësimit të ofertave të procedurave prokuruese, të merren masa të pranohen oferta kur përputhen plotësisht specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 82 si devijime të vogla, të cilat të specifikohen në raportet përmbledhëse të procedurave prokuruese, duke mbajtur në konsideratë parimet e ekonomicitetit dhe eficiencës, bazuar kriterëve të vlerësimit të çmimit më të ulët.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

22.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë vlerësimit të ofertave të procedurave prokuruese, të marrë masa, që të pranohen oferta, kur përputhen plotësisht specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 82 si devijime të vogla, të cilat të specifikohen në raportet përmbledhëse të procedurave prokuruese, duke mbajtur në konsideratë parimet e ekonomicitetit dhe eficiencës, bazuar kriterëve të vlerësimit të çmimit më të ulët.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

23.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marrin masat e nevojshme për plotësimin e të gjithë dokumentacionit të kërkuar sipas kuadrit ligjor dhe rregullator të prokurimeve. Procesverbalet dhe raportet përmbledhëse të hartuara nga KVO duhet të jenë të argumentuara me:

- Arsytet e s'kualifikimit të OE:

- Në rastin e ndryshimeve që kanë formë dozat e barit të ofertuar nga OE me atë të kërkuar në DT dhe të regjistruara në AKBPM, të jenë argumentuar nga KVO këto ndryshime dhe të bashkëshoqëruara me dokumentacionin përkatës, ku vërtetohet ekuivalenca e dozave të barit të prokuruar me atë të ofertuar.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionit justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar. Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

24.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa në vijimësi, që përpara se të japë aprovimin për likuidimin e kontratave të mallrave/shërbimeve/punëve të cilat merren në dorëzim nga njësitë e vartësisë, të kërkohej që nga grupi i mbikëqyrjes ngritur me urdhrin e NA të MSHMS, të dokumentohet verifikimi fizik se mallrat/shërbimet/punët e marra nga njësitë e vartësisë janë në përputhje me kontratat e nënshkuara dhe me specifikimet e përcaktuara në DT.

Në vijimësi

Observacion i ardhur nga MSHMS me shkresën Nr. 2969/4 Prot, datë 23.07.2024 protokolluar me tonën Nr.880/5 Prot, datë 024.07.2024.

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me rekomandimin e mësipërm, sqarojmë se ky rekomandim është kundërshtuar nga Drejtoria e Koncesioneve, Prokurimeve dhe Parteriteteve, pasi kjo drejtori nuk merret me procesin e likuidimit të kontratave. Pra, rekomandimi nuk është pranuar nga kjo drejtori për shkak të mos kompetencës funksionale për zbatimin e tij.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Referuar shkresës të MSHMS me Nr. 2969/2 Prot, datë 08.07.2024, “Zbatimi i programit të punës mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të auditimit me objekt “Auditim financiar dhe përputhshmërie” përcjellë në MSHMS me shkresën Nr. 1178/11 Prot, datë 31.07.2023” protokolluar në KLSH me Nr.880/3 Prot, datë 11.07.2024 si dhe komentit të mësipërm të Institucionit, rekomandimi Nr 24.1 nuk është pranuar nga Drejtoria e Koncesioneve, Prokurimeve dhe Parteriteteve.

-Sa më sipër, observacioni nuk paraqet fakt të ri dhe si i tillë nuk merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm nuk pranohet.

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim nuk është pranuar nga ana e Institucionit dhe si rrjedhim nuk është zbatuar. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pa pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

25.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masat në vijimësi që për marrëveshjet kuadër të lidhura për Spitalet Rajonale në përfundim të afatit të marrëveshjes të kërkojë nga njësitë raportet e monitorimit të zbatimit dhe të mbarëvajtjes së këtyre kontratave, me qëllim që minikontratat e lidhura nga këto njësi të mbulojnë të gjithë afatin kohor të parashikuara në këtë kontratë. Për mangësitë e konstatuara nga zbatimi i tyre si rrjedhojë e mos marrjes së masave konkrete nga Spitalet Rajonale dhe nga OE, MSHMS të ngarkojë me përgjegjësi personat, të cilët nuk kanë zbatuar kushtet e marrëveshjes dhe specifikimeve të përcaktuara në DT.

Në vijimësi

Observacion i ardhur nga MSHMS me shkresën Nr. 2969/4 Prot, datë 23.07.2024 protokolluar me tonën Nr.880/5 Prot, datë 024.07.2024.

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me rekomandimin e mësipërm, sqarojmë se MSHMS me shkresën Nr.3098 Prot, datë 10.07.2024 me objekt “Mbi monitorimin e Marrëveshjes Kuadër për barna”, ka kërkuar raportim nga Spitalet Rajonale lidhur me monitorimin e zbatimit dhe të mbarëvajtjes së kontratave të lidhura në zbatim të Marrëveshjes Kuadër të barnave të vitit 2022.

Në përgjigje të kësaj shkrese, Spitalet Rajonale kanë përcjellë informacion me shkresat, të cilat do ti gjeni bashkëlidhur. Sa më lart rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi nga ana e Autoritetit.

Qëndrimi i grupit të Auditimit :

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrim tuaj, konkludon se argumentimi paraqet *fakt të ri dhe do të pranohet.*

-Sa më sipër, observacioni merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Projekt Raport.

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion në observacion konkretisht shkresa me Nr. 2583/1 Prot, datë 12.07.2024 nga Spitali Universitar i Traumës, shkresa me Nr.1568 Prot, datë 12.07.2024 nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës, shkresa me Nr.3286/1 Prot, datë 12.07.2024 nga Qendra Spitalore Rajonale Berat, shkresa me Nr. 1392 Prot, datë 12.07.2024 nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë, shkresa me Nr. 817/1 Prot, datë 12.07.2024 nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Lezhë, shkresa me Nr. 535 Prot, datë 11.07.2024 nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Tepelenë, shkresa me Nr. 915/1 Prot, datë 12.07.2024 nga Spitali Rajonal Fier, shkresa me Nr. 778/1 Prot, datë 12.07.2024 nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat, shkresa me Nr. 203/1 Prot, datë 12.07.2024 nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mallakastër, shkresa me Nr. 314/1 Prot, datë 12.07.2024 nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Bulqizë, shkresa me Nr. 269/1 Prot, datë 12.07.2024 nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kurbin, shkresa me Nr.189 Prot, datë 12.07.2024 nga Spitali Ditor Peqin, shkresa me Nr. 694 Prot, datë 12.07.2024 nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor “Shenjta Mari” Mirditë, shkresa me Nr. 318 Prot, datë 12.07.2024 nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Devoll, shkresa me Nr.1147/1 Prot, datë 12.07.2024 nga Spitali Rajonal Elbasan, shkresa me Nr.659/1 Prot, datë 12.07.2024 nga Spitali Universitar Obstretrik-Gjinekologjik “Koco Glozheni” Tiranë, shkresa me Nr.3338 Prot, datë 12.07.2024 nga Qendra Spitalore Rajonale Berat, Njësia Kuçovë, shkresa me Nr.965 Prot, datë 15.07.2024 nga Operatori I Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër, shkresa me Nr. 228/1 Prot, datë 12.07.2024 nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pukë, shkresa me Nr. 271 Prot, datë 15.07.2024 nga Spitali Bashkiak Kolonjë, shkresa me Nr. 2817 Prot, datë 12.07.2024 nga Spitali Rajonal Vlorë, shkresa me Nr. 83/1 Prot, datë 12.07.2024 nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Malësi e Madhe, shkresa me Nr. 339/1 Prot, datë 12.07.2024 nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pogradec, shkresa me Nr.561/1 Prot, datë 17.07.2024 nga Spitali Universitar Obstretrik-Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldine” Tiranë, shkresa me Nr. 589/1 Prot, datë 15.07.2024 nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor “Dr. Stefan Gjoni” Krujë, shkresa me Nr. 415/2 Prot, datë 12.07.2024 nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Gramsh, shkresa me Nr. 901/1 Prot, datë 12.07.2024 nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastër, shkresa me Nr. 233/1 Prot, datë 12.07.2024 nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has, shkresa me Nr. 1010/1 Prot, datë 16.07.2024 nga Spitali Rajonal Durrës në përgjigje të shkresës Nr. 3098, datë 10.07.2024 dërguar nga MSHMS, ky rekomandim është pranuar nga ana e Institucionit dhe është në proces zbatimi.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

26.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të kërkoj nga Spitalet Rajonale, që për minikontratat e lidhura deri në prishjen e marrëveshjes kuadër me datën 25.11.2022 dhe e përealizuar për furnizimet, sipas minikontratës nga OE “T.” sh.p.k, që të mbahet sigurimi i kontratës.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe shkresës me Nr.3098 Prot, datë 10.07.2024 dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi është zbatuar pjesërisht. Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

27.1 Rekomandimi: Titullari i AK/MSHMS të marrë masa në vijimësi që për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale,

- procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe
- procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik nga komisionet e vlerësimit të ofertave, me qëllim rritjen e eficiencës në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, të cilat janë të përbalueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara në plotësimin e nevojave të AK.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion, regjistrave të parashikimit dhe të realizimit të procedurave të realizimit, dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

28.1 Rekomandimi: MSHMS, të marrë masa për trajnimin në mënyrë të vazhdueshme të punonjësve që angazhohen me realizimin e procedurave të prokurimit, me synim prokurimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve në mënyrë sa më eficiente.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion planit vjetor të trajnimeve si dhe realizimit të tyre, si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, konkludohet se rekomandimi është zbatuar. -Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

28.2 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një s 'kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të

ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

29.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa në vazhdimësi për plotësimin e dosjet së personelit me dokumentacionin përkatës.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion lista e rekrutimeve, dosjet e personelit, si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, konkludohet se rekomandimi është në proces zbatimi.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

30.1 Rekomandimi: MSHMS të marrë masa për krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, sipas përcaktimeve ligjore në VKM Nr. 160 datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike”, i cili ofron këshilla e rekomandime objektive Titullarit të njësisë publike në lidhje me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, me qëllim arritjen e objektivave si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësi të saj.

Menjëherë

Observacion i ardhur nga MSHMS me shkresën Nr. 2969/9 Prot, datë 28.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr. 880/27 Prot, datë 30.10.2024.

Pretendimi i subjektit:

Komenti institucionit mbi zbatim e rekomandimit:

Mli i drejtorisë së Auditit të Brendshëm lidhur me rekomandimin

From: M.B. Sent: Monday, October 28, 2024 1:00 PM To: A.K. Subject: Pergjigje per rek.30.1 te KLSH-se.

Përshëndetje Drejtor!

Në përgjigje të e-Mlit lidhur me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lena nga KLSH (reference Projekt Raport Auditimi i KLSH-se nr. 880/20 prot., date 24.09.2024, me objekt "Për zbatimin e rekomandimeve të lena në auditimet e evaduara në vitin 2023"), dhe konkretisht rekomandimi nr. 30.1, për njësinë e AB, ju sqarojme si më poshtë:

Me emërimin e drejtuesit të ri të AB, do të adresohet tek Titullari i Njesisë Publike (Ministri), zgjidhja për zbatimin e rekomandimit sipas kërkesave të përcaktuara në VKM nr. 160, datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Njësive Publike”

Dokumentacioni mbështetës e-Mli i datës 28.10.2024

Për sa më sipër, kërkojmë që ky rekomandim të kalojë nga “i pazbatuar” në “në proces”.

Referuar observacionit të ardhur pas periudhës së auditimit në terren, grupi i auditimit pasi shqyrtoi me vëmendje pretendimin e subjektit vendosi të mos e marrë në konsideratë pasi dokumentacioni i paraqitur në këtë fazë nuk paraqet fakt të ri dhe është irrelevant me rekomandimin e dhënë.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi nuk paraqet *fakt të ri dhe nuk do të pranohet*. Sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë. ***Observacioni mësipërm nuk pranohet.***

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar mungesës së dokumentacionit dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është zbatuar**.

C.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, germa b) dhe c) “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së” dhe mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,032,139 lekë** si më poshtë:

1.1. Rekomandimi: MSHMS, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **684,387 lekë** nga kontraktori BOE "B." sh.p.k dhe “B.N” sh.p.k, për punime të mbivendosura dhe të likuiduara, por të pa realizuara.

Menjëherë

Observacion i ardhur nga MSHMS me shkresën Nr. 2969/9 Prot, datë 28.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr. 880/27 Prot, datë 30.10.2024.

Pretendimi i subjektit:

Dokumentacioni mbështetës (kërkesë padi Nr.4413, datë 25.10.2024).

Referuar observacionit të ardhur pas periudhës së auditimit në terren, grupi i auditimit pasi shqyrtoi me vëmendje pretendimin e subjektit vendosi ta marrë në konsideratë dhe ta reflektojë ndryshimin në raportin përfundimtar të auditimit si më sipër.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi paraqet *fakt të ri dhe do të pranohet* pasi është ngritur kërkesë padi në lidhje me rastin.

Sa më sipër, observacioni merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Raport Përfundimtar.

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion në observacion konkretisht me shkresën Nr. 2969/9 Prot, datë 28.10.2024, dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit kërkesë padi Nr.4413, datë 25.10.2024 ky rekomandim është pranuar nga ana e Institucionit dhe është në proces zbatimi.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

2.1. Rekomandimi: MSHMS, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për

arkëtimin e vlerës prej **347,752 lekë** nga kontraktori OE “C.” sh.p.k, për punime të mbivendosura dhe të likuiduara.

Menjëherë

Observacion i ardhur nga MSHMS me shkresën Nr. 2969/9 Prot, datë 28.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr. 880/27 Prot, datë 30.10.2024.

Pretendimi i subjektit:

Dokumentacioni mbështetës (kërkesë padi Nr.4413/1, datë 25.10.2024).

Referuar observacionit të ardhur pas periudhës së auditimit në terren, grupi i auditimit pasi shqyrtoi me vëmendje pretendimin e subjektit vendosi ta marrë në konsideratë dhe ta reflektojë ndryshimin në raportin përfundimtar të auditimit si më sipër.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi paraqet *fakt të ri dhe do të pranohet* pasi është ngritur kërkesë padi në lidhje me rastin.

Sa më sipër, observacioni merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Raport Përfundimtar.

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion në observacion konkretisht me shkresën Nr. 2969/9 Prot, datë 28.10.2024, dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit kërkesë padi Nr.4413/1, datë 25.10.2024 ky rekomandim është pranuar nga ana e Institucionit dhe është në proces zbatimi.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

C.2. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1 Rekomandimi: Nga Strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masa në bashkëpunim me DAP, për rikthimin në punë të të gjithë punonjësve që kanë fituar këtë të drejtë sipas përcaktimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Në vijimësi

Observacion i ardhur nga MSHMS me shkresën Nr. 2969/9 Prot, datë 28.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr. 880/27 Prot, datë 30.10.2024.

Pretendimi i subjektit:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Urdhërin nr. 746, datë 18.12.2023 "Për ngritjen e komisionit të posaçëm, ka marrë në shqyrtim dosjet për 14(katërmëdhjetë) gjyqfitues, ku 2(dy) prej tyre ishin nga insitucionet e varësisë. Nga lista e gjyqfituesve janë larguar punonjësit:

1. Znj. M. C.

a. Emëruar me shkresën nr. 3596/2, datë 09.02.2024, në pozicionin Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme rregullatore për Shëndetësinë dhe Mbrojtjesn Sociale, në MSHMS.

b. Liruar me shkresën nr. 4973/2, datë 17.09.2024.

2. Z. A. Z.

a. Pushuar ekzekutimi i vendimit për z. A. Z, me kërkesë të kreditorit, referuar shkresës së Shërbimit Përmbarimor Privat "Astrea" me nr. 2935, datë 24.04.2024.

3 . Znj. L.Gj.

a. Emëruar me shkresën me nr 3286/3, datë 09.07.2024 në pozicionin specialist, në sektorin për Mbrojtjen dhe Monitorimin e të Drejtave të Fëmijëve, Në ASHMDF.

b. Liruar nga shërbimi civil me shkresën nr. 177/8, datë 05.08.2024.

4. Z. S. F.

a. Emëruar me shkresën nr. 4284, datë 22.08.2024, në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve të Përgjithshme, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në MSHMS.

5. Znj. L. B. Ç, e datëlindjes 04.02.1963, ka mbushur moshën e daljes në pension me datë 04.10.2024, për këtë arsye largohet nga lista e gjyqfituesve.

Komisioni i Posaçëm vijon punën për shqyrtimin e rasteve që nuk janë ekzekutuar.

Dokumentacioni mbështetës (Urdhër Nr. 746, datë 18.12.2023 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm, shkresa Nr. 3596/2, datë 09.02.2024, shkresa Nr. 4973/2, datë 17.09.2024, shkresa me Nr 3286/3, datë 09.07.2024, shkresa Nr. 177/8, datë 05.08.2024, shkresa Nr. 4284, datë 22.08.2024).

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi paraqet *fakt të ri në lidhje me emërimet dhe largimet, por gjykojmë se procesi është i papërfunduar*.

Sa më sipër, rekomandimi mbetet pjesërisht i zbatuar.

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Raport Përfundimtar.

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi është zbatuar pjesërisht. Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germa (b, c, ç) e nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” **i rekomandohet** Titullarit të institucionit, që nëpërmjet një grupi pune, të bëjë vlerësimin dhe shqyrtimin e shkelleve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të cituara më poshtë, sipas përgjegjësisë individuale të nisë procedurat për dhënien e masave disiplinore sipas shkallës nga “vërejtje” deri në “largim”, për punonjësit si më poshtë:

1. Z.S.K., në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar; për mangësitë e konstatuara në:

- Çeljen e projekteve të investimit pa kaluar në procesin ligjor të miratimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 17-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit);

- Për gabime e parregullsi të ndryshme në pasqyrat financiare, të cilat kanë efekt në saktësinë e raporteve dhe pasqyrave financiare. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit);

- Parregullsi në vlerësimin e ofertave për procedurat e prokurimit publik me objekt:

a) “Rikonstruktion i godinës së Qendrës Kombëtare Transfuzionit të Gjakut Tiranë ”

b) “Rikonstruktion i qendrave shëndetësore (viti 2022-2023) e ndarë në 2 Lote”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. Znj. D. K. në cilësinë e Përgjegjës të Sektorit Investimeve; për mangësitë e konstatuara në çeljen e projekteve të investimit pa kaluar në procesin ligjor të miratimit të Programit Buxhetor Afatmesëm *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 17-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3. Z. S. C. në cilësinë e Përgjegjës të Sektorit të Financës, për gabime e parregullsi të ndryshme në pasqyrat financiare, të cilat kanë efekt në saktësinë e raporteve dhe pasqyrave financiare. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Për regjistrimin me vonesë të kontratës dhe të urdhrit të procedurës së prokurimit me objekt: *“F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore”* në SIFQ, ku urdhri i prokurimit për realizimin e procedurës ka dalë me datën 04.10.2021, ndërsa regjistrimi në SIFQ është bërë me datën 28.12.2021 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit);*

4. Znj. M.K. në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit për Shëndetësinë, për mangësitë e konstatuara në parregullsinë e vlerësimit e ofertave dhe të dokumentimit e saktë të veprimtarisë së KVO gjatë shqyrtimit të ofertave për procedurat me objekt: *“B1-Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, Anestezi Reanimacion, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular, Sistemi muskolo-skeletik, Sistemi nervor dhe Sistemi Respirator, Gjaku dhe organet formuese të gjakut”* dhe • *“B2-Blerje barna Antineoplastike dhe immunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese te gjakut, Lende kontrasti për CT, Lende kontrasti për MRI, Lende Kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës dhe Barna* *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5. Znj. M.K. në cilësinë e Specialistit në Sektorin e Administrimit të Shërbimit Spitalor, për mangësitë e konstatuara në parregullsinë e vlerësimit e ofertave dhe të dokumentimit e saktë të veprimtarisë së KVO gjatë shqyrtimit të ofertave për procedurat me objekt: *“B1-Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, Anestezi Reanimacion, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular, Sistemi muskolo-skeletik, Sistemi nervor dhe Sistemi Respirator, Gjaku dhe organet formuese të gjakut”* dhe • *“B2-Blerje barna Antineoplastike dhe immunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese te gjakut, Lende kontrasti për CT, Lende kontrasti për MRI, Lende Kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës dhe Barna* *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6. Z. E.H. në cilësinë e Specialistit në Sektorin e Projekteve dhe Inovacionit për mangësitë e konstatuara:

- Në vlerësimin e ofertave dhe të dokumentimit të saktë të veprimtarisë së KVO gjatë shqyrtimit të ofertave, për procedurat me objekt: *“B1-Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, Anestezi Reanimacion, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular, Sistemi muskolo-skeletik, Sistemi nervor dhe Sistemi Respirator, Gjaku dhe organet formuese të gjakut”* dhe • *“B2-Blerje barna Antineoplastike dhe immunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese te gjakut, Lende kontrasti për CT, Lende kontrasti për MRI, Lende Kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës dhe Barna* *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Në vlerësimin e ofertave për procedurat e prokurimit publik me objekt:

- a) "Rikonstruksion i godinës së Qendrës Kombëtare Transfuzionit të Gjakut Tiranë";
b) "Rikonstruksion i qendrave shëndetësore (viti 2022-2023) e ndarë në 2 Lote".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7. Znj. V. H. në cilësinë, Specialistit në Sektorin e Investimeve.

- Parregullsi në vlerësimin e ofertave për procedurat e prokurimit publik me objekt:
a) "Rikonstruksion i godinës së Qendrës Kombëtare Transfuzionit të Gjakut Tiranë";
b) "Rikonstruksion i qendrave shëndetësore (viti 2022-2023) e ndarë në 2 Lote".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8. Znj. A. P. në cilësinë, Drejtore e Drejtorisë së Koncesioneve dhe Prokurimeve dhe Partneriteteve, për mangësitë e konstatuara:

- Në regjistrat e parashikimit dhe të realizimit të procedurave të prokurimit, si dhe mos arkivimit të tyre në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.
- Në përkthimin e dokumentacionit pa realizuar asnjë procedurë paraprake të blerjeve të vogla/ose marrëveshje kuadër, por realizimi i shpenzimit si blerje e drejtpërdrejtë.
- Për regjistrimin me vonesë të kontratës dhe të urdhrit të procedurës së prokurimit me objekt "F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore" në SIFQ, ku urdhri i prokurimit për realizimin e procedurës ka dalë me datën 04.10.2021, ndërsa regjistrimi në SIFQ është bërë me datën 28.12.2021. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit);

9. Z. E. L. në cilësinë, Specialistit në Sektorin e Prokurimeve, për mangësitë e konstatuara:

- Në regjistrat e parashikimit dhe të realizimit të procedurave të prokurimit, si dhe mos arkivimit të tyre në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.
- Në përkthimin e dokumentacionit pa realizuar asnjë procedurë paraprake të blerjeve të vogla/ose marrëveshje kuadër, por realizimi i shpenzimit si blerje e drejtpërdrejtë, (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit);
- Në parregullsi për procedurën me objekt "Blerje pajisje mjekësore për QKTRF".

10. Znj. L.A në cilësinë, Specialist në Sektorin e Prokurimeve, për mangësitë e konstatuara:

- Në regjistrat e parashikimit dhe të realizimit të procedurave të prokurimit, si dhe mos arkivimit të tyre në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.
- Në përkthimin e dokumentacionit pa realizuar asnjë procedurë paraprake të blerjeve të vogla/ose marrëveshje kuadër, por realizimi i shpenzimit si blerje e drejtpërdrejtë, (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit);
- Në parregullsitë për procedurën me objekt "Blerje pajisje mjekësore për QKTRF".

11. Z.O.Dh Drejtor i Qendrës kombëtare Teknike Biomjekësore për mangësitë e konstatuara, për parregullsitë në procedurën me objekt "Blerje pajisje mjekësore për QKTRF".

12. Znj. L.P në cilësinë, Përgjegjës Sektori në Sektorin e Produkteve Kozmetike dhe Pajisjeve Mjekësore, në cilësinë e anëtarit të grupit të mbikëqyrjes së kontratës "F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore" e ngritur me urdhër nr. 503, datë 26.11.2021 të Titullarit të MSHMS, për mosverifikimin fizik të pajisjeve, por kanë dhënë aprovimin për likuidimin e kontratave të mallrave/shërbimeve/punëve bazuar vetëm në procesverbalet e marrjen në dorëzim të mbajtura nga Spitalet Rajonale, ku nga verifikimi në vend i grupit të auditimit janë konstatuar mospërputhje të të dhënave teknike të pajisjeve të montuar me dokumentacionin teknik dhe katalogun e paraqitur nga OE.

13. Z. H. T në cilësinë, Përgjegjës Sektori në Sektorin e PPP-ve dhe ndjekjes së kontratave, në cilësinë e anëtarit të grupit të mbikëqyrjes së kontratës "F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore" e ngritur me urdhër nr. 503, datë

26.11.2021 të Titullarit të MSHMS, për mosverifikimin fizik të pajisjeve, por kanë dhënë aprovimin për likuidimin e kontratave të mallrave/shërbimeve/punëve bazuar vetëm në procesverbalet e marrjen në dorëzim të mbajtura nga Spitalet Rajonale, ku nga verifikimi në vend i grupit të auditimit janë konstatuar mospërputhje të të dhënave teknike të pajisjeve të montuar me dokumentacionin teknik dhe katalogun e paraqitur nga OE.

14. Znj. R.M në cilësinë, *Specialiste e Sektorit të Investimeve Përgjegjës*, në cilësinë e grupit të mbikëqyrjen e kontratës “*F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore*” e ngritur me urdhër nr. 503, datë 26.11.2021 të Titullarit të MSHMS, për mosverifikimin fizik të pajisjeve, por kanë dhënë aprovimin për likuidimin e kontratave të mallrave/shërbimeve/punëve bazuar vetëm në procesverbaleve e marrjen në dorëzim të mbajtura nga Spitalet Rajonale, ku nga verifikimi në vend i grupit të auditimit janë konstatuar mospërputhje të të dhënave teknike të pajisjeve të montuar me dokumentacionin teknik dhe katalogun e paraqitur nga OE.

- Për regjistrimin me vonesë të kontratës dhe të urdhrit të procedurës së prokurimit me objekt: “*F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore*” në SIFQ, ku urdhri i prokurimit për realizimin e procedurës ka dalë me datën 04.10.2021, ndërsa regjistrimi në SIFQ është bërë me datën 28.12.2021 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*);

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion Urdhrit Nr. 649, datë 19.10.2023, si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

E. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7/1 dhe 12, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar dhe UKM nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, pika 1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2014 “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, i rekomandojmë Titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, sipas kontratave respektive, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të nxjerrë vendime për marrjen e masave përkatëse dhe sanksioneve administrative:

1. Subjekti BOE "N. S." sh.p.k, përfaqësuar nga administrator z. E.N., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Në kontratën me objekt: “*Rikonstruktion i disa QSH-ve në qarqet Berat, Korçë dhe Elbasan*”, datë 08.06.2020, për mbivendosje të volume të punime të deklaruara përfituar padrejtësisht nga kontraktori, në vlerën 684,387 lekë me TVSH.

Observacion i ardhur nga MSHMS me shkresën Nr. 2969/9 Prot, datë 28.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr. 880/27 Prot, datë 30.10.2024.

Pretendimi i subjektit:

Rekomandimi i është përcjellë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor.

-Dokumentacioni mbështetës (shkresa nr. 2969/5, datë 23.07.2024)

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi paraqet *fakt të ri dhe do të pranohet*. Sa më sipër, observacioni merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Raport Përfundimtar.

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion në observacion konkretisht me shkresën 2969/9 Prot, datë 28.10.2024, dhe shkresa Nr.2969/5 Prot, datë 23.07.2024, ky rekomandim është pranuar nga ana e Institucionit dhe është zbatuar plotësisht.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është zbatuar plotësisht.

2. Subjekti "T. " sh.p.k, përfaqësuar nga administrator Znj. D.Q, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Në kontratën me objekt: “*Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Gjirokastër, Vlorë dhe Fier*”, datë 02.11.2020, për mbivendosje të volume të punime të deklaruara përfituar padrejtësisht nga kontraktori, në vlerën 347,752 lekë me TVSH. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 34-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

Në proces.

Observacion i ardhur nga MSHMS me shkresën Nr. 2969/9 Prot, datë 28.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr. 880/27 Prot, datë 30.10.2024.

Pretendimi i subjektit:

Rekomandimi i është përcjellë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor.

-Dokumentacioni mbështetës (shkresa nr. 2969/5, datë 23.07.2024)

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi paraqet *fakt të ri dhe do të pranohet*.

Sa më sipër, observacioni merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Raport Përfundimtar.

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion në observacion konkretisht me shkresën 2969/9 Prot, datë 28.10.2024, dhe shkresa Nr.2969/5 Prot, datë 23.07.2024, ky rekomandim është pranuar nga ana e Institucionit dhe është zbatuar plotësisht.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është zbatuar plotësisht.

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit që do të jepen masat disiplinore për shkeljet sa më sipër, MSHMS, pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit mbështetës (Urdhri Nr. 649, datë 19.10.2024 si dhe relacioni i grupit të punës me Nr.225/58, datë 31.10.2024) vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar plotësisht për sa kohë është ngritur grupi i punës i cili ka marrë vendimmarrje.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Në përfundim të procesit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, rezulton se nga **57** rekomandime të lëna, nga Subjekti **MSHMS** janë pranuar të **56** rekomandime, dhe 1- rekomandim i pa pranuar, nga të cilat: janë zbatuar **19** masa ose **33.9 % e tyre**; 1-masa janë zbatuar pjesërisht; **24**-masa janë në proces zbatimi si dhe **12**- masa janë pa zbatuar, pra **13**- masa mbeten për tu zbatuar nga subjekti **MSHMS**, për periudhën në vijim. Grupi i auditimit duke analizuar Rekomandimet e pranura dhe të zbatuara nga **MSHMS** (njësitë përgjegjëse të saj) apo dhe ato në proces zbatimi, arriti në konkluzionin që: - Për kategorinë "Masa Organizative"- Rekomandimet R 1.1; R 2.1; R 4.1; R 5.1; R 6.1; R 10.1; R 11.1; R 12.2; R 13.1; R 14.1; R 15.1; R 16.1; R 17.1; R 18.1; R 19.1; R 20.1; R 20.2; R 21.1; R 22.1; R 25.1; R 27.1; R 28.1; R 28.2; R 29.1; - Kategorinë "Masa shpërblim dëmi"- R 1.1; R 2.1; Për kategorinë "Masa Administrative", - R 1.1; R 1.2; Për kategorinë "Masa Disiplinore", për 14 punonjës dhe “Njoftim për DAPP/ KMSHC”, 2 masa; janë pranuar dhe zbatuar apo në proces zbatimi nga **MSHMS**, prandaj nuk mund të qëndrojnë për periudhën në vijim.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmisimin e gjëndjes *Rikërkojmë që*, MSHMS të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara si dhe pjesërisht zbatuar brenda 3-mujorit të parë të vitit 2025.

Si dhe marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH-së të pranura prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara. **Në auditimet e radhës në MSHMS, do të shtohet pika e zbatimit të rekomandimeve.**

A.MASA ORGANIZATIVE:

3.1 Rekomandimi: NA dhe NZ të marrin masat për monitorimin e zbatimit të Buxhetit të Shtetit duke hartuar raportet të monitorimit të buxhetit çdo katër muaj për aparatin e MSHMS si njësi shpenzuese për produktet e buxhetit të administruara nga ana e saj, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit.

5.2 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masa për vënien në punë të sistemit financiar “Financa 5”, me qëllim evidentimin në kohë

dhe me besueshmëri të të dhënave të kontabilitetit, magazinës dhe inventarit.

6.2 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa që në të gjitha praktikat për udhëtime dieta për jashtë shtetit, dokumentit të pagesave t'i bashkëngjitet ftesa e vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve/takimeve etj.

7.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që menjëherë pas marrjes së faturave për blerje mallra/shërbime/punë të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

7.2 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që menjëherë pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit të plotë të titullit ekzekutiv, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

8.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të analizojë mosveprimet dhe të marrë masat për sistemimin e këtyre vlerave, të cilat janë të parashkruara dhe të paarkëtueshme, me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të Institucionit.

9.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa që për diferencat e konstatuara dhe të paargumentuar të bëjë sistemimet kontabël, me qëllim paraqitjen e drejte të gjendjes së llogarive vjetore të institucionit.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MSHMS të marrë masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve.

23.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marrin masat e nevojshme për plotësimin e të gjithë dokumentacionit të kërkuar sipas k uadrit ligjor dhe rregullator të prokurimeve. Procesverbalet dhe raportet përmbledhëse të hartuara nga KVO duhet të jenë të argumentuara me:

- Arsytet e s'kualifikimit të OE:

- Në rastin e ndryshimeve që kanë formë dozat e barit të ofertuar nga OE me atë të kërkuar në DT dhe të regjistruara në AKBPM, të jenë argumentuar nga KVO këto ndryshime dhe të bashkëshoqëruara me dokumentacionin përkatës, ku vërtetohet ekuivalenca e dozave të barit të prokuruar me atë të ofertuar.

24.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa në vijimësi, që përpara se të japë aprovimin për likuidimin e kontratave të mallrave/shërbimeve/punëve të cilat merren në dorëzim nga njësitë e vartësisë, të kërkohej që nga grupi i mbikëqyrjes ngritur me urdhrin e NA të MSHMS, të dokumentohet verifikimi fizik se mallrat/shërbimet/punët e marra nga njësitë e vartësisë janë në përputhje me kontratat e nënshkruara dhe me specifikimet e përcaktuara në DT.

26.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të kërkoj nga Spitalet Rajonale, që për minikontratat e lidhura deri në prishjen e marrëveshjes kuadër me datën 25.11.2022 dhe e parealizuar për furnizimet, sipas minikontratës nga OE "T." sh.p.k, që të

mbahet sigurimi i kontratës.

30.1 Rekomandimi: MSHMS të marrë masa për krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, sipas përcaktimeve ligjore në VKM Nr. 160 datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike”, i cili ofron këshilla e rekomandime objektive Titullarit të njësisë publike në lidhje me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, me qëllim arritjen e objektivave si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësi të saj.

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:

1.1 Rekomandimi: Nga Strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masa në bashkëpunim me DAP, për rikthimin në punë të të gjithë punonjësve që kanë fituar këtë të drejtë sipas përcaktimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

3.4 MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

3.4.1 PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në **Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit** mbi “*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara të vitit 2023*” për auditimin e kryer në vitin 2023, për periudhën objekt auditimi 01.01.2020 deri në 31.12.2022, përcjellë me shkresën Nr. 325/6 datë 11.10.2023, protokolluar në subjekt me nr. 4920/1 Prot., datë 12.10.2023 duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

Vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

Vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

Vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve;

Vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, si dhe manualit “*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve*”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 880/1 prot., datë 02.07.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Auditimi u krye nga:

1. S.Z, përgjegjës grupi

2. N. M, anëtar

Auditimi ka filluar më, 03.07.2024

Auditimi ka përfunduar më, 18.07.2024

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 325/6 datë 11.10.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLZIONI:

-Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se janë lënë në total 57 rekomandime nga të cilat: 56 janë pranuar dhe 1 pa pranuar dhe se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **45 Masa organizative** nga ku **45** rekomandim, janë pranuar plotësisht **44** të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, **7** zbatuar plotësisht, **3** masa janë zbatuar pjesërisht, **14** në proces zbatimi dhe **20** pa zbatuar.

-Për përmirësimin e gjendjes është lënë **1 Masë shpërblim dëmi** nga ku **1** rekomandim i pranuar plotësisht në vlerën totale 264.2 mijë Lekë , dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, **1** zbatuar plotësisht.

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **2 Masa për menaxhimin e Efektivitetit dhe Ekonomicitet të Fondeve Buxhetore** nga ku **2** rekomandime i pranuar plotësisht në vlerën totale 36,067 mijë lekë, dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, **1** zbatuar dhe **1** në proces.

-Për përmirësimin e gjendjes është lënë **1 Masë për njoftimin e Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit të Mbikëqyrjes të Shërbimit Civil** nga ku **2** rekomandime të pranuar plotësisht, dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, **2 zbatuar plotësisht.**

-Për përmirësimin e gjendjes është lënë **1 Masë disiplinore** nga ku **1** rekomandim i pranuar plotësisht, dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, **1 i zbatuar plotësisht.**

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezulton në nivel **98%**, konkretisht nga **51** rekomandime gjithsej, janë pranuar **50** rekomandime

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht rezultoi në masën **24 %**, niveli i zbatimit të rekomandimeve në proces zbatimi rezultoi **30%**, niveli i rekomandimeve pa zbatuara rezultoi **40%**, niveli i rekomandimeve zbatuara pjesërisht rezultoi **6%**, nivele këto të cilat tregojnë vlerësimin e këtij procesi në lidhje me ndjekjen e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

Nga auditimi i ushtruar në **Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit** për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për periudhën nga data 01.01.2020 deri në 31.12.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me

Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 188, datë 10.10.2023, përcjellë. me shkresën Nr. 325/6 datë 11.10.2023

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën me nr. 4920/1 datë 01.11.2023.

Sa më sipër rezulton se subjekti e ka zbatuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

Auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga ana e subjektit të audituar lidhur me raportimin mbi zbatimin të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara sipas strukturave përgjegjëse, subjekti ka raportuar në KLSH, me shkresën nr. 4340/2 Prot., date 17.07.2024 jashtë afatit 6 mujor të raportimit, **sipas** ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30.

Sa më sipër rezulton se nuk e ka zbatuar afatin 6 mujor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik, të marrin masat e nevojshme, që në periudhat në vijim të eliminohen praktikat e çeljes së projekteve të reja pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore, si dhe të respektohen projektet e investimeve të parashikuara në PBA.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar rekomandimit nuk ka dokumentacion provues dhe si i tillë rekomandimi është i pazbatuar. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

2.1. Rekomandimi: NA dhe NZ në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të marrin masat, për hartimin e raporteve të monitorimit të buxhetit çdo katër muaj për aparatin e MTM-së si njësi shpenzuese, për produktet e buxhetit të administruara nga ana e saj, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit, si dhe publikimin e tyre në faqen zyrtare të ministrisë.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar rekomandimit nuk ka dokumentacion provues dhe si i tillë rekomandimi është i pazbatuar. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pa pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

3.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe raportimit, për efekt të hartimit dhe monitorimit të planit buxhetor sa më të detajuar dhe transparente, duke përfshirë të gjitha njësitë përgjegjëse për buxhetin e programeve të administruara nga institucioni.

Në vijimësi

Observacion i ardhur nga MTM me shkresën Nr. 4340/4 Prot., datë 25.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 880/6 Prot., datë 26.07.2024.

Pretendimi i subjektit:

1. Fondet e akorduara për rindërtimin e në shumën 200,000 lekë, për Agjencinë Kombëtare të Bregdetit për vitin 2020 fillimisht nuk kanë qenë të evidentuar në një produkt të veçantë, si rrjedhim i kushteve emergjente të situatës së krijuar nga tërmeti. Me njoftimin e Ministrisë së Financave me shkresën 23038 datë 10.12.2020, ku janë njoftuar të gjithë institucionet qendrore dhe vendore në vijim të ligjit nr. 88 datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020” i cili miratoi fondin e rindërtimit të pasojave të tërmetit të datës 26 nëntor 2019 në vlerën 20 miliard lekë, me qëllim evidentimin e saktë të shpenzimeve të rindërtimit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka ndjekur të gjitha hapat për krijimin e produktit të dedikuar konkretisht kodi 92603AD produkti “Të dëmtuar nga tërmeti të akomoduar përkohësisht”. Në raportet e monitorimit për vitin 2020 raportimi për këtë produkt është bërë në relacion e monitorimit tek pjesa përshkruese në hyrje të relacionit dhe në analizën e produkteve në programin “Zhvillimi i Turizmit”.

Referuar observacionit të ardhur pas periudhës së auditimit në terren, grupi i auditimit pasi shqyrtoi me vëmendje pretendimin e subjektit vendosi të mos e marrë në konsideratë.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi i ardhur me observacion nuk rakordon me rekomandimin e mësipërm.

Sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm nuk pranohet dhe u reflektua në Projekt Raport.

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion sipas observacionit të ardhur, konkludohet se rekomandimi është zbatuar pjesërisht. -Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

4.1.Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat për të përditësuar rregulloren e brendshme të ministrisë me qëllim përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi për të gjithë pozicionet e punës sipas strukturës organike në fuqi.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim konsiderohet i zbatuar plotësisht. *Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe i zbatuar plotësisht.*

5.1.Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat për të respektuar afatet kohore për të gjitha procedurat në rastet e ndryshimeve në strukturë të cilat shoqërohen me mbylljen apo ristrukturimin e institucionit, gjithashtu këto procedura të shoqërohen me praktikatat respektive.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandim 6.1: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që menjëherë pas lindjes së detyrimit të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit të plotë, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim mbetet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandim 6.2: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi për të rakorduar me Sektorin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, sa i takon informacionit të plotë të vendimeve të gjykatës të formës së prerë, të cilat duhet të njihen në vlerën e tyre të plotë, si detyrime për tu shlyer në periudhat e ardhshme dhe për të cilat duhet të provigjionohen shumat përkatëse. Njëkohësisht vlera e tyre duhet njohur edhe si shpenzim periudhe në pasqyrat financiare të institucionit.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar argumentimeve nga ana e subjektit rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandim 6.3: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në çdo rast të ndjekë dhe të zbatojë me përpikmëri parimin FIFO, gjatë likuidimit të detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim është në process zbatimi.Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandim 6.4: Nga ana e Sektorit të Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, të merren masa për ndjekjen me kujdes të proceseve gjyqësore dhe përcjelljen në kohë të informacionit të plotë dhe të saktë në njësinë përkatëse, përgjegjëse për financë/kontabilitetin, në mënyrë që kjo e fundit të njohë dhe kontabilizojë në kohë vlerat që lidhen me këto shpenzime/detyrime, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionit justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi **nuk është zbatuar**.-Për sa mësipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe **i pa zbatuar** .

Rekomandimi 7.1: Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar, të marrë masa që të kryejë analizimin dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për

projektet/investimet e mbartura në llogarinë nr.28 “Caktime të Aktiveve Afatgjata”, në mënyrë të tillë që të verifikohet, saktësohet dhe të analizohen vlerat e paraqitura në Pasqyrat Financiare dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar argumentimeve të dhëna nga subjekti vihet re që janë ende në punë për zbatimin e këtij rekomandimi dhe si i tillë rekomandimit konsiderohet në proces. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë nr.230 “Investime në proces” me mbylljen e bilancit të vitit pasardhës, për vlerën kontabël prej 17,372,947 lekë, të projekteve të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë nr.202 “Studime dhe Kërkime” dhe në kredi të llogarisë nr.230 “Investime në proces”

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar rekomandimit nuk ka dokumentacion provues dhe si i tillë rekomandimi është i pazbatuar. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

9.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masa për sistemimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, duke rakorduar çdo muaj vlerat e llogarisë, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar/transferuar shumat e garancive të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit dhe argumentimeve nga ana e subjektit konkludohet që rekomandimi është në proces. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë të fondit neto, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

11.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masa për verifikimin e pakësimeve të aktiveve të llogarisë 218 “Inventar Ekonomik” në vlerën prej 5,752,654 lekë të konstatuara nga grupi i auditimit dhe nxjerrjen e përgjegjësive për mos identifikimin dhe dokumentimin/argumentimin e tyre nga komisionet e inventarizimit.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, konkludohet se rekomandimi është në proces zbatimi pasi janë ngritur komisionet e inventarizimit duke bërë të mundur rakordinin e hyrjeve dhe daljeve përkatëse.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

11.2.Rekomandimi: Titullari i Institucionit në cilësinë e NA të marrë masa në vijimësi për shmangien e përfshirjes së punonjësve në proceset e punës, të cilat e vendosin atë në konflikt interesi, me qëllim funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm sa më të qëndrueshëm.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionit justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

12.1.Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat, që për çdo procedurë transferimi, e pakësimit ose të shtesës së aktive në kontabilitet nga lëvizjet kapitale pa pagesë brenda apo jashtë sistemit, të administrojë të gjithë dokumentacionin përkatës të kalimit kapital të aktiveve hyrëse ose dalëse, me qëllim mbylljen e ciklit të transferimit si dhe verifikimin e regjistrimit në kontabilitet të tyre.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionit justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

13.1.Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për krijimin e një regjistri të plotë të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me, datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacioni të vënë dispozicion konkludohet që rekomandimi është zbatuar plotësisht. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

14.1.Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që në të gjitha dokumentacionet e pagesave, të cilat kanë të bëjnë me praktikën për udhëtime dieta për jashtë vendi, t'i bashkëngjitet ftesa e vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve, me qëllim krijimin e gjurmës së auditimit të përdorimit të fondeve buxhetore.

Në vijimësi

Observacion i ardhur nga MTM me shkresën Nr. 4340/4 Prot., datë 25.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 880/6 Prot., datë 26.07.2024.

Pretendimi i subjektit:

Rekomandimi është zbatuar dhe bashkëlidhur do të gjeni një praktikë.

Referuar observacionit të ardhur pas periudhës së auditimit në terren dhe dokumentit bashkëlidhur, grupi i auditimit pasi shqyrtoi me vëmendje pretendimin e subjektit vendosi ta marrë në konsideratë dhe ta reflektojë ndryshimin në projekt raportin e auditimit si më sipër.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi paraqet **fakt të ri dhe do të pranohet**.

Sa më sipër, observacioni merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Projekt Raport.

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion në observacion konkretisht shkresa nr. 4340/4 datë 25.07.2024 me lëndë “Mbi katin e verifikimit nr. 1”, dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim është pranuar nga ana e institucionit dhe është zbatuar plotësisht. -Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

15.1. Rekomandimi: Nga Sektori i Prokurimeve, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa në vijimësi për dokumentimin e çdo procesi pune dhe administrimin e të gjithë dokumentacionit të kërkuar sipas ftesës për ofertë, me qëllim sigurimin e dobishmërisë së përdorimit të fondeve publike.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

16.1.Rekomandimi: Komisionet e marrjes në dorëzim mallrave/shërbimeve/punëve të ngritura nga Titullari i Institucionit të marrin masa në vijimësi që procesverbalet e mbajtura për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve /punëve të jenë të detajuara sipas kërkesave të përcaktuar në ftesën për ofertë dhe në kontratën e lidhur mes AK dhe OE fitues, me qëllim evidentimin e realizimit të mallrave/shërbimeve/punëve sipas kërkesave dhe cilësisë së kërkuar nga AK.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit të shqyrtuar në subjekt rezultoi se për disa nga proces verbalet e mbajtura, për marrjen në dorëzim të mallrave ishin kryer sipas kërkesave të përcaktuara. -Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

16.2. Rekomandimi: Titullari i Institucionit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa, që në urdhrin për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve, në përbërje të tij , të paktën një anëtar të jetë specialistë i fushës bazuar në objektin e procedurës së prokurimit, me qëllim sigurimin e cilësisë së mallrave sipas specifikimeve.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit të shqyrtuar në subjekt rezultoi se për disa nga urdhërat e ngritura për marrjen në dorëzim të mallrave ka nisur të merret parasysh fakti që një nga anëtarët e komisionit është specialist i fushës bazuar në objektin e procedurës së prokurimit. -Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

17.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, personat për hartimin e parashikimeve të investimeve kapitale, të marrin masat në vijimësi për planifikimin e tyre bazuar në prioritetet e institucionit, me qëllim mirë menaxhimin e fondeve publike, evitimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura, e ndryshimit të prioritetëve të projekteve, si dhe cënimin apo favorizimin e projekteve specifike.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

18.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, personat përgjegjës të parashikimit të investimeve, të marrin masat në vijimësi për realizimin e studimeve paraprak në bashkëpunim me autoritet përkatëse pjesë e projekteve, me qëllim mirë menaxhimin e fondeve publike, evitimin e ndryshimit të prioritetëve të projekteve, si dhe cenimin apo favorizimin e projekteve specifike.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) si dhe bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

18.2. Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për ngritjen e një komisioni me specialist të fushës, me qëllim ndarjen dhe përcaktimin e vlerave që i përkasin tre pikave doganore për të cilat MTM nuk duhet ti kishte përfshirë në projekt.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar rekomandimit nuk ka dokumentacion provues dhe ngelet i pazbatuar.Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

18.3. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të informojë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar në lidhje me ndryshimet që do të kenë në projekt dhe pas finalizimit të dërgojë pikat doganore për të cilat nuk do të realizohet projekti.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar rekomandimit nuk ka dokumentacion provues dhe si i tillë rekomandimi është i pazbatuar. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

19.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vijimësi, të marrë masa që çdo proces pune të jetë i argumentuar teknikisht dhe i dokumentuar me dokumentacionin përkatës.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Në procedurat e prokurimit të mallrave dhe shërbimeve po merren masa që disa nga proceset e punës të mirë argumentohen teknikisht dhe të dokumentohen sipas kriterve të përcaktuara. -Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

20.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vijimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, si dhe të hartojë analiza teknike, ku të parashikohet fuqia punëtore dhe mjetet/makineritë që nevojiten

për realizimin e secilit zë punimesh, sipas afateve kohore të parashikuara në grafikun e punimeve dhe, mbi bazën e analizave përkatëse të përcaktohet numri minimal i punonjësve të domosdoshëm, për realizimin e punimeve objekt kontrate.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

21.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të marrin masa për eliminimin e praktikave të prokurimit me shkelje ligjore, dhe të shpallura fituese në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara në DST, me qëllim përdorimin me eficiency dhe efektivitet e fondeve publike.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

22.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësia e Prokurimit të marrë masat që, në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, çdo kriter i veçantë të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, si dhe të hartojë analiza teknike, ku të parashikohet fuqia punëtore dhe mjetet/makineritë që nevojiten për realizimin e secilit zë punimesh, si dhe dokumentacioni që duhet të paraqesë operatori ekonomik për të përmbushur këto kriterë, duke shmangur sa më shumë të jetë e mundur përdorimin e kriterëve të përgjithshme, të papërcaktuara.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

23.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të marrin masa për eliminimin e praktikave të prokurimit me shkelje ligjore, dhe të shpallura fitues në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara në DST, me qëllim përdorimin me eficiency dhe efektivitet e fondeve publike.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

23.2. Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa në vijimësi që pagesat të mos copëzohen në këste, nëse kjo nuk është e parashikuar në kushtet e veçanta të kontratës së lidhur mes AK dhe operatorit ekonomik, me qëllim përdorimin me eficiency dhe efektivitet të fondeve buxhetore.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Nga komunikimi me sektorin e financës, rezultoi se pagesat do të kryhen sipas kushteve të veçanta të kontratës së lidhur mes AK dhe operatorit ekonomik.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

24.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të marrë masa në vijimësi që përpara fillimit të procesit për përmirësimin e vend depozitimeve të vlerësojë dhe të miratojë planin nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, duke i kaluar për shqyrtim pranë Komitetit Ndërmënyor për Mbetjet, në përputhje me parashikimet ligjore.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

25.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo proces pune të jetë i argumentuar teknikisht dhe i dokumentuar me dokumentacionin përkatës.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

26.1. Rekomandimi: Komisionet e marrjes në dorëzim mallrave/shërbimeve/punëve të ngritura nga titullari i institucionit të marrin masa në vijimësi që procesverbalet e mbajtura për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve /punëve të jenë të detajuara sipas kërkesave të përcaktuar në DT dhe në kontratën e lidhur mes AK dhe OE fitues, me qëllim evidentimin e realizimit të kontratës sipas kërkesave dhe cilësisë së kërkuar nga AK.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

27.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Sektori i Prokurimeve të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e të gjithë procedurave, duke dokumentuar të gjithë procesin në rend kronologjik, në zbatim të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

28.1. Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse të MTM-së, të marrin masa për plotësimin e mangësive të evidentuara, si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konform përcaktimeve të ligjit të MFK-së dhe aktet në zbatim të tij, për ta bërë atë efektiv dhe në dobi të veprimtarisë institucionale.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konkludohet se rekomandimi është zbatuar pjesërisht.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

29.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim plotësimin e strukturës të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm me personel me qëllim mbarëvajtjen e punës së kësaj drejtorie dhe të gjithë institucionit për shkak të rolit të rëndësishëm që kjo drejtori ka në evidentimin e problematikave të menaxhimit.

Menjëherë

Komenti institucionit mbi zbatim e rekomandimit Në periudhën e auditimit, në strukturën e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm ka pasur 2 (dy) vende vakante, vende të cilat janë plotësuar gjatë vitit 2024. Rekomandimi është zbatuar tërësisht.

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim konsiderohet i zbatuar plotësisht. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

29.2. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa të menjëhershme për krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, i cili ofron këshilla e rekomandime objektive Titullarit të njësisë publike në lidhje me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, me qëllim arritjen e objektivave si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësi të saj.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim konsiderohet i zbatuar plotësisht. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

30.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për hartimin e prioritetëve sa më të qarta mbi zonat me përparësi në zhvillimin e turizmit dhe burimet turistike për të cilat do të zhvillohen këto projekte, me qëllim përdorimin e fondeve publike në këto programe, me eficiencë dhe efektivitet si dhe me impakt në fushën e turizmit.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

30.2. Rekomandimi: Komisioni i përzgjedhjes së projekteve në MTM, të marrë masa që në procesverbalet e mbajtur mbi përzgjedhjen e aplikantëve të argumentojë mënyrën e përzgjedhjes së projekteve duke patur në fokus impaktin që kanë në planin e zhvillimit turizmit.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe argumentimeve nga ana e subjektit rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

30.3. Rekomandimi: Komisioni i përzgjedhjes së projekteve në MTM, gjatë vlerësimit të projekteve brenda një viti të marrë masa për kualifikimin e projekteve duke shmangur rastet

e përzgjedhjes, ku ortakut dhe/ose administratori rezulton të jetë pjesë e projekteve të tjera në këtë pozicion.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

30.4. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit të marrë masa për hartimin e një regjistri me projektet fituese, ku të evidentohen të gjitha rastet, ku është lidhur kontrata dhe nuk janë përmbushur kushtet e saj, me qëllim heqjen e të drejtës së aplikimit sërish me të njëjtin projekt në periudhat pasardhëse.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar argumentimeve të dhëna nga subjekti konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

30.5. Rekomandimi: Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të merren masa për hartimin e një plani monitorimi periodik të projektet në fushën e Turizmit, me qëllim vlerësimin e përdorimit të fondeve publike në këto programe, me eficiencë dhe efektivitet si dhe me impakt në fushën e turizmit.

Në vijimësi

Observacion i ardhur nga MTM me shkresën Nr. 4340/4 Prot., datë 25.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 880/6 Prot., datë 26.07.2024.

Pretendimi i subjektit:

Në kuadër të përfitimit të mbështetjes financiare të projekteve në fushën e turizmit, në zbatim dhe të Urdhrit nr. 102, datë 26.02.2024 “Për miratimin e projekteve në turizëm që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit”, Ministri ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për monitorimin e kontratave nëpërmjet Urdhrit nr. 114, datë 29.02.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e kontratave për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit”, në përbërje të të cilit janë ngarkuar për ndjekjen dhe monitorimin e projekteve, nëpunës të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si dhe përfaqësues të Drejtorive Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Bashkëlidhur do të gjeni 2 urdhrat e lart përmendur si dhe shkresë/përgjigje e AKZM për vënien në dispozicion të kontakteve të Titullarëve të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura.

Referuar observacionit të ardhur pas periudhës së auditimit në terren dhe dokumentit bashkëlidhur, grupi i auditimit pasi shqyrtoi me vëmendje pretendimin e subjektit vendosi ta marrë në konsideratë dhe ta reflektojë ndryshimin në projekt raportin e auditimit si më sipër.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi paraqet **fakt të ri dhe do të pranohet**.

Sa më sipër, observacioni merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Projekt Raport.

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion në observacion konkretisht shkresa nr. 4340/4 datë 25.07.2024 me lëndë “Mbi katin e verifikimit nr. 1”, dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim është pranuar nga ana e institucionit dhe është në zbatim.

plotësisht.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

31.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit e Mjedisit në bashkëpunim me bashkitë të realizojë vlerësimin e landfilleve për mënyrën e depozitimit të mbetjeve dhe përcaktimin e jetëgjatësisë së tyre, për marrjen e masave pas mbylljes së tyre. Gjithashtu të kryhen trajnime për rritjen e kapaciteteve menaxhuese dhe mënyrën e trajtimit të integruar të mbetjeve në landfille, të bashkive përkatëse dhe atyre ku do të kryhen investime të reja.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua : Referuar argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, rezultoi se gjatë vitit 2024 janë ngritur 3 qendra të reja të kompostimit në bashkitë Përmet, Pogradec dhe Shkodër. Si dhe në vijimësi i njëjti process do të kryhet dhe në bashkitë e tjera.- Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

32.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit e Mjedisit në bashkëpunim me sipërmarrësin e punimeve të marrë masa për riparimin e shtresave mbrojtëse të dëmtuara, sistemet e kullimit duke shmangur kontaminimin e mjedisit përreth si dhe rrethimet e dëmtuara për parandalimin e hedhjes së mbetjeve jo të lejuara, për minimizimin e kostove në të ardhmen me rritjen e jetëgjatësisë së landfilleve.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua: Referuar argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit dhe dokumentacioneve të vëna në dispozicion, ky rekomandim ngelet të vlerësohet i zbatuar plotësisht.Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

C.1 MASA SHPËRBLIM DËMI

1.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marri masa, për arkëtimin e shumës **264,170 Lekë pa TVSH**, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit nga *OE "A.K."* shpk sipas kontratës së lidhur me Nr.333/5Prot. datë 25.06.2021 për realizimin e punimeve civile.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim konkludohet se është zbatuar plotësisht.Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht..**

C.2 MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit e Mjedisit në bashkëpunim Bashkinë Kukës të marrë masa të menjëhershme për verifikimin se ku depozitohen mbetjet urbane si dhe monitorimin e situatës se si menaxhohet trajtimi i tyre, duke shmangur ndotjen e ambientit e ruajtjen e shëndetit publik.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim konkludohet se është zbatuar plotësisht. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

2.1 Rekomandimi: Nga Strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të merren masa në bashkëpunim me DAP, për rikthimin në punë të të gjithë punonjësve që kanë fituar këtë të drejtë sipas përcaktimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, pika 4, germa “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë **Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit**, në vlerësim të shkeljeve sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe nenit 57, pika 1, germa “a” dhe “b” të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit sipas përgjegjësive të tyre, në lidhje me çështjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkeljet e konstatuara, sipas nenit 58, germa “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”.

Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i ardhur nga MTM me shkresën Nr. 4340/4 Prot., datë 25.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 880/6 Prot., datë 26.07.2024.

Pretendimi i subjektit:

Referuar grupimeve të masave, përkatësisht Masa Disiplinore dhe Njoftimi i DAP dhe KMSHC për punonjësit që do të merren masa disiplinore për shkeljet e konstatuara, ju bëjmë me dije se:

Në mbështetje të Kreut X të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimet e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në Shërbimin Civil, struktura përgjegjëse për menaxhimin e proceseve që lidhen me dhënien e masave disiplinore në MTM (Njësia e Burimeve Njerëzore), bazuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bëri një analizë të personave dhe strukturave përkatëse ku nëpunësit përgjegjës janë pjesë me qëllim orientimin e gjetjeve të KLSH të këto struktura. Përkatësisht u ndoqën këto hapa: Njësia e Burimeve Njerëzore shqyrtoi Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe evidentoi punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi për parregullsitë e konstatuara në Raport. Konform legjislacionit të fuqi, këto konstatime ju përcollën me emalin zyrtar eprorit direkt të çdo punonjësi q u evidentua në Raport, për të shqyrtuar të gjitha faktet dhe provat dhe për të vlerësuar nëse ekzistojnë elemente që mund të klasifikohen si shkelje disiplinore. Secili nga eprorët përkatës solli vendimarrjen e tij në formë shkresore pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore, të cilat do ti gjeni bashkëlidhur. Sa i takon pikës E, lidhur me njoftimin e DAP dhe KMSHC për regjistrimin e masave disiplinore për shkeljet e konstatuara, për shkak se në përfundim të

procedurës nuk konkluduar në asnjë masë disiplinore të dhënë, nuk lind nevoja për njoftimin e DP dhe KMSHC.

Referuar observacionit të ardhur pas periudhës së auditimit në terren dhe dokumentit bashkëlidhur ku vihet re komunikimi me emalin nga ana e NJBNJ drejtuar eprorëve respektiv të personave të listuar në këto emali dhe si dhe shkresave ku gjendet vendimmarrja e cdo eprori për këto masa, grupi i auditimit pasi shqyrtoi me vëmendje pretendimin e subjektit vendosi ta marrë në konsideratë dhe ta reflektojë ndryshimin në projekt raportin e auditimit si më sipër.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrim tuaj, konkludon se argumentimi paraqet *fakt të ri dhe do të pranohet*.

Sa më sipër, observacioni merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Projekt Raport.

Nga verifikimi u konstatua: Referuar rekomandimit nuk ka asnjë dokumentacion provues për realizimin e këtij rekomandimi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit që do të jepen masat disiplinore për shkeljet sa më sipër, MTM, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i ardhur nga MTM me shkresën Nr. 4340/4 Prot., datë 25.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 880/6 Prot., datë 26.07.2024.

Pretendimi i subjektit:

Referuar grupimeve të masave, përkatësisht Masa Disiplinore dhe Njoftimi i DAP dhe KMSHC për punonjësit që do të merren masa disiplinore për shkeljet e konstatuara, ju bëjmë me dije se: Në mbështetje të Kreut X të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimet e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në Shërbimin Civil, struktura përgjegjëse për menaxhimin e proceseve që lidhen me dhënien e masave disiplinore në MTM (Njësia e Burimeve Njerëzore), bazuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bëri një analizë të personave dhe strukturave përkatëse ku nëpunësit përgjegjës janë pjesë me qëllim orientimin e gjetjeve të KLSH të këto struktura. Përkatësisht u ndoqën këto hapa: Njësia e Burimeve Njerëzore shqyrtoi Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe evidentoi punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi për parregullsitë e konstatuara në Raport. Konform legjislacionit të fuqi, këto konstatime ju përcollën me emalin zyrtar eprorit direkt të çdo punonjësi q u evidentua në Raport, për të shqyrtuar të gjitha faktet dhe provat dhe për të vlerësuar nëse ekzistojnë elemente që mund të klasifikohen si shkelje disiplinore. Secili nga eprorët përkatës solli vendimmarrjen e tij në formë shkresore pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore, të cilat do ti gjeni bashkëlidhur. Sa i takon pikës E, lidhur me njoftimin e DAP dhe

KMSHC për regjistrimin e masave disiplinore për shkeljet e konstatuara, për shkak se në përfundim të procedurës nuk konkludohet në asnjë masë disiplinore të dhënë, nuk lind nevoja për njoftimin e DP dhe KMSHC. Referuar observacionit të ardhur pas periudhës së auditimit në terren dhe dokumentit bashkëlidhur ku vihet re komunikimi me emalin nga ana e NJBNJ drejtuar eprorëve respektiv të personave të listuar në këto emali dhe si dhe shkresave ku gjendet vendimmarrja e cdo eprori për këto masa, grupi i auditimit pasi shqyrtoi me vëmendje pretendimin e subjektit vendosi ta marrë në konsideratë dhe ta reflektojë ndryshimin në projekt raportin e auditimit si më sipër.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi paraqet *fakt të ri dhe do të pranohet*. Sa më sipër, observacioni merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Projekt Raport.

Nga verifikimi u konstatua: Referuar rekomandimit nuk ka asnjë dokumentacion provues për realizimin e këtij rekomandimi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Në përfundim të procesit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, rezulton se nga **51** rekomandime të lëna, nga Subjekti **MTM** janë pranuar të **50** rekomandime, dhe 1- rekomandim i pa pranuar, nga të cilat: janë zbatuar **12** masa ose **24 % e tyre**; **3**-masa janë zbatuar pjesërisht; **15**-masa janë në proces zbatimi si dhe **20**- masa janë pa zbatuar, pra **24**- masa mbeten për tu zbatuar nga subjekti **MTM**, për periudhën në vijim. Grupi i auditimit duke analizuar Rekomandimet e pranuar dhe të zbatuara nga **MTM** (njësitë përgjegjëse të saj) apo dhe ato në proces zbatimi, arriti në konkluzionin që: - Për kategorinë "Masa Organizative"- Rekomandimet R 4.1; R 5.1; R 6.1; R 6.2; R 6.3; R 7.1; R 9.1; R 11.1; R 13.1; R 14.1; R 15.1; R 16.1; R 16.2; R 19.1; R 20.1; R 23.2; R 29.1; R 29.2; R 30.1; R 30.2; R 30.5; R 31.1; R 32.1; - Kategorinë "Masa shpërblym dëmi", R 1.1; -Kategorinë "Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave"- R 11; R 2.1; -Kategorinë "Masa disiplinore" dhe Njoftim tek DAP/KMSHC janë pranuar dhe zbatuar apo në proces zbatimi nga **MTM**, prandaj nuk mund të qëndrojnë për periudhën në vijim.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmisimin e gjëndjes *Rikërkojmë që*, **MTM** të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara si dhe pjesërisht zbatuar brenda 3-mujorit të parë të vitit 2025.

Si dhe marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH-së të pranuar prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara. ***Në auditimet e radhës në MTM, do të shtohet pika e zbatimit të rekomandimeve***

A.MASA ORGANIZATIVE:

1.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik, të marrin masat e nevojshme, që në periudhat në vijim të eliminohen praktikatat e çeljes së projekteve të reja pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore, si dhe të respektohen projektet e investimeve të parashikuara në PBA.

2.1. Rekomandimi: NA dhe NZ në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të marrin masat, për hartimin e raporteve të monitorimit të buxhetit çdo katër muaj për aparatin e MTM-së si njësi shpenzuese, për produktet e buxhetit të administruara nga ana e saj, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit, si dhe publikimin e tyre në faqen zyrtare të ministrisë.

3.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe raportimit, për efekt të hartimit dhe monitorimit të planit buxhetor sa më të detajuar dhe transparente, duke përfshirë të gjitha njësitë përgjegjëse për buxhetin e programeve të administruara nga institucioni.

Rekomandim 6.4: Nga ana e Sektorit të Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, të merren masa për ndjekjen me kujdes të proceseve gjyqësore dhe përcjelljen në kohë të informacionit të plotë dhe të saktë në njësinë përkatëse, përgjegjëse për financë/kontabilitetin, në mënyrë që kjo e fundit të njohë dhe kontabilizojë në kohë vlerat që lidhen me këto shpenzime/detyrime, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë nr.230 “Investime në proces” me mbylljen e bilancit të vitit pasardhës, për vlerën kontabël prej 17,372,947 lekë, të projekteve të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë nr.202 “Studime dhe Kërkime” dhe në kredi të llogarisë nr.230 “Investime në proces”

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë të fondit neto, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

11.2.Rekomandimi: Titullari i Institucionit në cilësinë e NA të marrë masa në vijimësi për shmangien e përfshirjes së punonjësve në proceset e punës, të cilat e vendosin atë në konflikt interesi, me qëllim funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm sa më të qëndrueshëm.

12.1.Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat, që për çdo procedurë transferimi, e pakësimit ose të shtesës së aktive në kontabilitet nga lëvizjet kapitale pa pagesë brenda apo jashtë sistemit, të administrojë të gjithë dokumentacionin përkatës të kalimit kapital të aktiveve hyrëse ose dalëse, me qëllim mbylljen e ciklit të transferimit si dhe verifikimin e regjistrimit në kontabilitet të tyre.

17.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, personat për hartimin e parashikimeve të investimeve kapitale, të marrin masat në vijimësi për planifikimin e tyre bazuar në prioritet e institucionit, me qëllim mirë menaxhimin e fondeve publike, evitimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura, e ndryshimit të prioriteteve të projekteve, si dhe cenimin apo favorizimin e projekteve specifike.

18.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, personat përgjegjës të parashikimit të investimeve, të marrin masat në vijimësi për realizimin e studimeve paraprak në bashkëpunim me autoritet përkatëse pjesë e projekteve, me qëllim mirë menaxhimin e fondeve publike, evitimin e ndryshimit të prioriteteve të projekteve, si dhe cenimin apo

favorizimin e projekteve specifike.

18.2. Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për ngritjen e një komisioni me specialist të fushës, me qëllim ndarjen dhe përcaktimin e vlerave që i përkasin tre pikave doganore për të cilat MTM nuk duhet ti kishte përfshirë në projekt.

18.3. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të informojë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar në lidhje me ndryshimet që do të kenë në projekt dhe pas finalizimit të dërgojë pikat doganore për të cilat nuk do të realizohet projekti.

20.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vijimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, si dhe të hartojë analiza teknike, ku të parashikohet fuqia punëtore dhe mjetet/makineritë që nevojiten për realizimin e secilit zë punimesh, sipas afateve kohore të parashikuara në grafikun e punimeve dhe, mbi bazën e analizave përkatëse të përcaktohet numri minimal i punonjësve të domosdoshëm, për realizimin e punimeve objekt kontrate.

21.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të marrin masa për eliminimin e praktikave të prokurimit me shkelje ligjore, dhe të shpallura fituese në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara në DST, me qëllim përdorimin me efience dhe efektivitet e fondeve publike.

22.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësia e Prokurimit të marrë masat që, në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, çdo kriter i veçantë të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, si dhe të hartojë analiza teknike, ku të parashikohet fuqia punëtore dhe mjetet/makineritë që nevojiten për realizimin e secilit zë punimesh, si dhe dokumentacioni që duhet të paraqesë operatori ekonomik për të përmbushur këto kriterë, duke shmangur sa më shumë të jetë e mundur përdorimin e kriterëve të përgjithshme, të papërcaktuara.

23.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të marrin masa për eliminimin e praktikave të prokurimit me shkelje ligjore, dhe të shpallura fitues në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara në DST, me qëllim përdorimin me efience dhe efektivitet e fondeve publike.

24.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të marrë masa në vijimësi që përpara fillimit të procesit për përmirësimin e vend depozitimeve të vlerësojë dhe të miratojë planin nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, duke i kaluar për shqyrtim pranë Komitetit Ndërmnistror për Mbetjet, në përputhje me parashikimet ligjore.

25.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo proces pune të jetë i argumentuar teknikisht dhe i dokumentuar me dokumentacionin përkatës.

26.1. Rekomandimi: Komisionet e marrjes në dorëzim mallrave/shërbimeve/punëve të ngritura nga titullari i institucionit të marrin masa në vijimësi që procesverbalet e mbajtura

për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve /punëve të jenë të detajuara sipas kërkesave të përcaktuar në DT dhe në kontratën e lidhur mes AK dhe OE fitues, me qëllim evidentimin e realizimit të kontratës sipas kërkesave dhe cilësisë së kërkuar nga AK.

27.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Sektori i Prokurimeve të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e të gjithë procedurave, duke dokumentuar të gjithë procesin në rend kronologjik, në zbatim të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

28.1. Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse të MTM-së, të marrin masa për plotësimin e mangësive të evidentuara, si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konform përcaktimeve të ligjit të MFK-së dhe aktet në zbatim të tij, për ta bërë atë efektiv dhe në dobi të veprimtarisë institucionale.

30.3. Rekomandimi: Komisioni i përzgjedhjes së projekteve në MTM, gjatë vlerësimit të projekteve brenda një viti të marrë masa për kualifikimin e projekteve duke shmangur rastet e përzgjedhjes, ku ortaku dhe/ose administratori rezulton të jetë pjesë e projekteve të tjera në këtë pozicion.

30.4. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit të marrë masa për hartimin e një regjistri me projektet fituese, ku të evidentohen të gjitha rastet, ku është lidhur kontrata dhe nuk janë përmbushur kushtet e saj, me qëllim heqjen e të drejtës së aplikimit sërish me të njëjtin projekt në periudhat pasardhëse.

3.5 MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

3.5.1 PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim tematik në **Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural** me objekt “*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara të vitit 2023*” për auditimin e kryer në vitin 2023, për periudhën objekt auditimi 01.04.2021 deri në 31.12.2022, përcjellë me shkresën Nr. 1175/28 Prot., datë 01.08.2023, protokolluar në subjekt me nr. 211/64 Prot., datë 03.08.2023 duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH^{së} të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

Vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

Vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

Vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve;

Vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, si dhe manualit “*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve*”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 880/1 prot., datë 02.07.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Auditimi u krye nga:

1. S.Z, përgjegjës grupi

2. N.M, anëtar

Auditimi ka filluar më, 03.07.2024

Auditimi ka përfunduar më, 18.07.2024

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 1175/28 Prot., datë 01.08.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLZIONI:

-Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se janë lënë në total 39 rekomandime nga të cilat 38 janë pranuar dhe 1 pa pranuar nga subjekti dhe se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **31 Masa organizative** nga ku **30** rekomandime, janë pranuar plotësisht të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, **12** Zbatuar, **4** pa zbatuar, **8** në proces zbatimi dhe **6** zbatuar pjesërisht.

-Për përmirësimin e gjendjes është lënë **3 Masa shpërblim** dëmi nga ku **3** rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht në shumën totale 7,590.8 mijë lekë të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, **2** zbatuar dhe **1** në proces.

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **2 Masë mbi të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit**, nga ku **2** rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht në shumën totale 481,859 mijë lekë dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, **2** Zbatuar pjesërisht.

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **2 Masa për menaxhimin me Efektivitet dhe Ekonomicitet të Fondeve Buxhetore** nga ku **2** rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht në shumën totale 68,378.7 mijë lekë dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, **2** në proces zbatimi.

-Për përmirësimin e gjendjes është lënë **1 Masë Disiplinore** nga ku **1** rekomandim, e cila ka statusin e ecurisë së zbatimit, **1** zbatuar pjesërisht.

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezulton në nivel **97,4 %**, konkretisht nga **39** rekomandime gjithsej, janë pranuar **38** rekomandime.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht rezultoi në masën **37%**, niveli i zbatimit të rekomandimeve në proces rezultoi **29%**, niveli i rekomandimeve pa zbatuara rezultoi **11%**, niveli i rekomandimeve të zbatuara pjesërisht rezultoi **23%**, nivele këto të cilat

tregojnë vlerësimin e këtij procesi në lidhje me ndjekjen e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

Nga auditimi i ushtruar në **Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural** për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë*” për periudhën nga data 01.04.2020 deri në 31.12.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 145, datë 01.08.2023, përcjellë. me shkresën Nr. 1175/28 Prot., datë 01.08.2023.

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën me nr. 211/66 datë 23.08.2023.

Sa më sipër rezulton se subjekti e ka zbatuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga ana e subjektit të audituar lidhur me raportimin mbi zbatimin të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara sipas strukturave përgjegjëse, subjekti ka raportuar në KLSH me shkresën nr. 970/1 Prot. datë 05.02.2024 brenda afatit 6 mujor të raportimit, **sipas** ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30.

Sa më sipër rezulton se e ka zbatuar afati 6 mujor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Rekomandimi: MBZHR të marrë masa që në të ardhmen të monitorojë me përgjegjësi dhe në kohë nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, për përmirësimin e treguesve dhe menaxhimit me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve të buxhetit të shtetit ashtu edhe të burimeve njerëzore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar shkresës nr. 1175/28 prot, datë 1.8.2023, me nr. hyrës në MBZHR 211/64 prot., datë 03.08.2023. ky rekomandim është në proces zbatimi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

1.2 Rekomandimi: MBZHR të marrë masa të menjëhershme për nxjerrjen e përgjegjësive për personat e ngarkuar për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve sipas detyrave

funkionale të përcaktuara në Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të brendshëm të MBZHR-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar dokumentacionin të vënë në dispozicionin dhe argumentimeve nga ana e subjektit, rekomandimi konsiderohet i zbatuar. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

2.1 Rekomandimi: MBZHR të marrë masat që në likuidime/ urdhër shpenzime të ruajë të njëjtën radhë kronologjike me numrin elektronik sekuencial të vendosur nga Sistemi Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), në funksion të respektimit dhe reflektimit të saktë të tyre në ditarin e bankës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe argumenteve nga ana e subjektit, pagesat e kryera janë në radhë kronologjike. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

3.1 Rekomandimi: MBZHR të marrë masa në planifikimin e duhur buxhetor në lidhje me procesin e arbitrazhit, si dhe të mos përdorë fonde të lira për realizimin e produkteve jashtë programit pa miratimin e duhur ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, nuk janë bërë më pagesa për arbitrazhin jashtë programit 01110. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

4.1 Rekomandimi: MBZHR të marrë masat në pasqyrimin në regjistrin e aktiveve të kontratave koncesionare për të cilat është autoriteti përgjegjës për ndjekjen dhe raportimin, në funksion të ruajtjes së gjurmës së auditimit.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Për këtë rekomandim nuk na është vënë asnjë dokumentacion në dispozicion për shkak se institucioni nuk e ka pranuar rekomandimin. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pa pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

5.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Titullari i institucionit që në të ardhmen të monitorohen me përgjegjësi dhe të analizohen në kohë veprimtaria e kryer nga Institucionet e varësisë si dhe Drejtoritë në MBZHR, konkretisht për Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akua Kulturës në MBZHR, të hartohet regjistri i kontratave si pjesë integrale e regjistrit të aktiveve të aparatit të MBZHR.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konkludohet që rekomandimi është zbatuar. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

5.2 Rekomandimi: Të hartohen plane monitorimi vjetorë dhe mujorë nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe të Akuakulturës (DPSHA) dhe të miratohen nga Sekretari i Përgjithshëm në MBZHR.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konkludohet që

rekomandimi është zbatuar. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

5.3 Rekomandimi: Të raportohet në mënyrë periodike dhe vjetore mbi shfrytëzimin e lagunave bregdetare dhe mbrojtjen e ekosistemeve të tyre, për menaxhimin me efikasitet dhe efektivitet të të ardhurave që këto të fundit gjenerojnë në buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konkludohet që rekomandimi është zbatuar. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

6.1 Rekomandimi: MBZHR të marrë masat në regjistrimin e menjëhershëm të tokave bujqësore në Agjencinë e Kadastrës dhe më tej në pasqyrat financiare dhe regjistrin e aktiveve për të pasqyruar sa më saktë gjendjen e saj pasurore në administrim dhe evidentimin e të ardhurave dytësore që këto qiradhënie gjenerojnë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe argumentimi nga ana e subjektit, konkludohet që rekomandimi është në proces. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

7.1 Rekomandimi: MBZHR të marrë masat e menjëhershme në raportimin e duhur financiar të listës së debitorëve në lidhje me tokat bujqësore, duke bërë regjistrimin në pasqyrat financiare si dhe regjistrin e aktiveve të aparatit të MBZHR.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konkludojmë që dokumentacioni nuk është i plotë dhe rekomandimi është i pazbatuar. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

8.1 Rekomandimi: MBZHR, të vlerësojë me prioritet burimet njerëzore të nevojshme në funksion të detyrave që lidhen me administrimin e tokës bujqësore, të analizojë nga pikëpamja sasiore (numër punonjësish në raport me kontratat, subjekt monitorimi) dhe nga pikëpamja e ekspertizës, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike. MBZHR të marrë masa mbi shtimin e numrit të punonjësve në sektorin e Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave, në funksion të mbarëvajtjes së punës.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konkludohet se rekomandimi është zbatuar pjesërisht. Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

8.2 Rekomandimi: Nga titullari i MBZHR, për realizimin e procedurës së dhënies me qira të tokave bujqësore, të vendosen zyrtarët përgjegjës në grupet e punës duke mbajtur parasysh parimet e kontrollit të brendshëm dhe vepruar në mënyrë të tillë, që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, dhe kontrollin sipas kërkesave që dikton ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konkludohet që nga ristrukturimi i ri, sektori i mëparshëm është ndarë në dy sektorë të

veçantë. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

9.1 Rekomandimi: Nga ana e MBZHR të merren masa, për përditësimin, inventarizimin, dhe regjistrimin e gjithë fondit të tokës bujqësore që ka në administrim MBZHR, duke bashkëpunuar dhe koordinuar punën me Drejtoritë Rajonale të Administrimit të Tokave në Qarqe dhe Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe argumentimeve nga ana e subjektit konkludohet që rekomandimi është në proces. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

10.1 Rekomandimi: MBZHR të marrë masat e nevojshme për miratimin e regjistrit për kontratat e qirasë, në të cilin të mirë përcaktohet forma, përmbajtja si dhe të evidentohet në një kolonë të veçantë monitorimi i secilës kontratë në fund të çdo viti ushtrimor.

Në vijimësi

Observacion i ardhur nga MBZHR me shkresën Nr. 4916/1 Prot., datë 22.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 880/4 Prot., datë 23.07.2024.

Pretendimi i subjektit:

Për rekomandimin nr 10 pika 1 seksioni B masa organizative, MBZHR ka miratuar këtë regjistrë me Udhëzimin nr. 19 datë 18.07.2024 me nr 4922/1 Prot., datë 18.07.2024 “Miratimin e formës, përmbajtjes dhe administrimit të regjistrit të kontratave të qerasë së tokës bujqësore në pronësi të shtetit, në përgjegjësi administrimi të MBZHR”

Referuar observacionit të ardhur pas periudhës së auditimit në terren, grupi i auditimit pasi shqyrtoi me vëmendje pretendimin e subjektit vendosi ta marrë në konsideratë dhe ta reflektojë ndryshimin në projekt raportin e auditimit si më sipër.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi paraqet **fakt të ri dhe do të pranohet**.

Sa më sipër, observacioni merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Projekt Raport.

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion në observacion konkretisht shkresa Udhëzimin nr. 19 datë 18.07.2024 me nr 4922/1 Prot., datë 18.07.2024 “Miratimin e formës, përmbajtjes dhe administrimit të regjistrit të kontratave të qerasë së tokës bujqësore në pronësi të shtetit, në përgjegjësi administrimi të MBZHR”, dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim është pranuar nga ana e Institucionit dhe është në proces zbatimi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

10.2 Rekomandimi: MBZHR të marrë masat në hartimin e një plani vjetor në fillim të çdo viti për monitorimin e kontratave. MBZHR të hartojë dhe standardizojë procedurat për ndjekjen dhe monitorimin e kontratave, ku të pasqyrohet dokumentacioni që duhet të plotësohet gjatë monitorimit, për argumentimin e investimeve kapitale të kryera si dhe për shpenzimet për përmirësimin e tokës.

Observacion i ardhur nga MBZHR me shkresën Nr. 6371/1 Prot., datë 28.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr. 880/28 Prot., datë 31.10.2024.

Pretendimi i subjektit:

Duke ju referuar Projekt-Raportit të Auditimit Tematik Me Objekt “Për Zbatimin e Rekomandimeve të lëna në Auditimet e Evaduara të vitit 2023 (Gjashtë mujori i dytë)” dërguar me shkresën Nr. 880/18 Prot, datë 24.09.2024 dhe ardhur në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me Nr. 6371 Prot, datë 26.09.2024, ju përcjellim komentet tona mbi këtë Projekt Raport si më poshtë vijon:

10.2 Rekomandimi: MBZHR të marrë masat në hartimin e një plani vjetor në fillim të çdo viti për monitorimin e kontratave. MBZHR të hartojë dhe standartizojë....

Komenti shpjegues i institucionit mbi zbatimin e rekomandimit:

Referuar statusit të rekomandimit të KLSH, përcjellë nëpërmjet Projekt Raportit të dërguar me shkresën Nr. 880/18 Prot, datë 24.09.2024 dhe ardhur në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me Nr. 6371 Prot, datë 26.09.2024 ju informojme se:

1. Është miratuar në datë 29.8.2024, plani i monitorimit të kontratave të qirasë për vitin 2024 dhe aktualisht janë kryer 2 monitorime në terren. Gjatë muajve në vijim do të vazhdohet me monitorimin e kontratave të qirasë sipas planit.

Bashkëlidhur ju paraqesim Planin e Monitorimit të kontratave, të miratuar për vitin 2024 si dhe procesverbalet e monitorimit në terren.

Bashkëlidhur observacionit, -MEMO me Nr.5742 Prot, datë 29.08.2024 me lëndë “Mbi planin e monitorimi në terren të kontratave të qirasë së tokës bujqësore në pronësi të shtetit për vitin 2024. -ProcesVerbal me Nr.6275/2 Prot, datë 30.09.2024 “Për monitorimin e kontratës Nr.5672 Prot, Nr 2182 Rep,Nr 441 Kol datë 15.07.2020. -ProcesVerbal me Nr.6275/3 Prot, datë 30.09.2024 “Për monitorimin e kontratës Nr.1824 Prot, Nr 1269 Rep,Nr 287 Kol datë 03.03.2016, ndryshuar me amendim kontrate Nr.3101 Prot, Nr.1388 Rep, Nr.237 Kol, datë 04.05.2020.

Referuar observacionit të ardhur pas periudhës së auditimit në terren, grupi i auditimit pasi shqyrtoi me vëmendje pretendimin e subjektit vendosi ta marrë në konsideratë dhe ta reflektojë ndryshimin në raportin përfundimtar të auditimit si më sipër.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrim tuaj, konkludon se argumentimi paraqet *fakt të ri dhe do të pranohet.*

Sa më sipër, observacioni merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Raport Përfundimtar.

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion në observacion konkretisht me shkresën Nr. 6371/1 Prot., datë 28.10.2024 , dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, Memo dhe dy procesverbale bashkëlidhur, ky rekomandim është pranuar nga ana e Institucionit dhe është në proces zbatimi.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

11.1 Rekomandimi: MBZHR të marrë masat për protokollimin e të gjitha procesverbaleve të monitorimit të kontratave të qirasë dhe procesverbalet të nënshkruhen dhe nga ana e qiramarrësit.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konkludohet që rekomandimi është zbatuar. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

12.1 Rekomandimi: Titullari i MBZHR të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim vlerësimin e kontratave me problematikë në mospërputhjen e vlerës së investimit në plan biznes krahësuar kjo me vlerën e investimit të paraqitur në kontratën e qirasë. Në vijim të mundësohet dakordësia për amendim kontrate midis palëve me qëllim përputhshmërinë e investimit real me atë të parashikuar në kontratë sipas investimeve të kryera në terren dhe përshtatjen e afatit të qiradhënies sipas plan biznesit të ri.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe argumentimeve të subjektit, konkludohet që rekomandimi është në proces zbatimi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

13.1 Rekomandimi: Nga titullari i MBZHR të merren masa për vlerësimin dhe mundësimin e amendimit të kontratave të mësipërme midis palëve, në të cilat të vendoset sipërfaqja e saktë në përdorim. MBZHR të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, për verifikimin dhe identifikimin në terren të kontratave të tjera, nëse kanë mbi vendosje të sipërfaqeve bujqësore, me qëllim realizimin me sukses të kontratave. Për të gjitha rastet, MBZHR të marrë masa që të mos japë me qira tokë bujqësore, pa realizuar procesin e identifikimit dhe verifikimit të mungesës së mbivendosjeve nga palë të treta.

Brenda vitit 2023

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga MBZHR konkludohet që rekomandimi është zbatuar pjesërisht. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

14.1 Rekomandimi: MBZHR, të marrë masa të menjëhershme për njoftimin periodik për arkëtimin e garancive vjetore për të gjithë subjektet që nuk kanë mbaruar ende investimin, me qëllim parandalimin e risqeve që lidhen me mos respektimin e detyrimeve kontraktuale në kryerjen e investimeve sipas plan bizneseve të miratuara.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga MBZHR, konkludohet që subjektet nuk janë njoftuar periodikisht për marrjen e garancisë. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

15.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i institucionit/ministri në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike për plotësimin e vendit të lirë/vakant në pozicionin "drejtor" në Drejtorinë e AB.

Brenda vitit 2023

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konkludohet që është emëruar drejtori i ri i drejtorisë së auditit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

16.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i institucionit/ministri, që në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për burimet njerëzore, për punonjësit e kontraktuar përkohësisht në

zbatim të akteve nënligjore që nxjerr Këshilli i Ministrave (VKM) rast pas rasti për vitin respektiv, të lidhen kontrata pune me të kontraktuarit krahas akteve të emërimit në detyrë.

Rast pas rasti

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konkludohet që kontratat janë lidhur sipas akteve ligjore. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

16.2 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i institucionit/ministri, që në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për burimet njerëzore, aktet e emërimit në detyrë të punonjësve të kontraktuar përkohësisht në zbatim të VKM-ve respektive të nxirren në afat, me qëllim që vonesat në nxjerrjen e akteve të mos sjellin pasoja financiare në buxhet nga përfitimi i pagës në kushtet e fuqisë prapavepruese të aktit nënligjor kur një gjë e tillë nuk është shprehur në aktin nënligjor.

Rast pas rasti

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

17.1 Rekomandimi: Të merren masa nga njësia përgjegjëse për prokurimin në MBZHR për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të prokurimit për vitin 2019-2022 me qëllim sistemimin arkivor të dokumentacionit.

Deri në 31.09.2023

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe argumentimi i institucionit konkludohet që rekomandimi nuk është zbatuar në afat. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është **i zbatuar pjesërisht**.

18.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (MBZHR), të marrë masa për trajnimin në mënyrë të vazhdueshme të punonjësve që angazhohen me realizimin e procedurave të prokurimit, me synim prokurimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve në mënyrë sa më eficiente. MBZHR (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe llojin e kontratës për punë, mallra, shërbime. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, duke i dokumentuar në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Rast pas rasti

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

19.1 Rekomandimi: AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në

përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një s' kualifikim apo kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Rast pas rasti

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

20.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Titullari i Institucionit për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njërive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, sigurimit të gjurmës së auditimit si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet”.

Rast pas rasti

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konkludohet se rekomandimi është zbatuar pjesërisht.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

21.1 Rekomandimi: Nga ana e MBZHR të merren masa për argumentimin e kriterëve të vendosura në procedurat e prokurimit si dhe përzgjedhjen e tyre në raport me nevojat e investimeve me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

22.1 Rekomandimi: Nga ana e MBZHR të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative për mos kryerjen e pagesës prej 14,426,158.6 lekë si shumë e mbajtur për garanci punimesh ndaj BOE S. & P. I. për shkak të cilësisë së dobët të punimeve të kryera në fakt në kontratën me objekt ‘Rikonstruksion i Godinës së QTTB Fushë Krujë dhe Ndërtim Godine’, kjo pasi likuidimi i kësaj shume do të përbënte dëm ekonomik ndaj buxhetit të MBZHR.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Bazuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konkludohet që dokumentacioni nuk është i plotë dhe si e tillë rekomandimi është zbatuar pjesërisht.Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

23.1 Rekomandimi: AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një s' kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, i cili nuk ndryshon thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, duke e kualifikuar në këtë rast si ofertë të vlefshme me

qëllim menaxhimit me ekonomikitet, efektivitet dhe eficiencë të fondeve të buxhetit të shtetit.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

24.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i MBZHR për ndërtimin e një sistemi funksional të kontrollit të brendshëm publik dhe financiar. Struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore të marrë masa që në rastet e largimit nga puna për punonjësit me shërbim civil, dorëzimi i dokumentacionit të administruar prej tyre të bëhet me procesverbal, me qëllim eliminimin e vonesave të krijuara në rastet e auditimit të tij nga audit i jashtëm apo audit i brendshëm.

Rast pas rasti

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

25.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të MBZHR-së që para miratimit të Raportit vjetor mbi funksionimin e AB dhe dërgimit të tij në MFE, të rakordohet nga të gjithë anëtarët e grupit për hartimin e tij, për saktësinë e të dhënave të raportuara dhe gabimet materiale, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin cilësor të kontrollit të brendshëm.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim është i zbatuar.Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1 Rekomandimi: Nga ana e MBZHR të kërkohej në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **6,461,698 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE S. (me nr. licence NZ.) & P. I. (me nr. licence NZ.) për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 6764/5 prot., datë 16.10.2020 me objekt ‘Rikonstruktion i Godinës së QTTB Fushë Krujë dhe Ndërtim Godine’.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ana e subjektit si më sipër, gjykojmë se rekomandimi është i zbatuar.Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

2.1 Rekomandimi: Nga ana e MBZHR të kërkohej në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **956,402 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE B. & B. & B. & N. për punime jo sipas preventivit dhe situacionit përfundimtar të kontratës së sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me

nr. 3273/25 prot., datë 31.08.2020 me objekt “Loti 3, Rehabilitimi i veprave hidrike Rajoni Jug 2, Qarku Fier-Vlorë”) nën objekti “Mbrotjtje nga lumi Vjosë, në Hekal Mallakastër”.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Në bazë të dokumenteve dhe kërkesë padisë të vënë në dispozicion rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

3.1 Rekomandimi: Nga ana e MBZHR të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 172,718 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE R. për punime të likuiduara por të pakryera në fakt në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 6766/10 prot., datë 03.12.2019 me objekt “Rikonstruksioni i merkatos së tregtimit të peshkut me shumicë, Vlorë”.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rekomandimi konsiderohet i zbatuar. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

D. TË ARDHURA TË MUNGUARA NË BUXHETIN E SHTETIT.

1.1 Rekomandimi: MBZHR, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 55,830 mijë lekë, si pasojë e mos plotësimit të detyrimit kontraktor nga mos pagesa në afat e detyrimit vjetor të qirave duke krijuar vlera financiare të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit, si vijon:

- Shoqëria “P. I.” ShPK. në vlerën 27,483 mijë lekë (4,619 + 22,863)
- Shoqëria “A. I. G.” ShPK në vlerën 9,007 mijë lekë
- Shoqëria “B. N. F.” ShPK. në vlerën 14,799 mijë lekë
- Shoqëria “R. S.” ShPK në vlerën 2,180 mijë lekë për qira të pashlyer dhe kamatëvonesa;
- Shoqëria “S. G.” ShPK në vlerën 1,899 mijë lekë
- E. B., person fizik; K. C.; A. B. dhe F. A. dhe K. D. kanë në total 462 mijë lekë.
- MBZHR, të marrë masa si dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe administrative për zgjidhjen e njëanshme të kontratës në rast mospagimi.

Në vijimësi

Komenti institucionit mbi zbatim e rekomandimit

Janë njoftuar të gjithë subjektet me shkresë për këto detyrime gjatë vitit 2023. Disa nga subjektet kanë kundërshtuan këto detyrime në rrugë gjyqësore: “B. N. F.” shpk; “A.I.G” shpk; L. Z., Person Fizik; “F. A.” shpk. Konkretisht janë njoftuar subjekti “P. C.” me shkresën Nr. 5142/4 prot datë 27.9.2023, subjekti “E.B.” me shkresën Nr. 5142/1 prot datë 27.9.2023, subjekti “P. I.” shpk me shkresën Nr. 5142/2 prot datë 27.9.2023, subjekti “A.P.” shpk me shkresën Nr. 5142/3 prot datë 27.9.2023, subjekti “S.G.” shpk me shkresën Nr. 5142/5 prot datë 27.9.2023, Subjekti “A. I. G.” shpk, dërguar shkresa Nr. 5142/6, datë 27.9.2023, Subjekti “SH.M.”, dërguar shkresa Nr.5142/7, prot date 27.9.2023, Subjekti “L.Z.”, dërguar shkresa nr. 5142/8 prot, date 27.9.2023, Subjekti “B.P.” shpk, dërguar Shkresa Nr.5142/9, prot date 27.9.2023, Subjekti “B. N. F.” shpk, dërguars Shkresa Nr.5142/10, prot date 27.9.2023, Subjekti “K.D.” shpk, dërguar shkresa Nr.5142/11, prot date 27.9.2023, Subjekti “B.A.I.” shpk, dërguar Shkresa Nr.5142/12, prot date 27.9.2023, Subjekti “A.C.” shpk, dërguar Shkresa Nr.5142/13, prot date 27.9.2023, Subjekti “A.B.F.” shpk,

dërguar Shkresa Nr.5142/14, prot date 27.9.2023, Subjekti "F.A." shpk, dërguar Shkresa Nr.5142/15, prot date 27.9.2023, Subjekti "R. S." shpk, dërguar Shkresa Nr.5142/16, prot date 27.9.2023.

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e MBZHR konkludohet se rekomandimi është zbatuar pjesërisht. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

2.1 Rekomandimi: MBZHR, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e vlerës 426,029 mijë lekë si pasojë e mos plotësimit të detyrimit kontraktor në mos kryerjen e investimeve duke krijuar vlera financiare të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit, si vijon:

- Shoqëria "P.I" ShPK. në vlerën 45,465 mijë lekë;
 - Shoqëria "K.D" ShPK. në vlerën 12,938 mijë lekë;
 - Shoqëria "B.A.I" ShPK në vlerën 281,250 mijë lekë
 - Shoqëria "K.C." ShPK në vlerën 15,571 mijë lekë;
 - Shoqëria "B.N.F" ShPK. në vlerën 9,084 mijë lekë;
 - Shoqëria "A.I.G" ShPK në vlerën 6,778 mijë lekë;
 - Shoqëria "B.P" ShPK. në vlerën 4,714 mijë lekë;
 - Person fizik L.Z, në vlerën 5,147 mijë lekë;
 - Shoqëria "A.P" ShPK. në vlerën 17,063 mijë lekë;
 - Shoqëria "A" ShPK. në vlerën 1,438 mijë lekë;
 - Shoqëria "F.A" ShPK në vlerën 25,650 mijë lekë;
 - Shoqëria "M" ShPK në vlerën 931 mijë lekë.
- MBZHR, të marrë masa si dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe administrative për zgjidhjen e njëanshme të kontratës në rast mospagimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e MBZHR konkludohet se rekomandimi është në zbatuar pjesërisht. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

E. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.1 Rekomandimi: Nga ana e MBZHR të merren të gjitha masat e nevojshme për vënien në përdorim të investimit të bërë për pjesën e stallës së lopëve pasi aktualisht mos përdorimi e bën këtë shpenzim të jetë krejtësisht jo efektiv duke shkaktuar kështu edhe një përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet në masën prej **67,633,707 lekë me TVSH**. Gjithashtu, MBZHR dhe QTTB të marrin masat e nevojshme për sigurimin nga vjedhjet, tjetërsimin si dhe nga përdorimet e paautorizuara të këtij aseti.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e MBZHR konkludohet se rekomandimi është në proces zbatimi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

2.1 Rekomandimi: Nga ana e MBZHR të merren masa për ngritjen e grupeve efektive për monitorim/ndjekje kontrate dhe atyre të marrjes në dorëzim me qëllim shmangien e rasteve të mospërputhshmërisë mes zërave të preventivave dhe atyre të kryer në fakt, duke shmangur kështu edhe përdorimet pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve si është ai i shumës prej **745,000 lekë pa TVSH** i shkaktuar prej mos respektimit të detajeve të projektit.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

F .MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, pika 4, shkronja “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë **Ministrit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**, në vlerësim të shkeljeve të konsideruara nga ana jonë, sipas pikës 1 shkronja “a” dhe “b” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës të atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkeljet e konstatuara sipas nenit 58, shkronja “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”.

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konkludohet se rekomandimi është zbatuar pjesërisht.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

KONKLuzioni I AUDITIMIT

Në përfundim të procesit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, rezulton se nga **39** rekomandime të lëna, nga Subjekti **MBZHR** janë pranuar të **38** rekomandime, dhe **1-** rekomandim i pa pranuar, nga të cilat: janë zbatuar **14** masa ose **36.8 % e tyre**; **9-**masa janë zbatuar pjesërisht; **11-**masa janë në proces zbatimi si dhe **4-** masa janë pa zbatuar, pra **14-** masa mbeten për tu zbatuar nga subjekti **MBZHR**, për periudhën në vijim. Grupi i auditimit duke analizuar Rekomandimet e pranura dhe të zbatuara nga **MBZHR** (njësitë përgjegjëse të saj) apo dhe ato në proces zbatimi, arriti në konkluzionin që: - Për kategorinë "Masa Organizative"- Rekomandimet R 4.1; R 5.1; R 6.1; R 6.2; R 6.3; R 7.1; R 9.1; R 11.1; R 13.1; R 14.1; R 15.1; R 16.1; R 16.2; R 19.1; R 20.1; R 23.2; R 29.1; R 29.2; R 30.1; R 30.2; R 30.5; R 31.1; R 32.1; - Kategorinë "Masa shpërblim dëmi", R 1.1; -Kategorinë "Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave"- R 11; R 2.1; -Kategorinë "Masa disiplinore" dhe Njoftim tek DAP/KMSHC janë pranuar dhe zbatuar apo në proces zbatimi nga **MBZHR**, prandaj nuk mund të qëndrojnë për periudhën në vijim.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjëndjes *Rikërkojmë që*, MBZHR të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara si dhe pjesërisht

zbatuar brenda 3-mujorit të parë të vitit 2025.

Si dhe marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH-së të pranuar prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

A.MASA ORGANIZATIVE:

4.1 Rekomandimi: MBZHR të marrë masat në pasqyrimin në regjistrin e aktiveve të kontratave koncesionare për të cilat është autoriteti përgjegjës për ndjekjen dhe raportimin, në funksion të ruajtjes së gjurmës së auditimit.

7.1 Rekomandimi: MBZHR të marrë masat e menjëhershme në raportimin e duhur financiar të listës së debitorëve në lidhje me tokat bujqësore, duke bërë regjistrimin në pasqyrat financiare si dhe regjistrin e aktiveve të aparatit të MBZHR.

8.1 Rekomandimi: MBZHR, të vlerësojë me prioritet burimet njerëzore të nevojshme në funksion të detyrave që lidhen me administrimin e tokës bujqësore, të analizojë nga pikëpamja sasiore (numër punonjësish në raport me kontratat, subjekt monitorimi) dhe nga pikëpamja e ekspertizës, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike. MBZHR të marrë masa mbi shtimin e numrit të punonjësve në sektorin e Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave, në funksion të mbarëvajtjes së punës.

13.1 Rekomandimi: Nga titullari i MBZHR të merren masa për vlerësimin dhe mundësimin e amendimit të kontratave të mësipërme midis palëve, në të cilat të vendoset sipërfaqja e saktë në përdorim. MBZHR të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, për verifikimin dhe identifikimin në terren të kontratave të tjera, nëse kanë mbi vendosje të sipërfaqeve bujqësore, me qëllim realizimin me sukses të kontratave. Për të gjitha rastet, MBZHR të marrë masa që të mos japë me qira tokë bujqësore, pa realizuar procesin e identifikimit dhe verifikimit të mungesës së mbivendosjeve nga palë të treta.

14.1 Rekomandimi: MBZHR, të marrë masa të menjëhershme për njoftimin periodik për arkëtimin e garancive vjetore për të gjithë subjektet që nuk kanë mbaruar ende investimin, me qëllim parandalimin e risqeve që lidhen me mos respektimin e detyrimeve kontraktuale në kryerjen e investimeve sipas plan bizneseve të miratuara.

17.1 Rekomandimi: Të merren masa nga njësi përgjegjëse për prokurimin në MBZHR për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të prokurimit për vitin 2019-2022 me qëllim sistemimin arkivor të dokumentacionit.

19.1 Rekomandimi: AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një s'kualifikim apo kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit".

20.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Titullari i Institucionit për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njërive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, sigurimit të gjurmës së auditimit si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë".

21.1 Rekomandimi: Nga ana e MBZHR të merren masa për argumentimin e kriterëve të vendosura në procedurat e prokurimit si dhe përzgjedhjen e tyre në raport me nevojat e investimeve me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomikitet.

22.1 Rekomandimi: Nga ana e MBZHR të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative për mos kryerjen e pagesës prej 14,426,158.6 lekë si shumë e mbajtur për garanci punimesh ndaj BOE S. & P I. për shkak të cilësisë së dobët të punimeve të kryera në fakt në kontratën me objekt *'Rikonstruksion i Godinës së QTTB Fushë Krujë dhe Ndërtim Godine'*, kjo pasi likuidimi i kësaj shume do të përbënte dëm ekonomik ndaj buxhetit të MBZHR.

23.1 Rekomandimi: AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një s' kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, i cili nuk ndryshon thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, duke e kualifikuar në këtë rast si ofertë të vlefshme me qëllim menaxhimin me ekonomikitet, efektivitet dhe eficiencë të fondeve të buxhetit të shtetit.

B.TË ARDHURA TË MUNGUARA NË BUXHETIN E SHTETIT.

1.1 Rekomandimi:

MBZHR, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e vlerës 55,830 mijë lekë si pasojë e mos plotësimit të detyrimit kontraktor nga mos pagesa në afat e detyrimit vjetor të qirave duke krijuar vlera financiare të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit, si vijon:

- Shoqëria "P.I" ShPK. në vlerën 27,483 mijë lekë (4,619 + 22,863)
- Shoqëria "A IG" ShPK në vlerën 9,007 mijë lekë
- Shoqëria "B.N.F" ShPK. në vlerën 14,799 mijë lekë
- Shoqëria "R S ShPK në vlerën 2,180 mijë lekë për qira të pashlyer dhe kamatëvonesa;
- Shoqëria "S. G" ShPK në vlerën 1,899 mijë lekë
- EB, person fizik; K C; A. B. dhe F.A dhe K.D kanë në total 462 mijë lekë.
- MBZHR, të marrë masa si dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe administrative për zgjidhjen e njëanshme të kontratës në rast mospagimi.

2.1 Rekomandimi: MBZHR, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e vlerës 426,029 mijë lekë si pasojë e mos plotësimit të detyrimit kontraktor në mos kryerjen e investimeve duke krijuar vlera financiare të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit, si vijon:

- Shoqëria "P.I" ShPK. në vlerën 45,465 mijë lekë;
- Shoqëria "K.D" ShPK. në vlerën 12,938 mijë lekë;
- Shoqëria "B.A.I" ShPK në vlerën 281,250 mijë lekë
- Shoqëria "K.C." ShPK në vlerën 15,571 mijë lekë;
- Shoqëria "B.N.F" ShPK. në vlerën 9,084 mijë lekë;
- Shoqëria "A.I.G" ShPK në vlerën 6,778 mijë lekë;
- Shoqëria "B.P" ShPK. në vlerën 4,714 mijë lekë;
- Person fizik L.Z, në vlerën 5,147 mijë lekë;

- Shoqëria “A.P” ShPK. në vlerën 17,063 mijë lekë;
 - Shoqëria “A” ShPK. në vlerën 1,438 mijë lekë;
 - Shoqëria “F.A” ShPK në vlerën 25,650 mijë lekë;
 - Shoqëria “M” ShPK në vlerën 931 mijë lekë.
- MBZHR, të marrë masa si dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe administrative për zgjidhjen e njëanshme të kontratës në rast mospagimi.

C.MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 59, pika 4, shkronja “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*, i rekomandojmë **Ministrit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**, në vlerësim të shkeljeve të konsideruara nga ana jonë, sipas pikës 1 shkronja “a” dhe “b” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës të atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkeljet e konstatuara sipas nenit 58, shkronja “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, *“Për nëpunësin civil”*.

3.6 MINISTRIA E DREJTËSISË

3.6.1 PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim tematik në **Ministrin e Drejtësisë** *“Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023”*, për periudhën objekt auditimi 01.01.2020 deri më datën 31.12.2022, përcjellë me shkresën Nr. 249/14 Prot, datë 11.09.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
 - a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
 - b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
 - c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve;
 - ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, si dhe manualit *“Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”*.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 880/1 prot., datë 02.07.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Auditimi u krye nga:

1. M.N, përgjegjëse grupi
2. S.Z anëtar.

Auditimi ka filluar më 03.07.2024.

Auditimi ka përfunduar më 18.07.2024.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën Nr. 249/14 Prot., datë 11.09.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI:

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se janë lënë në total 21 rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht nga subjekti dhe se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **20- Masa organizative** të cilat kanë statusin e ecursë së zbatimit si vijon, **10- Zbatuar Plotësisht**, **6- në Proces Zabtimi** dhe **4 pa zbatuar**.

-Për përmirësimin e gjendjes është lënë **1- Masë shpërblim dëmi** në shumën 848.4 mijë lekë nga ku **1- rekomandim** i pranuar plotësisht, dhe ka statusin e ecursë së zbatimit si vijon, **1- në proces**.

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE:

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezulton në nivel 100%, konkretisht nga **21** rekomandime gjithsej, janë pranuar **21** rekomandime.ss

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht rezultoi në masën **48%**, niveli i zbatimit të rekomandimeve në proces rezultoi **52%**, nivele këto të cilat tregojnë vlerësimin e këtij procesi në lidhje me ndjekjen e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM:

Nga auditimi i ushtruar në **Ministrnë e Drejtësisë** për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë*” për periudhën nga data 01.01.2020 deri në 31.12.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me Vendimin e Kryetarit të KLSH Nr.152, datë 08.09.2023, përcjellë. me shkresën Nr.249/14 Prot., datë 11.09.2023, rezultoi si më poshtë vijon:

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **Ministria e Drejtësisë**, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën me Nr.4277/10 Prot, datë 06.10.2023, brenda afatit ligjor.

Sa më sipër rezulton, se është zbatuar afati **20 ditor** për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecursë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga ana e subjektit të audituar lidhur me raportimin mbi zbatimin të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara sipas strukturave përgjegjëse, subjekti ka raportuar në KLSH me shkresën Nr. 1832/2 Prot, datë 16.05.2024 brenda afatit 6 mujor të raportimit, **në përputhje me** Ligjin Nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30 pika 2 e tij.

Sa më sipër rezulton, së është zbatuar afati 6 mujor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III/3. Realizimi i rekomandimeve të lëna, si pas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, rezulton si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Drejtësisë të marra masa për ngritjen e grupit të punës përkatës për përmirësimin e Rregullores së Brendshme të funksionimit, duke e plotësuar atë me rregulla dhe përshkrime të hollësishme mbi detyrat, përgjegjësitë dhe rolet në administrimin e veprimtarisë së përditshme për përgjegjësit e sektorëve dhe specialistëve

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

2.1 Rekomandimi: Titullari i MD dhe Komisionet përkatëse disiplinore të marrin masa që në të ardhmen vendimet për shkarkimet nga puna të jenë të argumentuara saktë, në mënyrë të dokumentuar dhe të justifikuar, si dhe të garantohej ndjekjen e të gjitha hapave të nevojshme të njoftimit apo vlerësimit të arsyes së largimit, në mënyrë që të shmangen efektet financiare negative në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i ardhur nga MD me shkresën Nr. 4097/3 Prot, datë 30.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr.880/29 Prot, datë 04.11.2024.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me rekomandimin 2.1

Lidhur me zbatimin e këtij rekomandimi, procedurat e marrjes së masave disiplinore për nëpunësit civil, bazohen në Ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", aktet nënligjore si VKM nr.115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" dhe Udhëzimi nr.1, datë 02.04.2014 "Për elementët kryesorë proceduralë dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore". Ky rekomandim, është mbajtur parasysh gjatë vitit 2023. Në vitin 2023, Ministria e Drejtësisë nuk ka patur procedura për dhënie masash disiplinore "Largim nga shërbimi civil". (Nga MD, ky rekomandim konsiderohet i zbatuar)

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi paraqet **fakt të ri**.

Sa më sipër, rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Raport Përfundimtar.

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) gjatë kësaj periudhe nuk ka patur raste ndaj ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

2.2 Rekomandimi: Titullari i MD dhe Komisionet përkatëse, të marrin masa për vlerësimin dhe sistemimin e gjyq fituesve në listë pritje, në pozicionet vakante të cilat MD i ka në një nivel të lartë aktualisht, qoftë edhe në mënyrë të përkohshme, duke qenë se kjo mundësi parashikohet nga aktet ligjore përkatëse mbi shërbimin civil.

Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i ardhur nga MD me shkresën Nr. 4097/3 Prot, datë 30.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr.880/29 Prot, datë 04.11.2024.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me rekomandimin 2.2:

Për periudhën objekt auditimi, në datën 31.12.2022, Ministria e Drejtësisë, kishte gjithsej 6 gjyqfitues në listë pritje. Në zbatim të Urdhrit nr.5151, datë 28.10.2015, të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil", Komisioni i Posaçëm ka zhvilluar veprimtarinë e administrative për shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimit gjyqësor formë të prerë. Në përfundim të këtyre procedurave, si pas rastit janë ndërmarrë veprimet përkatëse. Në mbështetje të parashikimeve të pikës 4 dhe të pikës 5 të Kreut IV, të Urdhrit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr.5151, datë 28.10.2015, janë përcjellë pranë DAP akt-rekomandimet për sistemim në një pozicion të rregullt të shërbimit civil të gjyqfituesve, për të vijuar më tej me emërimin e tyre në pozicionet e propozuara nga Komisioni i Posaçëm. Kokretisht: 1. është emëruar nga DAP një gjyqfitues në pozicion të rregullt TND; 2. është propozuar emërimi në një pozicion të rregullt të shërbimit civil për një gjyqfitues; 3. janë realizuar procedurat përkatëse për shkak të plotësimit të moshës për pension pleqërie për një gjyqfitues; 4. janë realizuar procedurat përkatëse për një gjyqfitues që ka hequr dorë nga rikthimi në vendin e punës; 5. për një gjyqfitues Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin për rigjykim pranë të njëjtës gjykatë me tjetër trup gjyqësor; 6. mbetet për t'u trajtuar një gjyqfitues për të cilin MD ka vetëm detyrimin e rikthimit në punë dhe nuk ka detyrim për t'i dhënë pagë. Komisioni i Posaçëm, vijon veprimtarinë e tij për shqyrtimin sipas legjislacionit në fuqi, të gjyqfituesve të rinj, për të cilët janë depozituar kërkesat për ekzekutim në tetor/nëntor 2023. Aktualisht MD ka 2 (dy) gjyqfitues në listë pritje, nga të cilët: 1 (një) gjyqfitues për rikthim në vendin e punës dhe likuidimin e detyrimit financiar, pasi edhe pse është dërguar pranë DAP Akt - rekomandimi për emërim, nuk janë finalizuar procedurat përkatëse për shkak të rrethanave të reja dhe 1 (një) gjyqfitues për të cilin është detyrimi vetëm për rikthimin në punë. Gjithashtu janë shtuar në listë pritje dhe 2 (dy) gjyqfitues për të cilat po vijojnë procedurat përkatëse. (Nga MD, ky rekomandim konsiderohet i zbatuar)

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi nuk paraqet *fakt të ri*.

Sa më sipër, rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

Observacioni mësipërm nuk pranohet

Nga verifikimi u konstatua se : Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni rezultoi se rasti nr.1 dhe rasti nr. 2 janë ende në listë pritje.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

3.1 Rekomandimi: Sektori përgjegjës për përkthimet zyrtare të marrë masa për plotësimin e mëtejshëm të Udhëzimit nr. 3165, datë 12.05.2004, "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm, si dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët", ose për hartimin e një rregullore të funksionimit të këtij

shërbimi, duke pasqyruar qartë dhe në mënyrë transparente mënyrën e shpërndarjes së përkthimeve, normat e lejueshme dhe afatet përkatëse të përkthimit në varësi të numrit të faqeve., si dhe të vijojë me miratimin e listës së përkthyesve zyrtar deri në momentin e vënies në funksion të plotë të regjistrit kombëtar të përkthyesve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se : Bazuar në shkresën nr.4277/10 Prot., datë 06.10.2023 “programi i punës mbi masat e mara për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të MD”, për rekomandimin 3.1, Titullari i institucionit ka urdhëruar Sektorin e Përkthimit Zyrtar për “... Sektori përgjegjës për përkthimet zyrtare të marrë masa për plotësimin e mëtejshëm të Udhëzimit nr. 3165, datë 12.05.2004 “. Referuar ndryshimeve të ndodhura sa i takon bazës ligjore dhe rregullatore, Udhëzimi nr. 3165, datë 12.05.2004, “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm, si dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”, është shfuqizuar me Ligjin nr. 82/2021 dhe është nxjerrë VKM nr.407, datë 05.07.2023 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave për përzgjedhjen, kontraktimin dhe shpërblimin e përkthyesve zyrtarë, si dhe të mënyrës së kontrollit të shërbimit të kryer nga përkthyesit zyrtarë”. Nga ana e Institucionit është vijuar me zbatimin e VKM nr.407, datë 05.07.2023 për kryerjen e procedurave të përkthimeve zyrtare.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

3.2 Rekomandimi: Duke marrë shkak nga volumi tepër i lartë i përkthimeve zyrtare në MD, si dhe vlera tepër e lartë e fondeve që zë në buxhet ky shërbim, sektori përkatës për përkthimet zyrtare dhe titullari i MD të marrin masa për studimin dhe analizimin nga pikëpamja financiare, të mundësisë së shtimit, sipas nevojës, të numrit të punonjësve në strukturën e Sektorit të Përkthimeve, në mënyrë që të shmangen sa më tepër të jetë e mundur shpenzimet e larta për këtë shërbim, por edhe risqet e shpërndarjes së materialeve konfidenciale jashtë institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i ardhur nga MD me shkresën Nr. 4097/3 Prot, datë 30.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr.880/29 Prot, datë 04.11.2024.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me rekomandimin 3.2:

Për periudhën objekt auditimi, në datën 31.12.2022, Ministria e Drejtësisë, kishte gjithsej 6 gjyqfitues në listë pritje. Në zbatim të Urdhrit nr.5151, datë 28.10.2015, të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, Komisioni i Posaçëm ka zhvilluar veprimtarinë e administrative për shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimit gjyqësor formë të prerë. Në përfundim të këtyre procedurave, si pas rastit janë ndërmarrë veprimet përkatëse. Në mbështetje të parashikimeve të pikës 4 dhe të pikës 5 të Kreut IV, të Urdhrit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr.5151, datë 28.10.2015, janë përcjellë pranë DAP akt-rekomandimet për sistemim në një pozicion të rregullt të shërbimit civil të gjyqfituesve, për të vijuar më tej me emërimin e tyre në pozicionet e propozuara nga Komisioni i Posaçëm. Kokretisht: 1. është emëruar nga DAP një gjyqfitues në pozicion të rregullt TND; 2. është propozuar emërimi në një pozicion të rregullt të shërbimit civil për një gjyqfitues; 3. janë realizuar procedurat përkatëse për shkak të plotësimit të moshës për pension pleqërie për një gjyqfitues; 4. janë realizuar procedurat përkatëse për një gjyqfitues që ka hequr dorë nga rikthimi në vendin e punës; 5. për një gjyqfitues Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin për rigjykim pranë të njëjtës gjykatë me tjetër trup gjykues; 6. mbetet për t'u trajtuar një gjyqfitues për të cilin MD ka

vetëm detyrimin e rikthimit në punë dhe nuk ka detyrim për t'i dhënë pagë. Komisioni i Posaçëm, vijon veprimtarinë e tij për shqyrtimin sipas legjislacionit në fuqi, të gjyqfituesve të rinj, për të cilët janë depozituar kërkesat për ekzekutim në tetor/nëntor 2023. Aktualisht MD ka 2 (dy) gjyqfitues në listë pritje, nga të cilët: 1 (një) gjyqfitues për rikthim në vendin e punës dhe likuidimin e detyrimit financiar, pasi edhe pse është dërguar pranë DAP Akt - rekomandimi për emërim, nuk janë finalizuar procedurat përkatëse për shkak të rrethanave të reja dhe 1 (një) gjyqfitues për të cilin është detyrimi vetëm për rikthimin në punë. Gjithashtu janë shtuar në listë pritje dhe 2 (dy) gjyqfitues për të cilat po vijojnë procedurat përkatëse. (Nga MD, ky rekomandim konsiderohet i zbatuar)

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi paraqet *fakt të ri*.

Sa më sipër, rekomandimi konsiderohet i zbatuar plotësisht

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Raport Përfundimtar.

Nga verifikimi u konstatua se Bazuar në shkresën nr.4277/10 Prot., datë 06.10.2023 Programi i punës mbi masat e mara për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të MD”, Titullari institucionit për rekomandimin 3,2 ka urdhëruar Sektorin e Përkthimit Zyrtar ... “Sektori për përkthimet zyrtare dhe Titullari i MD të marrin masa për studimin dhe analizimin nga pikëpamja financiare, të mundësisë së shtimit sipas nevojës të numrit të punonjësve në strukturën e sektorit ...” dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni në observacion rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

4.1 Rekomandimi: Sektori përgjegjës për prokurimet dhe komisionet e prokurimeve të blerjeve me vlerë të vogël, të marrin masa për garantimin e një procesi sa më transparent të prokurimit të fondeve publike, duke hartuar specifikime konkrete dhe të matshme për objektet që prokurojnë dhe në këtë mënyrë edhe procesi i marrjes në dorëzim të ketë një bazë krahasimi dhe të dokumentohet me detaje se objekti i prokuruar që po pranohet, përputhet me nevojat e AK.

Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i ardhur nga MD me shkresën Nr. 4097/3 Prot, datë 30.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr.880/29 Prot, datë 04.11.2024.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me rekomandimin 4.1:

Ministria e Drejtësisë si Autoritet Kontraktor në procedurat e realizuara ka mbajtur në konsideratë çdo kriter të veçantë dhe specifikim teknik, për argumentin teknik dhe ligjor në zbatim të përcaktimeve të nenit 78, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi nuk paraqet *fakt të ri*.

Sa më sipër, rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

Observacioni mësipërm nuk pranohet

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

5.1 Rekomandimi: Sektori i Financës në MD të marrë masa për zbatimin e rregullave që lidhen me menaxhimin financiar, kontrollin dhe kontabilitetin dhe të mbaje parasysh që dokumenti financiar të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë e ato të vlerës, si dhe të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Në këtë kuadër, Sektori i Financës të marrë masa për mos likuidimin e faturave tatimore jo origjinale për të cilat nuk mund të verifikohen elementët e rregullshmërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i ardhur nga MD me shkresën Nr. 4097/3 Prot, datë 30.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr.880/29 Prot, datë 04.11.2024.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me rekomandimin 5.1:

Ky rekomandim është mbajtur në konsideratë për vitin ushtrimor në vijim.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi nuk paraqet *fakt të ri*.

Sa më sipër, rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Observacioni mësipërm nuk pranohet .

Nga verifikimi u konstatua se : Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

6.1 Rekomandimi: Nga ana e MD të merren masa që pasqyrat financiare të shoqërohen me akt rakordimet për tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në përputhje me Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, duke plotësuar elementet e gjurmës së auditimit mbi zërat e posteve të bilancit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar Pasqyrave financiare të vitit 2023, dërguar me shkresën nr. 1788 Prot., datë 27.03.2024, akt rakordimit me thesarin rezulton reflektim i rekomandimit.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

7.1 Rekomandimi: Nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të merren masa për të siguruar arkëtimin e debitorëve të trashëguar me vite. Për debitorët pa shpresë arkëtimi të ri-verifikojë dhe evidentojë realisht statusin apo mundësinë për arkëtim të detyrimit në favor të buxhetit të shtetit dhe vetëm pas miratimit nga Ministria e Financave për “Debitorët pa shpresë arkëtimi”, të bëjë parashkrimin e tyre dhe sistemimin në kontabilitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i ardhur nga MD me shkresën Nr. 4097/3 Prot, datë 30.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr.880/29 Prot, datë 04.11.2024.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me rekomandimin 7.1:

Për zbatimin e këtij rekomandimi, janë marrë masat për evidentimin dhe arkëtimin e mundshëm të debitorëve individë/subjekte private. Ministria e Drejtësisë, me shkresën

nr.2616, datë 08.05.2024 dhe shkresën me nr.2616/2, datë 28.05.2024, i ka kërkuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, informacion lidhur me punësimin e tyre në sektorin privat. Nga DRTT ende nuk është marrë informacioni i kërkuar. (Nga MD ky rekomandim konsiderohet në process zbatimi)

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi nuk paraqet *fakt të ri*.

Sa më sipër, rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

Observacioni mësipërm nuk pranohet

Nga verifikimi u konstatua se : Bazuar në dokumentacion e vënë në dispozicion nga ana e subjektit gjykojmë se rekomandimi është proces zbatimi, pasi vijon puna për arkëtimin e vlerave debitorë të trashëguara në vite.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **ne proces zbatimi**.

8.1 Rekomandimi: Nga ana e institucionit të merren masa për kryerjen e procesit të rivlerësimit të asetëve, me qëllim përafrimin e vlerës kontabël me vlerën aktuale të tregut për aktivin.

Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i ardhur nga MD me shkresën Nr. 4097/3 Prot, datë 30.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr.880/29 Prot, datë 04.11.2024.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me rekomandimin 8.1:

Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë për periudhën në vijim.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi nuk paraqet *fakt të ri*.

Sa më sipër, rekomandimi konsiderohet i pazbatuar

Observacioni mësipërm nuk pranohet

Nga verifikimi u konstatua se :Sipas komenteve nga subjekti i audituar, nuk u paraqit dokumentacion mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimit.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pazbatuar**.

8.2 Rekomandimi: Nga ana e institucionit, të merren masa për përmbylljen e procedurave dhe pajisjen me certifikatat e pronësisë për godinat e regjistruara në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, me qëllim formalizmin e marrëdhënies së MD dhe objekteve në pronësi dhe rrjedhimisht pasqyrimin e vlerave përkatëse të trojeve në funksion tyre në llogarinë 210.

Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i ardhur nga MD me shkresën Nr. 4097/3 Prot, datë 30.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr.880/29 Prot, datë 04.11.2024.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me rekomandimin 8.2:

Në zbatim të rekomandimit 8.2 të KLSH-se ku kërkohet marrja e masave për pajisjen me certifikate pronësie për godinat e regjistruara në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" ju informojmë si më poshtë:

1. Jane pajisur me çertifikatë pronësie godina e Ministrisë së Drejtësisë (bashkëlidhur çertifikatat e pronësisë së godinës).

2. Disponojmë çertifikatën e pronësisë për godinën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit. (bashkëlidhur çertifikata e pronësisë)

3. Përsa i përket godinës së Gjykatës Administrative të Apelit, ju informojmë se është ngritur grupi i përbashkët i punës Nr.324 Prot date 05.07.2023 "Për ngritjen e grupit të punës për përditësimin e pasurive të paluajtshme, ku ushtrojnë veprimtarinë gjykata dhe prokuroritë në kuadër të riorganizimit të rretheve gjyqësore".

Dokumentat mbështetëse :

-Çertifikatë për vertetimin e pronësisë nr. 1768151.

-Kartelat e pasurisë së paluajtshme

-Urdhër nr.324, datë 03.05.2023.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi paraqet *fakt të ri*.

Sa më sipër, rekomandimi konsiderohet në **proces zbatimi**

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Raport Përfundimtar

Nga verifikimi u konstatua se -Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

8.3 Rekomandimi: Nga ana e institucionit, për kategoritë e aktiveve a) kompjuterët, sistemet e informacionit, produktet e programeve kompjuterike (softëare) dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave për aktivet e kategorisë, të procedohet me përlllogaritjen e amortizimit në mënyrë individuale sipas paragrafit nr. 36 të Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*"; i ndryshuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i ardhur nga MD me shkresën Nr. 4097/3 Prot, datë 30.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr.880/29 Prot, datë 04.11.2024.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me rekomandimin 8.3:

Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë për vitin ushtrimor në vijim.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi nuk paraqet *fakt të ri*.

Sa më sipër, rekomandimi konsiderohet i pazbatuar

Observacioni mësipërm nuk pranohet

Nga verifikimi u konstatua se Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

9.1 Rekomandimi: Nga ana e institucionit të merren masa për plotësimin e relacioneve shoqëruese të pasqyrave financiare dhe dhënin e sqarimeve për Llogarinë 85 "*Rezultati i ushtrimit nga funksioni*".

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se Referuar Pasqyrave financiare të vitit 2023, dërguar me shkresën nr. 1788 Prot., datë 27.03.2024, akt rakordimit me thesarin rezulton reflektim i rekomandimit.

-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

10.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Sekretari i Përgjithshëm i MD në bashkëpunim me Drejtorinë e Kabinetit të ministrit, që në të ardhmen dokumentacioni për miratimin e stafit shoqërues të ministrit në evente jashtë vendit, të përgatitet menjëherë pas marrjes dijeni nga organizatorët për eventin si dhe konfirmimit nga Kryeministri në ato raste kur kërkohet për pjesëmarrje të ministrit në event, me qëllim minimizimin e vonesave në fillimin e procedurës së prokurimit dhe blerjes së biletave me kosto të lartë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i ardhur nga MD me shkresën Nr. 4097/3 Prot, datë 30.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr.880/29 Prot, datë 04.11.2024.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me rekomandimin 10.1:

Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë për vitin ushtrimor në vijim.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi nuk paraqet *fakt të ri*.

Sa më sipër, rekomandimi konsiderohet në **proces zbatimi**

Observacioni mësipërm nuk pranohet

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

11.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Autoriteti Kontraktor /MD që në hartimin e dokumenteve të tenderit/vendosja e kriterëve të veçanta të jetë në përputhje me objektin e prokurimit në çdo rast, me qëllim shmangien e pabarazisë në tendera.

Rast pas rasti

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar dhe në mungesë të dokumentacionit vërtetues rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

12.1 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë, Njësitë e Prokurimit në procedurat e prokurimit të shërbimeve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i vlerësimi duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke stimuluar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Sipas komenteve nga subjekti i audituar, nuk u paraqit dokumentacion mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimit, por vetëm interpretim të dispozitave ligjore.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

13.1 Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Drejtësisë dhe sektori përkatës i burimeve njerëzore të marrin masa për planifikimin e saktë dhe dërgimin në kohë të nevojave për

rekrutime pranë Departamentit të Administratës Publike, si dhe të mbajë me këtë të fundit një bashkëpunim më koherent sa i takon plotësimin e vendeve vakante.

Në vijimësi

Observacion i ardhur nga MD me shkresën Nr. 4097/3 Prot, datë 30.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr.880/29 Prot, datë 04.11.2024.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me rekomandimin 13.1:

Në zbatim të këtij rekomandimi MD me shkresën nr.6295, datë 06.11.2023”Mbi planifikimin e nevojave për pranim në shërbimin civil për vitin 2024”, ka dërguar në DAP, (tabelën përmbledhëse) për planifikimin e nevojave për rekrutim dhe plotësimin e vendeve vakante për Ministrinë e Drejtësisë dhe Institucionet e Varësisë. Nga MD, ky rekomandim konsiderohet i zbatuar)

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi paraqet *fakt të ri*.

Sa më sipër, rekomandimi konsiderohet i zbatuar plotësisht

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Raport Përfundimtar

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion nga ana e Institucionit, në observacion , rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

14.1 Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Drejtësisë të marrë masa për rritjen e kërkesës së llogarisë ndaj grupeve të menaxhimit strategjik të ngritura, duke kërkuar vazhdimisht raportime nga mbledhjet e tyre, mbi nivelin e realizimit të objektivave të MFK, problematikat e hasura dhe vendimmarrjen përkatëse për çdo rast.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

15.1 Rekomandimi: Në të ardhmen Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për mirë planifikimin e auditimeve që do të realizojë sa i takon përbushjes së afateve të mbylljes dhe dërgimit të raporteve, duke marrë parasysh çdo risk që mund të cenojë shkeljen e këtyre afateve.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

16.1 Rekomandimi: Për sa trajtuar më lart ri kërkojmë nga titullari i MD zbatimin e rekomandimit të pa zbatuar nga auditimi i mëparshëm si vijon:

Institucioni të marrë masat e nevojshme për hostimin e sistemeve IT pranë AKSHI-t referuar përcaktimeve të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, e ndryshuar, duke dokumentuar plotësisht transferimin e tyre fizik dhe kontabël, si dhe eliminimin e kostove të pa nevojshme nga buxheti i institucionit për mirëmbajtjen e tyre.

Menjëherë

Observacion i ardhur nga MD me shkresën Nr. 4097/3 Prot, datë 30.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr.880/29 Prot, datë 04.11.2024.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me rekomandimin 16.1:

Lidhur me këtë rekomandim, në zbatim të VKM-së nr. 673, datë 22.11.2017 “Mbi organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shqipërisë së Informacionit”, (AKSHI) të ndryshar, të gjitha sistemet IT i kanë kaluar AKSHI-t . Në vijim të këtij procesi, bazuar në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” të ndryshuar, do të përgatitet dokumentacioni për transferimin kapital dhe shkarkimin nga evidenca kontable të vlerës së këtyre aktiveve. (Ky rekoamndim vijon të jetë në proces zbatimi).

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi nuk paraqet *fakt të ri*.

Sa më sipër, rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

Observacioni mësipërm nuk pranohet

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të njësisë publike (Ministritë së Drejtësisë), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare gjyqësish, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **848,388 lekë**.

Brenda 31.12.2023

Observacion i ardhur nga MD me shkresën Nr. 4097/3 Prot, datë 30.10.2024, protokolluar në KLSH me Nr.880/29 Prot, datë 04.11.2024.

Pretendimi i subjektit:

Masa për shpërblim dëmi

Në lidhje me rekomandimin 1.1:

Për zbatimin e këtij rekomandimi, nga ana e strukturës së përfaqësimit gjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë, ka filluar procesi i ndjekjes në rrugë gjyqësore, si dhe i negocimit për kthimin vullnetar të detyrimit prej **848,388** leke nga operatori I”, shpk, vlerë e kostatuar nga KLSH si dëm ekonomik.(Ky rekomadim është në proces zbatimi)

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi nuk paraqet *fakt të ri*.

Sa më sipër, rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

Observacioni mësipërm nuk pranohet

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT.

Në përfundim të procesit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, rezulton se nga **21** rekomandime të lëna, nga Subjekti **MD** janë pranuar të **21** rekomandimet, nga të cilat: janë zbatuar **10** masa ose **47.6 %**

e tyre; 7-masa janë në proces zbatimi si dhe 4- masa janë pa zbatuar, pra 4- masa mbeten për tu zbatuar nga subjekti **MD**, për periudhën në vijim. Grupi i auditimit duke analizuar Rekomandimet e pranura dhe të zbatuara nga **MD** (njësitë përgjegjëse të saj) apo dhe ato në proces zbatimi, arriti në konkluzionin që: -Për kategorinë "Masa Organizative"- Rekomandimet R 1.1; R 2.1; R 2.2; R 3.1; R 3.2; R 4.1; R 5.1; R 6.1; R 7.1; R 8.2; R 9.1; R 13.1; R 14.1; R 15.1; - Kategorinë "Masa shpërblim dëmi", R 1.1; janë pranuar dhe zbatuar apo në proces zbatimi nga **MD**, prandaj nuk mund të qëndrojnë për periudhën në vijim.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmisimin e gjëndjes *Rikërkojmë që*, MD të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara si dhe pjesërisht zbatuar brenda 3-mujorit të parë të vitit 2025.

Si dhe marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH-së të pranura prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

A.MASA ORGANIZATIVE

8.1 Rekomandimi: Nga ana e institucionit të merren masa për kryerjen e procesit të rivlerësimit të aseteve, me qëllim përafrimin e vlerës kontabël me vlerën aktuale të tregut për aktivin.

8.3 Rekomandimi: Nga ana e institucionit, për kategoritë e aktiveve a) kompjuterët, sistemet e informacionit, produktet e programeve kompjuterike (softëare) dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave për aktivet e kategorisë, të procedohet me përllogaritjen e amortizimit në mënyrë individuale sipas paragrafit nr. 36 të Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*"; i ndryshuar.

11.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Autoriteti Kontraktor /MD që në hartimin e dokumenteve të tenderit/vendosja e kriterëve të veçanta të jetë në përputhje me objektin e prokurimit në çdo rast, me qëllim shmangien e pabarazisë në tendera.

12.1 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë, Njësitë e Prokurimit në procedurat e prokurimit të shërbimeve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i vlerësimit duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke stimuluar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.

3.7 QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"

3.7.1 PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditimin tematik në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza (*këtu e mëposhtme QSUNT*), me objekt "*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në vitin 2023*", për periudhën objekt auditimi 01.04.2021 deri më datën 31.12.2022, përcjellë me shkresën Nr.1177/29 Prot, datë 22.12.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si: Vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

Vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
Vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve;
Vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, si dhe Manualit *“Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë dhe regjistrit elektronik institucional”*.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 880/1 Prot, datë 02.07.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Auditimi u krye nga:

1. N.M , përgjegjës grupi
2. S.Z, anëtar

Auditimi filloi më datë 03.07.2024.

Auditimi përfundoi më datë 18.07.2024.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën Nr. 1177/29 Prot, datë 22.12.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetëror të KLSH-së.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI:

-Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se janë lënë në total 153 rekomandime të cilat janë pranuar nga ana e subjektit dhe se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **85** rekomandime si *Masa Oranizative* të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon **18** rekomandime janë zbatuar plotësisht, 8 janë zbatuar pjesërisht, **22** ne proces zbatimi, dhe **37** rekomandime rezultojnë të pa zbatuara.

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 8 rekomandime si *Masa shpërblim dëmi*, në vlerën totale 62,155,800 lekë të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon **0** rekomandime janë zbatuar plotësisht, 4 janë zbatuar pjesërisht, 1 ne proces zbatimi, dhe **3** rekomandime rezultojnë të pa zbatuara.

-Për marrjen e masave për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike u lanë **3** rekomandime, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si të pa pa zbatuara në shumën **1,891** mijë lekë.

-Për përmirësimin e gjendjes është lënë **3** Masë për Njoftimin në APP, të cilat rezultojnë të zbatuara plotësisht.

-Për fillimin e procedurës për dhënien e Masës disiplinore, në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, janë lënë **54** rekomandime, të cilat janë zbatuar plotësisht

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezultoi në nivel **100 %**, konkretisht nga **153** rekomandime gjithsej, janë pranuar **153** rekomandime.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht rezultoi në masën **49%**, niveli i zbatimit të rekomandimeve në proces zbatimi rezultoi **15%**, niveli i rekomandimeve të zbatuara rezultoi **28 %**, niveli i rekomandimeve të zbatuara pjesërisht rezultoi **8%** nivele këto të cilat tregojnë vlerësimin e këtij procesi në lidhje me ndjekjen e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve.

II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

Nga auditimi i ushtruar në **QSUNT** për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, “*Mbi auditimin e përputhshmërisë*” për periudhën nga data 01.04.2021 deri më 31.12.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së me Nr.217, datë 20.12.2023, përcjellë me shkresën Nr.1177/29 Prot, datë 22.12.2023, rezultoi si më poshtë vijon:

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) të nenit 15, në Ligjin Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH me shkresën Nr.55/14 Prot, datë 18.01.2024, në përputhje me Ligjin Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, shkronja j.

-Sa më sipër rezultoi se është zbatuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecuarisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga ana e subjektit të audituar në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, QSUNT, ka raportuar në KLSH me shkresën Nr. 1505/3 Prot, datë 18.07.2024, brenda afatit 6 muajsh të raportimit në përputhje me Ligjin Nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 30, pika 2 e tij.

-Sa më sipër rezultoi se është zbatuar afati 6 muajsh për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III/3. Realizimi i rekomandimeve, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, rezultoi si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE:

1.1. Rekomandimi: Të merren masa nga Drejtorët e Përgjithshëm të QSUNT dhe FSDKSH, që t’i kërkohej Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale krijimi i mekanizmave efektivë të monitorimit dhe mbikëqyrjes për të siguruar se palët përfituese jo vetëm duhet që të respektojnë obligimet për arsyeshmërinë e plotë të shpenzimeve të subvencionuara/rimbursuara, por të vendosen dhe kontrollet e duhura me synim që bari/barnat për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), të regjistrohen dhe raportohen saktë në kontabilitet dhe pasqyrat financiare, për QSUTN por edhe për spitalet e tjera.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi është në proces zbatimi. Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

1.2. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Përgjithshme e QSUNT të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për pranimin e barnave nga importuesit farmaceutikë, duke ngritur grupe pune për marrjen në dorëzim të tyre, me qëllim jo vetëm pranimin dhe marrjen në dorëzim me specialist të fushave, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i ardhur nga QSUNT me shkresën Nr. 1505/6 Prot, datë 30.07.2024 protokolluar me tonën Nr.880/9 Prot, datë 01.08.2024.

Pretendimi i subjektit:

Sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH për zbatim rekomandimin e lënë ju theksojme si më poshtë vijon:

QSUNT ka zbatuar kontratën trepalëshe rreth administrimit të barnave të cilat janë të përcaktuara në Nenin 13, *Administrimi i barnave nga QSUNT(Spitali)*, pika 1 dhe 2 ku citohet se:

1.QSU/Spitali (Farmacia) është e detyruar të marrë në dorëzim barnat nga Importuesi sipas kërkesës së Drejtorisë së QSU-së dhe kundrejt faturave përkatëse. Kërkesa hartohet mbështetur në nevojat 15 ditore të Farmacisë, për trajtimin e pacientëve ambulatorë me barnat objekt i kësaj kontrate. 2. QSU (Farmacisë) i rimbursohen vetëm barnat, të pajisura me pullën e kontrollit të AKBPM, të furnizuara nga Importuesit Farmaceutikë, sipas anekseve bashkëlidhur, të zbatuara me përpikmëri në çdo rast. Nisur nga sa më sipër, nuk është në tagrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" pra ndodhur në kushtet kur është Institucion tjetër ai që ka tagrin ligjor për korrigjimin e kësaj praktike/Kontrate mbi pranimin e barnave nga Importuesit farmaceutik dhe për këtë arsye, Drejtoria e Përgjithshme, nuk i ka instrumentet e duhura ligjore dhe administrative për të mundur sa pasqyrohet në Projekt Raport. Gjithsesi QSUNT ka përcjellë me shkresë zyrtare pranë FSDKSH rekomandimin e lënë nga KLSH me qëllim përfshirjen në kontratat trepalëshe përcaktimin e kolaudimit të barnave të rimbursuara. Mbi rekomandimin e lartë permenduar nga Drejtoria e Juridike e QSUNT janë ngritur dy komisione. Me anë të shkresës përcjellëse me Urdhër të Brendshëm nr.4, datë 04.01.2024 me nr.24.prot e datës 04.01.2024 është ngritur komisioni të kolaudimit të barnave dhe materialeve të mjekimit, ARV dhe lëndët radioaktive, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, dt 27.12.2011 "Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik," "Statutit të Qendrës Spitalore", "Nëna Tereza" me nr.5842.Prot, datë 10.10.2018 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Nr.10762/1.prot., datë 30.10.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Komisioni bën kolaudimin e barnave dhe materialeve mjekësore, ARV dhe lendeve radioaktive përpara hyrjes së vlerave materiale në deponë të Farmacisë Qëndrore, mbështetur në Ligjin nr. 105/2014 "Për barnat dhe Sherbimin Farmaceutik". Komisioni verifikon mallin në përputhje me specifikimet dhe afatet e vendosura në kontratë dhe të përpilojë akt-kolaudimin e mallit që dorëzohet, duke mbajtur proces- verbalet përkatëse. Në kontratën e kolaudimit të specifikohet se malli do të merret në dorëzim vetëm pasi të jetë shogëruar nga dokumentacioni vijues, i përcaktuar në ligjin nr. 105/2014 "Për barnat dhe Sherbimin Farmaceutik", si më poshtë: Fatura Tatimore Afati i levrimit të mallit sipas kontratës përkatëse. Origjinali e mallit të përcaktuar në specifikimet teknike të kontratës. Bari të jetë i pajisur me pullën A.K.B.P.M Bari të jetë i pajisur me vulën e kuge sipas Udhëzimit të Ministrisë së Shëndetësisë. Proces-verbalet që do të mbaje ky komision në procesin e kolaudimit duhet të firmosen nga të gjithë anëtarët e komisionit përveç rasteve kur mungesa e ndonjë anëtarit të komisionit është e justifikuar me raport mjekësor apo leje vjetore. Në do rast proces- verbalet do të jenë të vlefshme kur ato janë të nënshkruara nga të paktën tre nga anëtarët e komisionit të emëruar. Pas hartimit të aktit të kolaudimit, komisioni duhet të

percelle aktin e kolaudimit dhe gjithë dokumentacionin jeter te mundshem ne Drejtorine Ekonomike dhe te Planifikimit Financiar per t'iu bashkelidhur flete-hyrjes perkatëse kontabilizuar nga kjo drejtori. Per zbatimin e këtij urdheri ngarkohet Dreitoria e Sherbimit Farmaceutik dhe Dreitoria

Ekonomike dhe te Planifikimit Financiar ne QSUT.Ky komision do te funksionojë per kolaudimin e barnave dhe materialeve mjekësore per vitin 2024. Urdheri i mëparshem me nr. 11 me nr. 49 prot., date 05.01.2023 shfuqizohet. Kurse me anë të shkresës përcjellëse me Urdhër të Brendshëm nr.6, datë 04.01.2024 me nr.26.prot e datës 04.01.2024, është ngritur komisioni të kolaudimit të donacioneve për barna dhe materiale mjekësore, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, dt 27.12.2011 "Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik," "Statutit të Qendrës Spitalore", "Nëna Tereza" me nr.5842.Prot, datë 10.10.2018 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Nr.10762/1.prot., datë 30.10.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Komisioni bën kolaudimit të donacioneve, per plotesimin me barna dhe materiale mjekësore që furnizon (dorezohen) depon qendrore farmaceutike te QSUT, nga kompanite farmaceutike ne forme donacioni. Barnat dhe materialet mjekësore te furnizuara ne forme donacioni nga kompanite farmaceutike do te kolaudohen nga ky komision dhe pas kolaudimit do te merren ne dorezim nga depot qendrore farmaceutike te QSUT, duke respektuar regullat e percaktuara ne legjislacionin farmaceutik dhe spitalor.Procesi i kolaudimit do te behet vetem pasi malli te jete i shoqeruar nga dokumentacioni i mëposhtem" Akt-dorezimi te nenshkruar dhe vulosur nga subjekti qe dorezon donacionin dhe i nenshkruar nga perfaqesuesi i Sektorit Farmaceutik, per te konfirmuar donacionin prej tij. Pullën per perdorim spitalor. Procesverbalet do te mbahen nga ky komision ne procesin e kolaudimit te donacioneve janë te vlefshme kur ato jane te nenshkruara nga te gjithë anëtarët e tij. Pas perfundimit te ketij procesi, komisioni dorezon nje kopje te dokumentacionit ne Drejtorine Ekonomike dhe Planifikimit Financiar.Komisioni do te funksionojë per kolaudimet e donacioneve per vitin 2024. Ky urdher shfuqizon urdherin e mëparshem me nr. 12, me nr. 50 prot., date 05.01.2023 te ngritur per këte qellim.

Bashkëlidhur dokumentacioni që vërteton pretendimet tona 58 (pesëdhjetë) faqe.

Qëndrimi i grupit të Auditimit :

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrim tuaj, konkludon se argumentimi nuk paraqet *fakt të ri dhe ne mungesë te nje dokumenti/praktike vertetuese* observacioni nuk merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm nuk pranohet.

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është zbatuar**.

1.3. Rekomandimi: Të merren masa nga Drejtorët e Përgjithshëm të QSUNT dhe FSDKSH, për të ri negociuar kontratat/marrëveshjet në fuqi me importuesit farmaceutik, për të bërë amendimet përkatëse me qëllim për të përcaktuar detyrimet/ kërkesat mbi:

a. *Afatin e skadencës:* Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.

b. *Paketimin:* Mbi çdo paketim duhet të jetë shënuar barnat duhet detyrimisht të jenë edhe me vulën/pullën “Përdorim spitalor - ndalohet shitja”.

Brenda datës 31.03.2024

Observacion i ardhur nga QSUNT me shkresën Nr. 1505/6 Prot, datë 30.07.2024 protokolluar me tonën Nr.880/9 Prot, datë 01.08.2024.

Pretendimi i subjektit:

Sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH për zbatim rekomandimin e lënë ju theksojme si më poshtë vijon:

Ky rekomandim ka gjetur zbatim që në lidhjen e kontratave të furnizimit që nga Janar 2024. Në kontratë e lidhura nga QSUNT me Operatoret Ekonomik janë cituar sipas rekomandimit në Nenin 5 të kontratës Specifikimet Teknike.(hashkëlidhur dy kontrata furnizimi tip) *Bashkëlidhur dokumentacioni që vërteton pretendimet tona 58 (pesëdhjetë) faqe.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit :

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrim tuaj, konkludon se argumentimi paraqet *fakt të ri dhe do të pranohet.*

-Sa më sipër, observacioni merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Projekt Raport.

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion në observacion kontratat e furnizimit Nr.82/313 Prot, date 04.04.2024 dhe Nr.85/181 Prot, date 06.03.2024, konkludohet se rekomandimi është në proces zbatimi dhe ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është në proces zbatimi.**

2.1. Rekomandimi: Nga drejtorët e përgjithshëm të QSUNT/FSDKSH-së, të merren masa për të ri negociuar kontratat/marrëveshjet në fuqi me importuesit farmaceutikë për të bërë amendimet përkatëse, me qëllim përcaktimin e stokut (rezervës) të nevojshme në farmaci referuar numrit të pacientëve që trajtohen dhe të analizat e projeksioneve (pacientët e rinj), për të eliminuar riskun e mungesës dhe mos disponibilitetit të përkohshëm të barit/barnave për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimbursohen nga shteti.

Brenda datës 31.03.2024

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, ky rekomandim nuk është zbatuar.

-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar.**

2.2. Rekomandimi: Pas përfundimit të kontratave/marrëveshjeve në fuqi nga Drejtorët e Përgjithshëm QSUNT/FSDKSH, të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë duke vlerësuar lidhjen e marrëveshjeve kuadër, për furnizimin me bar/barna në princip aktiv jo në emrin tregtar me disa Importues Farmaceutik, për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimbursohen nga shteti.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, ky rekomandim nuk është zbatuar.Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar.**

2.3. Rekomandimi: Nga drejtorët e përgjithshëm të QSUNT/FSDKSH-së, të merren masa për të lidhur marrëveshje me homologët në vendet fqinje (Kosova, rajoni, etj.), për të shkëmbyer bar/barna nga stoku (rezerva) i secilës palë në raste të mos disponibilitetit të bar/barnave për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimbursohen nga shteti.

Brenda datës 30.06.2024

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, ky rekomandim nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar.**

3.1. Rekomandimi: Nga drejtori i përgjithshëm ti kërkohet Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, vendimi ose urdhri të për ngritjen e komisionit ndër spitalor.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar pjesërisht.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

3.2. Rekomandimi: Nga drejtori i përgjithshëm ti kërkohet Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, hartimi i rregullores të organizmit dhe funksionimit të komisionit ndër spitalor, duke përfshirë përgjegjësitë e anëtarëve, procesin e vendimmarrjes, dhe raportimin periodik.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar pjesërisht.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

3.3. Rekomandimi: Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për implementimin e një procesi të qartë dhe të dokumentuar për shqyrtimin dhe trajtimin e epikrizave nga personeli i caktuar, duke përfshirë kontrollin nga drejtori i përgjithshëm për të siguruar zbatimin e procedurave të duhura.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është zbatuar**.

3.4. Rekomandimi: Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për përcaktimin i një sistemi monitorimi për të vlerësuar zbatimin e rekomandimeve dhe për të siguruar që proceset janë në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet e aplikueshme. Ky rekomandim synon të adresojë mos rregullimet dhe të sigurojë një strukturë të përcaktuar dhe të qartë për veprimtarinë e komisionit ndërspitalor dhe trajtimin e dokumentacionit shëndetësor.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se:Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është zbatuar**.

4.1. Rekomandimi: Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për të korigjuar këtë praktikë për trajtimin e epikrizave nga komisioni ndërspitalor, duke eliminuar trajtimin me standard të dyfishtë të pacientëve në punën e këtij komisioni.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është zbatuar**.

5.1. Rekomandimi: Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për të formalizuar vulën e komisionit ndër spitalor në organet përkatëse, në rast të kundërt të gjitha vendimet dhe shkresat përcjellëse në Ministrinë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë), të bëhen me vulën e QSUNT-së.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se:Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është zbatuar**.

6.1. Rekomandimi: Nga organet drejtuese t'i kërkohet ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të bashkërendojë dhe koordinojë veprimtarinë me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për ri kompozimin e Bordit Drejtues në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe nën ligjor.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se:Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi është zbatuar pasi janë dërguar disa shkresa në vijimësi.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar plotësisht**.

7.1. Rekomandimi: Bordi Drejtues i Spitalit të ndërmarrë veprime institucionale për përcaktimin përfundimtar të statusit të punës të drejtorit dhe zv/drejtorëve të përgjithshëm, shpërblimit dhe lidhjes së kontratave.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar .-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

8.1. Rekomandimi: Autoriteti kontraktor në vijimësi duhet të hartojë kërkesat e veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

9.1. Rekomandimi: Procedura e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, duhet konsideruar si rast i veçantë dhe autoriteti kontraktor nuk duhet në asnjë rast të abuzojë me përdorimin e këtij instrumenti, me qëllim shtrembërimin e konkurrencës, por duhet të konsiderohet procedurë konkurrenre përjashtimore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

9.2.Rekomandimi: Autoriteti kontraktor nëpërmjet procedurave të tjera të prokurimit, duhet të çojë në rritjen e integritetit në prokurimin publik, me efekt të drejtpërdrejtë në konkurrencën, në çmimin për blerjen e mallrave, shërbimeve apo kryerjen e një pune, të cilat kanë efekt të drejtpërdrejtë në shpenzimet e shtetit, pra në burimet e taksapaguesve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

10.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për mirëmbajtje full-risk/ose jo të pajisjeve, me qëllim që para shpalljes së procedurave të prokurimit të jetë hartuar plani i mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore për çdo vit, plan i cili duhet miratuar nga komisioni mjekësor, si dhe të kryhet klasifikimi i pajisjeve mjekësore në të vogla dhe në të mesme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim është i zbatuar pjesërisht.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

10.2. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të mbajtur Sistemin e Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM), i QSUNT, historinë e plotë të pajisjes (kartelën), si dhe pjesët e dëmtuara të pajisjeve mjekësore pas zëvendësimit me të reja nga kontraktoret e shërbimit, të futen në termat e referencës së prokurimit, të përcaktohen në kontratë dhe iu jepen n.q.s. do t'i dëshirojnë kontraktoret duke i vlerësuar me vlerën e tregut.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim është i zbatuar pjesërisht.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

10.3. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa që specialistët e Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike të trajnohen me shpenzimet e QSUNT-së, për njohjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, duke rritur në këtë mënyrë kompetencën profesionale në monitorimin e kontratave dhe marrjen në dorëzim të shërbimit të mirëmbajtjes.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

11.1. Rekomandimi: Nga autoriteti kontraktor të merren masa që përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik të vlerësohet si procedurë e rëndësishme, pasi nga zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik varet saktësia e kësaj vlere, por edhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

12.1. Rekomandimi: Nga QSUNT t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomikë dhe ofertave të ofertuesve, pasi procesi i shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues e operatorëve është me rëndësi kapitale.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim nuk është zbatuar.Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

13.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për sigurimin e ambienteve të përshtatshme për ruajtjen e dokumentacionit arkivor, por edhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Brenda datës 30.06.2024

Nga verifikimi u konstatua se:Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet që dokumentacioni nuk është i plotë dhe si i tillë rekomandimi është zbatuar pjesërisht-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

14.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm t'i paraqesë kërkesë Institutit të Shëndetit Publik, për përcaktim të shkallës së vështirësisë dhe dëmshme risë për pozicionet e punës të arkiv- protokollit por jo vetëm, që të përcaktojë vendet e punës të vështira e të dëmshme për shëndetin e punëmarrësve në QSUNT, si dhe shkallën e vështirësisë e dëmshmërisë për çdo vend pune; pas përcaktimit të kësaj shkalle, të paraqesë kërkesën për miratim në ministrinë përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë dhe në ministrinë përgjegjëse për çështjet e punësimit, për shtesë mbi pagën bazë mujore në përqindje të caktuara.

Brenda datës 31.03.2024

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar plotësisht**.

15.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për emërimin e përgjegjësit të Sektorit të Auditit të Brendshëm, me qëllim që emërimi të bëhet me "Auditues të brendshëm në sektorin publik" të licencuar nga Ministria e Financave, por edhe me përvojë 5-vjeçare në profesion.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim nuk është zbatuar.Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

16.1. Rekomandimi: Nga Bordi dhe Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për krijimin dhe funksionimin e Komisionit Mjekësor të QSUNT .

Brenda datës 31.03.2024

Observacion i ardhur nga QSUNT me shkresën Nr. 1505/5 Prot, datë 30.07.2024 protokolluar me tonën Nr.880/10 Prot, datë 01.08.2024.

Pretendimi i subjektit:

Në QSUNT pas rekomandimeve të lëna nga grupi i KLSH-se, Drejtori i Përgjithshëm ka bere shpallje mbi përzgjedhjen si anëtar i KMS me shkresën përcjellëse Nr.2136 Prot, datë

14.11.2023. Me pas eshte mbledhur KMS me date 24.11.2023, process verbal i mbajtur me Nr.2136/1 Prot, datë 24.11.2023 e cila eshte firmosur nga anëtarët e KMS present.

Drejtoria e Burimeve Njerezore prane QSUNT ka bere nje relacion referuar shkreses Nr.2133 Prot, datë 13.11.2023, e protokolluar me Nr.2136/2 Prot, datë mbi Rikustrukturimi i Sherbimeve të Kardilogjise ne funksion te permiresimit te aktivitetit klinik, mesimor dhe kerkimor perms bashkimit ne nje sherbim te vetem te Kardilogjise.

Ky rekomandim nga ana e QSUNT eshte zbatuar nga ana jone.

Bashkëlidhur dokumentacioni që vërteton pretendimet tona 58 (pesëdhjetë) faqe.

Qëndrimi i grupit të Auditimit :

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrim tuaj, konkludon se argumentimi paraqet *fakt të ri dhe do të pranohet.*

-Sa më sipër, observacioni merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Projekt Raport.

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion në observacion shkresave Nr.2136 Prot, datë 14.11.2023, Nr Nr.2136/1 Prot, datë 24.11.2023, Nr.2136/2 Prot, datë 30.11.2023 konkludohet se rekomandimi është zbatuar. -Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar plotësisht.**

17.1. Rekomandimi: Komisioni i blerjeve me vlera të vogla të procedojë me shpalljen e OE fitues pasi të sigurohet se i gjithë dokumentacioni i kërkuar është depozituar dhe është në përputhje të plotë me kërkesat e AK.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi.**

17.2. Rekomandimi: Komisioni i blerjeve me vlera të vogla të procedojë me shpalljen e OE fitues pasi të sigurohet se i gjithë dokumentacioni i kërkuar është depozituar dhe është në përputhje të plotë me kërkesat e AK.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi.**

18.1. Rekomandimi: Drejtoria e IT-së dhe Inxhinierisë Klinike të marrë masa që në rastet e mosfunksionimit të pajisjeve mjekësore të ngrejë grup pune me qëllim identifikimin e defekteve të konstatuara, duke përcaktuar nëse pajisja ka nevojë për mirëmbajtje apo nxjerrjen jashtë funksionit dhe vetëm pas kryerjes së kësaj procedure të vijoje me procedurën për blerjen e pajisjeve zëvendësuese sipas rastit.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi.**

18.2. Rekomandimi: Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, i ngritur sipas rastit të marrë masa që në çdo procedurë të blerjeve të pajisjeve mjekësore, në kriteret për kualifikim të vendosë si kriter që pajisja duhet të jetë e regjistruar në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore që mbahet nga Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

19.1. Rekomandimi: Personeli infermieror të marrë masa që në çdo rast që kryhet dorëzimi i mbetjeve të rrezikshme të plotësojë regjistrat me të gjithë elementët e tyre: origjina e mbetjeve, lloji i materialit, sasia në kg, data e dorëzimit dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm që lidhet me këtë proces.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

19.2. Rekomandimi: QSUNT të marrë masa për ngritjen e grupit të administrimit të mbetjeve spitalore (GAMS), me qëllim zbatimin me efikasitet dhe efektivitet të Planit të Administrimit të Mbetjeve, si edhe hartimin dhe zbatimin e një programi për uljen e vëllimit, të sasisë dhe toksicitetit të mbetjeve të rrezikshme, me qëllim uljen e ndikimit në mjedis, shëndet publik dhe të kostove financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

20.1. Rekomandimi: Personat përgjegjës të hartimit të kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, në çdo rast duhet t'i argumentojnë teknikisht dhe ligjërisht.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

20.2. Rekomandimi: Komisioni i vlerësimit të ofertave, përpara kualifikimit të operatorit fitues, në çdo rast të sigurohet për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar dhe verifikimin e certifikatave që janë lëshuar me kusht vlefshmërie.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Bazuar në mungesën e dokumentacionit justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

21.1. Rekomandimi: Komisioni i hartimit të kërkesave për kualifikim, në procedurat e prokurimit me objekt “Asgjësimi i mbetjeve spitalore të rrezikshme” të marrë masa për përcaktimin si kritere kualifikuese, ndër të tjera: certifikatë e miratimit për mjetet (vetëm për brenda vendit) që transportojnë disa mallra të rrezikshme, vërtetim e mjetit të regjistruar në ministri për kryerjen e transportit të mbetjeve të rrezikshme, paraqitja e akt miratimit higjieno-sanitar lëshuar nga Inspektorati Shëndetësor Shtetëror; personeli i përfshirë në ngarkimin e koshave/kontejnerëve tranzit të jetë kompetent dhe i trajnuar, OE të dorëzojë mbetjet e dala nga përpunimi, në një subjekt të licencuar për depozitimin e hirit me qëllim uljen e dëmeve që shkaktohen në mjedis dhe në shëndetin publik.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

22.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit përpara nënshkrimit të kontratës me OE që do të trajtojë mbetjet e rrezikshme spitalore, të sigurohet nëpërmjet strukturave përgjegjëse se përgjatë periudhës që kontrata do të jetë në fuqi OE të ketë një marrëdhënie kontraktuale me një subjekt që do të kryejë asgjësimin e hirit. Gjithashtu, në çdo rast strukturat përgjegjëse të vijojnë me dokumentacionin justifikues për shlyerjen e faturës, vetëm pasi të sigurohen se hiri i prodhuar është asgjësuar, duke marrë siguri të plotë se hallka e fundit e procesit të asgjësimit ka përfunduar me sukses.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

22.2. Rekomandimi: QSUNT në çdo rast përpara shlyerjes së faturës me OE, i cili ka marrë përsipër trajtimin e mbetjeve të rrezikshme, të sigurohet me anë të dokumenteve provuese se procesi i trajtimit (me incenerim apo hidroklavë/autoklavë) për të gjithë sasinë e mbetjeve të dorëzuara ka përfunduar me sukses.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

23.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të QSUNT-së të marrin masa për mbetjet spitalore që mund të trajtohen me hidroklavë, ta kryejë vetë si proces pa qenë i nevojshëm prokurimi i këtij shërbimi. Në rastet kur pajisja “hidroklavë” nuk ka kapacitet të mjaftueshëm ose paraqet defekt, të argumentohet nga personat përgjegjës dhe t’i drejtohen OE i cili ka lidhur një marrëdhënie kontraktuale me QSUNT-në për mirëmbajtjen e pajisjeve me qëllim rregullimin e defektit të ndodhur dhe mire përdorimin e fondeve publike.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

24.1. Rekomandimi: ISHP të konsultohet me strukturat përkatëse të Organizatës Botërore të Shëndetësisë lidhur me rekomandimet e përditësuara për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve të prodhuara nga rastet e pacientëve me Covid-19 dhe në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi që rregullon këtë fushë të udhëzojë subjektet që prodhojnë mbetje nga rastet e pacientëve me Covid-19 me metodën e duhur të trajtimit dhe asgjësimit.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur dhe korrespondencën me ISHP si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim është i zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

25.1.Rekomandimi: Bordi Drejtues i QSUNT-së të programojë kalendarin e aktiviteteve në lidhje me miratimin e buxhetit dhe të raportit vjetor e pasqyrave financiare të llogaridhënies vjetore në përputhje me misionin dhe vizionin e QSUNT-së.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion gjatë fazës së terrenit si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, konkludohet ky rekomandim nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

25.2. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marr masa për të dërguar për miratim në Bordin Drejtues të QSUNT-së projektbuxhetin e vitit pasardhës dhe vlerësimin e raportit vjetor të veprimtarisë financiare të institucionit.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion e-MI drejtuar bordit dhe shkresës përcjellëse si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar .-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

26.1. Rekomandim: Në fazën e hartimit e miratimit final të projektbuxhetit, QSUNT-në të rrisë bashkëpunimin me MSHMS-në për listën e projekteve të investimeve për çdo program, duke dokumentuar në këtë fazë dhe në çdo rast procedurat e ndjekura për projektet me përfitues QSUNT, me qëllim shmangien e rishikimeve të fondeve buxhetore me impakt negativ në treguesit e monitorimit të buxhetit.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim është në proces.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

27.1 Rekomandimi: Për parashikimin e fondeve buxhetore për vitin pasardhës, të përmirësohet Rregullorja e Shërbimit Farmaceutik Nr. 2163/1 datë 17.06.2015, duke përcaktuar procedura standarde lidhur me metodologjinë që duhet përdorur për parashikimin e shpenzimeve buxhetore për barna dhe materiale mjekësore, për t'u përdorur nga farmacia qendrore dhe shërbimeve spitalore në QSUNT, bazuar në analizën e risqeve dhe masave për përballimin e tyre, sipas objektivave të MSHMS-së dhe QSUNT-së.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se:Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, Urdhër Nr.275, datë 10.07.2024 dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi është në proces zbatimi.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

28.1. Rekomandimi: Organet Drejtuese të QSUNT të marrin masa për përgatitjen e raporteve 4-mujore dhe vjetor të monitorimit të zbatimit të buxhetit, të cilat do t'i mundësojnë institucionit orientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit, mbështetur mbi ata tregues të planifikuar gjatë hartimit të programit buxhetor afatmesëm.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

29.1. Rekomandim: QSUNT , në bashkëpunim me FSDKSH dhe MSHMS, të marrë masa për përcaktimin e modaliteteve të parashikimit të shpenzimeve buxhetore, jo vetëm me zëra shpenzimesh sipas llogarive kontabël, por dhe buxhetim në kode të projekteve (paketave shëndetësore) konform VKM Nr. 308, datë 21.05.2014, “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga FSDKSH në shërbimin spitalor”, i ndryshuar.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe e-Mlet përkatëse dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar plotësisht**.

30.1. Rekomandim: QSUNT, në funksion të optimizimit të mundësive për rritjen e të ardhurave dytësore, të hartojë plan veprimi për gjenerimin, arkëtimin dhe përdorimin të tyre, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

31.1. Rekomandim: Mbështetur në Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, neni 10 , pika 2, QSUNT, t’i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për qëndrimin e saj zyrtar lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor për mbajtjen 15% të tatimit mbi fitimin nga pjesa takuese e të ardhurave të QSUNT-së në shumën 13,499,579 lekë, në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 135/2022, “Për disa shtesa në vendimin Nr. 688, datë 14.11.2018 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga MSHMS e FSHZH të objektit me emërtim “Oborr i QSUNT” dhe zbatimin e aktmarrëveshjes së nënshkruar midis QSUNT-së dhe FSHZH-së, me Nr. 1242/41, datë 16.11.2018, ndryshuar me Amendamentin Nr. 1, protokolluar me Nr. 884/2, datë 12.04.2022.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionit justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

32.1. Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i QSUNT-së në bashkëpunim me AKSH-in, të ngrenë një grup të përbashkët pune për të vlerësuar teknikisht nëse shërbimet e kërkuara me shkresën Nr. 1544/1 Prot, datë 01.06.2022 për hedhjen në Sistemin Informacionit për Shëndetin Publik (SISP) të tarifave të ndryshuara të shërbimeve, kanë qenë pjesë e kontratës së shërbimit Nr. 5216, datë 09.10.2020, nënshkruar midis kontraktuesit dhe përfituesit. Pas verifikimit, nëse kushtet nuk ndryshojnë, të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 2,055,301 lekë, për mos mbajtje tarife ditore (dëm) në vlerën 2,055,301 leke.

Brenda datës 31.03.2024

Nga verifikimi u konstatua se:Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet që dokumentacioni vërtetues në lidhje me këtë rekomandim është kryer jashtë afatit të vendosur në rekomandimi, si rrjedhojë ky rekomandim nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

33.1. Rekomandim: Strukturat përkatëse në QSUNT të marrin masa për hartimin dhe miratimin nga bordi drejtues i spitalit të rregullores së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore mbështetur në rregulloren bazë të institucionit, me qëllim mbarëvajtjen e punës për funksionimin sa më të mirë të strukturës përkatëse.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

33.2. Rekomandim: QSUNT bazuar në fondet buxhetore dhe të ardhurat dytësore, për shërbimet e ofruara nga personeli mjekësor në bazë të indikatorëve performancës, të shqyrtojë mundësinë e hartimit të një rregulloreje të posaçme për shpërbimin e tyre në funksion të nxitjes dhe rritjes së interesit për punësim.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është në proces zbatimi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

34.1. Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa që vlerësimet vjetore të performancës në punë të punonjësve të bëhen brenda një afati të paracaktuar nga titullari dhe sipas shkallës hierarkike të vlerësimit nga miratimi nga eprori drejtpërdrejt deri tek aprovimi nga drejtori i Përgjithshëm.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

34.2. Rekomandim: Nga ana e strukturave përgjegjëse në QSUT të ndryshohen elementet e fletës prezantuese të dosjes së personelit, sipas kriterëve të VKM Nr. 833, datë 28.10.2020, “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar. -Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

35.1.Rekomandim: Nga organet drejtuese të QSUNT-së të merren masa për të bërë unifikimin e kontratës kolektive me kontratën individuale të punës në lidhje me përcaktimin e datës së pagesës së punonjësve.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion Urdhër Nr. 20, datë 12.01.2024 si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar pjesërisht. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

36.1.Rekomandim: Për punonjësit social, në dosjen e të cilëve mungon leja e ushtrimit të profesionit të punonjësit social, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për pajisjen me licencë për ushtrimin individual të profesionit të punonjësit social të lëshuar nga Urdhri i Punonjësve Socialë.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si më sipër dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është në process zbatimi.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

37.1. Rekomandim: QSUNT të marrë masa për menaxhimin e llogaritjes së pagave nëpërmjet implementimit të regjistrimit qendror të personelit disponuar nga DAP ose përdorimit të programit të informatizuar që përdoret nga sektori i financës, për të siguruar në çdo kohë të dhëna të sakta dhe të sigurta mbi marrëdhëniet e punësimit si për punëdhënësin, dhe për punëmarrësin.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si më sipër dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim është në proces zbatimi.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

38.1 Rekomandim: Nga organet drejtuese t’i kërkohet Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të bashkërendojë dhe koordinojë veprimtarinë me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për procedurat e marrjes në punë të drejtuesve të shërbimeve spitalore.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar .-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

39.1.Rekomandim:DBNJ në QSUNT për vendet vakante të organizojë procesin e përzgjedhjes së drejtuesve të shërbimit spitalor për ushtrimin e detyrës të drejtuesit të shërbimit spitalor.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar .-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

40.1 Rekomandim: Dosja e drejtuesve të shërbimeve të plotësohet me vërtetimin respektive të lëshuar nga MSHMA-së në përputhje me piken 25.2 të statutit të QSUNT-së miratuar me urdhër të përbashkët ndërmjet MSHMS dhe MARS Nr. 709/2018.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

41.1. Rekomandim: Procedura e pranimit dhe emërimit të mjekëve në statutin e QSUNT-së miratuar me urdhrin të përbashkët të MSHMS dhe MARS Nr. 709/2018, (statuti i QSUNT) paragrafi 24 dhe rregulloren bazë të QSUNT-së, pika 2.5 “*Rregulla të përgjithshme të procedurës së punësimit për personelin mjekësor dhe administrativ*”, të harmonizohet me procedurën e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë, me Udhëzim Nr. 499/2019, “*Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike*”.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

42.1. Rekomandim: Nga organet drejtuese t’i kërkohet Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të bashkërendojë dhe koordinojë veprimtarinë me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për përcaktimin e rregullave dhe procedurave në përzgjedhjen e kërkesave për mbulimin e shërbimit 24 ore për mjek vullnetarë mbi nevojat për mbulimin e këtij shërbimi.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

43.1 Rekomandim: Nga QSUNT të ngrihet një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplan të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe mbi këtë bazë të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore dhe të aplikohet për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e

rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

43.2. Rekomandim: Nga QSUNT të merren masa për përlogaritjen e vlerave nga ekspertët e fushës dhe më pas Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të ndërmarrë veprimet e nevojshme të regjistrimit të pasurisë në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Menjëherë e në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

44.1.Rekomandim: QSUNT të marrë masa, duke krijuar një grup pune të veçantë me përfaqësues të fushës së financave dhe fushës juridike për analizimin e hollësishëm të debitorëve. Të bashkëpunohet me Polet e Administrimit të Integruar (PAI), për gjetjen e saktë të të dhënave të debitorëve fizikë (ish-punonjës) dhe të subjekteve fizike e juridike, për të identifikuar shumat pa shpresë arkëtimi të klientëve dhe debitorëve të ndryshëm, pasi të jenë ezauruar më parë të gjitha rrugët e mundshme ligjore për arkëtimin e tyre .

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim nuk është zbatuar. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

44.2. Rekomandim: Organet Drejtuese të QSUNT-së duhet të sigurojnë nisjen e një procesi rivlerësimi, ku të gjitha të drejtat me palët e treta të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për arkëtimin dhe likuidimin e tyre, si dhe të propozojnë masa konkrete, duke mos përjashtuar masat administrative dhe të tjera nëse është e nevojshme.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

44.3. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të marri masa për të sistemuar veprimin e mbylljes së llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura” në debi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në këto llogari në datën 31.12.2022.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme, për P.F të vitit 2022.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

45.1. Rekomandim: Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme në caktimin e nëpunësit zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të të gjitha aktiveve të institucionit si dhe pronave, të cilat ka në administrim në formë kartelevë ose të sintetizuar të miratuar prej tij.

Dokumentacioni mbështetës

Shkresa Nr. 55/10 Prot. Datë 15.01.2024 nga DSHM

Shkresa Nr. 266/2 Prot. Date 26.10.2023 + kartela e pronave e mbajtur nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 368 date 26.09.2022

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion gjatë fazës së terrenit si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

46.1. Rekomandim: Personat përgjegjës të përmbyllin procesin e inventarizimit duke u shprehur për gjendjen fizike e cilësore të aktiveve, me qëllim përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të tyre.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

47.1. Rekomandim: Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme që të ngrejë grupet e punës për vlerësimin e aktiveve, si dhe grupin e punës për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të cilat janë vlerësuar për t'u nxjerr jashtë funksionit, duke bërë të mundur lirimin e ambienteve të pavijoneve në shërbim të qytetarit dhe jo pajisjeve të nxjerra jashtë funksionit.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion Urdhër Nr. 729 Prot. 01.12.2023 si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është në proces zbatimi.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

48.1. Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa të menjëhershme në hartimin dhe miratimin e procedurës për monitorimin dhe ndjekjen e kontratës së shërbimit të lavanterisë, në mënyrë që secili nga personat përgjegjës të ndjekjes/monitorimit të kontratës të ketë instruksione mbi të drejtat dhe detyrimet mbi kontrollet dhe raportimet, si dhe shpeshësinë e kryerjes së tyre.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar .-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

48.2. Rekomandim: Sektori i Monitorimit të Kontratës të marrë masa të menjëhershme për të kryer verifikime në ambientet e lavanterisë, si dhe nëpër pavijone në bashkëpunim me kryeinfermieret (si përgjegjëse të materialeve të buta) për t'u siguruar se detyrat (ku përfshihet procesi si dhe pajisjet) e të kontraktuarit po zbatohen në mënyrë rigorozë, të saktë dhe në kohë prej tij, si dhe të mbahet procesverbali me numër dhe datë protokolli. Të merren masa të menjëhershme ku OE “AGS” të rivendosë në punë dy barrierat larëse për mos të

cenuar punën në vazhdimësi si dhe të furnizojë AK me 5 (pesë) thasët për mbledhjen e materialeve të buta referuar specifikimeve teknike të kontratës së sipërpërmendur.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

49.1. Rekomandim: Për kontratat e qirave të lidhura nga QSUNT duhet të bëhet dorëzimi i aktivitet afatgjatë material me anë të një procesverbali/akt dorëzimi, në mënyrë të tillë të përshkruhet qartë gjendja fizike, vlera kontabël si dhe çdo element tjetër i rëndësishëm që identifikon pronën.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se ky rekomandim nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

49.2. Rekomandim: Nga QSUNT të merren masa për të hartuar kartelën shoqëruese për çdo aktiv të dhënë me qira.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si më sipër dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se ky rekomandim është zbatuar pjesërisht. -Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**.

49.3. Rekomandim: QSUNT të marrë masa për evidentimin në një regjistër të veçantë për secilën nga objektet e dhëna me qira me të gjithë elementët përbërës të pronës, si: Sipërfaqen e objektit në m2, numrin dhe datën e kontratës së qirasë, afatin e vlefshmërisë së kontratës, afatin e kohëzgjatjes, veprimtarin që kryhet, subjektin përfitues, qiranë mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si më sipër dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se ky rekomandim është zbatuar pjesërisht.Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**.

50.1.Rekomandimi: Drejtori i përgjithshëm i QSUNT në cilësinë e njësisë që ka në administrim pronën dhe MFE në cilësinë e qiradhënësit të ndërmarrin të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për zgjidhjen kontratës me subjektin “K.Gj”, pasi nuk ka përmbushur kushtet eksplicite të kontratës.

Brenda 31.03.2024

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është zbatuar**.

50.2.Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për monitorimin dhe përmbushjen e detyrimeve, kriterëve dhe vazhdueshmërinë e kontratave të qirave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion shkresa nr. 370/14 Prot, datë 26.09.2022, nr. 266/3 Prot, datë 01.02.2023, 266/9 Prot, datë 03.07.2023 si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar .-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

50.3.Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa që kontratat e qirave, që kanë për objekt një send të paluajtshëm dhe me afat më shumë se 9 vite, duhet të bëhen me akt noterial dhe të regjistrohen në regjistrat publikë pranë zyrës së Drejtorisë Vendore të ASHK Tiranë, për efekt vlefshmërie.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar. Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është zbatuar**.

51.1. Rekomandimi: Struktura përgjegjëse të angazhohet për analizimin dhe rishikimin e çmimit të qirave në mënyrë të drejtë me vlerën dysHEME për pasuritë shtetërore që jepen me qira, sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionit justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

52.1. Rekomandimi: Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për lidhjen menjëherë të kontratës së qirasë me operatorin ekonomik “A.” sh.p.k, për shfrytëzimin e ambienteve të kuzhinës.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion kontratave të qirave me subjektet si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar .-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

53.1. Rekomandimi: Nga drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të ngritur një grup pune, për vlerësimin e investimeve të kryera në aktivet afatgjata/ambientet të dhëna me qira. Të hartohet lista e investimeve prioritare në akt-marrëveshjen e parkimit, e cila ka si qëllim kryesor një shërbim sa më cilësor ndaj pacientëve, si dhe lista emërore me targat përkatëse të automjeteve për personat të cilët do të përfitojnë shërbim/pagesë të reduktuar (stafin mjekësor dhe operatorët ekonomikë) që bashkëpunojnë me QSUNT për të përfituar pagesë të reduktuar. Ndërmjet AEM dhe QSUNT-së duhet të mundësohet një sistem i përbashkët kontrolli mbi numrin e automjeteve që parkojnë, përveç deklarimit që AEM bën tek QSUNT e si rrjedhojë QSUNT të marrë siguri të mjaftueshme lidhur me numrin e saktë të automjeteve që hyjnë në parkim.

Brenda 31.03.2024

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është zbatuar**.

54.1. Rekomandimi: AK të marrë masa për parashikimin dhe kryerjen në kohë të procedurave të prokurimit që lidhen me kujdesin shëndetësor të pacientëve me qëllim

diagnostikimin në kohë të sëmundjeve dhe shmangien e procedurave të tjera emergjente për plotësimin e nevojave me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

55.1.Rekomandimi: AK të marrë masa për evidentimin, argumentimin dhe planifikimin e nevojave për materialet mjekësore, me qëllim trajtimin e pacientëve në kohë me cilësi dhe kryerjen e prokurimit me efektivitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

56.1.Rekomandimi: QSUNT, strukturat e prokurimit, të marrin masa për argumentimin e saktë e nevojave të sistemeve të transfuzionit të gjakut referuar konsumit të vitit të mëparshëm, me qëllim plotësimin e nevojave të PAI-t përkatës dhe arritjen e një prokurimi me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet duke respektuar parimin e konkurrencës.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

57.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse për zbatimin e kontratave të marrin masa për hartimin e procesverbaleve të kryerjes së shërbimit, duke përcaktuar të gjitha shërbimet e kryera sipas llojit të skanerit.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar. Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

58.1.Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Planifikimit Financiar të marrë masa që çdo urdhër-shpenzim të plotësohet me dokumentacion justifikues referuar kontratës së nënshkruar nga palët duke respektuar objektin, afatet, vlerën dhe llojin e shërbimit të kryer.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

59.1 Rekomandim: Nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” të merren masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilat nga ky auditim rezultuan të pazbatuara dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacione vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

1.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **25,605,000 lekë** nga shoqëria “R” sh.p.k. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, si pasojë e moszbatimit të specifikimeve teknike në kontratën “Mobilimi i Spitalit të Ri të Ndërtuar (A2), me fond limit 147,864,531 lekë pa TVSH.

Brenda datës 31.03.2024

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion shkresa Nr.280/13 Prot, datë 12.07.2024 dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi është zbatuar pjesërisht.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

2.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **12,480,000 lekë** nga shoqëria “B. A.” sh.p.k. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, si pasojë e moszbatimit të specifikimeve teknike në kontratën “Mobilimi i Spitalit të Ri të Ndërtuar (A2), me fond limit në vlerën 147,864,531 lekë pa TVSH.

Brenda datës 31.03.2024

Observacion i ardhur nga QSUNT me shkresën Nr. 1505/8 Prot, datë 01.08.2024 protokolluar me tonën Nr.880/13 Prot, datë 05.08.2024.

Pretendimi i subjektit:

Lënda: Njoftim detyrimi në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së drejtuar O.E “B. A.” sh.pk, me shkresën Nr. 288/16 Prot, datë, 31.07.2024.

Qëndrimi i grupit të Auditimit :

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrim tuaj, konkludon se argumentimi paraqet **fakt të ri dhe do të pranohet**.

-Sa më sipër, observacioni merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Projekt Raport.

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion në observacion me shkresën Nr. 1505/8 Prot, datë 01.08.2024 dhe shkresën Nr. 288/16 Prot, datë, 31.07.2024 si dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi është zbatuar pjesërisht.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

3.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **17,184,000 lekë** nga shoqëria “A.” Sh.p.k. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, pasi pajisja është asambluar në Shqipëri. Procesimi/mbledhja (asamblimi) i pjesëve në një pajisje është bërë nga një shoqëri e pa certifikuar/licencuar për këtë qëllim.

Brenda datës 31.03.2024

Observacion i ardhur nga QSUNT me shkresën Nr. 1505/8 Prot, datë 01.08.2024 protokolluar me tonën Nr.880/13 Prot, datë 05.08.2024.

Pretendimi i subjektit:

Lënda: Njoftim detyrimi në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së drejtuar O.E "A." sh.pk, me shkresën Nr. 287/4 Prot, datë, 31.07.2024.

Qëndrimi i grupit të Auditimit :

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrim tuaj, konkludon se argumentimi paraqet *fakt të ri dhe do të pranohet*.

-Sa më sipër, observacioni merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Projekt Raport.

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion në observacion me shkresën Nr. 1505/8 Prot, datë 01.08.2024 dhe shkresën Nr. 287/4 Prot, datë, 31.07.2024 si dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi është zbatuar pjesërisht. Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

4.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **6,886,800 lekë** nga shoqëria "M." Sh.p.k. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, pasi shkakton mbivendosje, (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e mirëmbajtjes në vlerën 5,636,219.18 lekë me TVSH, e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik "M." sh.p.k dhe QSUTN me numër Prot., 173/36 datë 04.02.2021.

Brenda datës 31.03.2024

Nga verifikimi u konstatua se:Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është zbatuar**.

5.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **3,074,122 lekë** nga shoqëria "M." sh.p.k . Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, pasi shkakton mbivendosje (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik "M." sh.p.k dhe QSUTN-së me numër Prot., 581/28, datë 01.03.2022.

Brenda datës 31.03.2024

Observacion i ardhur nga QSUNT me shkresën Nr. 1505/8 Prot, datë 01.08.2024 protokolluar me tonën Nr.880/13 Prot, datë 05.08.2024.

Pretendimi i subjektit:

Lënda: Mbi mos pranimin e rekomandimit të grupit të auditimit të KLSH për prokurimin e veçantë të kokës goditëse të pajisjes Lithotripter, me shkresën Nr. 1505/7 Prot, datë 31.07, 2024.

Sipas rekomandimit Nr. 4.1 të KLSH, dërguar me shkresën nr. 1177/29 Prot, datë 22.12.2023, administruar pranë QSUNT me Nr. 175/151 Prot, datë 28.12.2023, prokurimi i veçantë i kokës goditëse për pajisjen ESËL është quajtur mbivendosje (pagesë e dubluar) pasi sipas pretendimeve të grupit të auditimit (faqe 219 - 221) zëvendësimi i kokës goditëse të pajisjes duhet të ishte pjesë e kontratës së mirëmbajtjes Full Risk që QSUNT endra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë ka lidhur për këtë pajisje.

Konkretisht në këtë raport citohet:

Me datë 01.03.2022 Autoriteti kontraktor, ka nënshkruar kontratën me afat 180 ditë për mirëmbajtjen full risk, me objekt: "Lot 15 Mirëmbajtje e pajisjeve Lithotripter prodhuesi S. M. /ose ekuivalent", me OE "M. shpk" me vlere 3,074,122 lekë me TVSH.Me datën 22.08.2022 është mbajtur procesverbali i konstatimit ndërmjet punonjësve të inxhinierisë

klinike të QSUTNS dhe operatorit ekonomik "M. Shpk", (që është operatori që kryen mirëmbajtjen e pajisjes së sipërcituar sipas kontratës 581/28 datë 01.03.2022), si me poshtë vijon "Përshkrimi i konstatimit; Shërbimi konstatoi që pajisja sinjalizon që numri i goditjeve të kokës goditëse është drejt përfundimit; Konstatimi u krye me pas nga inxhinieret e kompanisë Montal dhe Njësia inxhineirike Klinike; Nevojitet ndërrimi i kokës goditëse; Pajisja është në gjendje të plotë pune aktualisht". Ndërkohe nga Shefi i Shërbimit të Urologjisë, është paraqitur kërkesa për marrje masash për zëvendësimin e pjesës kokë goditëse që më datë 22.07.2022. Si rrjedhojë e detyrimeve kontraktuale të kontratës me Nr. 581/28 Prot. date 01.03.2022 operatori ekonomik i kontraktuar për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes në zbatim të termave të referencës së kontratës së sipërcituar, duhet të bënte zëvendësimin e pjesëve të pajisjes Lithotripter të prodhuesit S. M. /ose ekuivalent....

....Kontrata me numër Prot, 173/36 datë 04.02.2021 e lidhur ndërmjet O.E "M." sh.p.k dhe Autoriteti Kontraktor QSUNT, ku specifikohet në termat e references se...

.... , sugjerojmë që rekomandimi nr. 4.1 i KLSH, dërguar me shkresën nr. 1177/29 Prot, datë 22.12.2023, administruar pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë me nr. 175/151 Prot., datë 28.12.2023, të mos merret parasysh.

Qëndrimi i grupit të Auditimit :

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj për O.E "M." sh.p.k në lidhje me Masat Shperblim Dëmi përkatësisht në lidhje me rekomandimin Nr 4.1 dhe Nr 5.1 konkludon se argumentimi i kryer nuk paraqet *fakt të ri dhe nuk do të pranohet.*

Gjithashtu risjellim në vëmendjen tuaj se objekti i programit të auditimit Nr 880/1, datë 02.07.2024 është zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm "Mbi auditimin e përputhshmërisë" në QSUNT për periudhën nga data 01.04.2021 deri më 31.12.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së me Nr.217, datë 20.12.2023 përcjellë tek ju me shkresën Nr.1177/29 Prot, datë 22.12.2023, rekomandime të cilat janë pranuar tërësisht nga QSUNT, sipas shkresave Nr 55/14 Prot, datë 18.01.2024 dhe Nr.1505/3 Prot, datë 18.07.2024 drejtuar KLSH-së.

-Për sa më sipër trajtuar, observacioni nuk merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm nuk pranohet.

Nga verifikimi u konstatua se:Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.

-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është zbatuar.**

6.1. Rekomandimi: Bordi i spitalit të analizojë **vlerën 21,885,993 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me 192 aktive të munguara në Polin e Administrimit të Spitalit Polivalent, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës për zhdëmtim, vlerë e cila për QSUNT-në dhe buxhetin e shtetit përbën dëm ekonomik.

Brenda datës 31.03.2024

Observacion i ardhur nga QSUNT me shkresën Nr. 1505/4 Prot, datë 30.07.2024 protokolluar me tonën Nr.880/11 Prot, datë 01.08.2024.

Pretendimi i subjektit:

Referuar përmbajtjes së këtij Akt Verifikimi Nr.1 sqarojme se:

Siç i kemi referuar Drejtorisë së Policisë Tiranë në shkresën Nr. 912 Prot, datë 18.04.2023 'Dërgim Informacioni', nga QSUNT me Nr. 93/3 Prot., datë 03.02.2023 u hartua raporti përmbledhës mbi procesin e inventarizimit...; Në këtë kuadër nga Komisariati i Policisë Nr. 4 janë kryer një sërë veprimesh, si dhe korrespondenca shkresore, ku së fundi i kemi përcjellë informacion me shkresën Nr. 912/5 Prot, datë 03.08.2023 'Kthim përgjigje...'. Për sa i përket marrjes së masave nga QSUNT si dhe evidentimi i përgjegjësiave duke marrë vendim për

zhdëmtim, sqarojmë se referuar ndodhemi përpara faktit të përgjegjësisë penale dhe përgjegjësisë administrative. Për sa i përket përgjegjësisë civile për kërkimin e dëmshpërblimit, sqarojmë se referuar parashikimeve Nenit 120 të Kodit Civil të RSH, ku parashikohet se: Për kërkimin e shpërblimit të dëmit jokontraktor, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin e pësuar dhe për personin që e ka shkaktuar, QSUNT nuk ka dijeni për personin që e ka shkaktuar dëmin, në mënyrë që të vijojë per procedurat përkatëse për zhdëmtim. Në bazë të korrespondencave shkresore midis QSUNT-të dhe Drejtorisë së Policisë Tiranë, Komisariati i Policisë Nr.4. Kjo çështje i ka kaluar Prokurorisë Pranë Gjykatës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me shkresë përcjellëse Nr.12066.Prot, datë 19.10.2023 e administruar nga QSUNT me Nr.912/16.prot datë 23.10.2023 ku citon se kërkon infomacion dhe dokumenta përkatëse. Sqarojmë se referuar Nenit 4 të Kodit të Procedurës Penale ku në pikën 1 dhe 2 parashikohet se: 1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. 2. Gjykata jep vendim fajësie kur i pandehuri rezulton fajtor për faktin penal që i atribuohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Nenit 390, pika 1 ku parashikohet se: 1. Kur fajësia e të pandehurit provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, gjykata jep vendim dënimi, duke caktuar llojin dhe masën e dënimit, QSUNT është në pritje të kryerjes së të gjitha procedurave përkatëse nga organet ligjzbatuese dhe përfundimin e hetimeve, që të identifikohen personat përgjegjës. Kjo me qëllim marrjen e masave civile dhe administrative për punonjësit, duke respektuar parashikimet e Kodit të Punës në Nenin 27, pika 1, 2 dhe 3 ku citohet se: 1. Punëmarrësi përgjigjet ndaj punëdhënësit për dëmin që i shkakton kur shkel detyrimet kontraktuale me dashje ose nga pakujdesia. 2. Shkalla e kujdesit, që duhet të tregojë punëmarrësi në punë, varet nga njohuritë teknike, të nevojshme për të kryer punën e caktuar, duke pasur parasysh aftësitë dhe cilësitë e punëmarrësit, që punëdhënësi i njihte ose duhet t'i kishte njohur. Dëmi, që lidhet në mënyrë të qenësishme me kryerjen e punës, përballohet nga punëdhënësi. 3. Dëmi përfshin dëmin real dhe fitimin e munguar, si dhe afatet e përcaktuara në Nenin 203 ku citohet se: 1. Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet. Ky afat fillon nga data e lindjes të së drejtës. Kur e drejta bazohet në shkeljen e një dispozite të Kodit Penal, afati i parashkrimit për veprën penale është i zbatueshëm edhe për veprën civile., kjo duke marrë parasysh që aplikimi i pikës 2 të këtij neni, është i aplikueshëm në momentin e marrjes dijeni të punëdhënësit, mbi punëmarrësin i cili ka shkaktuar dëmin [ref. neni 120 i KC. Bashkëlidhur dokumentacioni që vërteton pretendimet tona 58 (pesëdhjetë) faqe.

Qëndrimi i grupit të Auditimit :

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrim tuaj, konkludon se argumentimi paraqet fakt të ri dhe do të pranohet.

-Sa më sipër, observacioni merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Projekt Raport.

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion në observacion, konkludohet se rekomandimi është në proces zbatimi.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është në proces zbatimi**.

7.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **11,032,753.88 lekë** nga shoqëria “A.” sh.p.k. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, si pasojë e diferencës së peshave të materialeve të buta të paguara me ato faktike.

Brenda datës 31.03.2024

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion shkresa Nr.1626 Prot, datë 12.07.2024 dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi është zbatuar pjesërisht. Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

8.1. Rekomandimi: Bordi i Spitalit të analizojë **vlerën 14,140,000 lekë**, e cila ka të bëjë me diferencë inventari (sondë) të pajisjes së elastografisë në PAI-n e Qendrës së Konsultave Ambulatore, jo vetëm që modifikimi me sondë tjetër është shpenzim i tepër, por është risk i lartë për kryerjen e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për jetën e pacientëve. Të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës për zhdëmtim, vlerë e cila për QSUNT-në dhe buxhetin e shtetit përbën dëm ekonomik. Dëmi shëndetësor është i pallogaritshëm, pasi nuk u është dhënë shërbimi për tre muaj t pacienteve me diagnozë (Hepatit B & C), por prej datës 21.08.2022 e në vazhdim, analizat e kësaj pajisjeje janë të pasigurta pasi nuk është kryer kalibrimi i kësaj pajisjeje. (pas vendosjes së sondës së re).

Brenda datës 31.03.2024

Nga verifikimi u konstatua se:Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është zbatuar**.

Ç. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:

1.1.Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i QSUNT, të prezantohet në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale risku i lartë i qëndrueshmërisë së godinës së Pediatriisë Infektive, i ardhur si pasojë e mos korrigjimeve të projektit, duke i kërkuar Ministrisë së linjës të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës për përcaktimin e integritetit strukturor të godinës, si dhe funksionalitetit operacional të saj në shërbim të pacientëve.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, shkresa përcjellëse midis QSUNT dhe MSHMS dhe UPT (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

1.2. Rekomandimi: Nga QSUNT dhe MSHMS, në të ardhmen të merren masa që çdo investim të vlerësohet rëndësia e ruajtjes së integritetit strukturor të godinave, duke përcaktuar dhe vlerësuar kapacitetin sizmik dhe metodikat për riaftësimin strukturor të tyre, në mënyrë që të mos keq menaxhohet vlera për investime dhe rikonstruksione të objekteve spitalore.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar.-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

2.1. Rekomandimi: Bordi i Spitalit të analizojë vlerën **86,754,536 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë 165 aktive të papërdorshme, të dëmtuara, për t'u vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit në Polin e Administrimit të spitalit Polivalent, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret

vendimi përkatës për zhdëmtim, vlerë e cila për QSUNT-në dhe buxhetin e shtetit është shpenzim pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet nga QSUNT.

Brenda datës 31.03.2024

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi nuk është zbatuar. Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është zbatuar**.

D. PËR AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe konstatimeve të pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe vërejtjeve, komentëve dhe dokumentacionit shoqërues të paraqitura nga subjekti i audituar, mbështetur në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) të Ligjit Nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020, date 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 129 si dhe VKM-së nr.285 ,datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar neni 107, pika 7 dhe 8, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, fillimin e procedimit administrativ, për:

1. Operatorin ekonomik "R" sh.p.k.

Për arsye të mos zbatimit të specifikimeve teknike në kontratën "Mobilimi i spitalit të ri të ndërtuar (A2), në QSUNT".

Agjencia Shtetërore e Blerjeve të Përqendruara me shkresën Nr. 119/26 Prot., datë 15.07.2022, protokolluar me Nr. 35/33 Prot., datë 15.07.2022, ka njoftuar Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza"(QSUNT) Tiranë për lidhje kontrate, për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyresh", me afat të marrëveshjes 1 vit, me fond limit 147,864,531 lekë pa TVSH.

Ndërmjet QSUNT-së dhe operatori ekonomik "R" sh.p.k është lidhur Marrëveshja kuadër me Nr. 7/26 Prot., datë 17.07.2020.

Nga verifikimi fizik i kryer në Spitalin A2 (Urgjencës), më datë 27 dhe 28.03.2023, në prani të përgjegjësit të Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore dhe specialistit/ inxhinier biomedikal të Sektorit të Inxhinierisë Klinike, u konstatua se në 1312 copë për 6 artikuj në vlerën 25,605,000 lekë me TVSH nuk janë zbatuar specifikimet teknike, si dhe mobiljet janë të pashoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat.

Për pasojë, vlera **25,605,000 lekë** për Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" dhe buxhetin e shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria "R" sh.p.k.

Veprime në kundërshtim me:

- Marrëveshjen kuadër të lidhur me Nr. 7/26 Prot., datë 17.07.2020, ndërmjet QSUNT-së dhe operatori ekonomik "R" sh.p.k.

-Kontratën e furnizimit Nr. I, lidhur me Nr. 62/127 Prot., datë 16.08.2022 ndërmjet QSUNT-së të përfaqësuar nga A.F në cilësinë e drejtorit të Përgjithshëm dhe shoqërisë "R" Sh.p.k në vlerën 59,736,000 lekë me TVSH, neni 5.

-Kontratën e furnizimit II, lidhur me Nr. 62/142 Prot., datë 22.08.2022 ndërmjet QSUNT-së të përfaqësuar nga A.F në cilësinë e drejtorit të Përgjithshëm dhe shoqërisë "R" sh.p.k në vlerën 81,970,200 lekë me TVSH, neni 5.

-Kontratën e furnizimi III, lidhur me Nr. 62/166 Prot., datë 30.09.2022 ndërmjet QSUNT-së të përfaqësuar nga A.F në cilësinë e drejtorit të Përgjithshëm dhe shoqërisë "R" sh.p.k në vlerën 59,736,000 lekë me TVSH.

- Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 122.
- Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690.
- Deklaratën datë 03.05.2022 mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe të termave të referencës nga operatori ekonomik “R” sh.p.k.

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar .-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

2.Operatorin ekonomik “B.A.” sh.p.k:

Për arsye se të mos zbatimit të specifikimeve teknike në kontratën “Mobilimi i spitalit të ri të ndërtuar (A2), në QSUNT.

Për furnizim, vendosje të aparaturave mjekësore për spitalin e ri të ndërtuar (A2), loti 10, viti 2022, është lidhur kontrata me Nr. 64/124 Prot., datë 26.07.2022, ndërmjet QSUNT-së të përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm dhe shoqërisë “B.A.” Sh.p.k në vlerën 23,064,000 lekë me TVSH.

Nga verifikimi fizik i kryer në Spitalin A2 (Urgjencës), më datë 27 dhe 28.03.2023, në prani të përgjegjësit të Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore dhe specialistit/ inxhinier biomedikal të Sektorit të Inxhinierisë Klinike, u konstatua se 130 shtretër pacienti me kontroll manual për vlerën 10,400,000 pa TVSH, ose 12,480,000 lekë me TVSH, **nuk janë të rinj, por të përdorur**.

Pajisjet/shtretërit janë të pashoqëruar me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test-raportin e fabrikës). Veprime në kundërshtim me:

-Kontratën me Nr. 64/124 Prot., datë 26.07.2022, ndërmjet QSUNT-së të përfaqësuar nga A.Fnë cilësinë e drejtorit të Përgjithshëm dhe shoqërisë “B.A.” sh.p.k në vlerën 23,064,000 lekë me TVSH, neni 5.1.

- Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 122 “Rregullat që zbatohen për kontratën”, pika 1.

- Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690 .

-Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 Prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1.

- Deklaratën datë 18.10.2021 mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe të termave të referencës nga operatori ekonomik “B.A.” sh.p.k.

Vlera **12,480,000 lekë** përbën dëm ekonomik për QSUNT-në dhe buxhetin e shteti dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria “B.A.” sh.p.k.

Nga verifikimi u konstatua se: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar .-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

3. Operatorin ekonomik “A.” sh.p.k.

Për arsye se të mos zbatimit të specifikimeve teknike në kontratën Furnizim vendosje të pajisjes mjekësore për Spitalin e Ri “Kabineti i Endoskopisë”, viti 2022 në QSUNT.

Kontrata është lidhur me Nr. 1387/28 Prot., datë 18.10.2022, ndërmjet QSUNT të përfaqësuar nga znj.A.F në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “A.” Sh.p.k

përfaqësuar nga administrator E.Xh për vlerën 17,184,000 lekë me TVSh, me afat të zbatimit të kontratës afat 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Pjesët përbërëse të pajisjes të paraqitura në ofertën teknike kanë ardhur në Republikën e Shqipërisë dhe regjistruar në QKBPM, secila më vete në data dhe vite të ndryshme nga viti 2021-2022, me prodhues të ndryshëm dhe operatorë të ndryshëm, çka dëshmon se pajisja është asambeluar në Shqipëri. Procesimi/mbledhja (asamblimi) në një pajisje është bërë nga shoqëria “A.” Sh.p.k e cila nuk e ka tagrin ligjor/teknik për ta kryer këtë asamblim, referuar pikës 13.6.4 të VKM Nr. 731, datë 2.9.2015 “Për miratimin e rregullit teknik” Për Kërkesat Thelbësore, Vlerësimin e Konformitetit. Asamblimi, i pajisjes Videoendoskop, si dhe mosmbajtja e raportit të instalimit, funksionimit dhe trajnimit të stafit mjekësor, jo vetëm është shpenzim që nuk ia ka arritur qëllimit, por është risk i lartë për kryerjen e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për jetën e pacientëve.

Pajisjet janë të pashoqëruara me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test-raportin e fabrikës). Vlera **17,184,000 lekë** përbën dëm ekonomik për QSUNT-në dhe Buxhetin e Shteti dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria “A.” sh.p.k. Ndërsa dëmi shëndetësor ndaj pacientëve është i pallogaritshëm (pra shumë herë më i madh), pasi shërbimi ndaj pacientëve me këtë pajisje të asambeluar në Shqipëri nga persona të palicensuar, pajisje pa kalibruar, pa raport instalimi dhe funksionimi, pa raport trajnimit për personelin, pa manuale shërbimi dhe përdorimi, pa raportet e testeve (test-raportin e fabrikës) është me risk të lartë për shëndetin e pacientëve.

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar .-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

DH. MASA DISIPLINORE:

DH. 1. Mbështetur në nenin 15, “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për nivelin menaxherial të aktivitetit të përgjithshëm të QSUNT-së, lihet në vlerësimin e **Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** shqyrtimi i shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

DH. 2. Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratës kolektive të punës neni 19, pika 3, kontratave individuale të punës, neni 12.3, i kërkojmë **Drejtorit të Përgjithshëm të QSUNT**, që në varësi të kompetencave të tij ligjore, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“VËREJTJE ME PARALAJMËRIM PËR ZGJIDHJE KONTRATE” PËR:

1. B.L., me detyrë drejtor i Drejtorisë Juridike, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për arsye se

a. Në procedurën prokurimit furnizim vendosje të pajisjes mjekësore për spitalin e Ri “Kabineti i endoskopisë, viti 2022, kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik “A.”, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” nenet 77, 87, 89, 90, 92 dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82. Në opinionin e grupit të auditimit duhet të ishte shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorin ekonomik “MSE” sh.p.k me ofertë në vlerën 14,800,000 lekë.

Furnizim vendosje të pajisjes mjekësore për Spitalin e Ri “Kabineti i Endoskopisë”, viti 2022. Pjesët përbërëse të pajisjes të paraqitura në ofertën teknike kanë ardhur në Republikën e Shqipërisë dhe regjistruar në QKBPM, secila më vete në data dhe vite të ndryshme nga viti

2021-2022, me prodhues të ndryshëm dhe operatorë të ndryshëm, çka dëshmon se pajisja është asambeluar në Shqipëri. Procesimi/mbledhja (asamblimi) në një pajisje është bërë nga shoqëria “A.” Sh.p.k e cila nuk e ka tagrin ligjor/teknik për ta kryer këtë asamblim, referuar pikës 13.6.4 të VKM Nr. 731, datë 2.9.2015 “Për miratimin e rregullit teknik” Për Kërkesat Thelbësore, Vlerësimin e Konformitetit. Asamblimi, i pajisjes Videoendoskop, si dhe mos mbajtja e raportit të instalimit, funksionimit dhe trajnimit të stafit mjekësor, jo vetëm është shpenzim që nuk ia ka arritur qëllimit, por është risk i lartë për kryerjen e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për jetën e pacientëve. *(Për sa trajtuar si më sipër është mbajtur akt konstatimi nr. 7, datë 31.05.2023)*

b. Për periudhën 13.09.20221- 31.12.2022, në të gjitha procedurat e prokurimit për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, blerjen e pajisjeve mjekësore dhe barnave, është vendosur kriteri favorizues i kualifikimit autorizim nga prodhuesi.

Vendosja e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim, ka orientuar operatorët ekonomik drejtpërdrejtë një prodhuesi të caktuar në treg. Për pasojë operatori ekonomik që disponon këtë autorizim dhe ka suportin teknik, është fitues i tenderit. Veprimet e mësipërme ulin në mënyrë të ndjeshme konkurrencën, duke favorizuar vetëm operatorët ekonomik të cilët gëzojnë autorizime të prodhuesve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.

Vendosja e këtij kriteri/specifikimi është në keq interpretim me:

- Rekomandimin Nr. 3341/1 Prot., datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar autoriteteve kontraktore”, rekomandim i cili është përforcuar me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), Nr. 7988 Prot., datë 24.12.2021, pika 12.

- Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 3 dhe 77, VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 93.

- Vendimin e Autoritetit të Konkurrencës Nr. 851, datë 03.12.2021 “Dhënie rekomandimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe DPPSH për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”, pika 2.

- Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.

- Vendimin Nr.00-2015-315, datë 23.01.2015 të Kolegjit Administrativë i Gjykatës së Lartë.

(Për sa trajtuar si më sipër është mbajtur akt konstatimi nr. 7, datë 31.05.2023)

c. Në tre raste nuk është raportuar në APP për çdo fazë të realizimit të kontratës në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës”, pika 5 dhe pika 6 dhe Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Neni 125 , pika 3.

(Për sa trajtuar si më sipër është mbajtur akt konstatimi nr. 15,16, datë 31.05.2023)

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion Vendim Nr.76, datë 06.03.2024 me Nr.55/63 Prot, datë 06.03.2024 si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar plotësisht.-Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

2. L. C, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse për periudhën 01.04.2021-31.12.2022.

Për arsye se në zbatimin e kontratës Nr. 543/4 Prot, datë 27.01.2020 me Shoqërinë “AGS” u konstatua një dëm ekonomik në vlerën 11,032,753.88 lekë.

QSUNT ka lidhur kontratë . 543/4 Prot, datë 27.01.2020 me Shoqërinë “A.” Sh.p.k me objekt “Për ofrimin e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në

pavijonet e QSUNT për 30.05 ditë/muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, më të drejtë rinovimi automatikisht çdo muaj deri në lidhjen e kontratës bazë” në vlerën 26,738,538.88 lekë me TVSH. Grupi i auditimit përzgjedhi 11 materiale të buta për ti peshuar, nga 15 materiale në total për shërbimin e lavanterisë nga ku krahasuar peshave për të cilat QSUNT paguan referuar stacioneve të firmosura nga OE “A.”, u konstatuan diferenca në peshë për 5 materiale. Referuar stacioneve mujore, grupi i auditimit për çdo muaj për periudhën objekt auditimi kreu llogaritjen e tyre sipas peshave faktike, nga ku u konstatua se për periudhën prill-dhjetor 2021 OE “A.” Sh.p.k është likuiduar në vlerën 193,300,331.07 pa TVSH, ndërkohë që referuar peshave reale duhej të likuidohej në vlerën 189,622,252.16 lekë, më një diferencë prej 3,678,078.91 lekë ose 4,413,693.82 lekë me TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për QSUNT dhe Buxhetin e Shtetit.

Për vitin 2022 OE “A.” SHPK është likuiduar/paguar në vlerën 259,913,157.42 lekë pa TVSH ndërkohë që referuar peshave reale duhej të likuidohej/paguhej në vlerën 254,397,274.03 lekë, më një diferencë prej 5,515,883.39 lekë pa TVSH ose 6,619,060.07 me TVSH, e cila përbën dëm ekonomik për QSUNT dhe Buxhetin e Shtetit.

OE “A.” SHPK për periudhën objekt auditimi ka përfituar pa të drejtë në total vlerën 9,193,961.57 lekë ose 11,032,753.88 lekë me TVSH, duke shkaktuar dëm për QSUNT dhe Buxhetin e Shtetit. Veprime në kundërshtim me kontratën Nr.543/4 datë 27.01.2022, neni 3, Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 122, Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690, Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe të termave të referencës nga operatori ekonomik “A.” Sh.p.k, Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij.(Për sa trajtuar si më sipër është mbajtur akt konstatimi nr. 19, datë 31.05.2023)

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar plotësisht.Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

DH. 3. Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratës kolektive të punës neni 19, pika 3, kontratave individuale të punës, neni 12.3, i kërkojmë **Drejtorit të Përgjithshëm të QSUNT**, marrjen/ose jo të masave disiplinore ndaj personelit si më poshtë vijon, duke marrë në konsideratë shkeljet ligjore dhe përgjegjësit respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të performancës së punës së tyre.

1. **E.C**, me detyrë specialiste e sektorit të financës dhe kontabilitetit në drejtorinë ekonomike dhe planifikimin financiar.
2. **E.U (Z)**, me detyrë drejtoare e drejtorisë ekonomike dhe planifikimit financiar.
3. **A. V**, me detyrë drejtoare e drejtorisë së burimeve njerëzore.
4. **S. A**, me detyrë përgjegjëse e sektorit të menaxhimit të burimeve njerëzore.
5. **E. B**, me detyrë specialiste e sektori të inxhinierisë klinike.
6. **R. A**, me detyrë specialist tek urgjenca e sëmundjeve të brendshme.
7. **S. SH**, me detyrë specialiste e sektorit të prokurimeve.
8. **R. H**, me detyrë drejtor i drejtorisë së IT dhe inxhinierisë klinike.
9. **I.J**, me detyrë specialist në sektorin e ndjekjes së investimeve.
10. **I.H**me detyrë specialiste ing/klinike.
11. **E. B**, me detyrë specialiste/inxhinier biomedikal i sektorit të inxhinierisë klinike.
12. **D. V**, me detyrë përgjegjës sektori/drejtoria juridike.
13. **E.K**, me detyrë specialist në sektorin e inxhinierisë klinike.

14. **E. K**, me detyrë ekonomist/PAI Polivalent.
 15. **M.B**, me detyrë juriste, specialiste e prokurimeve.
 16. **E.J**, me detyrë përgjegjëse e sektorit/drejtoria ekonomike dhe planifikimit financiar.
 17. **L.V**, me detyrë specialiste në sektorin e kostove/ekonomiste.
 18. **M.M**, me detyrë specialist në sektorin e prokurimeve/jurist.
 19. **E. SH**, me detyrë specialiste e IT dhe Inxhinierisë Klinike.
 20. **E.K**, me detyrë specialist në sektorin e inxhinierisë klinike.
 21. **J. S**, me detyrë specialist/ekonomie PAI Enkologjik.
 22. **H. C**, me detyrë specialiste e sektorit të prokurimeve.
 23. **M.P**, me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve.
 24. **M. R**, me detyrë drejtore e drejtorisë farmaceutike.
 25. **F.C**, me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve.
 26. **E.K**, me detyrë specialiste në sektorin e financës dhe kontabilitetit.
 27. **J. S**, me detyrë specialiste në drejtorinë e shërbimit farmaceutik/farmaciste.
 28. **D. B**, me detyrë farmacist e sektorit të planifikimit dhe menaxhimit të barnave dhe materialeve mjekësore.
 29. **I.N**, me detyrë farmacist e sektorit të planifikimit dhe menaxhimit të barnave dhe materialeve mjekësore.
 30. **Th.K**, me detyrë farmacist i sektorit të planifikimit dhe menaxhimit të barnave dhe materialeve mjekësore.
 31. **E.B**, me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit dhe menaxhimit të barnave dhe materialeve mjekësore.
 32. **M.A**, me detyrë specialiste e sektorit të financës dhe kontabilitetit.
 33. **L. S**, me detyrë specialiste e sektorit të monitorimit të shërbimeve të kontraktuara.
 35. **F. R**, me detyrë specialiste e sektorit të financës dhe kontabilitetit.
 37. **E. S**, me detyrë specialiste e sektorit logjistik.
 38. **S. B**, me detyrë ekonomiste PAI Spitali i Pediatriës.
 39. **E. C**, me detyrë specialiste e sektorit të financës dhe kontabilitetit.
 40. **E.S**, me detyrë përgjegjëse e sektorit të kostos.
 41. **L. S**, me detyrë specialist i sektorit të monitorimit të shërbimeve të kontraktuara.
- DH. 4.** Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratës kolektive të punës neni 19, pika 3, kontratave individuale të punës, neni 12.3, **do ti kërkohej Drejtorit të Përgjithshëm**, marrja/ose jo të masave disiplinore për personat që nuk janë në marrëdhënie pune me QSUNT si më poshtë vijon, duke marrë në konsideratë shkeljet ligjore dhe përgjegjësit respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të performancës së punës së tyre.
1. **I.K**, me detyrë ish-drejtor e drejtorisë ekonomike dhe planifikimit financiar.
 2. **S.A**, me detyrë ish-përgjegjës i sektorit të menaxhimit të burimeve njerëzore.
 3. **S.Z**, me detyrë ish-drejtor i drejtorisë së burimeve njerëzore
 4. **Xh.H**, me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve.
 5. **Xh.H**, me detyrë specialist në drejtorinë juridike.
 6. **V.T** me detyrë specialist në sektorin e prokurimeve.
- E.4.** Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin Përfundimtar të auditimit janë konstatuar përgjegjësi të natyrës administrative, për personat që ***nuk janë në marrëdhënie pune*** me QSUNT, të cilat do të vlerësoheshin me masën disiplinore:
- “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje kontrate” për:**
1. **B.M**, drejtor i Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike për periudhën 01.04.2021 deri më 08.09.2022.
 2. **E. D**, me detyrë drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar për periudhën 01.04.2021 deri më 20.02.2022.

3. **I.K.** me detyrë drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar për periudhën 21.02.2022 deri më 11.11.2022.
4. **G.S.**, me detyrë përgjegjëse sektori e Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike për periudhën 01.04.2021 deri më 03.10.2022.
5. **A. F.**, me detyrë drejtor i Drejtorisë Juridike për periudhën 01.04.2021-13.09.2022.

Nga verifikimi u konstatua se:Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) konkludohet se ky rekomandim është i zbatuar. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT.

Në përfundim të procesit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, rezulton se nga **153** rekomandime të lëna, nga Subjekti **QSUNT** janë pranuar të **153** rekomandimet, nga të cilat: janë zbatuar **75- masa ose 49 % e tyre; 12-** masa pjesërisht zbatuar; **23-**masa janë në proces zbatimi si dhe **43-** masa janë pa zbatuar, pra **55-** masa mbeten për tu zbatuar nga subjekti **QSUNT**, për periudhën në vijim. Grupi i auditimit duke analizuar Rekomandimet e pranura dhe të zbatuara nga **QSUNT**, (njësitë përgjegjëse të saj) apo dhe ato në proces zbatimi, arriti në konkluzionin që: - Për kategorinë "Masa Organizative"- Rekomandimet R 1.1; R 1.3; R 6.1; R 7.1; R 8.1; R 9.1; R 9.2; R 14.; R 16.1; R 17.1; R 17.2; R 18.1; R 19.2; R 20.1; R 24.1; R 25.2; R 26.1; R 27.1; R 28.1; R 29.1; R 30.1; R 33.1; R 33.2; R 34.1; R 34.2; R 36.1; R 37.1; R 38.1; R 40.1; R 44.3; R 45.1; R 47.1; R 48.1; R 50.2; R 52.1; R 54.1; R 55.1; R 58.1; R 59.1; - Kategorinë "Masa shpërblim dëmi", R 6.1; R 20.1; "Masa disiplinore ", për 54 punonjës dhe "Njoftim në APP", janë pranuar dhe zbatuar apo në proces zbatimi nga **QSUNT**, prandaj nuk mund të qëndrojnë për periudhën në vijim.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmisimin e gjëndjes **Rikërkime që, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"** të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara si dhe pjesërisht zbatuar brenda 3-mujorit të parë të vitit 2025. Si dhe marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH-së të pranura prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

A. MASAT ORGANIZATIVE:

1.2. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i QSUNT të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për pranimin e barnave nga importuesit farmaceutikë, duke ngritur grupe pune për marrjen në dorëzim të tyre, me qëllim jo vetëm pranimin dhe marrjen në dorëzim me specialist të fushave, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

2.1. Rekomandimi: Nga drejtorët e përgjithshëm të QSUNT/FSDKSH-së, të merren masa për të ri negociuar kontratat/marrëveshjet në fuqi me importuesit farmaceutikë për të bërë amendimet përkatëse, me qëllim përcaktimin e stokut (rezervës) të nevojshme në farmaci referuar numrit të pacientëve që trajtohen dhe të analizat e projeksioneve (pacientët e rinj), për të eliminuar riskun e mungesës dhe mos disponibilitetit të përkohshëm të barit/barnave për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimbursohen nga shteti.

2.2. Rekomandimi: Pas përfundimit të kontratave/marrëveshjeve në fuqi nga Drejtorët e Përgjithshëm QSUNT/FSDKSH, të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë duke

vlerësuar lidhjen e marrëveshjeve kuadër, për furnizimin me bar/barna në princip aktiv jo në emrin tregtar me disa Importues Farmaceutik, për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimbursohen nga shteti.

2.3. Rekomandimi: Nga drejtorët e përgjithshëm të QSUNT/FSDKSH-së, të merren masa për të lidhur marrëveshje me homologët në vendet fqinje (Kosova, rajoni, etj.), për të shkëmbyer bar/barna nga stoku (rezerva) i secilës palë në raste të mos disponibilitetit të bar/barnave për pacientët ambulatorë (jo të hospitalizuar), për barnat që rimbursohen nga shteti.

3.1. Rekomandimi: Nga drejtori i përgjithshëm ti kërkohet Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, vendimi ose urdhri të përgjithshëm të komisionit ndër spitalor

3.2. Rekomandimi: Nga drejtori i përgjithshëm ti kërkohet Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, hartimi i rregullores të organizmit dhe funksionimit të komisionit ndër spitalor, duke përfshirë përgjegjësitë e anëtarëve, procesin e vendimmarrjes, dhe raportimin periodik.

3.3. Rekomandimi: Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për implementimin e një procesi të qartë dhe të dokumentuar për shqyrtimin dhe trajtimin e epikrizave nga personeli i caktuar, duke përfshirë kontrollin nga drejtori i përgjithshëm për të siguruar zbatimin e procedurave të duhura.

3.4. Rekomandimi: Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për përcaktimin i një sistemi monitorimi për të vlerësuar zbatimin e rekomandimeve dhe për të siguruar që proceset janë në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet e aplikueshme. Ky rekomandim synon të adresojë mos rregullimet dhe të sigurojë një strukturë të përcaktuar dhe të qartë për veprimtarinë e komisionit ndërspitalor dhe trajtimin e dokumentacionit shëndetësor.

4.1. Rekomandimi: Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për trajtimin e epikrizave nga komisioni ndërspitalor, duke eliminuar trajtimin me standard të dyfishtë të pacientëve në punën e këtij komisioni.

5.1. Rekomandimi: Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për të formalizuar vulën e komisionit ndër spitalor në organet përkatëse, në rast të kundërt të gjitha vendimet dhe shkresat përcjellëse në Ministrinë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë), të bëhen me vulën e QSUNT-së.

10.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për mirëmbajtje full-risk/ose jo të pajisjeve, me qëllim që para shpalljes së procedurave të prokurimit të jetë hartuar plani i mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore për çdo vit, plan i cili duhet miratuar nga komisioni mjekësor, si dhe të kryhet klasifikimi i pajisjeve mjekësore në të vogla dhe në të mesme.

10.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për mirëmbajtje full-risk/ose jo të pajisjeve, me qëllim që para shpalljes së procedurave të prokurimit të jetë hartuar plani i mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore për çdo vit, plan i cili duhet miratuar nga komisioni mjekësor, si dhe të kryhet klasifikimi i pajisjeve mjekësore në të vogla dhe në të mesme.

10.3. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa që specialistët e Drejtorisë

së IT dhe Inxhinierisë Klinike të trajnohen me shpenzimet e QSUNT-së, për njohjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, duke rritur në këtë mënyrë kompetencën profesionale në monitorimin e kontratave dhe marrjen në dorëzim të shërbimit të mirëmbajtjes.

11.1. Rekomandimi: Nga autoriteti kontraktor të merren masa që përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik të vlerësohet si procedurë e rëndësishme, pasi nga zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik varet saktësia e kësaj vlere, por edhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike.

12.1. Rekomandimi: Nga QSUNT t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomikë dhe ofertave të ofertuesve, pasi procesi i shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues e operatorëve është me rëndësi kapitale.

13.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për sigurimin e ambienteve të përshtatshme për ruajtjen e dokumentacionit arkivor, por edhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

15.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për emërimin e përgjegjësit të Sektorit të Auditit të Brendshëm, me qëllim që emërimi të bëhet me “Auditues të brendshëm në sektorin publik” të liçensuar nga Ministria e Financave, por edhe me përvojë 5-vjeçare në profesion.

18.2. Rekomandimi: Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, i ngritur sipas rastit të marrë masa që në çdo procedurë të blerjeve të pajisjeve mjekësore, në kriteret për kualifikim të vendosë si kriter që pajisja duhet të jetë e regjistruar në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore që mbahet nga Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

19.1. Rekomandimi: Personeli infermieror të marrë masa që në çdo rast që kryhet dorëzimi i mbetjeve të rrezikshme të plotësojë regjistrat me të gjithë elementët e tyre: origjina e mbetjeve, lloji i materialit, sasia në kg, data e dorëzimit dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm që lidhet me këtë proces.

20.2. Rekomandimi: Komisioni i vlerësimit të ofertave, përpara kualifikimit të operatorit fitues, në çdo rast të sigurohet për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar dhe verifikimin e certifikatave që janë lëshuar me kusht vlefshmërie.

21.1. Rekomandimi: Komisioni i hartimit të kërkesave për kualifikim, në procedurat e prokurimit me objekt “Asgjësimi i mbetjeve spitalore të rrezikshme” të marrë masa për përcaktimin si kriter kualifikuese, ndër të tjera: certifikatë e miratimit për mjetet (vetëm për brenda vendit) që transportojnë disa mallra të rrezikshme, vërtetim e mjetit të regjistruar në ministri për kryerjen e transportit të mbetjeve të rrezikshme, paraqitja e akt miratimit higjieno-sanitar lëshuar nga Inspektorati Shëndetësor Shtetëror; personeli i përfshirë në ngarkimin e koshave/kontejnerëve tranzit të jetë kompetent dhe i trajnuar, OE të dorëzojë mbetjet e dala nga përpunimi, në një subjekt të licencuar për depozitimin e hirit me qëllim uljen e dëmeve që shkaktohen në mjedis dhe në shëndetin publik.

22.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit përpara nënshkrimit të kontratës me OE që do të trajtojë mbetjet e rrezikshme spitalore, të sigurohet nëpërmjet strukturave përgjegjëse se përgjatë periudhës që kontrata do të jetë në fuqi OE të ketë një marrëdhënie kontraktuale me

një subjekt që do të kryejë asgjësimin e hirit. Gjithashtu, në çdo rast strukturat përgjegjëse të vijnë me dokumentacionin justifikues për shlyerjen e faturës, vetëm pasi të sigurohen se hiri i prodhuar është asgjësuar, duke marrë siguri të plotë se hallka e fundit e procesit të asgjësimit ka përfunduar me sukses.

22.2. Rekomandimi: QSUNT në çdo rast përpara shlyerjes së faturës me OE, i cili ka marrë përsipër trajtimin e mbetjeve të rrezikshme, të sigurohet me anë të dokumenteve provuese se procesi i trajtimit (me incenerim apo hidroklavë/autoklavë) për të gjithë sasinë e mbetjeve të dorëzuara ka përfunduar me sukses.

23.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të QSUNT-së të marrin masa për mbetjet spitalore që mund të trajtohen me hidroklavë, ta kryejë vetë si proces pa qenë i nevojshëm prokurimi i këtij shërbimi. Në rastet kur pajisja “hidroklavë” nuk ka kapacitet të mjaftueshëm ose paraqet defekt, të argumentohet nga personat përgjegjës dhe t’i drejtohen OE i cili ka lidhur një marrëdhënie kontraktuale me QSUNT-në për mirëmbajtjen e pajisjeve me qëllim rregullimin e defektit të ndodhur dhe mire përdorimin e fondeve publike.

25.1.Rekomandimi: Bordi Drejtues i QSUNT-së të programojë kalendarin e aktiviteteve në lidhje me miratimin e buxhetit dhe të raportit vjetor e pasqyrave financiare të llogaridhënies vjetore në përputhje me misionin dhe vizionin e QSUNT-së.

31.1. Rekomandim: Mbështetur në Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, neni 10 , pika 2, QSUNT, t’i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për qëndrimin e saj zyrtar lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor për mbajtjen 15% të tatimit mbi fitimin nga pjesa takuese e të ardhurave të QSUNT-së në shumën 13,499,579 lekë, në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 135/2022, “Për disa shtesa në vendimin Nr. 688, datë 14.11.2018 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga MSHMS e FSHZH të objektit me emërtim “Oborr i QSUNT” dhe zbatimin e aktmarrëveshjes së nënshkruar midis QSUNT-së dhe FSHZH-së, me Nr. 1242/41, datë 16.11.2018, ndryshuar me Amendamentin Nr. 1, protokolluar me Nr. 884/2, datë 12.04.2022.

32.1. Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i QSUNT-së në bashkëpunim me AKSH-in, të ngrenë një grup të përbashkët pune për të vlerësuar teknikisht nëse shërbimet e kërkuara me shkresën Nr. 1544/1 Prot, datë 01.06.2022 për hedhjen në Sistemin Informacionit për Shëndetin Publik (SISP) të tarifave të ndryshuara të shërbimeve, kanë qenë pjesë e kontratës së shërbimit Nr. 5216, datë 09.10.2020, nënshkruar midis kontraktuesit dhe përfituesit. Pas verifikimit , nëse kushtet nuk ndryshojnë, të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 2,055,301 lekë, për mos mbajtje tarife ditore (dëm) në vlerën 2,055,301 leke.

35.1.Rekomandim: Nga organet drejtuese të QSUNT-së të merren masa për të bërë unifikimin e kontratës kolektive me kontratën individuale të punës në lidhje me përcaktimin e datës së pagesës së punonjësve.

41.1. Rekomandim: Procedura e pranimit dhe emërimit të mjekëve në statutin e QSUNT-së miratuar me urdhrin të përbashkët të MSHMS dhe MARS Nr. 709/2018, (statuti i QSUNT) paragrafi 24 dhe rregulloren bazë të QSUNT-së, pika 2.5 “Rregulla të përgjithshme të procedurës së punësimit për personelin mjekësor dhe administrativ”, të harmonizohet me procedurën e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë, me Udhëzim Nr. 499/2019, “Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në

Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike”.

42.1. Rekomandim: Nga organet drejtuese t’i kërkohet Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të bashkërendojë dhe koordinojë veprimtarinë me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për përcaktimin e rregullave dhe procedurave në përzgjedhjen e kërkesave për mbulimin e shërbimit 24 ore për mjek vullnetarë mbi nevojat për mbulimin e këtij shërbimi.

43.1 Rekomandim: Nga QSUNT të ngrihet një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplan të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe mbi këtë bazë të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore dhe të aplikohet për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të institucionit.

43.2. Rekomandim: Nga QSUNT të merren masa për përlogaritjen e vlerave nga ekspertët e fushës dhe më pas Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të ndërmarrë veprimet e nevojshme të regjistrimit të pasurisë në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

44.1.Rekomandim: QSUNT të marrë masa, duke krijuar një grup pune të veçantë me përfaqësues të fushës së financave dhe fushës juridike për analizimin e hollësishëm të debitorëve. Të bashkëpunohet me Polet e Administrimit të Integruar (PAI), për gjetjen e saktë të të dhënave të debitorëve fizikë (ish-punonjës) dhe të subjekteve fizike e juridike, për të identifikuar shumat pa shpresë arkëtimi të klientëve dhe debitorëve të ndryshëm, pasi të jenë ezauruar më parë të gjitha rrugët e mundshme ligjore për arkëtimin e tyre.

44.2. Rekomandim: Organet Drejtuese të QSUNT-së duhet të sigurojnë nisjen e një procesi rivlerësimi, ku të gjitha të drejtat me palët e treta të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për arkëtimin dhe likuidimin e tyre, si dhe të propozojnë masa konkrete, duke mos përjashtuar masat administrative dhe të tjera nëse është e nevojshme.

46.1. Rekomandim: Personat përgjegjës të përmbyllin procesin e inventarizimit duke u shprehur për gjendjen fizike e cilësore të aktiveve, me qëllim përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të tyre.

48.2. Rekomandim: Sektori i Monitorimit të Kontratës të marrë masa të menjëhershme për të kryer verifikime në ambientet e lavanterisë, si dhe nëpër pavijone në bashkëpunim me kryeinfermieret (si përgjegjëse të materialeve të buta) për t’u siguruar se detyrat (ku përfshihet procesi si dhe pajisjet) e të kontraktuarit po zbatohen në mënyrë rigorozë, të saktë dhe në kohë prej tij, si dhe të mbahet procesverbali me numër dhe datë protokolli. Të merren masa të menjëhershme ku OE “A.” të rivendosë në punë dy barrierat larëse për mos të cenuar punën në vazhdimësi si dhe të furnizojë AK me 5 (pesë) thasët për mbledhjen e materialeve të buta referuar specifikimeve teknike të kontratës së sipërpërmendur.

49.1. Rekomandim: Për kontratat e qirave të lidhura nga QSUNT duhet të bëhet dorëzimi i aktivitetit afatgjatë material me anë të një procesverbali/akt dorëzimi, në mënyrë të tillë të përshkruhet qartë gjendja fizike, vlera kontabël si dhe çdo element tjetër i rëndësishëm që identifikon pronën.

49.2. Rekomandim: Nga QSUNT të merren masa për të hartuar kartelën shoqëruese për çdo aktiv të dhënë me qira.

49.3. Rekomandim: QSUNT të marrë masa për evidentimin në një regjistër të veçantë për secilën nga objektet e dhëna me qira me të gjithë elementët përbërës të pronës, si: Sipërfaqen e objektit në m2, numrin dhe datën e kontratës së qirasë, afatin e vlefshmërisë së kontratës, afatin e kohëzgjatjes, veprimtarin që kryhet, subjektin përfitues, qiranë mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

50.1.Rekomandimi: Drejtori i përgjithshëm i QSUNT në cilësinë e njësisë që ka në administrim pronën dhe MFE në cilësinë e qiradhënësit të ndërmarrin të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për zgjidhjen kontratës me subjektin “K.Gj”, pasi nuk ka përmbushur kushtet eksplicite të kontratës.

50.3.Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa që kontratat e qirave, që kanë për objekt një send të paluajtshëm dhe me afat më shumë se 9 vite, duhet të bëhen me akt noterial dhe të regjistrohen në regjistrat publikë pranë zyrës së Drejtorisë Vendore të ASHK Tiranë, për efekt vlefshmërie.

51.1. Rekomandimi: Struktura përgjegjëse të angazhohet për analizimin dhe rishikimin e çmimit të qirave në mënyrë të drejtë me vlerën dysHEME për pasuritë shtetërore që jepen me qira, sipas përcaktimeve ligjore.

53.1. Rekomandimi: Nga drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të ngritur një grup pune, për vlerësimin e investimeve të kryera në aktivet afatgjata/ambientet të dhëna me qira. Të hartohet lista e investimeve prioritare në akt-marrëveshjen e parkimit, e cila ka si qëllim kryesor një shërbim sa më cilësor ndaj pacientëve, si dhe lista emërore me targat përkatëse të automjeteve për personat të cilët do të përfitojnë shërbim/pagesë të reduktuar (stafin mjekësor dhe operatorët ekonomikë) që bashkëpunojnë me QSUNT për të përfituar pagesë të reduktuar. Ndërmjet A. dhe QSUNT-së duhet të mundësohet një sistem i përbashkët kontrolli mbi numrin e automjeteve që parkojnë, përveç deklarimit që A. bën tek QSUNT e si rrjedhojë QSUNT të marrë siguri të mjaftueshme lidhur me numrin e saktë të automjeteve që hyjnë në parkim.

56.1.Rekomandimi: QSUNT, strukturat e prokurimit, të marrin masa për argumentimin e saktë e nevojave të sistemeve të transfuzionit të gjakut referuar konsumit të vitit të mëparshëm, me qëllim plotësimin e nevojave të PAI-t përkatës dhe arritjen e një prokurimi me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet duke respektuar parimin e konkurrencës.

57.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse për zbatimin e kontratave të marrin masa për hartimin e procesverbaleve të kryerjes së shërbimit, duke përcaktuar të gjitha shërbimet e kryera sipas llojit të skanerit.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

1.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **25,605,000 lekë** nga shoqëria “R” sh.p.k. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, si pasojë e moszbatimit të specifikimeve teknike në kontratën “Mobilimi i Spitalit të Ri të Ndërtuar (A2), me fond limit 147,864,531 lekë pa TVSH.

2.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 12,480,000**

lekë nga shoqëria “B.A.” sh.p.k. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, si pasojë e moszbatimit të specifikimeve teknike në kontratën “Mobilimi i Spitalit të Ri të Ndërtuar (A2), me fond limit në vlerën 147,864,531 lekë pa TVSH.

3.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **17,184,000 lekë** nga shoqëria “A.” Sh.p.k. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, pasi pajisja është asambeluar në Shqipëri. Procesimi/mbledhja (asamblimi) i pjesëve në një pajisje është bërë nga një shoqëri e pa certifikuar/licencuar për këtë qëllim.

4.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **6,886,800 lekë** nga shoqëria “M.” Sh.p.k. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, pasi shkakton mbivendosje, (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e mirëmbajtjes në vlerën 5,636,219.18 lekë me TVSH, e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik “M.” sh.p.k dhe QSUTN me numër Prot., 173/36 datë 04.02.2021.

5.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **3,074,122 lekë** nga shoqëria “M.” sh.p.k. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, pasi shkakton mbivendosje (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik “M.” sh.p.k dhe QSUTN-së me numër Prot., 581/28, datë 01.03.2022.

7.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **11,032,753.88 lekë** nga shoqëria “AGS” sh.p.k. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, si pasojë e diferencës së peshave të materialeve të buta të paguara me ato faktike.

8.1. Rekomandimi: Bordi i Spitalit të analizojë vlerën **14,140,000 lekë**, e cila ka të bëjë me diferencë inventari (sondë) të pajisjes së elastografisë në PAI-n e Qendrës së Konsultave Ambulatore, jo vetëm që modifikimi me sondë tjetër është shpenzim i tepër, por është risk i lartë për kryerjen e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për jetën e pacientëve. Të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës për zhdëmtim, vlerë e cila për QSUNT-në dhe buxhetin e shtetit përbën dëm ekonomik. Dëmi shëndetësor është i pallogaritshëm, pasi nuk u është dhënë shërbimi për tre muaj të pacientëve me diagnozë (Hepatit B & C), por prej datës 21.08.2022 e në vazhdim, analizat e kësaj pajisjeje janë të pasigurta pasi nuk është kryer kalibrimi i kësaj pajisjeje (pas vendosjes së sondës së re).

C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:

1.1.Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i QSUNT, të prezantohet në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale risku i lartë i qëndrueshmërisë së godinës së Pediatriisë Infektive, i ardhur si pasojë e mos korrigjimeve të projektit, duke i kërkuar Ministrisë së linjës të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës për përcaktimin e integritetit strukturor të godinës, si dhe funksionalitetit operacional të saj në shërbim të pacientëve.

1.2. Rekomandimi: Nga QSUNT dhe MSHMS, në të ardhmen të merren masa që çdo

investim të vlerësohet rëndësia e ruajtjes së integritetit strukturor të godinave, duke përcaktuar dhe vlerësuar kapacitetin sizmik dhe metodikat për riaftësimin strukturor të tyre, në mënyrë që të mos keq menaxhohet vlera për investime dhe rikonstruksione të objekteve spitalore.

2.1. Rekomandimi: Bordi i Spitalit të analizojë vlerën **86,754,536 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë 165 aktive të papërdorshme, të dëmtuara, për t'u vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit në Polin e Administrimit të spitalit Polivalent, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës për zhdëmtim, vlerë e cila për QSUNT-në dhe buxhetin e shtetit është shpenzim pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet nga QSUNT.

3.8 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR; SHTËPIA E TË MOSHUARVE (SHKODËR) DHE SHTËPIA E TË MOSHUARVE (TIRANË)

3.8.1 PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në **Shërbimin Social Shtetëror** mbi “*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023*” për auditimin e kryer në vitin 2023, për periudhën objekt auditimi 01.01.2020 deri më datën 31.12.2022, përcjellë me shkresën Nr.438/12 Prot., datë 29.12.2023, protokolluar në subjekt me nr. 5915/3 Prot., datë 03.01.2024 duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH^{së} të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

- a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

- b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

- c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve;

- ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

3.8.2 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, si dhe manualit “*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve*”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 880/1 prot., datë 02.07.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. E.K, përgjegjëse grupi

2. L.L, anëtare

Auditimi ka filluar më, 03.07.2024.

Auditimi ka përfunduar më, 18.07.2024.

3.8.3 KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti **Shërbimi Social Shtetëror**, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 438/12 Prot., datë 29.12.2023, rezultoi se, nga **59** masa të rekomanduara (*përmirësim ligjor, organizative, shpërblim dëmi, 3-E dhe Disiplinore*), janë pranuar nga subjekti **59** masa të rekomanduara ose **100 %**.

Nga 59 rekomandimet e pranuara rezultoi se janë zbatuar plotësisht 7 masa ose 12% e tyre, janë në proces zbatimi 48 masa ose 81% dhe nuk janë zbatuar 4 masa ose 7 % e tyre. Nga sa shikohet niveli i realizimit plotësisht të rekomandimeve rezultoi në masën **12%**, e cila tregon se **Shërbimi Social Shtetëror** nuk ka vlerësuar plotësisht procesin e zbatimit të rekomandimeve.

3.8.4 OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve rezultoi në masën **12%**, niveli i zbatimit të rekomandimeve në proces rezultoi **81%**, niveli i rekomandimeve pa zbatuar rezultoi **7%** nivele këto të cilat tregojnë vlerësimin e këtij procesi në lidhje me ndjekjen e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve.

3.5.5 PËRSHKRIMI I AUDITIMIT:

Sipas shkresës nr.438/12 Prot., datë 29.12.2023 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Mbi Auditimin e Përputhshmërisë*” të ushtruar në **Shërbimit Social Shtetëror**, sipas programit të auditimit nr.438/1 Prot., datë 02.06.2023, për veprimtarinë nga data 01.01.2020 deri në 31.12.2022, janë rekomanduar gjithsej **59 rekomandime**, nga ku **4 rekomandime** janë për përmirësim ligjor, **25 rekomandime** për marrjen e masave organizative, **2 rekomandime** për marrjen e masave për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike, **28 rekomandime** për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi u lanë **4 rekomandime** të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, **1 rekomandim** pa zbatuar dhe **3 rekomandime** në proces zbatimi.
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **25 rekomandime** të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon **7 rekomandime** janë zbatuar plotësisht, **2 rekomandime** rezultojnë pa zbatuar dhe **16 rekomandime** rezultojnë në proces zbatimi.
- Për marrjen e masave për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike u lanë **2 rekomandime**, të pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon **1 rekomandim** pa zbatuar dhe **1 rekomandim** në shumën **1,891 mijë lekë** në proces zbatimi.
- Për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, janë lënë **28 rekomandime** të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit **28 masa në proces zbatimi.**

a. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH-s me nr.438/12 Prot., datë 29.12.2023 dhe protokolluar në **Shërbimin Social Shtetëror** me Nr. 5915/3 Prot. datë 03.01.2024, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Përmirësim Ligjor	4	4	-
2	Organizative	25	25	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	2	2	-
		1,891 mijë lekë	1,891 mijë lekë	
4	Masa Disiplinore	Vlerësim i shkeljeve nga institucioni për 28 punonjës	Po	-

b. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmblledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim Ligjor	4	-	-	3	1
2	Organizative	25	7	-	16	2
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	2	-		1	1
		1,891 mijë lekë				
4	Masa Disiplinore	28		-	28	-
	Total	59	7	-	48	4

ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM:

Nga auditimi i ushtruar në **Shërbimin Social Shtetëror** për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë*” për periudhën nga data 01.01.2020 deri më datën 31.12.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me Vendimin e Kryetarit të KLSH Nr.226 datë 26.12.2023, përcjellë. me shkresën nr.438/12 Prot., datë 29.12.2023, rezultoi si më poshtë vijon:

1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **Shërbimi Social Shtetëror**, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën me nr.5915/4 Prot., datë 23.02.2024

Sa më sipër rezulton se subjekti ka shkelur afatin 20 ditor për kthimin e përgjigjes mbi zbatimin e rekomandimeve.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga ana e subjektit të audituar lidhur me raportimin mbi zbatimin të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara sipas strukturave përgjegjëse, subjekti ka raportuar në KLSH me shkresën nr. 5915/5 Prot. datë 08.07.2024 jashtë afatit 6 mujor të raportimit, sipas ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30.

Sa më sipër rezulton se nuk ka zbatuar afati 6 mujor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve

3. Realizimi i rekomandimeve, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, rezultoi si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

Rekomandimi 1.1: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrë masat e duhura për plotësimin e kuadrit nënligjor për funksionimin më të mirë të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke hartuar dhe propozuar akte ligjore e nënligjore për zbatimin të nenit 23.3 dhe nenit 23.4 dhe nenit 46 pika

2 dhe të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, për përcaktimin e kriterëve për përfituesit e shpenzimeve personale të shërbimeve dhe pagesat e tarifave shërbimeve që ofrohen nga kontributet e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji.

Menjëherë dhe në vijimësi

-Pretendimi i subjektit:

Observacion i ardhur nga Shërbimi Social Shtetëror me shkresën nr. 5113/5 Prot., datë 25.10.2024 protokolluar me tonën nr. 880/30 Prot., datë 06.11.2024, nga Titullari i institucionit janë shprehur objeksionet si më poshtë:

1. Për masa për përmirësim ligjor rekomandimin 1.1 sqarohet se SHSSH duke marrë parasysh kërkesat e institucioneve të paraqitura në projekt buxhet bënë rakordimin e fondeve në total për vitin pasardhës për institucionet e vartësisë. Fondi i kërkuar dhe akorduar ka ardhur çdo vit në rritje. Në PBA 2025-2027, institucione të vartësie kanë paraqitur midis të tjerave kërkesat për shpenzime për furnizim dhe shërbim për ushqim të llogaritur duke përfshirë indeksimin vjetor të parashikuar (shkresa nr. 133 prot, datë 12.07.2024 nga SHM Tiranë dhe shkresa nr. 200 prot, datë 17.07.2024 nga SHM Shkodër.

-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

1. Lidhur me rekomandimin 1.1, sqarojmë se në argumentet tuaja shpjegohet se SHM Tiranë në përcaktimin e shpenzimeve operative për ushqime për vitin 2025-2027 është mbështetur në kuotën aktuale të indeksuar me 1.15% duke vlerësuar kuotën e indeksuar në PBA 435 lekë/person në ditë. SHM Shkodër me shkresën nr. 200 prot, datë 17.07.2024, ka llogaritur shpenzime për “Furnizim dhe Shërbim me ushqim për mensat”, me kuote të indeksuar 440/lekë/person.

Sa më sipër institucionet e vartësisë nuk kanë parashikuar një shpenzimet ushqimore mbi një kuote të indeksuar vjetore të njëjtë të shpenzimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare, sipas indeksit të çmimeve të konsumit, nëngrupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” të llogaritur nga institucionet përgjegjëse për vlerësimin e saj, por sipas një kuote të indeksuar nga vete ato, kuote të cilat nuk gjen mbështetje ligjore për hartimin e nevojave për shpenzime në PBA 2025-2027. **Sa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.**

Nga verifikimi u konstatua se: Sipas informacionit të SHSSH, rezultoi se subjekti ka vazhduar përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe ka vlerësuar zbatimin e rekomandimit në vazhdimësi, për plotësimin e kuadrin nënligjor i cili duhet të gjeje zbatim në subjektin/et e audituar Shtëpia e të Moshuarve Tirane dhe institucione të tjera shtetërore në të cilat ofrohet shërbimi i kujdesit shoqëror për të moshuar. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 2.1: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrin masa të menjëhershme për miratimin e ndryshimeve të nivelit të kuotës ushqimore referuar Udhëzimit Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Sipas informacionit të SHSSH, rezultoi se subjekti ka vazhduar përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe ka vlerësuar zbatimin e rekomandimit në vazhdimësi, për plotësimin e kuadrin nënligjor i cili duhet të gjeje zbatim në subjektin/et e audituar Shtëpia e të Moshuarve Tirane dhe institucione të tjera shtetërore në të cilat ofrohet

shërbimi i kujdesit shoqëror për të moshuar. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

MSHMS dhe Shërbimi Social Shtetëror nuk ka reflektuar ndryshimet e kuotës ushqimore në Udhëzimin nr. 689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore” sipas ndryshimeve të përcaktuara në Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 662 Prot., datë 06.12.2022.

Sipas komenteve nga subjekti SHSSH, rezultoi se subjekti vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit të lënë duke vlerësuar mundësinë e realizimit të tij në vazhdimësi.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 2.2: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe miratimin e Manualit mbi propozimet e grupit të punës lidhur me menutë ditore të përfituesve në institucionet publike rezidenciale komunitare të përkujdesit shoqërore” sipas projekt studimit “Si të ushqehemi në Moshën e Tretë”, për miratimin e normative ushqimore dhe ushqyerjes së grup moshës së tretë sipas kërkesave të nenit 23.4, neni 46.2 dhe neni 51.3 të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Sipas informacionit të SHSSH, rezultoi se subjekti ka vazhduar përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe ka vlerësuar zbatimin e rekomandimit në vazhdimësi, për plotësimin e kuadrin nënligjor i cili duhet të gjeje zbatim në subjektin/et e audituar Shtëpia e të Moshuarve Tirane dhe institucione të tjera shtetërore në të cilat ofrohet shërbimi i kujdesit shoqëror për të moshuar. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Sipas dokumentacionit të paraqitur SHSSH, rezultoi se subjekti vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit duke vlerësuar mundësinë e realizimit të tij në vazhdimësi.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 3.1: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa për nxjerrjen e akteve nënligjore për miratimin e standardeve për ofrimin e shërbimit të kujdesit shoqërore për të moshuar, për nxjerrjen e akteve nënligjore për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave dhe nivelit të tyre, për nxjerrjen e akteve nënligjore mbi mekanizmat e financimit për dhurimet, sponsorizimet, donacionet dhe financime të tjera nga organizata, persona fizikë ose juridikë.

Menjëherë dhe në vijimësi

-Pretendimi i subjektit:

Për masa për përmirësim ligjor rekomandimin 3.1 sqarohet se MSHMS ka nxjerre Udhëzimin nr. 168, datë 29.03.2024 “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqërore për të moshuar në Qendrat Rezidenciale dhe Manuali i Zbatimit”, protokolluar pranë SHSSH me nr. 2448 prot, datë 02.04.2024.

-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Lidhur me rekomandimin 3.1, sqarojmë se bashkëlidhur observacionit nr. 5113/3, date 30.07.2024 keni vendosur shkresën e miratimit Udhëzimit nr. 168, datë 29.03.2024 “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqërore për të moshuar në Qendrat Rezidenciale dhe Manuali i Zbatimit” nga Ministër e MSHMS.(1 flete).

Ne të dy shkresat e ardhura prej jush (5113/2 dhe 5113/3) ne asnjë rast prej jush nuk argumentohet nëse standardet e miratuara të përkujdesit shoqëror për të moshuar kanë

*përputhshmëri me rekomandimin nr. 3.1. Sa më sipër në këtë fazë auditimi në mungese të shpjegimeve tuaja, grupi i auditimit e ka të pamundur të vlerësojë ecurinë e zbatimit të këtij rekomandimi, arsye për të cilën observacioni juaj **nuk pranohet**.*

Nga verifikimi u konstatua se: Sipas informacionit të SHSSH, rezultoi se subjekti ka vazhduar përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe ka vlerësuar zbatimin e rekomandimit në vazhdimësi, për plotësimin e kuadrin nënligjor i cili duhet të gjeje zbatim në subjektin/et e audituar Shtëpia e të Moshuarve Tirane dhe institucione të tjera shtetërore në të cilat ofrohet shërbimi i kujdesit shoqëror për të moshuar. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Kuadri nënligjor mbete i paplotësuar më akte normative për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave dhe nivelit të tyre, për nxjerrjen e akteve nënligjore mbi mekanizmat e financimit për dhurimet, sponsorizimet, donacionet dhe financime të tjera nga organizata, persona fizikë ose juridikë.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

B. MASAT ORGANIZATIVE.

Rekomandimi 1.1: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrin masa të parashikimit të fondeve buxhetore edhe si efekt i indeksimit vjetor të kuotave të shpenzimeve personale dhe shpenzimeve ditore të ushqyerjes së të moshuarve në përputhje me VKM nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqërore komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, duke siguruar jetesë të qete dhe me dinjitet në të përditshmen e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Sipas informacionit të SHSSH, rezultoi se subjekti ka vazhduar përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe ka vlerësuar zbatimin e rekomandimit në vazhdimësi, për plotësimin e kuadrin nënligjor i cili duhet të gjeje zbatim në subjektin/et e audituar Shtëpia e të Moshuarve Tirane dhe institucione të tjera shtetërore në të cilat ofrohet shërbimi i kujdesit shoqëror për të moshuar. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Kuadri nënligjor mbete i paplotësuar më akte normative për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave dhe nivelit të tyre, për nxjerrjen e akteve nënligjore mbi mekanizmat e financimit për dhurimet, sponsorizimet, donacionet dhe financime të tjera nga organizata, persona fizikë ose juridikë.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Grupi i auditimit konstatoi se në PBA 2024-2026 në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë dhe Shkodër, parashikimin buxhetor për shpenzime për furnizim dhe shërbim për ushqyerjen e të moshuarve e kanë llogaritur mbi kuotën ditore, pa përfshirë indeksimin vjetor.

Ne informacioni e paraqitur nga SHSSH nuk u paraqit dokumentacion mbi parashikimin e kuotës ushqimore të indeksuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Rekomandimi 2.1: Shërbimi Social Shtetëror të marrë masat e nevojshme duke ofruar sistem të unifikuar rregullash për t’u zbatuar në aplikimin e tarifave që paguhen nga përfituesi i shërbimit të kujdesit shoqëror në qendrat e shërbimit rezidencial për të moshuar, deri në

miratimin e Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sipas kërkesave të nenit 51.1 të Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Sipas komenteve nga subjekti i audituar, rezultoi se subjekti i audituar SHSSH i është drejtuar MSHMS me shkresën me nr.1317 Prot., datë 15.02.2024 me objekt “Propozim për rishikim të VKM-së 518, datë 04.09.2018 dhe problematika të hasura mbi moshimin”, duke kërkuar rishikimin e VKM-së 518, datë 04.09.2018.

Aktualisht propozimet e SHSSH për MSHMS me shkresën nr. 1317 Prot, datë 15.02.2024 nuk janë reflektuar në VKM 518/2018. Subjekti i audituar ka vazhduar përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerësuar mundësinë e realizimit të tij në vazhdimësi, por nuk ka realizuar plotësisht atë.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 3.1: Shërbimin Social Shtetëror në bashkëpunim me Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, para dërgimit të projekt buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të vlerësojë rëndësinë dhe prioritetin e kërkesave për zërin “Investime” në llogarinë 231, në përmbushje të Standardit 10 “Shtëpia, mjediset e banimit dhe pajisjet e saj”, me qëllim rritjen e cilësisë së cilësinë së jetesës së të moshuarve në këto institucione rezidenciale.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Sipas komente nga subjekti i audituar, rezultoi se subjekti vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerëson mundësinë e realizimit të tij në vazhdimësi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 4.1: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në rolin dhe përgjegjësinë e organit publik të ngarkuar me ligj për hartimin e dokumenteve dhe politikave të reformimit e modernizimit të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe si institucion përgjegjës për organizimin dhe administrimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të marrë masat e nevojshme që në të gjitha qendrat rezidenciale ofrimi i shërbimeve rezidenciale tu transferohet njësisë të qeverisjes vendore, në përputhje me kërkesat dhe standardet e ofrimit të shërbimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Nga Ministria e Shëndetësisë dhe informacionit të paraqitur nga SHSSH, rezultoi se ende nuk janë marrë masa për transferimin e shërbimeve rezidenciale në njësitë e qeverisjes vendore. Aktualisht Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër vazhdojnë të ndodhet nën juridiksion të SHSSH. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Rekomandimi 5.1: Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, të marrin masa për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin që mungon, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar plotësisht**.

Rekomandimi 6.1: Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të aplikojë sistemin e krediteve sipas programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në rekrutimet e punonjësve, i cili përfshin si subjekte të certifikimit punonjësit socialë dhe psikologët e ofruesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Procesi certifikimit punonjësit socialë dhe psikologët, ofrues të shërbimeve të përkujdesit shoqëror nuk ka përfunduar. Sipas komenteve nga subjekti/et e audituar, rezultoi se vazhdojnë përpjekjet për zbatimin e rekomandimit duke vlerësuar mundësinë e realizimit të tij në vazhdimësi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 7.1: Komisioni i blerjeve me vlera të vogla pranë Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër të marrë masa që në procedurat për prokurim me vlerë të vogël, dokumentacioni i kërkuar sipas ftesës për ofertë të pranohet vetëm nëse dorëzohet nga OE sipas formës së kërkuar nga ligji, në zyrën e protokollit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Për prokurimet ende nuk janë organizuar dosje prokurimi. Sipas komenteve subjekti/et ei audituar ende nuk kanë organizuar dosjet e prokurimit. Ato vazhdojnë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimit, duke vlerësuar mundësinë e realizimit plotë të tij në vijimësi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 7.2: Komisioni i marrjes në dorëzim pranë Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër në çdo rast përpara marrjes në dorëzim të mallit të verifikojë plotësimin e të gjitha kushteve të vendosura në ftesën për ofertë duke e pasqyruar në një procesverbal të posaçëm dhe furnizimi të bëhet në çdo rast në përputhje me grafikun e lëvrimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Sipas komente nga subjekti i audituar, rezultoi se subjekti vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerëson mundësinë e realizimit të tij në vazhdimësi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 8.1: Komisioni i blerjeve me vlera të vogla pranë Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë, të marrë masa që në procedurat për prokurim me vlerë të vogël, të mos shpall OE fitues pa u siguruar se i gjithë dokumentacioni i kërkuar është depozituar dhe është në përputhje të plotë me kërkesat e AK, si dhe përfaqësuesit e operatorit ekonomik të veprojnë në përputhje me tagrin ligjor.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Sipas komenteve nga subjekti i audituar, rezultoi se subjekti vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerëson mundësinë e realizimit të tij në vazhdimësi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 9.1: Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër, të marrin masa për:

- Hartimin e një plani të posaçëm vjetor me qëllim plotësimin e nevojave mjekësorë për përfituesit dhe për kryerjen e procesit të inventarizimit vjetor.
- Komisionet e marrjes në dorëzim në çdo rast të mbajnë procesverbal në momentin e marrjes në dorëzim të medikamenteve dhe të pasqyrojnë qartë datën e skadencës dhe praninë e pullës.

- Komisionet e blerjeve me vlera të vogla të marrin masa që në procedurat për prokurim me vlerë të vogël, dokumentacioni i kërkuar sipas ftesës për ofertë të pranohet vetëm nëse dorëzohet nga OE sipas formës së kërkuar nga ligji, në zyrën e protokollit.
- Në çdo rast, që nuk është i arsyetuar nga mjeku i Institucionit arsyeja se përse kërkohet medikamenti me emër tregtar, procedurat e prokurimit të kryhen me emër principi aktiv.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Dokumentacioni mbështetës

- Shkresa Nr.131 Prot dt.9/10/2023; U.Prok nr.1 Prot., dt 10/01/202;Testim tregu dt.10/01/2024; F.oferte dt 24/01/2024; *Njoftim fituesi 26/01/202; Kontrata nr. 40 Prot dt 26/01/2024
- Shkresa nr. 160 Prot dt 08.05.2024 procesverbal i posaçëm dt 08.05.2024.

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar**.

Rekomandimi 10.1: Në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, Komisioni i blerjeve me vlera të vogla të marrë masa që në procedurë të blerjeve të vogla në ftesën për ofertë të mos vendosë fondin limit të procedurës.

Për medikamentet e rimbursueshme të ndiqet procedura për përfitimin e rimbursimit, si dhe të gjitha fletëdaljet të plotësohen saktë me të gjithë informacionin e kërkuar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Sipas komenteve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i audituar, rezultoi se subjekti vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerëson mundësinë e realizimit të tij në vazhdimësi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 11.1: Shtëpia e të Moshuarve Tiranë, komisioni i blerjeve me vlera të vogla të marrë masa që:

- Në çdo rast përllogaritja e fondit limit të pasqyrohet me procesverbal të veçantë se si është përllogaritur ai.
- Të mos shpallë fitues operatorë ekonomik në mungesë të plotësimit të dokumentacionit ligjorë të kërkuar nga AK.
- Në çdo rast të kryhet inventarizimi i medikamenteve.

Nga verifikimi u konstatua se: SHM Tirane: Sipas komenteve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i audituar, rezultoi se subjekti vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerëson mundësinë e realizimit të tij në vazhdimësi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **proces zbatimi**.

Rekomandimi 12.1: Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër të ngrihet një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe mbi këtë bazë të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore dhe të aplikohet për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të institucionit në ASHK.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se:Subjektet e audituar nuk kanë përfunduar procesin e certifikimit të sipërfaqes truall. Sipas komenteve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i audituar, rezultoi se subjekti vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe

vlerëson mundësinë e realizimit të tij në vazhdimësi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 12.2: Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër të merren masa për përlllogaritjen e vlerave nga ekspertët e fushës dhe më pas Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të ndërmarrë veprimet e nevojshme të regjistrimit të pasurisë në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Sipas komenteve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i audituar, rezultoi se subjekti i audituar SHMSH nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme të regjistrimit të pasurisë në kontabilitet, duke e vlerësuar statusin e rekomandimit pa zbatuar.

Ndërsa SHMT me *Shkresat me nr. 93.prot dt.15/6/2023; Shkresa me nr. 95 Prot, dt.23/6/2023; Shkresa nr.111 Prot dt. 7.08/2023* ka ndermarre veprime për zbatimin e rekomandimit duke vlerësuar mundësinë e realizimit të tij në vazhdimësi, dhe vlerësuar statusin e rekomandimit në proces zbatimi.Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 13.1: Shtëpia e të Moshuarve Tiranë të bëjë sistemimin dhe pasqyrimin e saktë në pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto” dhe për aktivet e nxjerra jashtë përdorimi të bëhet sqarimi për këto aktive nëse është vlerë e mbetur apo vlerë bruto në pasqyrimin e bilancit për vitin 2023.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar**.

Rekomandimi 14.1: Nga Shtëpia e të Moshuarve Tiranë të bëhet sistemimi dhe pasqyrimi i saktë në pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto” dhe për aktivet e nxjerra jashtë përdorimi të bëhet sqarimi për këto aktive nëse është vlerë e mbetur apo vlerë bruto në pasqyrimin e bilancit për vitin (2023).

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar**.

Rekomandimi 14.2: Nga Shtëpia e të Moshuarve Tiranë të bëhet sistemimi dhe përlllogaritja e saktë e amortizimit vjetor për aktivet në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në pasqyrimin e bilancit për vitin 2023.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Nga verifikimi u konstatua se:Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar plotësisht**.

Rekomandimi 15.1: Titullari i institucionit në Shtëpinë e të Moshuarve Tirane dhe Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër në cilësinë e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim më përgjegjësën e Sektorit të Administratës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, në vazhdimësi të marrë masa që në çdo urdhër për ngritjen e komisionit/ve të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjet jashtë përdorimi të aktiveve, të kërkojë dhe zbatojë me përpikëri procedurën e parashikuar në

Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, duke eliminuar problematiken e hasur gjatë këtij auditimi të konstatimit të mungesës së urdhrit për ngritje komisioni, mungese e deklaratës së shmangies së konfliktit të interesit, mungesës së mbajtjes së proces verbalit, të shmangies së të njëjtëve anëtar komisioni për dy vite resht, mungesë firmosje nga personat e ngarkuar me përgjegjësi materiale, mungesës së relacionit për titullarin etj.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar**.

Rekomandimi 16.1: Nëpunësi zbatues për Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, të marrë masa të menjëhershme për krijimin e regjistrit të aktiveve duke përcaktuar edhe personat përgjegjës të materialeve. Grupi i inventarizimit duhet të kryej inventarizimin e aktiveve të cilat janë në ngarkim të personave përgjegjës, në prani të tyre si dhe të hartojë proces-verbalin përkatës. Titullari i institucionit të marrë masa që gupi punës për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të përbëhet nga 5 anëtarë.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Lidhur me rekomandimin 16.1 sqarojmë se regjistri i aktiveve nuk ishte në formën e kërkuar nga Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Rregjisitri i mbajtur prej jush nuk mund të konsiderohet regjistër aktivesh, pasi ai nuk përmban të dhëna të plota si data e hyrjes së aktiveve, amortizimi i akumuluar, amortizimi vjetor dhe vlera e mbetur për çdo aktiv. Këto të dhëna duhet të jenë përditësuara prej jush, duke i grupuar sipas normës së amortizimit dhe të paraqesin një evidencë të plotë dhe të saktë të aktiveve, si pjesë e procesit për menaxhimin e pasurive të paluajtshme.

Mungesa e regjistrit të aktive konform kërkesave të Udhëzimit nr. 30/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, përbën shkak që zbatimi i rekomandimit të konsiderohet në proces zbatimi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 17.1: Nëpunësi zbatues të marrë masa ku në zbatim të urdhrit të Titullarit, në rolin e përgjegjës për monitorimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit të kryej çdo fund viti, inventarin edhe të gjendjes sasiore dhe cilësore të artikujve të institucionit si dhe kuzhinës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar**.

Rekomandimi 18.1: Autoriteti Kontraktor gjatë zbatimit të kontratës duhet të mbajë në konsideratë jo vetëm hartimin e kriterit për kualifikim mbi paraqitjen e certifikatës/ve që vërtetojnë kërkesat e cilësisë gjatë procesit të vlerësimit të ofertave të paraqitura në një procedurë prokurimi, por duhet të ndjekë me rigorozitet plotësimin e tyre nëpërmjet dokumenteve vërtetues mbi plotësimin e kërkesave të cilësisë sipas dokumentacionit të prokurimit, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe kriteret e kualifikimit të OE.

Këto dokumente duhet të evidentohen në proces verbalin e pranimi të mallit dhe të bëhen pjesë e dosjes së zbatimit të kontratës. Proces verbalit të hartohet në tre kopje, njëra prej të cilave të bëhet pjesë e dosjes.

Në vijimësi.

Nga verifikimi u konstatua se: Sipas komenteve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i audituar, rezultoi se subjekti vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerëson mundësinë e realizimit të tij në vazhdimësi.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 19.1: Nëpunës zbatues i Shtëpia e të Moshuarve Shkodër si përgjegjës për ndjekjen e kontratës, të marri masa të menjëhershme, ku në zbatim të pikën 2/b të nenit 6 të të gjitha kontratave të lidhura me OE “M.C .C”, ky i fundit të kryej furnizimet e ushqimeve sipas grafikut të lëvrimit, për të siguruar cilësinë e tyre si dhe ti paraqesin në proces verbalet pjesore për të lënë gjurmë për sasinë, cilësinë dhe shpeshhtësinë e furnizimit.

Në vijimësi.

Nga verifikimi u konstatua se: Sipas komenteve dhe dokumentacionit të paraqitur nga SHMSH, rezultoi se subjekti vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerësuar mundësinë e realizimit të tij në vazhdimësi, duke hartuar në 6-mujorin e parë të vitit 2024 grafikun e levrimit të mallit për furnizimet me ushqime. Por grupi auditimit nuk ka informacionin e plotë mbi zbatimin e grafikut të levrimit të mallit për kontratat e lidhura me me OE “M.C.C”.Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 20.1: Përgjegjësja e Sektorit të Administratës në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, të marrë masa të menjëhershme për ndjekjen zbatimin e kuotës ushqimore ditore në fuqi të çdo përfituesi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Sipas komenteve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i audituar, rezultoi se subjekti vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerëson mundësinë e realizimit të tij në vazhdimësi.Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 21.1: Nëpunësi Zbatues në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër në cilësinë e personit përgjegjës që kontrollon të gjitha veprimet që bëhen në magazinë, në lidhje me hyrjet dhe daljet nga magazina të marri të masa të menjëhershme që flete daljet e magazinës të plotësohet konformë ligjit dhe elementeve të dokumentacionit duke mos lejuar shënime dhe korrigjime mbi dokument.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Sipas komenteve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i audituar, rezultoi se subjekti vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit duke vlerësuar mundësinë e realizimit të tij në vazhdimësi. Fletë daljet e paraqitura nga subjekti i audituar nuk përmbanin korrigjime apo shënime mbi dokument. Auditimi i verifikimit të plotësimi elementeve të dokumentacionit flete- hyrje, flete -dalje në përputhje me standardet e kërkuara nga ligji për mbajtjen e tyre, nuk mund të verifikohet gjatë këtij auditimit, për shkak të volumit të konsiderueshem të tyre. Pra grupi auditimit bazuar në dokumentacionin e paraqitur nuk mund të shprehet për realizimin e plotë të rekomandimit, dhe vlerësoi statusin e tij aktual të tij në proces zbatimi.Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 22.1: Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër të marrin masa për të plotësuar nevojat minimale të kujdesit personal për të moshuarit rezident si dhe të sigurojnë vendosjen e sinjaleve për thirrje urgjence në të gjitha shërbimet higjienike

si dhe për çdo krevat në mënyrë që shërbimi ndaj tyre të jetë sa më efikas, eficient dhe i sigurtë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Sipas komenteve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i audituar, rezultoi se subjekti vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerëson mundësinë e realizimit të tij në vazhdimësi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

Rekomandimi 1.1: Shërbimin Social Shtetëror të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet dhe të dalin përgjegjësitë, në lidhje prokurimet e kryera nga Institucioni për mbivendosjen e kontratave për shërbimin “*Furnizim me ushqim*” në vlerën totale **1,891,176 lekë**, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore dhe shmangien e risqeve financiare për Buxhetin të Shtetit.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Subjekti i audituar nuk vuri në dispozicion të grupit të auditimit asnjë dokumentacion që të mund të shqyrtohet për të vlerësuar statusin e zbatimit të rekomandimit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Rekomandimi 1.2: Titullari i institucioni në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues të marrë masa të menjëhershme për të respektuar të gjitha kushtet e parashkruara në Marrëveshjen Kuadër, ku një prej tyre është edhe afati i zbatimit të kontratës, për të shmangur mbivendosjet e kontratave, apo prokurimet e pajustificuara dhe argumentuara të zhvilluara nga AK për të shmangur shpenzimet pa efikasitet, eficiencë dhe efektivitet për Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Sipas komenteve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i audituar, rezultoi se subjekti vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerëson mundësinë e realizimit të tij në vazhdimësi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

D. MASA DISIPLINORE

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në shkronjat (b) dhe (c) të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenit 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë” dhe të kontratës individuale, i **rekomandon** Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror të vlerësojë shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2022, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga puna**”, për **28 (njëzetetë)** punonjësit, si më poshtë:

I. Në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë:

Nr.	Emer/Mbiemer	Masa	Statusi	Shënime
1	A.P	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
2	E. T	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
3	A. H	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
4	Xh. K	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
5	B.K	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	

6	J.P	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
7	Z. H	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
8	G. M	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
9	L. D	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
10	L. I	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
11	K. Z	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
12	Z.A	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
13	L.J	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	

Nga verifikimi u konstatua se: Sipas komenteve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i audituar, rezultoi se subjekti vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerëson mundësinë e realizimit të tij në vazhdimësi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**

Në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër

Nr.	Emer/Mbiemer	Masa	Statusi	Shënime
1	F. H	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
2	A. R	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
3	M. R	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
4	Xh U	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
5	A. U	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
6	A. B	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
7	S.Z	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
8	T. Sh	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
9	D. M	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
10	O. L	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
11	A.U	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
12	S. B	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
13	S.D	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
14	M. H	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	
15	N. U	Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”	Proces zbatimi	

Observacion i ardhur nga Shërbimi Social Shtetëror me shkresën nr. 5113/2 Prot., datë 26.07.2024 protokolluar me tonën nr. 880/7 Prot., datë 26.07.2024 dhe shkresën nr. 5113/3 prot, datë 30.07.2024 protokolluar në KLSH me nr. 880/12 Prot, datë 02.08.2024

1. Për masa për përmirësim ligjor rekomandimin 1.1 sqarohet se akordimi i fondeve ne PBA për vitin pasardhës për institucionet e vartësisë ka ardhur në rritje. PBA do të dërgohet për miratim në fund të muajit Korrik 20224 dhe institucionet e vartësisë do të marrin parasysh në parashikimin buxhetor indeksimin e kuotës vjetore.

2. Për masa për përmirësim ligjor rekomandimin 3.1 sqarohet se MSHMS ka nxjerre Udhëzimin nr. 168, datë 29.03.2024 “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqërore për të moshuar në Qendrat Rezidenciale dhe Manuali i Zbatimit”, protokolluar pranë SHSSH me nr. 2448 prot, datë 02.04.2024.

3. Për masa për përmirësim ligjor rekomandimin 4.1 sqarohet se rekomandimi i adresohet MSHMS. Ne ligjin nr. 135/2018 “Për miratimin e statusit të Shërbimit Social Shtetëror”, i ndryshuar, përcaktohet se SHSSH ka si mision zbatimin e politikave të MSHMS.

4. SHSSH me shkresën nr. 5113/3 prot dt 30.07.2024, protokolluar ne KLSH me nr 880/12 Prot, datë 02.08.2024, ka plotësuar me dokumentacion observacionin ardhur me shkresë nr.5113/2 dt 26.07.2024 duke bashkëngjitur :

- Shtojcën 1/A “Pasqyrat shitesë për Buxhetin Vjetor”, dërguar me shkresë nr. 102 prot, datë 18.07.2024;

- Udhëzimin nr. 168, datë 29.03.2024 “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit”

Qëndrimi i Grupit të Auditimit

1. Lidhur me rekomandimin 1.1, sqarojmë se parashikimi buxhetor në PBA 2025-2027 në institucionet e vartësisë është parashikuar sipas kuotës ushqimore të pa indeksuar, arsye për të cilën pretendimi juaj nuk pranohet. Paraqitja e Shtojcës I/A “Pasqyrat shtese për buxhetin vjetor 2024-2026”, nuk jep të dhëna mbi parashikim buxhetor me kotën e indeksuar, arsye për të cilën pretendimi juaj nuk pranohet.

2. Lidhur me rekomandimin 3.1, sqarojmë se bashkëlidhur observacionit nr. 5113/3, date 30.07.2024 keni vendosur shkresën e miratimit Udhëzimit nr. 168, datë 29.03.2024 “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqërore për të moshuar në Qendrat Rezidenciale dhe Manuali i Zbatimit” nga Ministër e MSHMS. (1 flete).

Ne të dy shkresat e ardhura prej jush (5113/2 dhe 5113/3) ne asnjë rast prej jush nuk argumentohet nëse standardet e miratuara të përkujdesit shoqëror për të moshuar kanë përputhshmëri me rekomandimin nr. 3.1. Sa më sipër në këtë fazë auditimi në mungese të shpjegimeve tuaja, grupi i auditimit e ka të pamundur të vlerësojë ecurinë e zbatimit të këtij rekomandimi, arsye për të cilën observacioni juaj nuk pranohet.

3. Lidhur me rekomandimin 4.1, institucioni juaj në zbatim të nenit 52 të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH” ka detyrim ligjor që “Brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha qendrat rezidenciale dhe ofrimi i shërbimeve rezidenciale u transferohen njësisë të qeverisjes vendore”. Mosveprimi për transferimin e qendrave rezidenciale në njësitë e qeverisjes vendore bie ndesh me kërkesat e nenit 52 të ligjit 121/2016, si dhe përgjegjësitë dhe funksionet e shërbimit Social Shtetëror përcaktuar në Piken II, germa “dh” të VKM nr. 135, datë 03.07.2018 “Për Miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, i ndryshuar sipas së cilës Shërbimi Social Shtetëror ... “Siguron zbatueshmërinë e politikave dhe të legjislacionit që rregullojnë veprimtarinë në fushën e ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të kujdesit shëndetësor në të gjitha nivelet”. Njëkohësisht në pikën 3.3 germa “a” VKM nr. 135/2018 i përcaktohet se SHSSH i propozon ministrisë standardet, protokollet për menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe ndryshimet në to, si dhe në pikën 3.3 germa “l” përcaktohet si përgjegjësi ushtrimi i çdo kompetence tjetër specifike sipas legjislacionit për shërbimet e kujdesit shoqëror. Sa më sipër nga institucioni juaj si nivel qendror nuk u paraqit ndërveprim me MSHMS ose institucione të tjera të kompetencës, lidhur transferimin qendrave rezidenciale në njësitë e qeverisjes vendore, arsye për të cilën pretendimi juaj nuk pranohet.

Nga verifikimi u konstatua se: Sipas komenteve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i audituar, rezultoi se subjekti vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerëson mundësinë e realizimit të tij në vazhdimësi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Në përfundim të procesit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, rezulton se nga **59** rekomandime të lëna, nga Subjekti **DPSHSSH** janë pranuar të **59** rekomandimet, nga të cilat: janë zbatuar **7- masa ose 11.9 % e tyre; 0- masa pjesërisht zbatuar; 48-masa janë në proces zbatimi si dhe 4- masa janë pa zbatuar, pra 4- masa mbeten për tu zbatuar nga subjekti DPSHSSH**, për periudhën në vijim. Grupi i auditimit duke analizuar Rekomandimet e pranuar dhe të zbatuara nga **DPSHSSH**, (njësitë përgjegjëse të saj) apo dhe ato në proces zbatimi, arriti në konkluzionin që: - Për kategorinë "Masa Organizative"- Rekomandimet R 1.1; R 1.3; R 6.1; R 7.1; R 8.1; R 9.1; R 9.2; R 14.; R 16.1; R 17.1; R 17.2; R 18.1; R 19.2; R 20.1; R 24.1; R 25.2; R 26.1; R 27.1; R 28.1; R 29.1; R 30.1; R 33.1; R 33.2; R 34.1; R 34.2; R 36.1; R 37.1; R 38.1; R 40.1; R 44.3; R 45.1; R 47.1; R 48.1; R 50.2; R 52.1; R 54.1; R 55.1; R 58.1; R 59.1; -

Kategorinë "Masa shpërblim dëmi", R 6.1; R 20.1; "Masa disiplinore ", për 54 punonjës dhe "Njoftim në APP", janë pranuar dhe zbatuar apo në proces zbatimi nga **DPSHSSH**, prandaj nuk mund të qëndrojnë për periudhën në vijim.

IV.GJETJET DHE REKOMANDIMET

*Për përmisimin e gjëndjes **Rikërkojmë që**, Shërbimi Social Shtetëror/Shtëpia e të Moshuarve Shkodër/ Shtëpia e të Moshuarve Tiranë të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara si dhe pjesërisht zbatuar brenda 3-mujorit të parë të vitit 2025.*

Si dhe marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH-së të pranuar prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

Rekomandimi 3.1: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa për nxjerrjen e akteve nënligjore për miratimin e standardeve për ofrimin e shërbimit të kujdesit shoqëror për të moshuar, për nxjerrjen e akteve nënligjore për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave dhe nivelit të tyre, për nxjerrjen e akteve nënligjore mbi mekanizmat e financimit për dhurimet, sponsorizimet, donacionet dhe financime të tjera nga organizata, persona fizikë ose juridikë

B. MASAT ORGANIZATIVE:

Rekomandimi 1.1: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrin masa të parashikimit të fondeve buxhetore edhe si efekt i indeksimin vjetor të kuotave të shpenzimeve personale dhe shpenzimeve ditore të ushqyerjes së të moshuarve në përputhje me VKM nr. 518, datë 04.09.2018 *"Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar"*, duke siguruar jetesë të qete dhe me dinjitet në të përditshmen e tyre.

Rekomandimi 4.1: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në rolin dhe përgjegjësinë e organit publik të ngarkuar me ligj për hartimin e dokumenteve dhe politikave të reformimit e modernizimit të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe si institucion përgjegjës për organizimin dhe administrimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të marrë masat e nevojshme që në të gjitha qendrat rezidenciale ofrimi i shërbimeve rezidenciale të transferohet njësisë të qeverisjes vendore, në përputhje me kërkesat dhe standardet e ofrimit të shërbimeve.

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:

Rekomandimi 1.1: Shërbimin Social Shtetëror të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet dhe të dalin përgjegjësitë, në lidhje prokurimet e kryera nga Institucioni për mbivendosjen e kontratave për shërbimin *"Furnizim me ushqim"* në vlerën totale **1,891,176 lekë**, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore dhe shmangien e risqeve financiare për Buxhetin të Shtetit.

4 . ANEKSE

ANEKSI 1: EVIDENCA PËR NDRYSHIMET LIGJORE DHE MASAT ORGANIZATIVE

Formulari nr.1

Subjekti	Respekimi afatit		Ndryshime e përmirësime ligjore								Masa organizative					
			Nga këto		Nga rekomandimet e pranuara						Nga këto		Nga rekomandimet e pranuara			
	20 ditë	6 muaj	Gjithësej	Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar	Gjithësej	Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë	PO	JO	1	1	0	1	0	0	0	34	34	0	20	5	3	6
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	JO	PO	4	4	0	1	0	1	2	47	47	0	9	6	11	21
Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	PO	JO	0	0	0	0	0	0	0	36	35	1	1	1	22	11
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	PO	JO	0	0	0	0	0	0	0	45	44	1	7	3	14	20
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	PO	PO	0	0	0	0	0	0	0	31	30	1	12	6	8	4
Ministria e Drejtësisë	PO	PO	0	0	0	0	0	0	0	20	20	0	10	0	6	4
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"	PO	PO	0	0	0	0	0	0	0	85	85	0	18	8	22	37
DPSHSH/Tirane Shkoder	JO	JO	4	4	0	0	0	3	1	25	25	0	7	0	16	2
Totali			9	9	0	2	0	4	3	323	320	3	84	29	102	105

ANEKSI 2: EVIDENCA PËR MASAT SHPËRBLIM DËMI

Formulari nr.2

Masa për shpërbllim dëmi në mijë lekë														
Subjekti	Gjithsej		Nga këto				Nga rekomandimet e pranuara							
			Pranuara		Pa pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1	155.696	1	155.696	0	0	1	155.696	0	0	0	0	0	0
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	3	756	3	756	0	0	0	0	1	346	0	0	2	410
Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	2	1.032	2	1.032	0	0	0	0	0	0	2	1.032	0	0
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1	264	1	264	0	0	1	264	0	0	0	0	0	0
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	3	7.590	3	7.590	0	0	2	6.634	0	0	1	956	0	0
Ministria e Drejtësisë	1	848	1	848	0	0	0	0	0	0	1	848	0	0
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"	8	112.289	8	112.289	0	0	0	0	4	66.302	1	21.886	3	24.101
DPSHSH/Tirane Shkoder	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	19	278.475	19	278.475	0	0	4	162.594	5	66.648	5	24.722	5	24.511

ANEKSI 3: EVIDENCA PËR MASAT PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE FINANCIARE NEGATIVE

Formulari nr.3

Masa për eliminimin e efekteve financiare negative në mijë lekë														
Subjekti	Gjithsej		Nga këto				Nga rekomandimet e pranuara							
			Pranuara		Pa pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	2	76.902	2	76.902	0	0	1	44.498	0	0	0	0	1	32.404
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	12	33.930	12	33.930	0	0	0	0	0	0	10	27.567	2	6.363
Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	1	38.935	1	38.935	0	0	0	0	0	0	0	0	1	38.935
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	2	36.067	2	36.067	0	0	1	27.921	0	0	1	8.146	0	0
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	2	68.379	2	68.379	0	0	0	0	0	0	2	68.379	0	0
Ministria e Drejtësisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"	3	113.393	3	113.393	0	0	0	0	0	0	0	0	3	113.393
DPSHSH/Tirane Shkoder	2	1.891	2	1.891	0	0	0	0	0	0	1	0	1	1.891
Totali	24	369.497	24	369.497	0	0	2	72.419	0	0	14	104.092	8	192.986

ANEKSI 4: SHKALLA E PRANUESHMËRISË DHE ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE SIPAS LLOJIT TË MASËS PËR SECILIN SUBJEKT TË AUDITUAR

Nr.	Subjektet dhe lloji i masave	Gjithsej	Nga këto		Nga rekomandimet e pranuar			
			Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
	Totali	497	494	3	170	37	154	133
	<i>Përmirësime për ndryshime ligjore</i>	9	9	0	2	0	4	3
	<i>Masa organizative</i>	323	320	3	84	29	102	105
	<i>Masa Administrative</i>	2	2	0	2	0	0	0
	<i>Masa për shpërblim dëmi</i>	19	19	0	4	5	5	5
	<i>Masa për eliminimin e efekteve financiare negative</i>	24	24	0	2	0	14	8
	<i>Te ardhura te munguara</i>	2	2	0	0	2	0	0
	<i>Njoftim APP</i>	3	3	0	3	0	0	0
	<i>Masa disiplinore</i>	111	111	0	69	1	29	12
	<i>Njoftim DAP/KMSHC</i>	4	4	0	4	0	0	0
1	MIE	39	39	0	23	5	4	7
	<i>Përmirësime për ndryshime ligjore</i>	1	1	0	1	0	0	0
	<i>Masa organizative</i>	34	34	0	20	5	3	6
	<i>Masa Administrative</i>	0	0	0	0	0	0	0
	<i>Masa për shpërblim dëmi</i>	1	1	0	1	0	0	0
	<i>Masa për eliminimin e efekteve financiare negative</i>	2	2	0	1	0	0	1
	<i>Masa disiplinore</i>	1	1	0	0	0	1	0
2	MEPJ	78	78	0	10	7	22	39
	<i>Përmirësime për ndryshime ligjore</i>	4	4	0	1	0	1	2
	<i>Masa organizative</i>	47	47	0	9	6	11	21
	<i>Masa Administrative</i>	0	0	0	0	0	0	0
	<i>Masa për shpërblim dëmi</i>	3	3	0	0	1	0	2
	<i>Masa për eliminimin e efekteve financiare negative</i>	12	12	0	0	0	10	2
	<i>Masa disiplinore</i>	12	12	0	0	0	0	12
3	MSHMS	57	56	1	19	1	24	12
	<i>Masa organizative</i>	36	35	1	1	1	22	11
	<i>Masa Administrative</i>	2	2	0	2	0	0	0
	<i>Masa për shpërblim dëmi</i>	2	2	0	0	0	2	0
	<i>Masa për eliminimin e efekteve financiare negative</i>	1	1	0	0	0	0	1
	<i>Masa disiplinore</i>	14	14	0	14	0	0	0
	<i>Njoftim DAP/KMSHC</i>	2	2	0	2	0	0	0

4	MTM	51	50	1	12	3	15	20
	Masa organizative	45	44	1	7	3	14	20
	Masa Administrative	0	0	0	0	0	0	0
	Masa për shpërbllim dëmi	1	1	0	1	0	0	0
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	2	2	0	1	0	1	0
	Njoftim DAP/KMSHC	2	2	0	2	0	0	0
	Masa disiplinore	1	1	0	1	0	0	0
5	MBZHR	39	38	1	14	9	11	4
	Masa organizative	31	30	1	12	6	8	4
	Masa Administrative	0	0	0	0	0	0	0
	Masa për shpërbllim dëmi	3	3	0	2	0	1	0
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	2	2	0	0	0	2	0
	Te ardhura te munguara	2	2	0	0	2	0	0
	Masa disiplinore	1	1	0	0	1	0	0
6	MD	21	21	0	10	0	7	4
	Masa organizative	20	20	0	10	0	6	4
	Masa për shpërbllim dëmi	1	1	0	0	0	1	0
7	QSUNT	153	153	0	75	12	23	43
	Përmirësime për ndryshime ligjore	0	0	0	0	0	0	0
	Masa organizative	85	85	0	18	8	22	37
	Masa Administrative	0	0	0	0	0	0	0
	Masa për shpërbllim dëmi	8	8	0	0	4	1	3
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	3	3	0	0	0	0	3
	Njoftim APP	3	3	0	3	0	0	0
	Masa disiplinore	54	54	0	54	0	0	0
8	DPSHSSH/Tirane Shkodër	59	59	0	7	0	48	4
	Përmirësime për ndryshime ligjore	4	4	0	0	0	3	1
	Masa organizative	25	25	0	7	0	16	2
	Masa Administrative	0	0	0	0	0	0	0
	Masa për shpërbllim dëmi	0	0	0	0	0	0	0
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	2	2	0	0	0	1	1
	Masa disiplinore	28	28	0	0	0	28	0

ANEKSI 5: EVIDENCA PËR MASAT DISIPLINORE DHE ADMINISTRATIVE

Formulari nr.5

Subjekti		Masa Disiplinore							Masa Administrative/ APP / DAP/ KMSHC					
	Gjithsej	Nga këto		Nga rekomandimet e pranuara				Gjithsej	Nga këto		Nga rekomandimet e pranuara			
		Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar		Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	12	12	0	0	0	0	12	0	0	0	0	0	0	0
Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	14	14	0	14	0	0	0	4	4	0	4	0	0	0
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1	1	0	1	0	0	0	2	2	0	2	0	0	0
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Ministria e Drejtësisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”	54	54	0	54	0	0	0	3	3	0	3	0	0	0
DPHSHH/Tiranë Shlodër	28	28	0	0	0	28	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	111	111	0	69	0	29	12	9	9	0	9	0	0	0

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT